

SAHÎHU-L-BUHÂRI  
NË GJUHËN SHOÏPE

6

PRISHTINË  
2002

**SAHÎHU-L-BUHÂRI**  
**NË GJUHËN SHQIPE**

**Libri 6.**  
**3949-4473**  
**HADITHE**

**Prishtinë**  
**2002**

# **SAHÎHU-L-BUHÂRI në gjuhën shqipe-libri 6**

**Përktheu:  
Bahri Aliu**

**Përkthyesi rezervon të drejtën  
e shumëzimit dhe të ribotimit**

**Redaktor profesional:  
Mr. Ruzhdi ef.Lata**

**Redaktor gjuhësor:  
Qeram Lleshi**

**Realizimi kompjuterik:  
Faruk Aliu**

***“ . . .Çdo gjë që ju vjen nga unë, krahasojeni me Kur’anin,  
dhe ajo që është në pajtim me të është thënë nga unë, e  
çkado që nuk pajtohet me të nuk është nga unë”.***

***Muhammedi a.s.***



*Atyre që kanë etje për t'i njohur  
burimisht traditën dhe themelet e Fesë  
Islame  
Përkthyesi*



---

---

**Kreu 37.**  
**Puna me mëditje**

---

**PUNA ME MEDITJE E NJERIUT TË MIRË  
DHE FJALËT E ALL-LLAHUT XH.SH.:**

**“Eshte më i miri prej atyre qe ka pas marrë në shërbim,  
i fortë, i besueshëm”<sup>1</sup>**

Për arkëtarin e besueshëm dhe për atë që nuk merrte në punë njeriun që e dëshironte

2260. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf, këtij i ka transmetuar Sufjani nga Ebi Burde i cili ka thënë:

Më ka kumtuar gjyshi im Ebu Burde, që përcjell nga babai i vet Ebu Musa El-Eshariu r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

Arkëtari i besueshëm që me vullnet e kryen atë çka i urdhërohet, është bëmires, sikur ai që jep sadaka.

2261. Museddedi na ka treguar se Jahja i ka transmetuar nga Kurrat b. Halid, i cili i thotë:

Më ka kamtuar Humejd b Hilal, atij Ebu Burde nga Ebu Musa, i cili thotë: Shkova te Pejamberi s.a.v.s. me dy vetë nga fisi El-Esh'ar dhe i thashë”

**- A e di se ata dy kerkojnë punë?**

**- Nuk do t'iu japim punë, gjegjësisht nuk i punësojmë -  
tha ai - te na ata qe e dëshirojnë atë punë. (Krahaso: 3038,  
4341, 3443, 6124, 6923, 7149, 7756)**

**RUAJTJA E BAGËTIVE NË KARARIT**

2662. - Na ka treguar Ahmed b Muhammed Al-MeEki se Amr b Jahia i transmetoi nga gjyshi i vet, ky nga Ebu Hurejre r.a se Pejgamberi s.av.s. ka thënë:

**- All-llahu nuk ka dërguar asnjë pejgamber, i cili më parë nuk i ka ruajtur bagëtitë.**

---

<sup>1</sup>. Kur'an, 98:26.

---

Shokët e tij pastaj e pyetën: **“Po ti?”**

- **Po, i kam kullotur, ruajtur, bagëtitë e mekkasve në Kararit u përgjigj ai.<sup>2</sup>**

### **PUNESIMI I POLITEISTIT ME MEDITJE, NE RAST NEVOJE DHE KUR NUK KA MUSLIMAN**

Pejgamberi s.a.v.s. i merrte në punë hebrenjtë e Hejberit.<sup>3</sup>

2263 - Më ka treguar Ibrahim b. Musa, i cili transmeton nga Hishami, ai nga Ma'meri, ky nga Zuhriu të cilit Urve b. Zubejri i transmeton se Aisheja r.a. ka thënë:

- **Pejgamberi s.a.v.s. dhe Ebu Bekri e morën me mëditje një njeri nga fisi Benu Dil, degë e fisit Benu Abd b. Adijj, si ciceron i aftë. Ai u betua në fisin As b. Vail dhe i përkiste besimit të kufarëve kurejshit. Ata i besuan, ia dorëzuan dy devet e tyre për shalim dhe u morën vesh të gjenden pas tri ditësh te shpella Thevr. Ai i solli devet në mëngjesin e ditës së tretë dhe këta hipën. Bashkë me këta u nis edhe Amr b. Fuhejr dhe ciceroni i përmendur Dilij, dhe u priu atyre bregut detit.<sup>4</sup>**

### **MARRJA E PUNËTORIT ME MEDITJE, TE KRYEJE PUNE PAS TRI DITËSH, PAS NJË MUAJI OSE PAS NJË VITI, I EJOHET DHE KUSHTET E VENA VLEJNË DERI KUR TË KALOJË AFATT T KONTRAKTUAR**

---

<sup>2</sup> Muhammedi a.s. kur ishte si femië, kulloste bagëtitë në Xhijad dhe Kararit, kullosat e mekasve. Jeta baritore e stërvit nejrion që më vonë t'u bëjë rezistencë dhe t'i përballoje më lehtë peripetitë jetësore, të jetë modest dhe të Kujdeset për çdo anëtar të bashkësisë së vet.

<sup>3</sup> Pas pushtimit të Hajberit shumë hebrenj u ndalën aty që si ekspertë të punojnë tokën dhe të kultivojnë tokën pemishtet dhe, njëkohësisht, t'i aftësojnë për këto punë arabët që pranonin fenë islame.

<sup>4</sup> Ciceroni, udhëhëqësi, i Muhammedit a.s. që i priu nga Thevr deri në Medinë quhej Abdullah b. Erikat.

---

2264. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr se i ka transmetuar Lejthi nga Ulajli se Ibn Shihabi ka thënë: Më ka transmetuar Urve b. Zubejr se Aisheja r.a, bashkëshortja e Pejgamberit s.a.v.s., ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. dhe Ebu Bekri morën me mëditje një njeri nga fisi Benu Dil, si ciceron të aftë, dhe ai ishte në besimin e kufarëve kurejshit. Ata ia dorëzuan devet e tyre të shalës dhe u morën vesh me te të gjinden te shpella Thevr pas tri netësh, pikërisht në mëngjesin e tretë. (Krahaso: 3038, 4341, 4343, 4124, 4923, 7149).

### **ANGAZHIMI ME MËDITJE NË EKSPEDITË LUFTARAKE**

2265. - Më ka treguar Jakub b. Ibrahim, këtij Ismail b. Ulejje, të cilit i transmetoi Ibn Xhurejxh, i cili thotë se i ka kumtuar A'ta nga Sufian Sefvan b. Ja'la, ky nga Ja'la b. Umejja r.a.

**- Kam qenë bashkë me Pejgamberin s.a.v.s. në betejën e rëndë (në Tebuk) dhe këtë e konsideroj, sigurisht, një nga veprat e mia më të vlefshme, por kisha edhe një luftëtar me mëditje. Ai u zu me një nejrri të cilit ia kafshoi gishtin, ndërsa tjetri e tërhoqi gishtin dhe ia nxori dhëmbët e parë, të cilët i ranë përtokë. Ai pastaj, shkoi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e pyeti për këtë, e ky iu përgjigj: A ti do ta lërë gishtin e vet në gojën tënde ta kafshosh? Mandej, thotë Ja'la, se i ka thënë: "Sikur mazi që kafshon"**

2266. - Ibn Xhurejxh thotë:

Më ka transmetuar Abdullah b. Ibi Mulejke nga gjyshi i vet version të njejtë, se njëri ia kafshoi dorën një tjetrit dhe ai ia shkuli dhëmbët, kurse Ebu Bekri nuk e përfilli këtë punë fare.

---

---

## MARRJA ME MËDITJE E PUNËTORIT NË KOHË TË CAKTUAR, PA E DEFINUAR PUNËN SI DUHET SIPAS AJETIT:

“Unë dëshiroj të të martoj me njërin nga këto dy vajzat e mia, - tha ai, - por që të më shërbesh tetë vjet; nëse i bën dhjetë, ajo është punë e vullnetit tënd, unë nuk dëshiroj të të ngarkoj për këtë. Ti do të shohësh ; Në dashtë All-llhu, se unë jam i mirë. Ajo le të jetë ndërmjet meje dhe teje, tha (Mensa), cilindo afat të plotësoj nga këta, nuk ka gjë kundër meje, ndërsa All-llahu garanton për këtë që themi ne”.

(EI-Kasas, 27-28).<sup>5</sup>

Marria me mëditje e dikujt me shpërblim do të thotë: i jep pagesën. Në këtë bënë pjesë edhe ajo, në rast ngushëllimi “Axherkell-llah”, d.m.th. “All-llahu të shpërbleftë”.

---

<sup>5</sup> Sipas permbajtjes se këtij ajeti dhe hadithit të mesipërm punetori mund të merret për kohë të caktuar për shërbime të ndryshme. Në luftë mund të; marrësh ndihmës për nevoja individuale dhe ndihmë në lufte kundër armikut. Pejgamberi Shuajb e mori Musën a. s. për 8 (tete) vjet t’i ruaje dhente, për punë bujqësie dhe punë tjera, siç është përshkruar gjerësisht në surën Kasas.

Hamalli e ka për detyrë t’i fusë në shtëpi sendet që i bart, por jo edhe t’i vendosë në vende të caktuara.

Ai që merr punëtorë me mëditje nuk e ka obligim ta ushqejë punetorin, përveçse nëse kjo është bërë traditë.

Konktratë për marrëdbënie pune mund të lidhin vetëm palët me aftësi juridike.

Objekti i marrëveshjes (për blerje) duhet të jete definuar saktë. Marrëveshja e qirasë nuk është e vlefshme nëse dikush jep me qera njërin nga dy lokalet, por pa e caktuar se cili jepet dhe duke mos lejuar që ai që e merr të zgjedhë, cilin do ta marrë.

---

**LEJOHET ANGAZHIMI I PUNËTORIT ME  
MËDITJE TË NDREQË MURIN QË ËSHTË DUKE U  
RRËZUAR**

2267. - Më ka treguar Ibrabim b. Musa se i ka kumtuar Hisham b. Jusuf, këta i ka informuar Ibn Xhurejxh, të cilit i transmetuan Ja'la b. Muslim dhe Umer b. Dinar nga Seid b. Xhubejr të cilët plotësojnë njëri-tjetrin, madje edhe të tjerë përveç këtyre dyve, duke thënë:

**- E kam dëgjuar këtë në transmetim të Seidit i cili ka thënë: Më ka thënë Ibn Abbasi r.a. se i ka transmetuar Ubej b. Ka'bi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

**“Morën rrugë dhe rrugës hasën një mûr që ishte kah rrëzohet” Seidi thotë e ka treguar me dorën e vet “kështu dhe e ngriti dorën, e pastaj e drejtoi”.**

Ja'la ka thënë: Më duket se Seidi ka shtuar edhe këtë: **“E fërkoji me dorë të vet dhe ai u drejtua”.**

Sikur të kisha dashtur kisha marrë pagë, shpërblim për këtë! Seidi thotë “Fitimin që të hamë”.<sup>6</sup>

**PUNËTOR ME MËDITJE PER GJYSME DITE**

2268. - Na ka trequar Sulejavn b. Harb se i ka transmetuar Hammadi nga Ejubi, ky nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri r.a. i cili thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Shembulli juaj dhe shembulli i pasuesve të dy librave (qiellorë) i ngjan njeriut që i merr me mëditje punëtorët**

---

<sup>6</sup> Dialogu midis Musës dhe Hëzrit që është prezantuar në ajetet 61-62 të sures Kehf, aludon për një punë të caktuar të Hëzrit. Kushtet e preçizuara me saktësi nga palët shmangin kontestet e panevojshme dhe zënkat eventuale. Punëtorit që nuk e ka përcaktuar mëditjen, puna e kryer i paguhet sipas vlerësimit, përkatësisht sipas traditës sa paguhet mëditja e një punëtori të kategorisë se tij.

---

---

dhe thotë: “Cili do të punojë prej mëngjesi deri në gjysmë të ditës për një kirat?” dhe hebrenjtë punuan. Mandej tha: “Kush do të punojë prej iqindie e deri në prarim të diellit për dy kirat? Ata jeni ju.

Hebrenjtë dhe të krishterët u emëruan për këtë dhe thanë:

- Çka u bë me ne? punë më shumë e pagë më pak!
- A ju kam hequr ndonjë send - pyeti punëdhenësi - nga ajo që ju takon?
- Jo, u përgjigjën ata.
- E po kjo është mirësia ime - tha ai - që i jap kujt të dua.

### **PUNETORI ME MEDITJE DERI NË IQINDI**

2269. - Na ka treguar Ismail b. Fbi Uvejs se i ka transmetuar Maliku nga Abdullah b. Dinar, rob i liruar i libdullah b. Umerit, ky nga Abdullah b. Umer b. Hattabi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Shembulli i juaj i hebrenjve dhe i krishtërëve i ngjan atij njeriut që mori disa punëtorë dhe u tha: “Kush do të punojë te unë deri në mesditë për një kirat?” Hebrenjtë punuan për një kirat, mandej të krishterët punuan për një kirat, e pastaj ju punuat prej kohës së iqindisë deri në prarim të dillit për dy kirat.

Hebrenjtë dhe të krishterët u zemëruan dhe nisën të flasin:

- Ne punuam më shumë kurse u paguam më pak.
- A ju kam bërë ndonjë padrejtësi në marrëveshjen që kishim? i pyeti ai.
- Jo, u përgjigjën ata.
- Kjo është mirësia ime që ia dhuroj kujt të dua - u përgjig ky.

---

---

**MËKATI ATIJ QË PENGON PAGESËN E  
PUNËTORIT**

2270. - Na ka treguar Jusuf b. Muhammed, këti; Jahja b. Sulejman i cili transmeton nga Ismail b. Umejje, ky nga Seicl b. Ebi Seid kurse ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- All-llahu xh.sh. thotë: janë tri grupe njerëzish me të cilët do të jem në kundërshtim në Ditën e Gjykimit - do të jem armik i tyre: Njeriu që betohet me emrin tim dhe nuk e zbaton, njeriu që e shet njeriun e lirë dhe ato para i ha dhe njeriu i cili merr me mëditje punëtorin, e pranon punën e tij por nuk ia paguan shpërblimin që e meriton”**

**MËDITJA E PUNËTORIT PREJ IQINDIE  
DERI NË MBRËMJE**

2271. - Na ka treguar Muhammed b. El-Ala se i ka transmetuar Eb Usame nga Burejdi, ky nga Ebu Burde, ky nga Ebu Musa r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Shembulli i muslimanit, hebrejit dhe i krishterit i ngjan njeriut që merr disa punëtorë t’i kryejnë një punë për një ditë, deri në mbrëmje, për një shumë të caktuar, e ata punojnë gjysmë ditë dhe i thonë: “Nuk ta duam pagën që na e ke caktuar, e kjo që kami punuar nuk ka rëndësi”.**

**- Mos veproni ashtu! Plotësone punën dhe merrni fitimin e plotë - u thotë punëdhënësi. Ata refuzuan dhe e lanë punën.**

Pas këtyre punëdhënësi merr punëtorë të tjerë dhe u thotë: “Plotësone, punone, këtë pjesë të ditës dhe merrni pagën që ua kam folur atyre”. këta punojnë deri në iqindi dhe thonë: “Ç’ka kemi punuar nuk ka rëndësi, kurse fitimi që na caktove për atë punë të qoftë ty”.

---

---

- Mos bëni ashtu! Kryene punën që ka mbetur, u thotë punëdhënësi, ngase ka mbetur fort pak nga kjo ditë. Ata nuk deshën ta bëjnë këtë dhe ai mori me pagesë njerëz tjerë që të punojnë atë pjesë të ditës, deri në pranim të dillit. Këta morën fitimin e plotë për të dy grupet e mëparshme. Ky është shembulli i lyre dhe shembulli që pranuan nga kjo dritë.<sup>7</sup>

**ANGAZHIMI I PUNËTORIT ME MËDITJE I CILI  
HEQ DORË NGA FITIMI DHE KJO I MBETET  
PUNËDHËNËSIT, E AI E SHTON KETË, OSE  
MANIPULON ME PASURI TË HUAJ  
DHE REALIZIMI I TËPRICËS NGA KJO**

2272. - Na ka trequar Ebu-l-Jeman se i ka transmetuar Shuajbi nga Zuhriu që thotë: Salim b. Abdullahu më ka transmetuar se Abdullah b. Umeri r.a. ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke treguar:

- **Kishin marrë rrugën tre vetë nga një popull që ka jetuar përpara jush dhe u strehuan në një shpellë. Kur hynë aty, nga kodra u shemb një gur dhe ua mbylli shpellën. Ata thanë: Nuk ka shpëtim nga kjo shpellë pa iu lutur All-llahut në emër të veprës më të mirë që kemi punuar!”**

Njëri nga ata, pastaj tha: “O Zot, i kam pasur prindërit të vjetër e të pafuqishëm dhe unë përpara atyre nuk u kam dhënë darkë as shtëpiarëve e as shërbëtorëve. Një ditë

---

<sup>7</sup>Punëtori mund të angazhohet për një punë të caktuar me afat të shkurtër ose të gjatë. Koha e hebrenjve, krishterëve dhe muslimaneve është prezantuar si shembull i periudhës në të cilën parimet fetare nuk janë ndryshuar, kurse pejgamberët e mëvonshëm i kanë plotësuar me norma tjera, në përputhje me zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Muslimani e ka detyrë të besojë të gjithë pejgamberët e All-llahut prej Ademit deri te Muhammedi a.s. Ata që besojnë vetëm disa prej tyre, e lënë detyrën ndaj Zotit xh.sh. arbitrarisht dhe heqin dorë nga shpërblimi i tyre.

---

---

shkova në punë. Kur u ktheva në mbrëmje ata i kishte zënë gjumi. Unë, megjithatë, u përgatita tambël për darkë. Pasi që i kishte zënë gjumi, unë nuk desha t'u jap darkë njerëzve të shtëpisë dhe shërbëtorëve, para se t'u jap këtyre. Mbeta me gotën në dorë duke pritur që të zgjohen aq gjatë, sa më zuri mëngjesi. Atëherë u zgjuan dhe e pinë tamblin. O Zot, nëse e kam bërë këtë për hir Tëndin, largoje nga ne këtë që na ka zënë derën". Atëherë - thotë Pejgamberi s a.v.s., ai guri lëvizi e u largua pak, por ata nuk mund të dilnin.

Ai i dyti tha "O Zot, e kam pasur një vajzë të mixhës që e kam dashur sa gjithë botën, dhe desha ta përfitoj zemrën e saj, por ajo më refuzoi. Më pastaj ate; e goditi një vit skamje dhe erdhi te unë dhe i dhashë 120 dinarë (ari), me kusht që të më dorëzohet. Kjo e bëri këtë por kur unë iu qasa ta pushtoj, ajo më tha: "Nuk të lejoj aktin e fundit pa kryer obligimin e kurores". E konsiderova mëkat të madh këtë akt dhe hoqa dorë, anipse e kam dashur më shumë se tërë botën. Arin që ia pata dhënë ia fala. O Zoti im, Nëse e kam bërë këtë për hir Tëndin, të arrij kënaqësinë tënde, hape derën tonë! Guri u dynd, tha Pejgamberi a.s. por ata nuk mund të dilnin prej asaj shpelle.

I treti tha: O Zot, unë mora me mëditje disa punëtorë dhe ua pagova fitimin - hakun - me përjashtim të njërit punëtor i cili e la fitimin që i takonte dhe shkoi. Unë e shtova fitimin e tij ashtu që nga ajo u shumua pasuria. Ai pas një kohe të gjatë erdhi dhe më tha: "O njeri i zotit, ma jep fitimin tim!" Unë i thashë: "Tëra çka i sheh: deve, lopë, dhen edhe shërbëtorë janë nga pasuria yte".

- O burrë - tha ai - mos luaj me mua!

- Unë nuk luaj me ty i thashë.

Ateherë ai i mori të gjitha dhe i vuri përpara, pa më lënë asgjë prej tyre. O Zot, nëse këtë e kam bërë për hir të kënaqësisë Tënde, hape hyrjen e shpellës ku jemi ne!"

---

---

Atëherë u hoq guri, u hap dera dhe ata dolën dhe shkuan.

## ANGAZHIMI ME MEDITJE PËR TË BARTUR BARRË NË SHPINE DHE ATE FITIM PER TA DHENE SADAKA

2273. - Na ka treguar Seld b jahja b Seid El - Kurejshi, këtij A'meshi i transmeton nga Sheiku ky nga Ebu Mes'ud El - Ensariu r.a. i cili ka thënë:

Kur urdhëronte Pejgamberi a.s. shpërndarje më të madhe të sadakës, ndonjëri prej nesh shkante në treg, bartte sende - bënte hamall-llëk, dhe fitonte ndonjë mudd<sup>8</sup>, e disa prej tyre kishin nga disa qindra mijëra. Njëri nga ata është Ebu Mes'udi.

## PAGESA E NDËRMJETËSIT NË SHITBLERJEN E SENDEVE TË CAKTUARA

Këtë pagesë nuk e kane kontestuar: Ibn Sirin,. A'ta, Ibrahim dhe Hasan (Basriu)

Ibn Abbasi ka thënë:

- Nuk ka gjë të keqe nëse dikush thotë: - shite këtë teshë dhe çka të shesësh më shumë se kaq, është e jotja!”

Ibn Sirinë thotë: **“Shite për kaq, çka të jetë më tepër është e jotja, gjegjësisht e jotja dhe e imja”**.

Pejgamberi s.a.v s. ka thënë: ‘Muslimanët, vendosmërisht, i zbatojnë kushtet.

2274. - Na ka treguar Museddedi, këtij Abdu-l-Vahidi i cili thotë se Ma'meri i ka transmetuar nga Ibn Tavusi, ky nga babai i vet, e ky nga Ibn Abbasi r.a. i cili ka thënë:

---

<sup>8</sup> Shih: Sahihu-l-Buhari në gjuhën shqipe, 4, Prishtinë, 1994, fq. 132.

---

“Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar ndërhyrjen te karvanet dhe që qytetari të shesë ndonjë send përpara fshatarit”.

I thashë: O Ibn Abbas, ç’ka do të thotë deklarata e Pejgamberit a.s.: “që qytetari të mos shesë ndonjë send para fshatarit?”

- Të mos bëhet ndërmjetes në shitjen e prodhimeve të tij, u përgjigj ai<sup>9</sup>

## **A MUND TË PUNËSOHET MUSLIMANI TE POLITEISTINE SHTETIN JOISLAM**

2275. - Na ka treguar Umer b. Hafs se babai i tij i transmeton nga A’meshi, ky nga Muslimi, kurse ai nga Mesruku se Habbabi r.a ka thënë:

**- Kam qënë farkëtar dhe punoja te As b. Vaili dhe aty u tubua fitimi im.. Unë. Shkova që të pastrojmë llogaritë me të.**

**- Jo, pasha Zotin - më tha ai - nuk do të paguaj nëse nuk mohon besimin në Muhammedin.**

---

<sup>9</sup>Në qoftë se ndërmjetësi e bart, por nuk e shet sendin e shitblerjes, dhe më vonë e shet pronari personalisht, ai nuk ka të drejtë të kërkojë pagë për shërbimin e tij. Nëse të njëjtin send e transporton tjetri ndërmjetës dhe e shet, këtij i takon shpërblimi për shërbim të shitjes.

Nëse pronari ia dorëzon sendin ndërmjetësit dhe i thotë: “Shite për kaq para!” e ndërmjetësi e shet për më shumë, ajo tepricë i takon pronarit të sendit, nese nuk kanë pasur marreveshje tjetër.

Nëse pronari porosit korrarët që t’ia korrin grurin për një shumë të caktuar parash dhe ata korrin gjysmën, kurse tjetrën e shkatërron ndonjë furtunë natyrore, si breshër, vërshim etj., korrarët mund të kërkojnë vetëmi atë pjesë që përkon me sasinë e grurit të korrur.

Punëtori përgjigjet ligjëritisht për sjelljet që janë në kundërshtim me urdhërin e prerë ose me heshtje të mëditjemarrësit. Prandaj nëse pronari i bagëtive i urdhëron bariut se ku do t’i kullosë, kurse bariu i kullot në tjetër vend dhe këto ngordhin, fajtor është bariu dhe përgjigjet për dëmin që ka ndodhur.

---

**- Pasha All-llahun, jo - i thashë unë - sikur të vdesësh dhe prapë të ringjallesh!**

**- Pse, a unë do të vdes dhe prapë të ringjallem - pyeti ai.**

**- Po, iu përgjigja unë.**

**- E pra, atje - shtoi ai do të kemi pasuri e fëmije dhe do të paguaj.**

**Në këtë rast All-llahu xh.sh. shpalli:**

**“A e ke parë atë i cili ka përgenjështuar argumentet tona dhe ka thënë: “Gjithsesi do të më jepet pasuri dhe fëmijë!” Ai ose është thelluar në fshehtësi ose ka marrë premtimin nga i Gjithmëshirshmi. Po si jo! Ne do ta shënojmë se çka po flet dhe vuajtjen do t’ia zgjasim shumë. Dhe ne e trashëgojmë edhe atë çka thotë, dhe do të na vijë i vemtuar. Ata marrin, në vend të All-llahut, do farë hyjnish, të cilat duhet të jenë ndërmjetësues të tyre, Po si jo! Ata do të mohojnë adhurimin e atyre dhe do të jenë kundërshtarë të atyre.”**

### **ÇKA PAGUHET PËR MAGJI NË FISET ARABE, DUKE KENDUAR SUREN FATIHA**

Ibni Abasi ka transmetuar nga Peigambcri s.a.v.s.: **“Pagesa, shpërblimi më i denjë që merrni për magji është leximi i librit të Zotit”.**

Sha’biu thotë. **“Mësuesi nuk vë kusht për pagesë, por kur i jepet diçka le ta pranojë!”**

Hakemi ka thënë: **“Nuk karn dëgjuar askënd që ta ketë nënçmuar pagesën e mësuesit”.**

Hasan (Basriu) i ka dhënë (mësuesit) 10 dirhem.

Ibn Sirin nuk sheh gjë të keqe në pagesën e dëshmitarit që bëri be në të drejtë, por është folur, thotë ai: **“Është e ndaluar që palët të paguajnë për gjykim, kurse për vlerësim kanë paguar”.**

2276. - Na ka trequar Ebu Nu'man se i ka transmetuar Ebu Avane nga Ebu Bishr, ky nga Ebu-l-Mutevekkil, e ai nga Ebu Seidi r.a. i cili ka thenë:

- Tre sahabë të Pejgamberit a.s. u nisën në rrugë dhe shkuan deri kur hasën në një fis arab dhe aty lypen konak, por ata nuk deshën t'u bënë konak. Në atë moment kryetarin e fisit e kafshoi gjarpëri. Ata i përgatiten gjithfarë bari, por nuk i beri dobi. Dikur, dikush prej tyre tha: **"Të kishit shkuar te ai grup njerezish që është ndalur atje, mbase te ndonjëri prej tyre gjendet ndonjë bar"**. Këta shkuan atje dhe thanë: **"O burra, kryetarin tonë e ka thumbuar gjarpëri. Kemi bërë gjithçka që kemi ditur, por pa dobi. A mos keni ju ndonjë bar?"**

Njëri nga këta, në atë moment, tha: **"Pasha All-llahun, unë bëj magji, shëroj, por, pasha Zotin, kur lypëm konak te ju, ju nuk deshët të na strehoni, dhe unë nuk u ofroj asnjë shërbim, nëse nuk na ofroni ndonjë kompensim"**. Atëherë këta u morën vesh për një tufë dhensh dhe ai shkoi t'i fryjë. Këndoi **Elhamdu lil-lahi rabbil-âlemîn...**<sup>10</sup> dhe menjëherë kryetari i fisit, si ta kishte lëshuar nga zinxhiri, nisi të ecë pa kurrfarë dhembje.

Ata ua dhanë shpërblimin - tha Ebu Seid - sipas marrëveshjes që kishin bërë. Pastaj dikush nga mesi i tyre tha "Ndajeni ndërmjet nesh", kurse ai që ben magji tha: **"Mos e bëni këtë, derisa të shkojmë te Pejgamberi s.a.v.s. dhe t'ia sqarojnë se si ka ndodhur, e të shohim ç'ka do të na thotë ai!"**

Ashtu erdhën te Pejgamberi s.a.v.s., ia parashtruan rastin, e ai u tha: **"Po kush të tha se ajo është për t'i fryrë magji?"** Mandej shtoi: **"Jemi bërë pazar - jemi marrë vesh. Ndajini, dhe ndajeni edhe për mua një pjesë"**, dhe qeshi **Pejgamberi s.a.v.s..**

Ebu Abdullah (Buhariu) ka thënë: Shu'be ka thënë se Ebu

---

<sup>10</sup> Njëri nga sahabët e Pejgamberit a.s. këndoi suren Fatiha për këmbën e sëmure të kryetarit të fisit

---

Bishr i transmetoi “Ashtu kam dëgjuar edhe unë nga Ebu-l-Mutevekkili”<sup>11</sup> (Krahaso: 5007, 5736, 5749)

## **TATIMI PËR ROBIN DHE TATIMET E DETYRUESHME PËR ROBËRESHAT**

2277. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf, këtij Sufiani që transmeton nga Humejd Et-Tavili, ky nga Enes b. Maliku r.a.

---

<sup>11</sup> Paga e imamit dhe e mësuesit konsiderohet shpërblim, dhuratë nga punëdhënësi. Nëpunësi fetar nuk goditet për pagesë. Ai ia lën punëdhënësit lartësinë e pagesës, dhe, nëse i mjafton, kryen detyrën, e nëse nuk i mjafton për të përmbushur nevojat familjare e individuale, ai bën marrëveshje me punëdhënësit tjetër.

Hakemi në veprën e vet “Kitabu-l-Kafi” thotë: “Nuk lejohet që dikush me pagesë të caktuar të marrë njëri tjetër t’ia mësojë fëmijën të lexojë Kur’an dhe të kryejë detyrat e tjera fetare, si edhe detyrën e imamit dhe muezinit në Ramazan”.

Në “lulasatu-l-fetava” shkruan: “Nuk është e lejuar që me pagesë të kontraktuar të kryesh detyrën e mësimit-besimit, detyra tjera fetare, sidomos t’u mësosh të tjerëve Kur’anin, ezanin, kryerjen e haxhit për tjetër kënd dhe të ngjashme”. Ky është qëndrim i dijetarëve të shkollës henefite, ndërsa Ebu Leith, dijetarët Shafij, dhe ndonjë tjetër kanë mendim të kundërt, gjë që për rrethanat tona është më e përshtatshme.

Bashkësia dhe njerëzit e ditur e kanë obligim që t’i mësojnë muslimanët, pa pagesë, çka janë detyrat ndaj All-llahut, ndaj vetes dhe njerëzve të tjerë. Ebu Davud, Ibn Maxhe dhe Hakemi në koleksionet e tyre me hadithe shënojnë se Ubade b Samit ka thënë: “Ua kam mësuar Kur’anin shoqërisë së varfër sof dhe njëri prej tyre më ka dhënë këtë hark”.

- Nuk e kam bërë këtë për pagesë - i thashë, por vetëm për hir të All-llahut. Mandej e kam pyetur Pejgamberin s.a.v.s., ai më tha: “Pranoje, nëse dëshiron që Zoti xh.sh. në Ditën e Kijametit të të japë qaforen e xhehennemit”.

Është mirë të kendosh kur’an dhe lutje tjera me përmbajtje të mirë, duke lutur All-llahun për ato çështje që janë jashtë mundësisë së njeriut. Katade, Seid b. Xhubejr dhe shumë dijtare tjerë magjinë-fryrjen, e gjykojnë, ngase muslimani është i detyruar të mbështetet vetëm te All-llahu dhe te barërat e ekspertëve.

---

- Ebu Sajba i lëshoi gjak Pejgamberit s.a.v.s. dhe ky i caktoi një sa' apo dy sa' ushqim dhe foli me zotërinjët e tij. Ata ia ulën pak të ardhurat, gjegjësisht ia ulën tatimin”.

### **TË ARDHURAT E ATIJ QË LESHON GJAK**

2278. - Na ka treguar Musa b. ismail se i ka thenë Kutjebi që i ka transmetuar Ibn Tavos nga babai i vet se Ibn AbLasi r.a. ka thënë:

- **“Pejgamberi s.a.v.s. lëshonte gjak, dhe atij që ia bënte këtë shërbim i jepte shpërblimin përkatës”.**

2279. - Museddedi na ka treguar, këtij Jezid b. Zurej, që transmeton nga Halidi, ky nga Ikrime, ky nga Ibn Abbasi r.a.

- **Pejgamberi s.a.v.s. lëshonte gjak dhe atij që i bënte këtë shërbim i jepte fitimin e vet, dhe sikur ta konsideronte si punë të urrejtur, mekruh, nuk do t’ia japte”.**

2280. - Na ka treguar Eb Nuajm se i ka transmetuar Mis’ar nga Amr b. limir. E kam dëgjuar Enesin r.a. duke thenë: **“Pejgamberi s.a.v.s. i lejonte vetes të lëshoj gjak dhe askujt në fitimin e vet nuk i ka bërë padrejtësi (kushdo që e bënte këte e shpërblente nënyrë meritore)”.**

### **AI QË U THA ZOTËRINJVE TË ROBIT QË T’IA LEHTËSOJNË PAK TATIMIN**

2281. - Na ka treguar Ademi, këtij Shu’be që transmeton nga Humejd Et Tavili, ky nga Enes b. Maliku r.a.

- **Pejgamberi s.a.v.s. e thirri një rob (dialosh) që dinte të lëshojë gjak. I lëshoi gjak dhe ky i caktoi një sa' apo dy sa', një mud apo du muda dhe foli lidhur me këtë që t’ia ulin pak tatimin”.**

---

## FITIMI I PROSTITUTËS DHE ROBËRESHËS

Ibrahimi (Nehalu) e merrte pagesën për gratë që vajtojnë për të vdekurit dhe këngëtares, kurse fjala e All-llahut xh.sh. është: **“... Mos i detyroni shërbëtores tuaja të bëjnë kurvëri - e ato dëshirojnë të jenë të pastra - në mënyrë që të shijoni kënaqësinë e kësaj bote. Nëse dikush i detyron ato, All-llahu ato do t’i falë, sepse kanë qenë të detyruara, dhe do të ketë mëshirë ndaj tyre”**.<sup>12</sup>

Mushahidi ka thënë: **“Fetejatikum”** d.m.th **“robërshat tuaja”**.

**2282.** - Na ka treguar Kutejbe b. Seid i cili transmeton nga Maliku, ky nga Ibn Shihabi, ky nga Ebu Bekr b. Abdurrahman b. Harb b. Hisham, kurse ai nga Mes’ud El-Ensariu r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar paranë, fitimin nga shitja e qenit, paranë që fiton prostituta me përjetimet seksuale dhe fitimin e falltorit.

2283. - Na ka treguar Muslim b. Ibrahim këtij i transmetoi Shu’be nga Muhammed b. Xhuhada, ky nga Ebu Hazimi, ndërsa ai nga Ebu Hurejre r.a. që ka thënë:

**- Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar fitimin e robërshës (që fitohet me prostitucion).** (Krahaso: 5308)

### DEVEJA PËR MBARSIM

2284. - Na ka treguar Museddedi, këtij Abdu-l-Varith dhe Ismail b. Ibrahim i cili transmeton nga Ali b. El-Hakem, ky nga Nefiu, e ai nga Ibn Umeri r.a.

---

<sup>12</sup> Kar’an, 24:33.

- “Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar pagesën për mbarsje të deve<sup>13</sup>”.

## **TOKA ME QIRA DHE VDEKJA E NJERËS PALË**

Ibn Sirinë ka thënë: **“Shtëpiarët e atij që e ka dhënë me qiraqesim, nuk kanë të drejtë të largojnë atë që e ka marrë me qesim, deri në fund të plotësimit të afatit të marrëveshjes”**.

Hasani, Hakemi dhe Ijas b. Muavija kanë thënë: **“... qesimi, qiraja vazhdon deri në fund të afatit kontraktues”**.

Jbn Umeri ka deklaruar: Pejgamberi s.a.v.s. e pat dhënë Hajberin me përgjysmë dhe kjo kështu ka ndodhur në kohën e Pejgamberit a.s., të Ebu Bekrit dhe në fillim të hilafetit të Umerit dhe nuk është përmendur që Ebu Bekri dhe Umeri ta kenë përsëritur këtë kontratë qiraje pas vdekjes së Pejgamberi s.a.v.s..

2285. - Na ka treguar Musa b. Ismail se i ka transmetuar Xhurvejr b. Esmail nga Nafi, ky nga Abdullahu (b. Umeri) i cili ka thënë:

- **Pejgamberi s.a.v.s. e ka dhënë Hajberin ta punojnë dhe ta mbjellin hebrejtë, kurse këta marrin gjysmën e prodhimit të asaj toke”**.

Ibni Umeri i ka kumtuar Nafiut edhe këtë: **“Arat janë dhënë me qira për shumën që caktoi Nafi, por unë (thotë Xhurvejriu) nuk e kam mbajtur mend”**. (Krahaso: 2328, 2329, 2331, 2338, 2499, 2720, 3152, 4248).

---

<sup>13</sup> Për mbarsjen e kafshëve shtëpiake është e ndaluar pagesa.

Pronari i kafshës shtëpiake që mbarset mund t’i japë dhuratë pronarit të mbarësit, porse disa juristë të shkollës shafite dhe hambelite lejojnë të merret me qesim kafsha mashkull për një kohë të caktuar derisa të kryhet mbarsimi.

---

2286. - Rafi b. Hadixh tregon se Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar të jepet me qira toka e punës (me përjashtim të Hajberit), kurse Ubejdullahu transmeton nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri: "... deri kur i pat përzënë Umeri".<sup>14</sup> (Krahaso: 227, 2232, 2344, 2722).

## **Kreu 38.**

### **Pagesa e borxhit**

*Në emër të All-llahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit*

## **TRANSFERI I BORXHEVE, UDHËZIMI I KREDITORIT TE TJETRI; A MUND TË TËRHIQET UDHËZIMI**

Hasani dhe Katade thonë: **“Lejohet ta drejtosh kreditorin te tjetri, në qoftëse personi që ka marrë mbi vete të paguajë borxhin ditën që ka kaluar borxhi te ai, ka qenë në gjendje të mirë”**.

Ibn Abbasi ka thënë: “Bashkëpronarët dhe trasLëgimtarët e largojnë-përjasEtoben nieri-tjetrin, kësEtu që nëse njëri merr materialin e ai tjetri borxhin, e njërit prej tyre i humb, tjetri nuk mund t’i drejtohet (për dëmshpërblim) shokut të vet.

---

<sup>14</sup> Ai që merr me qira tokën që të mbjellë aty çka dëshiron ai, atë tokë mund ta shfrytëzojë dy herë për një vjet, dhe të mbjellë aty prodhime dimri dhe vere. Nëse afati i qirasë skadon para se bëhen të korrurat, qiramarrësi e lë bimën në tokë deri kur të piqet dhe i paguan qiradhënësit me qira për tokën në vazhdim, sipas vlerësimit të rendimentit.

Me qira mund të merret shtëpia komfore ose lokali afarist, pa e emërtuar se për çka merret, porse mënyra e shfrytëzimit caktohet sipas traditës së vendit.

Hebrenjtë nga Hajberi janë përzënë në Erih dhe Tajm.

---

2287. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Maliku i transmeton nga Ebuzinadi, ai nga A'rexhi, kurse ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **Zvaritja e pagesës nga ana e të pasurit është dhunë.** Nëse dikush prej jush udhëzohet te pasaniku, le të lypit". (Krahaso: 2288, 2400)

### **NËSE KREDITORI (BORXHLIU) UDHËZOHET TE PASANIKU, AI NUK KA TË DREJTË TA REFUZOJË**

2288. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf se i ka transmetuar Sufjani nga Ibn Dhekvani, ky nga A'rexhi, ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Vonesa e larjes së borxhit nga ana e pasanikut është dhunë. **Kush udhëzohet te pasaniku, le ta kërkojë borgjin.!<sup>15</sup>**

---

<sup>15</sup>Për vlefshmërinë e udhëzimit është i nevojshëm pëlqimi i udhëzuesit, i kreditorit dhe i personit të i cili kalon pagesa e borxhit. Udhëzimi mund të lidhet edhe ndërmjet personit të udhëzuar dhe likuidatorit të caktuar. Për shembull, nëse dikush i thotë tjetrit: "Pranoje ti mbi vete atë udbëzim për kaq e kaq dinarë të borxhit që duhet të ma paguaj filan fisteku", e ai i përgjigjet: "E pranoj". Ose, nëse dikush i thotë: "Më prano mua me atë udhëzim si borxhli tëndin për kërkesën tënde prej kaq e kaq dinarësh që e ka ky e ky", dhe këtë e pranon ai tjetri. Udhëzimi është i plotfuqishëm, madje edhe nëse pendohet borxhliu i caktuar, pendimi nuk i bën dobi. Udhëzimi i lidhur vetëm ndërmjet udhëzuesit dhe të udhëzuarit, bëhet i plotfuqishëm dhe i vlefshëm kur i kumtohet likvidatorit të caktuar dhe ai e pranon. Për shembull, nëse dikush e udhëzon kreditorin e vet me vulluetin, pëlqimin e tij te personi i tretë, që gjendet në një vend tjetër, udhëzimi do të jetë i vlefshëm atëherë kur likvidatori i caktuar të informohet për këtë dhe ta pranojë udhëzimin.

Udhëzimi që lidhet vetëm ndërmjet udhëzuesit dhe likvidatorit të caktuar është i përkohshëm deri kur të japë pëlqimin i udhëzuarit.

---

---

## LEJIMI 1 TRANSEFERIMIT TË BORXHIT NGA I VDEKURI TE TJETRI

2289. - Na ka treguar El-Mekij b. Ibrahim, këtij Jezid b. Ebi Ubejd i cili transmetoi nga Seleme b. Ekve'a r.a. që ka thënë:

- **Ishim duke ndejtur te Pejgamberi s.a.v.s. kur e sollën një xhenaze.**

- **Falja xhenazen - thanë të pramshmit.**

- **A ka ky ndonjë borxh, pyeti ai.**

- **Nuk ka - u përgjigjën ata.**

- **A ka lënë pas ndonjë send, pyeti ai.**

- **Jo, u përgjigjën ata, dhe ky ia fali xhenazen. Pastaj sollën një të vdekur tjetër, dhe thanë:**

- **O Pejgamberi i All-llahut, falja xhenazen!**

- **A ka ky ndonjë borxh, pyeti ai.**

- **Po - tha dikush.**

- **A ka lënë ndonjë send, pyeti prapë ai**

- **Tre dukatë (dinare) - i përgjigjën ata, dhe ky ia fali xhenazen. Më vonë e sollën të tretin, dhe i thanë:**

- **Falja xhenazan!**

- **A ka lënë ndonjë send, pyeti ai.**

- **Jo - u përgjigjën ata.**

- **A ka ndonjë borxh?**

- **Tre dukat - u përgjigjën ata.**

---

Objekt i udhëzimit mund të jetë vetëm borxhi, për të cilin garanca mund të jetë e vlefshme dhe borxhi, shuma e të cilit është e precizuar”.

Pasoja juridike e transferit të pagesës së borxhit te tjetri, ka të bëjë me atë që udhëzuesi lirohet nga borxhi i vet, kurse garanti, nëse e ka, lirohet nga garanca dhe që i udhëzuari ka të drejtë të kërkojë pagesën e borxhit nga paguesi – likvidator – i caktuar.

Udhëzimi mund të jetë i pakufizuar dhe i kufizuar me kushte të ndryshme.

---

- Fálnia ju shokut tuaj, tha ai. Pastaj Ebu Katade tha: "O i dërguari i All-llahut, falja se borxhi i tij është borxhi im", dhe ky atëherë ia fali xhenazen".<sup>16</sup> (Krahaso: 2295)

## Kreu 39

### *Garancia në hua*

## GARANCA NË HUA DHE BORXHE PËR PERSONA TË FJERË

2290. - Ebu-Zinadi ka transmetuar nga Muhammed b. Hamza b. Amr El-eslemij, ky nga babai i vet, të cilin Umeri r.a. kishte dërguar të mbledhë zekatin. Një njeri kishte rënë në grackë me robëreshën e gruas së vet, kurse Hamza i kishte marrë besën (garancën) atij burri deri kur të vijë prapë te Umeri. Umeri, ndërkaq, ia kishte dhënë (ra) atij 100 (njëqind) shkopinj. Ai këtë e kishte konfirmuar. Këtë e arsyetoi se nuk i kishte ditur normat.

Xheriri dhe Eshathi i thanë Abdullah b. Mesudit për të konvertuarit: "**Kërko të pendohen dhe të japin garancë!**" Ata pastaj u penduan dhe për ato garantoj familja e tyre.

---

<sup>16</sup> Dar Kutui ka shënuar se Aliu ka thënë: "Sa herë që vinin xhenaze, Pejgamberi a.s. nuk pyeste për asnjë punë të të vdekurit, por për borxh pyeste. Nëse i thoshin se i ka ndokuj borxh, nuk dëshironte t'ia falte xhenazen, e kur i thoshin se nuk i ka borxh askujt, ia falte. Një herë e sollën një xhenaze dhe kur deshi të marrë tekbir për t'i falë namazin e xhenazes, pyeti: "A i ka kujt borxh ky i vdekur".

- Dy dukat - thanë të pranishmit.

Ai menjëherë- u hoq anash dhe tha: "Fálnia xhenazen ju shokut tuaj!" Në këtë Aliu tha: "Falja, se ata dy dukatë borxh, janë borxhi im, ai është i lirë".

---

**Hammadi ka thënë: “Nëse dikush garanton për një person, e ai ndërron jetë për këtë më nuk ka detyra garantimi”” kurse Hakemi ka thënë: “Garanton”<sup>17</sup>**

---

<sup>17</sup> Pas vdekjes së Muhammedit a.s. disa fise arabe iu bashkuan Musejlemit dhe profetëve tjerë të rrejshëm. Një mëngjes dikush informoi të pranishmit të xhamia e Muhammedit a.s. për arratisjen (rebelimin) e 170 vetëve në rrethinën e xhamisë Benu Hanif dhe se ish muezini, Ibn Nevah në ezan në vend Muhammedit a.s. përmend Musejlemin. Menjëherë u nis Abdullah b. Mesudi me një njësi të armatosur e cila vrau Ibn Nevahin. Ai kishe për qëllim kështu të veprojë edhe me të arratisurit tjerë, por më në fund miratuan qëndrimin e lartpërmendur të Xherirët dhe Esh'athit. Garancia konfirmohet me vetë ofertën e garancës, por ky, në dobi të cilit garantohet, mund tërefuzojë ofertën, kurse garanca vazhdon deri atëherë kur ofertën e refuzon kreditori. (ai që ka borxh).  
Garanca proklamohet me fjalë të cilat, sipas traditës, kanë kuptimin e obligimit: “Unë garantoj, “Unë përgjigjem” dhe të tjera.  
Garantimi mund të jetë me kusht. Për shembull, garanti të thotë: “Nëse filan fisteku nuk ta paguan borxhin, po ta paguaj unë”.  
Garanca është e përkohshme, nëse dikush thotë: “Unë jam garant prej sot e deri në filan kohë”, por mund të jetë e pakufizuar.  
Për një borxh mund të kerë më tepër garantues.  
Garantuesi duhet të jetë, doemos, i moshës madhore dhe mentalisht i shëndoshë, kurse borxhliu mund të mos jetë kështu. Sipas kësaj garanca është e vlefshme edhe për borxhin e të miturit edhe të rriturit.  
Objekti i garancës mund të jetë individi, si person fizik-juridik, ose ndonjë pasuri si borxh. Nëse objekti i garancës është individi, është kusht që të emërtohet e nëse është ndonjë pasuri, është kusht që të theksohet përgjegjësia e përgjithshme dhe garanca për atë duhet të paguajë borxhliu.  
Për shembull, të thotë: “Garantoj për borxhin e filanit, për kaq e kaq.”  
Garanca, pra, është e vlefshme edhe atëhere kur nuk është e precizuar shuma e borxhit.  
Nëse garantuesi vdes, kurse trashëgimtarët e tij nuk mund ta gjejnë borxhliun kryesor, kreditori e paguan borxhin e vet nga pasuria e garantit të vdekur, e nëse vdes kreditori, trashëgimtarët e tij kanë të drejtë të kërkojnë borxhin.

---

2291. - Ebu Abdullah (Buhariu) thotë:

Lejthi ka thënë se i transmetoi Xhafer b. Rebi nga Abdurrahman b. Hurmazi, ai nga Ebu Hurejreja r.a. se Peigamberi s.a.v.s. përmendi një njeri nga izraelitët i cili kërkoi nga një izraelit t'i japë hua 1000 dukatë, e ai i tha: **“M’i sjell dëshmitarët të cilët do të dëshmojnë”**.

- **Mjafton të jetë dëshmitar All-llahu xh.sh.**, tha ai.

- **Më sjell garantues**, i tha ky

- **Mjafton për garantues Zoti** - tha ai.

- **E ke thënë të vërtetën**, tha izraeliti, **ia dorëzoi huan për deri në afatin e theksuar**.

Dikur borxhliu doli në breg të detit, kreu punët e veta dhe kërkoi ndonjë lundër të hipë në të dhe të shkojë te kreditori në afatin që i kishte caktuar. Pasi nuk gjeti asnjëfarë lundre, mori një dru, i hapi një zgavër, i futi aty një mijë dakatë dhe letrën për shokun e tij - kreditorin, e pastaj e mbylli zgavrën e drurit, u afrua në det dhe tha:

- **O Zot, Ti, padyshim, e di se unë huazova nga filan filani një mijë dukat, ai më kërkoi garant, e unë i thashë: “Mjafton Zoti për garant” dhe ai ishte i kënaqur me Ty. Më kërkoi edhe dëshmitarë, e unë i thashë: “Mjafton Zoti për dëshmi” e ai mbeti i kënaqur me ty. Unë u mundova, përnjëmend, të gjej ndonjë lundër që t’i dërgoj çka është e atij. Pasi që nuk munda ashtu, unë ta besoj Ty. E lëshoi në det dhe ai u fundos, kurse ky u kthye prapë të kërkojë lundër që ta shpinte në vendin e tij.**

Edhe ai njeriu, që ia kishte dhënë hua dukatët, njëllojë si ky, kishte dalë të shikojë mos po e shesh lundrën që duhej t'i sillte pasurinë e tij. Në një moment e pa atë drurin në të cilin ishte pasuria e tii, e mori për te shtëpia si lëndë djegëse dhe kur e çau aty gjeti pasurinë e vet dhe letrën.

Më vonë arriti edhe ai të cilit ia kishte huazuar paratë, i cili kishte me vete një mijë dukatë tjerë dhe i tha:

**“Pasha Zotin, jam munduar shumë të gjejë lundër që ta sjelli**

---

me kohë pasurinë tënde por nuk gjeta kurrfarë lundre më herët se kjo me të cilën erdha tash.

- A më ke dërguar ti më herët ndonjë send, e pyeti izraeliti.

- **Po të them - i tha ai, - se nuk gjeta kurrfarë mjete para kësaj lundre me të cilin, ja tash, erdha.**

- **Zoti, me të vërtetë, ma dorëzoi, në vend tëndin, atë që e kishe dërguar me atë drurin, prandaj rruga e mbarë të qoftë, kthehu me ato një mijë dukatët! - i tha izraeliti.<sup>18</sup>**

### **FJALËT E ALL-LLAHUT XH.SH.: “ATYRE ME TË CILËT KENI LIDHUR KONTRATA, JAPNU PJESËN E TYRE”<sup>19</sup>**

**2292.** - Na ka treguar Salt b. Muhammed, këtij Ebu Usame, që transmeton nga Idrisi, ai nga Talha b. Musarrifi, ky nga Seld

---

<sup>18</sup> Te garantimi i përkohshëm, garantuesi është përgjegjës vetëm derisa zgjat garancia e tij. Nëse garancia është e kontraktuar, garantuesi nuk mund ta ndërpresë arbitrarisht, por ajo e kushtëzuara edhe gjatë kohës që e vazhdon garancën, mund ta ndërpresë para se të kalojë obligimi të borxhliu kryesor.

Kreditori ka të drejtë të zgjedhë lidhur me kërkesën e borxhit të vet, nëse do, shumë vetë mund të garantojnë për një borxh me akte të ndryshme e me kohë të ndryshme, atëherë secili individ garanton për tërë shumën. Nëse kanë garantuar bashkarisht në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin akt, atëherë secili garant përgjigjet vetëm për atë pjesë të shumës që i takon këtij.

Nga ndodhija e përmendur rezulton:

- ngjarjet historike janë vetëm mësim për gjeneratat e ardhshme;
- lejohet të bësh tregti nëpër det dhe të marrësh kredit;
- huadhënësi ka të drejtë të kërkojë garant dhc dëshmitar;
- ai që i bryen detyrat ndaj All-llahut, me përpikmëri, mund të shpresojë në ndihmën e Tij;
- gjahu i detit i takon atij që e gjen, nëse nuk i dihet pronari.

<sup>19</sup> “Ne kemi caktuar trashëgimtarë për gjithçka që lënë prindërit dhe të afërmit. Atyre, me të cilët keni lidhur kontrata, jepnu pjesën e tyre! All-llahu është njëmend dëshmitar i çdo sendi.” (Nisa’: 33)

---

b. Xhubejr, kurse ai nga Ibn Abbasi r.a., i cili fjalinë: **“Çdo kuj i kemi caktuar mevali, e ka komentuar me trashëgimtarë”**, kurse fjalët: **“... atyre me të cilët keni kontrata...”** ka thënë: “kishte shumë muhaxherë dhe kur erdhën në Medinë secili muhaxher e trashëgonte ensarion krahas fisit të tij nga gjahu, për shkak të vëllazërimit që kishin lidhur nëpërmes të Pejgamberit a.s. e që është shkëputur me shpalljen e këtij ajeti: **“... çdokuj i kemi caktuar trashëgimtar”**. Mandej ka thënë edhe këtë: **“... Atyre me të cilët keni lidhur kontrata”**, d.m.th. **“vetëm ndihmë e ndërsjellë materiale dhe këshillim i singertë”**.

Trashëgimi, pra, është shkëputur, zhvleftësuar, porosia ka vazhduar.<sup>20</sup> (Krahaso: 4580, 6747).

2293. - Na ka treguar Kutejbe, këtij Ismail b. Xhafer, që transmeton nga Humejdi se Enesi r.a. ka thënë:

- Abdurrahman b. Afv erdhi te ne dhe Pejgamberi s.a.v.s. e ka vllazëruar me Sa'd b. Rebiun.

2294. - Na ka treguar Muhammed b. Es-Sabah, se i ka transmetuar Ismail b. Zekerija nga Asimi:

- I kam thënë Enesit r.a. **“A të kanë treguar se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë “Në Islam nuk ka tutori”**. Ai atëherë tha: **“Pejgamberi s.a.v.s. e ka zbatuar të vëllazëruarit (tutorinë) midis kurejshve dhe ensarëve në shtëpinë time”**. (Krahaso: 6083, 7340).

---

<sup>20</sup> “Dhe mos lakmoni atë me çka All-llahu i ka dalluar disa prej jush. Meshkujve u takon dhurata për atë që punojnë, kurse grave dhurata për atë që ato e kanë merituar. Kërkoni mirësi prej All-llahut, se All-llahu, pa dyshim, di çdo gjë”. (Nisa’: 32).

Para shpalljes së Kur’anit arabët lidhnin marrëveshje ndërmjet veti për mbrojtje të përbashkët dhe nëse ndonjëra nga ato palë vdiste, pala tjetër e trashëgonte në shumë prej 1/6 e tërë pasurisë që ka lënë. Feja Islame këtë status e ka zëvendësuar me ndihmë të ndërsjelltë dhe këshillim të singertë.

---

---

**AI QË GARANTON PËR BORXHIN E TË  
VDEKURIT, NUK MUND TË TËRHIQET NGA  
GARNACA SIPAS RREFIMIT TË HASANIT**

2295. - Na ka treguar Ebu Asimi nga Jezid b. Fbu Ubed, ai nga Seleme b. Ekva r.a. se Pejgamberit s.a.v.s. i ofruan të falte një xhenaze. Ai pyeti:

- **A i ka ndokujt borxh?**

- Nuk i ka - thanë të pranishmit - dhe k, v ia fali xhenazon.

Pastja erdhi një xhenaze tjetër, dbe ky pyeti: “**A ka ky ndonjë borxh?**”

- **Po, ka** - thanë ata.

- **Falnia ju shokut tuaj**, tha ky. Ebu Katade, mandej, i tha: “**O Pejgamber i Zotit, Borxhin e tij e marr përsipër unë**”. Ky pastaj ia fali xhenazen.

2296 - Na ka treguar Ali b. Abdullah se i ka kumtuar Suelani se Amri ka dëgjuar Muhammed b. Allun që transmetonte nga Xhabir b. Abdullahu r.a. se Pejgamberi s.a.v..s. ka thënë:

- **Po të arrinte fitimi nga Bahrejni do të kisha dhënë kaq, kaq dhe kaq**”.

Mirëpo Pejgamberi ndërroi jetë e ai mall nuk erdhi. Kur arriti ai mall, Ebu Bekri dha urdhër të jepet lajmerim: “**Kujt i ka premtuar Pejgamberi a.s. ndonje send, apo i ka ndonjë borxh, le të vijë te ne!**, Unë shkova dhe i thash: “Pejgamberi s.a.v..s. më ka thënë ‘do të kisha dhënë, kaq, kaq, dhe kaq’”. Ebu Bekri, atëherë, e mbushi grushtin, dhe unë kur i numërova kishte 500 dërhëm.

- Merri edhe dy herë nga kaq, tha ai.<sup>21</sup> (Krahaso: 2598, 2683, 3127, 3164, 4383)

---

<sup>21</sup> Sipas mendimit të Shafiut, Ahmedit dhe Ebu Hanifes është e pelqyeshme të plotësohet dëshira e të vdekurit, kurse sipas mendimit të H. Basrint kjo është detyrë.

Deklarata e një individi të besuesllem mund të mjaftojë të jetë argument i velefshëm për të marrë vendim organi kompetent

---

---

---

**MBROJTJA E EBU BEKRIT NË KOHËN  
E PEJGAMBERIT A.S. DHE OBLIGIMI I TIJ**

---

2297. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr, këtij Lejthi, ky transmetoi nga Ukajli se Ibn Shihabi ka thënë se i ka kumtuar Urve b. Zubejri që Aisheja r.a., bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v s., ka thënë: “I mbaj mend prindërit e mi që kanë kultivuar fenë Islame”.

Ebu Salibu ka thënë se i ka transmetuar Abdullahu nga Enesi, ky nga Zuhriu i cili thotë se i ka kumtuar Urve b. Zubejri se Aisheja r.a. ka thënë:

**- Nuk mbaj mend që prindërit e mi të mos e kanë kultivuar fenë Islame, dhe nuk kalonte ditë që të mos vinte Pejgamberi s.a.v.s., dhe kjo ndodhte në skaje të ditës, në mëngjes ose në mbrëmje. Kur ranë muslimanët në rrezik, Ebu Bekri doli e mori rrugën për në Abisini dhe kur arriti në Berku-l-Gimad e takoi Ibnu d-Degine, kryetar i fisit Karet, dhe e pyeti: “Kah je nisur, o Ebu Bekr?”**

**- Më ka përzënë populli im - tha Ebu Bekri - dhe dua të shkoj në një vend ku do të mundem ta adhuroj Krijuesin tim.**

**Në këtë moment Ibnud-degine i tha: “Njeriu siç je ti nuk del, dhe nuk përzinet”. Ti i ushqen të varfërit, e viziton farefisën, kurse në raste të konflikteve ndihmon të vërtetën. Po të marr në mbrojtje unë, prandaj kthehu dhe adhuroje Krijuesin tënd në vendin tënd!”**

Pastaj Ibnud-Degine i hipi deve dhe u kthye me Ebu Bekrin, i vizitoi parinë mosbesimtare kurejshite dhe tha:

**- Çifti i Ebu Bekrit: nuk del, nuk pëtzinet dhe nuk shpërngulet! A e përzoni (ndiqni) njeriun i cili ushqen të varfërit, viziton farefisën, bart barrën e jetimëve i ofron ndihmë udhëtarit dhe, në rast kontesti, është në anën e drejtësisë.**

Kurejshitet e moren parasysht mbrojtjen e Ibnud-Degine, i

---

---

afruan sigurinë Ebu Bekrit kurse Ibnud Degines i thane: **“Urdhëroje Ebu Bekrin që t’i lutet Xrijuesit të vet në shtëpinë e vet; të falet dhe le të kondojë çka të doje por ne të mos na shqetësojë. Këtë mos e bën haptazi sepse, nëjmend, kemi frike që mos i vë ne sprovë djemtë dhe gratë tona”**.

Ibnud-Degine ia percolli këtë Ebu Bckrit dhe Ebu Bekri i lutej Krijuesit të vet në shtëpi të vet edhe namazin nuk e falte haptazi, por as Kur’an nuk këndonte jashta shtëpise së vet.

Dikur, më vonë, Ebu Bekri nderoi mendimin dhe nderitoi nje objekt te veçante në oborrin e shtëpisë së vet për kryerjen e detyrave fetare, shkonte aty falej dhe këndone Kur’an, ndërsa gratë e politeistëve dhe djemtë e tyre rëzoheshin duke u shtyrë për ty ofruar te ai e shikonin dhe çuditëshi. Ebu Bekri ishte njeri me fizionomi të përvuajtur melankuoik dhe kur këndonte Kur’an nuk mund ti ndalte dot lotët kjo i frikësonte politesitët autoritativ-kureshitë, dhe i dërguan porosi Ibnud-Degines dhe e thirën. Kur erdhi Ai i thanë : **“Ne i ofruam mbrojtje Ebu Bekrit me kusht që ai t’i lutet Zotit të vet në shtëpi të vet. Mirëpo ai këtë e theu’ ndërtoi për vete objekt për detyrat fetare në oborr të shtëpisë dhe aty falet haptazi dhe këndon Kur’an**

**Ne kemi frikë mos i mashtroj gratë tona dhe djemtë tanë, prandaj shko te ai dhe thuaj: Nëse do të kufizohet të adhurojë Zotin në shtëpi të vet, le ta bëjë këtë, e nëse nuk dëshiron kështu, por do ta bëjë këtë haptazi kërko prej tij të heqë dorë nga mbrojtja që i ke ofruar ti, sepse ne nuk dëshirojmë që ta prishim besën tëndë, ani pse Ebu Bekrit nuk ia pranojmë veprimin publik.**

Mandej Ibnud-Degine - th Aishja - erdbi te Ebu Bekri dhe i tha: **“Ti e di se çka jam marre vesh me ty, prandaj ose përmbaju asaj ose hiq dorë nga mbrojtja ime, sepse unë nuk dëshiroj që arabët të thonë se unë kam tradhtuar njeriun të cilit i kam dhënë besë!”**

Ebu Bekri u përgjigj:

**“Po heqi dorë nga mbrojtja jote dhe jam i kënaqur me mbrojtjen e All-llahut”.**

Pejgamberi s. a. v.s. ne ate; kohe ishte ne Mekke. Pak pas kësaj Pejgamberi s.a.v.s. ka thenë: Mua më është treguar shtepia ku jeni shpërngulur ju, e kam pare moralin me pemishte midis dy shkrepave të zi, dy copa shkëmbi”. Kur e ka thënë këtë Pejgamberi s.a.v.s., në Medine erdhën kush e pat të vijë, madje në Medine i kthyen edhe disa nga ata të cilët më herët kishin shkuar në Abesini. Edhe Ebu Bekri bëhet gati për shpërngulje, prandaj Pejgamberi s.a.v.s. thotë: “Mos u ngut! Kam shpresë se do të më lejohet edhe mua shpërngulja”.

- A ke shpresë për këtë? U befsha kurban, tha Ebu Bekri.

- Po - u pergjigj ai

Prandaj u ndal edhe Ebu Berki per shkak te Pejgamberit s. a.v.s. që ta shoqeroje dhe i ushqei kater muja dy deve me gjeth therrash egjiptiane <sup>22</sup> (Krahaso, 2299, 4781’ 5371, 6131, 6745, 6763).

## **PASOJATE BORXHIT**

2298. - Na ka treguar Jahja b. Bukej, hëtij ketij i transmetoi nga Ukajl, ky nga Ibn Shihabi, ky nga Ebu Seleme, se Ebu Hurejara ka thene:

---

<sup>22</sup>Rasti i permendur tregon per flijimin makisimal moral dhe material te Ebu Bekrit per interes te bashkesise, dhe se njerezit e dobishem per një mes nuk duhet zhvendosur në mes tjetër, madje as nuk duhet lejuar të zhvendosen.

Muhamed b. Seleme thorë: “shkencëtarine nuk duhet dërguar në luftë se në vedn të tij mund të gjendet luftëtarë, madje edhe nëse ai insiston të shkojë, nuk duhet lejuar” **Këtë mednim e mbështesin në ajetnin 122 të suresë Tevbe gjithë besimtarët nuk duhet të shkojnë në luftë. Disa prej tyre, nga secila bashkësi, le të paraqiten të marrin rrugën e shkencës fetare dhe le t’i terheqin vërejtjen popullit të vet kur të kthehen nga lufta, ndoshta ata do të ruhen”.**

---

---

-Nesi i binin Pejgamberit a.s. te vdekurin qe ishte me borxhe, ai pyest:

**“A ka lënë ndonjë pasuri për borxhin e vet?”** dhe nesi i thuhej se kay ka lënë mjaft pasuri për borxhin e vet, ia falte xhenazen, në të kundërtën u drejtohej muslimanëve: **“Falnia shokut tuaj!”** Kur i jepte All-llahu pasuri nga luftërat, thoshte: **“Unë jamë te muslimanët më i rëndësishmë se veta ata, prandaj nëse vdes dikush nga muslimanët e varfër dhe lë ndonjë borxh, unë e kam për detyrë që ta paguaj, kurse kush lë ndonjë pasuri, ajo (me gjith borxhin u takon trashëgimtarëve të t ij”.**<sup>23</sup> (Krahaso:2298, 2299, 4781, 5371, 6731, 6745).

## **AUTORIZIMI I SHOQI-SHOQIT PËR NDONJË GJË**

Pejgamberi s. a.v. s. e pranoi Aliun bashkëpjesëmarrës në kurban, e pastaj e urdheroi qe ta shpëndaje

2299. -Na ka trguar Kabis a se i ka transmetuar Sufjani nga Ibn Ebi Nexhib, ky nga Muxhahidi, ky nga Adburrahman b. Ebi Lejla se Aliu r.a. ka terguar:

**- Më ka urdhëruar Pejgamberi s.a.v.s. që të shpërndajë sadaka mbulojat e deveve që ishin therur për kurbanë dhe lëkurat e tyre”.**

2300. - Na ka trequar Amr b. Ilalid, këtij Lejthi i transmeton n~a Jezidi, ky nga l\*, bu Hajri, kurse ai nga Ukbc b. Amr r.a. **se Pejgambéri s.a.v.s. ua dha shoLëve të vet fitimin e luftës**

---

<sup>23</sup>Hadithi i përmendur ven në pah nevojën e likuidimit me kohë të obligimeve materiale, ndaj tjerëve. Neveviu konsideron se të vdekurit lejohet t’i falet xhenazja vetëm atëherë kur paraëitet garantuesi për t’ia pagura borxhet.

Nëse vdes garanti, objekti i garancës do të kërkohet nga pasuria tij. Garanti liroht nga garancia kur borxhi i dorëzohet kreditorit (borxhliut) qoftë nga ana e borxhliut ose e garantit. Me të liruar të borxhliut nga ajo lërkesë, lirohet edhe garanti nga garancia që ka dhënë.

që ta shpërndajne dhe mbeti një edh. I trepuan Pejgamberit s.a.v.s., kurse ai i tha: “prej ti!”. (Krahaso: 2500, 5547, 5555).

**MUSLIMANI LEJOHET TË AUTORIZOJË  
JOMUSLIMANIN NË SHTETIN JOI SLAM  
OSE NË SHTETIN ISLAM**

2301. Na ka trceguar Abdu-l-liziz b. Abdullah i cili thote se i ka transmetuar Jusuf b. Fl-Maxllisbun nga Salih b. Ibrahim b. Abdurrahman b. Avf, ky nga babai dhe gjyshi i tij Abdurrahman b. Avfi r.a.:

- I shkrova Umejje b.Halefit nje leter qe te; mi ruaje njerezit e shtepise ne Mekke, ndersa une do te ruaj miqte e atij në Medine, por kur ia shkrova “**Rrahman**”, ai tha: “**Nuk e njoh “Rrahmanin”-in**, ma shkruaj emrin tend si e ke pasur ne periudhen xhabilije: “Atehere ia shkrova Abdu .Amr. Kur erdhi dita e Bedrit, dola deri ne nje koder qe ta mbroj kurse njerezit tjere flinin. Në këte moment pa Bilali dhe doli, u ndal te një grup i ensareve dhe tha: “**Mbajeni Umej b. Halefin! Nëse shpëton Umajje une nuk do të shpëtoj**”. Ateherë doli pas nesh një grup ensaresh dhe, pasi që kisha frikë se po na ndjekin, e alsh pas tyre djalin e tij që t’i vonojë, por ata e vranë dhe madje u krhen të na ndjekin. Ai ishte njeri i rëndë dhe kur na mbërrini, unë i thashë: “**Ulu!**” Ai u’ **ul dhe unë i hodha mbi te që ta mbroj, por ata e shpërthyen (therrën) me shigjeta, ashtu si ishte nën mua, sa gati e mbytën. Dikush nga ata më qëlloi edhe mua në këmbë.**

Abdurrahmani na trfoi gjurmën e atiu shpërthim në anën e mbrapme të këmbës <sup>24</sup> (Krahaso: 3971)

---

<sup>24</sup> Umejje b. Half ishte armik i përbetuar i muslimanëve.Një ditë i solli Muahmedit a.s. një asht të hudhur, e bëri thërrime para tij dhe tah: “O Muhammed, ti po thua se këtë do të ringjallë Zoti yt?”

---

---

## AUTORIZIM PËR NDËRRIM TË PARAVE

---

Umeri dhe Ibn Umeri kanë autorizuar tjetërkënd te nderrojë para.

2302, 2303. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se i ka transmetuar Maliku nga Abdul-Mexhid b. Suheil b. Abdurrahman b. Avf, ky nga Seid b. Musejeb, ai nga Ebu Said Hudri, kurse ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. e mori për mëkëmbës në Hajber nje njeri i cili i solli hurma të mira, dhe Muhammedit a.s. i tha:

“A janë kështu gjithë hurmat e Hajberit?”

- Ne - tha ai - **marrim një sa’ nga këto për dy sa’më të dohta, dhe dy sa’për tri tjera.**

- Mos veproni ashtu, tha ky. Shitni tëra të dobtat, sëbashku për para, e pastaj bleni më të mira për para!

Te njejtën gje e ka thënë për tërë artikuj që peshohen në kandar.

### **ËSHTË E LEJUAR QË BARIU OSE I AUTORIZUARI TË PRESË DELEN E CILA PO NGRODH, OSE DIÇKA QË PRISHET TA NDREQ, KUR ËSHTË NË RREZIK TË DËMTOHET**

2304. - Na ka treguar Is-Itak b. Ibrabim qe e ka degjuar Mu'temirin duke thënë:

Na ka lajmëruar Ubejdullahu që transmeton nga Nefiu se e ka degjuar Ibn Ka'b b. Malikun duke transmetuar nga babai i

Pastaj i fruni dhe pluhri i e shtrqve u shpërnda . Atëherë All-llahu xh.sh. shpalli ajetin 77-80 të sures Jasin- “a nuk e sheh njeriu se e kemi krijuar nga një pikë fare, kurse ai prapë bëhet kundrshtar flagrant! Dhe na solli një ëshembull ku e kishte harruar krijimin e vet, dhe tha: “Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben”? Thuaj: “do t’i ngjallë ai i cili i ka krijuar edhe herën eparë: Ai e njeh mirë çdo krijes. Ai i cili nga druri i njomë u bënë të mundshme që ju ta ndizni zjarrin”

vet se këta kishin një tufë dhensh që kullotnin në Sel'a. Robëresha jonë e pa një dele nga tufa jonë duke ngordhur dhe me të shpejtë e preu.

**Mos e hani!** - tha ai - **derisa ta pyes Pejgamberin s.a.v.s., ose ka thënë deri sa të çoj dikënd te Pejgamberi s.a.v.s. që ta pyes.**

Ai pastj e pyeti Pejgamberin s.a.v.s., apo çoi dikënd dhe e lejoi që ta hanë.

Ubejdullahu ka thënë: **“Më vjen çudi që ajo ishte robëreshë dhe ajo e ka prerë!”**

**Në versionin tjetër të transmetuesve Mutemirin e pason Abda që përcjell nga Ubjadullahu.<sup>25</sup> (Krahaso: 5501, 5502, 5504).**

---

<sup>25</sup> Për vlefshmërinë e autorizimit duhet oferta dhe pranimi i ofertës nga palët e interesuara. Autorizuesi duhet të thotë: “Te jap autorizim për këtë e këtë punë”, kurse i autorizuari thotë: “edhe unë e prano;”, ose ta bejnë kete me fjalë tjera që shprehin oferten dhe pranimin e autorizimit.

Autorizuesi duhet të jete vete i aftë ta kryejë punën e besuar. Në baze të kësaj nuk është i vlefshëm autorizimi me anë të të miturit dhe të marrit. I mituri i aftë nuk mund të autorizojë tjetër, qoftë edhe t'i ketë dhene leje kujdestari, për ato punë, që për të janë të demshme, siç janë dhuratat dhe sadaka, por mund të autorizojë tjetër kënd edhe pa kujdestarin, për ato punë që janë të dobishme për këtë, p.sh. të pranojë dhurata, sadaka, e të ngjashme.

Nga hadithi i permendur rezulton:

- deklaratën e bariut ose të besueshmit autorizuesi e perfill plotësisht, nëse ata nuk njihen si rrenacakë dhe njerëz janë të sigurtë.

- kasap mund të jetë gruaja, madje edhe femija, nëse është i aftë për këtë punë;

- kafshen duhet prerë me ndonjë mjet të mprehtë që mund të prese venat për të rrjedhe gjaku lirisht;

- lejohet ngrenia e misht: nga kafsha e prerë në momentin e fundit kur është duke ngordhur, nëse nuk është e semurë prej ndonjë semundje ngjitetse ose tjetër.

---

## AUTORIZIMI PËR ATË QË ËSHTË I PRANISHËM DHE ATË QË NUK ËSHTË I PRANISHËM

Abdullah b.Hmeri i shkroi shërbëtorit te vet, kur ai s' ishte i pranishëm, që të jap sadaka-fitrin per njerëzit e shtëpisë të mitur dhe të rritur.

2305. - Na ka treguar Ebu Nuajm, këtij Sufjani i transmetoi nga Seleme, ky nga Ebu Seleme se Ebu Hurejra r.a. ka thene:

- **Njëri kishte një deve njëvjeçare te Pejgamberi s.a.v.s. dhe erdhi ta paguaje.**

- **Jepjani** - tha Muhammedi a.s.

Ata kërkuan deve njëvjeçare, por nuk gjeten, veç me te vjeter se njëvjeçare, andaj Muhammedi a.s. tha: "jepjani ate!"

Ai mandej deklaroi: "Ma ke paguar plotesisht, All-llahut te dhashte!"

Atehere Pejgamberi s.a.v.s. deklaroi: "Ne mesin tuaj me te mire jane ate qe e paguajne borxhin me se miri".

## AUTORIZIMI PËR TË PAGUAR BORXHET

2306. - Na ka treguar Sulejman b. Harb se i ka transmetuar Shu'be nga Seleme b. Kuhejl:

E kam degjuar Ebu Seleme b. Abdurahmanin, ky Ebu Hurejren r.a. i cili thotë se një njeri erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. të kërkoi borxhin dhe u soll pak ashper. Sahabët deshën të ndajnë hesapin me të, por Pejgamberi s.a.v.s. tha: "Lereni atë!" Ai që ka të drejtë ai ka të drejtë të bëjë fjalë". Mandej tha: "**Jepjani një deve njëvjeçare sikur që ishte njëvjeçarja e tij!**"

- **O Pejgamber i Zotit** - thanë ata - **kemi vetëm që i ngjan njëvjeçares se tij?**

- **Jepjani ate** - tha ky - **sepse nga mesi juaj me i mire eshte ai qe paguan me se miri.**<sup>26</sup>

---

<sup>26</sup> I autorizuari e kryen punen qe i besohet plotesisht, edhe ne pranine e autorizuesit.

---

**LEJOHET DHURATA PËR PËRFAQËSUESIN E  
POPULLIT OSE NDËRMJETËSUESIT TË TIJ NË  
BAZË TË DEKLARATËS SË PEJGAMBERIT S.A.V.S.  
QE I THA DELEGACIONIT TË FISIT HEVAZIN,  
ME RASTIN E KERKIMIT TË ROBËRVE:**

Pejgamberi s.a.v.s atehere tha: "Pjesa ime është e juaja".

2307, 2308. - Na ka treguar Scid b. Ufejr qe thote se i ka transmetuar Lejthi këtij Ukajli nga Ibn Shibabi i cili thojte:

- Urve konfirmon se Mervan b Hakem dhe Misver b. Mallremc kanë kumtuar se Pejgamber; s.a.v.s. është ngritur në këmbë kur erdh delogacioni i fisit Havazin si musliman dhe kërkoi prej tij ttua kthejë pasurinë dhe robërit e tyre. Atehere Pejgamberi s.a v.s. tha: "Për mua është me i dushur ai që është më i singertë! Zgjidhne një nga këto dyja: ose robërit ose pasurinë. Unë i kam mbajtur bashkë: "Ashtu që kur u kthye Pejgamberi s.a.v.s. nga Taifi, priti edhe dhjete net e me tepër dhe kur ata u binden se Pejgarnberi s. a. v.s do t'ua kthejë vetëm njerën prej këtyre dyjave, thane: "Po vendosirn të marrirn robërit tanë".

Pastaj u ngrit Pejgamberi s.a.v.s. dhe në mesin e muslimanëve falënderoi All-llahun si i ka hije e mandej tha: "Tash këta i keni vëllezër. Kanë ardhur të penduar. Kam vendosur t'ua kthej robërit e tyre, dhe kush dëshiron nga ju që këtë ta bëjë vullnetarisht, le ta bëjë, e kush dëshiron të mbajë pjesën e vet deri kur t'ia paguajmë nga fitimi që do të kemi nga beteja e parë që na c cakton All-llahu xh.sh., le të veprojë ashtu".

Te pranishmit në kete moment thane: "Po ua japim vullnetarisht për hatër të Pejgamberit s.a.v.s.". Me këtë rast Pejgamberi s.a.v.s. tha: "Nuk e dimë cili nga ju e lejoi (me kompetencë) këtë e cili jo. Kthehuni që këtë vendim tuajin të na e konfirmojë edhe paria juaj!"

Atehere ata u kthyen biseduan me udheheqesit e tyre e pataj

---

u kthyen te Pejgamberit s.a.v.s.dhe i kumtuan se edhe ata kete e bene vullnetarisht dhe e lejuan <sup>27</sup> (Krahaso: 2529, 2584, 2607, 3131, 4318, 2540, 2583, 2608, 3122, 7177)

## **LEJOHET AUTORIZIMI I DIKUJT TË JAPË DIÇKA PA I SQARUAR SE SA, IA JEP SIPAS TARDITES SE VENDIT**

2309. - Na ka treguar Fl-Mekki b. Ibrahim, ketij i transmeton Ibn Xhurejxhi nga At'a b. Elbi Rebah dhe nga transmetues tjerë clë kanë transmetuar diçka por nuk e kanë përcjellë në tërësi, përvec njërit prej tyre i cili ka deklaruar se Xhabir b. Abdullahu r.a. ka thënë:

- Kam qenë me Pejgamberin s.a.v.s. në një ughëtim. Unë isha hipur në një deve të ngadalshme që gjithmonë ishte e fundit. Në një moment kaloi kah unë Pejgamberi s.a.v.s. **“Kush është ky?”** Xhabir b. Abdullau u pergjigja une.

- **Çka u bë kështu,** pyeti ai.

- **Kalëroj me një deve të ngadalshme,** thashë.

- **A ke shkop,** pyeti ai. - Kam - u pergjigja.

- **Ma jep mua,** tha Pejgamberi a.s.

- **Unë ia dhashë.** Ai i ra me të dhe bërtiti për ngadalësinë,

---

<sup>27</sup> Muslimanet, me 5 sheval te vitit 8 hixhrij ndërmoren një aksion të gjerë luftarak kundër fisit Hevazin që isht ei vendosur në luginën Hunejn. Pas përfundimit me sukses të luftës u zunë r5obër 6000 anëtarë të atij fisi, më se shumti femra dhe fëmijë, 2400 gjedhe dhe 40,000 gjë e tëi mta, kurse argjend rreth 4000 okë. Prej këtu Muhamedi a.s. niste për në Taif, e rrethoi dhe e mbajti 30 ditë, e mandae j kethehet dnë Medinë më qëllim që ta marrë vitin tjeër. Në rrugë të kthimit për Meidnë muslimantë u ndalën në Xhiran ku Muhammedi a.s. i pranoi të autorizuarit dhe përfaqësuesit të fisit Hevazin të cilët në ndërkhoë kishin pranuar fenë Islame, dhe Muhammedi a.s me pëlqimin e luftëtarëve, ua liroi robërit pa pagesë. Fitimi i luftës është pronë e luftëtarëve

---

dhe prej atenere ishte e para.

- **Shitma** - tha Muhammedi a s.

- **E jotja qoftë, o Pejgamber i Zotit**, u përgjigja unë.

- **Shitma!** - tha ai përsëri. Ta paqa marrë për katër dukat dhe ty të qoftë shpina e saj deri në Medine.

Pasi u afram në Medine unë shpejtova Muhammedi a s. pyeti **“Ku po ngutesh?”**

- **Jam martuar** - i thashë - me një grua së cilës i ka vdekur burri.- **Të ishte vajzë** - tha ai - do të kishte luajtur me të edhe ajo do të kishte luajtur me ty.

- **Më ka vdekur baba** - i thashë - **dhe ka lënë disa vajza dhe unë desha të martohem me një grua që ka përvojë dhe ka mbetur pa burrë.**

- **Ashtu është** - tha ai.

Pasi erdhëm në Medine, ai tha: **“O Bilal, pagaaja dhe jepi më shumë!”** Bilali i dha katër dinarë edhe një karat.

Xhabiri ka thënë: **“Shtesa e Pejgamberit s.a.v.s. nuk është ndarë nga unë”**.

Ai kirat, ka thënë A'tau, nuk u nda asnjëherë nga torba e Xhabir b. Abdullahut.

## **AUTORIZIMI I UDHËHEQËSIT NGA ANA E :NJË GRUAJE PËR TË LIDHUR KURORË - NIKAH**

**2310.** - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se i ka transmetuar Maliku nga Ebu Hazimi, ai nga Selh b. Sa'di i cili tha:

- Erdhi një grua te Pejgamberi i Zotit dhe i tha: **“Po ta lë amanet veten time ty!”** Ateherë një burrë i tha: **“Kurorëzoje me mna, o Pejgamber i Zotit”**.

- Të paqim vu kurorë me të - tha ai - për hir të asaj që ti di Kur'an.<sup>28</sup> (Krahaso: 5029, 5030, 5087, 5121, 5126, 5132, 5135, 5141, 5149, 5150, 5871, 7417)

---

<sup>28</sup> Në kapitullin “Kurorëzimi i varfanjakut” të Buharit, ky rast është mbarshtruar hollesisht Mandej Muhammedi a.s. i tha: **“Tash shko! Ta kam vënë kurorë për dhuratën Kur'anit”**.

---

---

**LEJOHET QË DIKUSH TË AUTORIZOJE NJE  
NJERI E KY TE LEJE MANGUT DIÇKA DHE  
AUTORIZUESI KETE E LEJON MË VONË, OSE I  
AUTORIZUARI I JEP HUA NDOKUJT PER NE  
KOHE TE CAKTUAR**

2311. - Osman b. Hejthem Ebu Amr ka thënë:

Na ka transmetuar Avf nga Muhammed b. Sirinë, ky nga Ebu Hurejre r.a

- Pejgamberi i All-llahut ma besoi të ruaj sadakatu-l-fitrin. Më erdhi një vjedhës dhe nisi të rrëmbejë ushqimin Unë e thira dhe i thashë: **“Pasha Zotin, do të padis te Pejgamberi s.a.v.s.”**.

- Unë, me të vërtetë, kam nevojë tha ai - Kam familje të madhe dhe nevoja të mëdha.

---

Pejgamberit te All-llahut i erdhi nje grua dhe i tha: “O Pejgamberi i Zotit, kam ardhur te dorezohem te ti”. Pejgamberi e shikoi dhe e preku me dore krese, e kur- ajo e pa se ky nuk i tha asgjë, ajo u ul. Në këte moment u ngrit një shok i tij dhe i tha: “O Pejgamber i Zotit, nëse nuk te duhet ty, bëne niqah me mual!”

-A ke ndonjë send per dhurate kurorë?, e pyeti Pejgamberi.

- Pasha Zotin nuk kam - u pergjigj ai.

- Shko në shtëpi dhe shiko mos ke ndonjë send! - i tha Pejgamberi a.s.

Ai shkoi ateherë, pastaj u kthye dhe tha: “Pasha Zotin, o Pejgamber i All-llahut, nuk kam gjetur asgjë.

- Hulumto, mos ke, të paktën, ndonjë unazë hekuri, i tha Pejgamberi.

Ai prapë shkoi në shtëpi, u kthye shpejt dhe tha: “O Pejgamber i All-llahut, nuk kam pasha Zotin, as unazë hekuri. Nik kam asgjë përvecc kësaj teshe që e kam veshur .

- Cka mund të bësh me atë teshë? Nëse e vesh ti, nuk ka ajo, e nëse e vesh këtë ajo, ateherë mbetesh ti pa te - i tha Pejgamberi a.s.

Ndejti edhe një kohë, ai njeri, e pastaj u ngrit dhe thirri dhe sapo erdh ai e pyeti: tllis, kurse Pej'ëramberi c thirri' dhe sapo erdhi ai e pyeti:

-”Çka di nga Kur'ani”

- Di kete c kete sure - u pergjigj ai.

- Do t'ia mësosh asaj - i tha Pejgamberi.

-Mire- u pergjigj ky

**Unë pastaj e lirova** - thotë Ebu Huriejre, dhc sapo gëdhiu, Pejgamberi s.a.v.s. pyeti: **“Ebu Hurejre, çka u bë mbrëmë me atë robin tënd?”**

E unë u përgjigja, thotë (Ebu Hurejra) **“O Pejgamber i Zotit, ai u ankua se ka familje të madhe dhe nevoja të mëdha, dde mua më erdhi gjynah dbe ia lëshova rrugën”**.

Ai me sigurit të ka mashtruar për atë çka të ka thënë - më tha Pejgamberi dhe ai do të vijë përsëri.

Kështu që unë e dija, me siguri, se ai do të vijë, nga se Pejgamberi s.a.v.s tha **“ai do të vijë përsëri”**, Unë e pritsha dhe ai erdhi, nisi të tubjë ushqim e unë e zura dhe i thashë: **“Po të paraqes të Pejgamberi a.s.”**

**Më lësho-** tha si - kam nevojë se kam familje të madhe, e nuk vij më!

Unë bërë mëshirë dhe e lëshova. Kur erdhi mëngjesi Pejgamberi s.a.v.s. më pyeti: **“O Ebu Hurejre, çka bëri ai robi yt?”**

- **O Pejgamber i Zotit, u përgjigja unë - u ankua për familje të madhe dhe unë bërë mëshirë dhe e lirova.**

- **Të ka mashtruar - më tha ai - do të vijë prapë.**

Pastaj e prita natë e tretë dhe ai erdhei, ia zisit të grtumbulloj ëushaim, dhe në e zura dhe i thashë: **“Pasha Zotin do të padis te Pejgamberi a.s. se kjo është hera e tretë.**

Ti thua se nuk do të vish më, e prape vjen”.

- **Më lësho, tha ai. Do të mësoj disa fjalë me ndihmën e të cilave do të fitosh ndihmën e All-llahut.**

- **Çfarë fjalësh jane ato, e pyeta une**

- **Kur bie për të fjetur - vazhdoi ai - kondoje “Ajetu-l-kursi;”, d.m th. “All-llahu është Një... deri në fund. Ateherë - tha ai - me ty do të jetë gjithmonë një roje nga ana e Zotit dhe nuk mund të afrohet shejtani deri në mëngjes.**

Une e lëshova dhe e prita namazin e sabahit, e Pejgamberi a.s me tha: **“Çka bëri mbrëmë i zoni rob?”**

---

**- O Pejgamberi i All-llahut - i thashë - ai ngulte këmbë të më mësojë disa fjalë për të cilat All-llahu do te më shpërblejë, dhe unë e lirova”.**

**- Çfarë fjalësh janë ato, pyeti ai**

- Kur të bie në shtrat - me tha - kondoje “Ajetu-l-kursijen” prej fillimi deri në fund: “All-llahu është Një... deri në fund dhe me ty - më tha do të jetë gjithmonë një roje nga ana e Zotit dhe shejtani nuk do të mund të afrohet deri kur të agojë.

As-habet kishin lajmi për çdo punë të mirë, më tepër se për gjithçka tjetër, e Pejgamber a.s. tha: “Ai të ka thënë të vërtetën e përndryshe ai është rrenacak i madh. O Ebu Hurejre, a e di ti me cilin ke folur tri netët e kaluara?”

- Nuk e di.

- Me shejtanin - tha Pejgamberi a.s.<sup>29</sup> (Krahaso: 3275, 5010)

## **SHITBLERJA E TË AUTORIZUARIT REFUZOHET, NËSE AI SHET NË MËNYRË TË PALIGJSHME**

2312. - Na ka treguar Is-haku, këtij Jahja b. Salih se i ka transmetuar Muaviu, i biri i Selemes nga Jahja:

E kam dëgjuar Ukbe h. Abdul-Gafarin i cili thoshte se e ka degjuar Ebu Seid B-Hudarin r.a. duke thënë “Bilali njehere i solli

---

<sup>29</sup> Sipas literatures se hadithit diçka e ngjashme i ka ndodhur Muadh b. Xhebalit, Ebu Zjub b Thabitit.

Nga ky hadith del perfundimi:

- Duket pranuar kur kerkoll falje dikush me arsvej

- çdo pune te mirë duhet nisur me Bismil-lah dhe me lutje që të përfundojë mirë e me fat.

- Sadakaifitr tubohet në mënyre te organizuar para Bajramit te Ramazanit, kurse ruajtja dhe shperndaria i besohet njeriut te caktuar te besueshëm;

- Me te dorezuar te sadakaifitrit muslimani e ka kryer detyrën e vet islame

- diturinë duhet pranuar edhe prej atij per kualitetet e punes se tij cilit nuk ke njohuri.

Pejgamberit s.a.v.s. hurma të mira”.

- Prej ku janë këto, pyeti Pejgamberi a.s.

- Tek ne hurmat janë të dobta - tha Bilali - dhe bëra këmbimin e një sa të dobta për një sahurma të mira që të nderoj Pejgamberin s.a.v.s..

- Ah, hə! - u çudit Pejgamberi s.a.v.s. - kamatë e mirë, plotësisht kamatë! **Mos bën ashtu, porse kur të duash të blesh, shiti ato llurma për ndonjë kundërvlerë tjetër (para, grurë, elb, e me ato pastaj blej).**<sup>30</sup>

### **AUTORIZIMI PËR VAKAF DHE SHPËRNDARJEN E TIJ, A MUNDET I BESUESHMI TË USHQEJË MIKUN E VET, APO TË USHQEHET VETË SIPAS TRADITËS**

**2313.** - Na ka trguar Kutjeibe b. Seld, ketij Sufjani i transmetoi nga Amr, i cili për vakafin nga koha e Umerit r.a. ka thënë:

“Për mirëmbajtësin (mutevel liun) nuk është gjuhah të ushqehet dhe të ushqejë ndonjë mik, por pa rezervuar, me këtë pasuri, për vete. Edhe Umeri , personalisht ka udhëhequr Vakufin e Emevijeve dhe ka dhënë ëdhura ta disa nga banorët e Mekkes, kur rrinte me ta.(Krahaso: 2737, 2764, 2772, 2773, 2777).

---

<sup>30</sup> Puna që i besohet te autorizuarit duhet të jetë caktuar dhe e njohur plotësisht. Autorizuesi duhet ta përshkruajë llojin e senclit të cilin i autorizuari duhet ta blejë. Nëse ai lloj ka shumë nënlloje tjera, duhet ta peshkruajë edhe nënllojill edhe cmimin e artikullit. Pa keto kushte të caktuara autorizimi nuk është i vlefshëm, me perjashtim nëse ka qenë dicka me karakter të përgjithshëm. I autorizuari nuk duhet që parjetër ta pranojë pullen te cilën i autorizuari e ka kryer ne kundërshtim me kushtet e caktuara me pare.

---

---

---

## AUTORIZIMI PËR DËNIM

2314, 2315. - Na ka treguar Ebu-l-Vdid, këtij Tejthi nga Ibn Shibabi, ai nga Ubejdullahu, ky nga Zejd b. Halidi dhe Ebu I Hrejre se Pejgamberi s.a.v.s. ka thenë:

**“O Unejs, shko më shpejt te ajo grua, dhe nëse pranon (veprën) ekzekutoje me gurë!”** (Krahaso: 2649, 2696, 2725, 6634, 6878, 6831; 6847, 6859, 7193, 7250, 7700, 7278)

2316. - Na ka treguar Ibnu Sel-lam se i ka transmetuar Abdu-l-Vebbab, ky nga eth-TheLafi nga Ejjubi, ai nga Ibn Ebu Mlulejke, ky nga Ukbe b. Harith i cili thote: - E sollën Nujmanin, apo Ibu Nujmanin, te dehur dhe **Pejgamberi s.a.v.s. u urdhëroi atyre që ishin në shtepi që ta rrahin. Ndër ata që e rrahën - tha ai - kam qenë edhe unë. E kemirrahur me këpucë dhe me rrema, degë.** (Krahaso: 0774, 0775).

## AUTORIZIMI PËR TË SHFRYTËZUAR DEVET

2317. - Na ka treguar Ismail b. Abdullah i cili thotë se i ka transmetuar Maliku nga Abdullah b. Ebi Beker b. Hami, ky nga Amra, e bija e Abdurrahmanit, e cila i ka kumtuar se Aishja r.a. ka thenë:

---

Ai qe eshte i autorizuar ne shitje, pa kufizim, artikullin e besuar mund ta shesë shtrenjte ose lirë, per shumën qe e konsideron të arsyeshme. Nëse pronari e ka caktuar cmimin i autorizuari nuk mund ta shesë me lirë, e nëse bën ashtu, autorizuesi mund të kërkoje per të ndryshimin konkret. I autorizuari i kufizuar për të shitur diçka, atë gjësend nuk mund ta marrë për vete, gjegjësisht nuk mund t'ua shesë personave, dëshmia e të cileve nuk është e vlefshme sipas sheriatit nëse deshmon në dobi të këtij. Bën përjashtim nëse e shndërron në para per cmim me të larte se sa te ndonje blerës tjetër. I autorizuari i pakufizuar mund ta shesë pasurinë e pronarit per para te gatshme ose me të pritur në afat të caktuar per pagese, që është e zakonshme në atë mes. Nëse te atutorizuarit pronari i lejon ne menyre decidive ose me heshtje shitjen për para të gatshme, ai nuk mund te shese asgje me afat per te pritur.

---

---

- “Unë u kam thurur qafore të gjithë kurbanave të Pejgamberit a.s. me këto dy duar të mia, kurse Pejgamberi s.a.v.s. ua varte me dorë të vet dhe i niste me babën tim. Pejgamberi s.a.v.s. nuk i ndalonte vetes asgjë çka ia kishte lejuar All-llahu, ashtu që edhe kurban është prerë (te Qabeja)”.

**KUR I THOTË TË AUTORTZUARIT:**

**“KRYEJE PUNËN SIÇ TË KA URDHËRUAR ALL-LLAHU” E AI PËRGJIGJET “E MORA VESH ÇKA THE”**

2318. - Na ka treguar Jahja b. Jahja i cili thote: ia kumtova Malikut transmetimin nga Is-hak b. Abblullahu i cili kishte degjuar Enes b Malikun r.a.

- Ebu Taha në Medine ishte Ensariu me i pasur, por pasurinë më të dashur e kishte pemishten Biruha që gjendej përballë xhamisë. Pejgamberi s.a.v.s. hynte aty dhe pinte ujë, e kishte ujt e mirë. Kur u shpall: “Nuk do të arrini bërësinë derisa të jepnj **atë që e duani** në së shumti”. Ebu Taha shkroi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i tha:

- O Pejgamber i Zotit, All-llahu xh.sh. në Librin e tij thotë: “Nuk do të...” e ime pasurinë më të dashur e kam në Biruh. Dhe unë e dhuroj në emër të All-llahut. **Shperblimin për këtë shpresoj** se e gjej te All-llaut. Ben me te çfare te duash, o Pejgamberi i All-llahut.

- Të lumtë, tha Pejgamberi. A, o pasuri është e mirë! Ajo njëmend është pasuri e këndshme! le dëgjova se çka the për të dhe konsideroj se është më mirë që **ate t’ua ndash** (caktosh) të afërmeve tu!

- Do te veproj ashtu, o i Dërguari i All-llahut - tha ai.

Ashtu që Ebu Talha ua ndau farefisit te afërt dhe kushrrinjve te vet.

Sipas versionit tjetër të transmetuesve, Jadjan e mbështet

---

---

Ismaili cili transmeton hadithin nga Maliku.

Revhi transmeton nga Maliku “me lavërdi”.<sup>31</sup>

## **AUTORIZIM TË BESUESHMIT PËR TË RUAJTUR ARKË etj.**

2319. - Na ka treguar Muhammed b. A'la, këtij Ebu Usame i transmetoi nga Burejd b. Abdullahu, ky nga Ebu Burejdi, ky nga Ebu Musa r.a. se Pejgamberi, s.a.v.s. ka thënë:

Arkëtari i besueshëm i cili shpërndan, nganjëhere thoshte, i cili e jep në tërësi ate çka i urdhërohet me vullnet te plotë atij për të cilin in urdhërohet, është një nga bëmiresitë - është hëmirës.

## **VLERA E BUJQËSISË DHE PEMTARISË**

Dhe fjala e All-llahut xh.sh. që thotë: “*A e shihni çka mbillni? A e bëni ju të mbijë ajo, apo e mbijmë ne? sikur të dëshironim mund ta bënim të pafrytshme dhe do të ishit habitur*”.

(*Kur'an, 56. 63-65*),

2320 - Na ka treguar Kutjeve b.Seid, këtij Ebu Avane, sipas një senedi tjetër, ka treguar Abdurrahman b. Mubarek se Ebu Avane ka transmetuar nga Katade se Enesi r.a. ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “**Muslimanit që mbjell një pemë ose një bimë nga e cila ha sa thërmia, shpendi, njeriu ose kafshët i llogaritet sadakë e vaçantë**”

Muslimi ka thënë se i ka transmetuar Ebani, të cilit Katade

---

<sup>31</sup> Personi i autorizuar për në punë nuk mund të autorizojë tjetër për ate punë, vetëm nese ia lejon autorizuesi ose i thotë: “Puno sipas vlerësimit tend, ose si të duhet ty më mirë”.

---

---

i ka kumtuar nga Enesi, kurse Enesi nga Pejgamberi s.a.v.s..<sup>32</sup>  
(Krahaso: 6012).

**PUNËT GJATË TË CILAVE DUHET RUAJTUR  
NGA PASOJAT E MJETEVE TË BUJQËSISË  
DHE TRANSPORTT I TYRE NË VENDE TË  
CAKTUARA**

2321. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Abdullah b. Salim alhimsi, i cili thotë se i ka transmetuar Muhammed b. Zijad al-Hani nga Ebu Umam al-Bahili, i cili ka thënë se kishte parë plurin dhe ca mjete tjera për lavër dhe ka thënë:

**- E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë: “Këto**

---

<sup>32</sup> Ngjashëm sikur kjo deklaratë transmetojnë edhe muhadithë tjere. Ahmedi ne Muvattain e tij, me anë të Ebu Ejub Ensariut, ka shënuar se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Nuk ka njeri që mbëlton një pemë e All-llahu të mos i caktojë shpërblimin sipas prodhimit të fryteve të asaj peme”. Muslimi me anë të Xhabirit, ka cvidentuar këtë deklaratë të Muhammedit a.s.:

“Nuk ka musliman që mbëlton një pemë e që për tërë atë çka hahet prej frutave të saj të mos i llogaritet sadaka: ajo çka mirret prej saj, pa leje, është sadakë, ajo çka hanë shpezët është sadakë, dhe askush nuk do të hajë asgjë e kjo të mos i llogaritet shpërblim i veçantë i sadakës”.

Me një rast Muhammedi a.s. hyri në pemishten e Hmimi Ma’bedit dhe pyeti: “Kush e ka mbjellë këtë pemë, muslimani apo jomuslimani?”

- Muslimani - u përgjigj plaka.

- Muslimani nuk do të mbjellë - tha ai - kurrfarë pemë as bimë e nga këto të haje diçka njeriu ose kafsha apo diçka tjetër, e që e tërë kjo të mos i llogaritet sadaka e veçantë.

Nga hadithi i përmendur rezulton:

- kultivimi i bujqësisë është shumë i rëndësishëm dhe punë e lavdëruar. Neveviu i jep përparësi bujqësisë, kurse disa tierë veprimtarisë ekonomike;  
- shpërblimin e përmendur bujku e meriton edhe nëse kur e ka mbjellë bimën ose vpemën nuk ka menduar për bëmirësi humanitare, por vetëm për nevoja të veta, ngase edhe me këtë njerzimit i ndihimohet pjesërisht.

---

---

**nuk hyjnë në shtëpi të njerëzve pa sjellë edhe përulje”.**

Muhamed b. Zijad ka thënë: **“Emri i Ebu Umames është Sudaj b. Axhlan”.**

## **PËRGATITJA E QENIT PËR LËVRIM**

2322. - Na ka treguar Muadh b. Fedale, këtij Hishami i transmetoi nga JaUja b. Ebi Kethiri, ky nga Ebu Seleme, kurse ai nga Ebu Hurejra r.a. i cili ka thënë:

**- Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Kush mban qen, për çdo ditë i pakësohen punët e mira nga një karat, me përjashtim të qenit për lavër dhe për bagëti. Ibn Sirini dhe Ebu Salih kanë deklaruar se kanë dëgjuar nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “... me përjashtim të qenit dbenve, të lavrës dhe të gjuetisë”, kurse Ebu Hazimi ka transmetuar nga Ebu Hurejreja r.a. kurse ky nga Pejgamberi a.s ... përveç qenit të dhenve dhe të gjuetisë.<sup>33</sup> (Krahaso: 3324)**

2323. - Na ka treguar Abdulla b. Jusuf se i ka transmetuar Maliku nga Jezid b Husajf, këtij Saib b Jezid i cili i transmetot nga Sufjan b Juhejri, nje burr nga fsi Ezdishana qe është nga shoket e Pejgamberit a.s i cili ka thënë:

**- E kam degjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “Ai që mban qen, i cili nuk i duhet për te mbrojtur fushën (te rnbjcelurat) ose bagëtitë, i pakësohet për çdo ditë nga një kirat nga punët e tij të mira”.**

**- Ti këtë e ke dëgjuar nga Pejgamberi a.s. - e pyeta unë?**

**- Po, - tha ai - pasha Zotin e kësaj xhamie. (Krahaso 3325)**

---

<sup>33</sup> Perktimi ne teresi i hadithit te permendur pjeserisht eshte: “Ai qe mban çfaredo qeni qofë, perveç qenti te gjuetise dhe qenit bagetise, e humb shperblimin e puneve te veta te mira per çdo dite nga nje karat”.

---

---

---

**PËRDORIMI E LOPËS PËR LAVER**

2324. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij Gunder i cili thote se i ka transmetuar Shu'be nga Sad b. Ibrahim b Abdurrahman b. Avf Zuhriu i cili thotë:

E kam dëgjuar Ebu Selemen që transmeton nga Ebu I Iurejreja r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

- **Një njeri kishte shaluar lopën dhe ecte, e ajo i kthehet e i thotë: Nuk jam e krijuar për këtë - për kalërim - Unë jam e kirjuar për lavër”.**

- **Këtë e besoj - tha Muhammedi - unë, Ebu Bekri dhe Umeri.**

**Ujku, në një rast, rrëmbeu delen dhe bariu iu vu ta ndjekë. Ujku i tha: “Cilin ka kjo sot bari, në këtë ditë të egerësisë? Nuk ka tjetër bari përveç meje?”**

- **Këtë e besoj - tha ai - unë, Ebu Bekri dhe Umeri.**

- **Por ata dy — ka thënë Seleme - nuk ishin atëherë në mesin e këtyre. Nuk ishin të pranishëm. (Krahaso: 3471, 3663, 3690).**

**KUR DIKUSH THOTË: “MË NDIHMO TË PUNOJ  
PEMISHTEN OSE DIÇKA TJETËR DHE DO TË  
JESH PJESËMARRËS (ORTAK) NË FRYTET E  
TYRE”**

2325. - Na ka treguar Hakem b. Nafiu, këtij i transmetoi Shuajbi, që thotë se i ka transmetuar Ebuz-Zinadi nga A'rexhi se Ebu Hurejre r.a. tregon:

- **Ensaret i patën thënë Pejgamberit s a.v s.: “Ndaji ndërmjet nesh dhe vëllezërve tanë të ardhur nga Mekka pemët!”**

- **Jo, - tha ai.**

- **Po a do të na ndihmoni të punojmë - pyetën ata - dhe të jem bashkëpjesëmarrës në fryte.**

---

- **Dëgjuam dhe u pajtuam** - thanë muhasherët. (Krahaso: 2719 3782).

## **PRERJA E TRUPAVE TË PEMËVE**

Enesi ka thenë: **“Pejgamberi s.a.v.s. ka urdhëruar dhe pema është prerë”**.

**2326.** - Na ka treguar Musa. b. Ismail, këtij Xhuvjeri që transmetuar nga Nafiu ky nga Abdullahu r.a. kurse ky nga Pejgamberi s.a.v.s. se e kishte- ndezar pemishten e fisit benu Nadir dhe e kishte prerë. Pcmishtja ishte ne Buvjer, për të cilën Hasani ka kenduar: **“Janë poshtëruar robët e Benu Luejjet me zjarrin në Buvejr dhe janë përzënë.”**<sup>34</sup> (Krahaso: 3021, 4031, 4032, 4884).

2327. - Na ka treguar Muhammed b. Mukatil se i ka transmetuar Abdullahu i cili thotë që i ka kamtuar Jahja b. Seid nga Hanzale b. Kajs El-Ensariu, i cili ka degjuar Rafi'a b. HaxhxUaxhin duke thënë:

- Nga banorët e Medines, më së shumti, ne jemi marrë me bujqësi. E merrnim me qesim tokon në luginë të Medines që ishte e rrethuar, ndarë për pronarin e tokës, dhe këtë pjesë nganjëherë, do të thotë, Rafiu - e godiste fatkeqësi, kurse toka tjetër shpëtonte; e ndonjëherë rrëmuja e godiste këtë (tokon e marrë me qesim) dhe shpëtonte ajo tjetra (e atij që e jepte me qesim), prandaj na është ndaluar, e atëherë nuk ka pasur ari e argjend”.

---

<sup>34</sup> Vitin e katert hixhti eshte organizuar një ekspedite ushtatake kundër fsit heurej. Benu Nadir kishte vendosur të banojë ne Buvejr, fortifikatat e te cilit me kishte pasur mundësi të mposhtet pa veprimet e permendura. Ndjekja e hebl-etljve nga ky vendbanimi është pezantuar në suren Hashr, në Kur'an.

---

---

**PUNIMI I TOKËS ME PËRGJYSMË OSE TË  
NGJASHME**

---

Kajs b. Niuslimi transmeton nga Ebu Xhaferi: “Në Medine nuk kishte asnjë shtëpi muhaxheri që nuk punonte tokë me një të tretën ose një të katërtën. Kështu ka punuar tokë: Aliu, Sa’ad b. Maliku, Abdullah b. Mes’udi, Umer b. Abdu-l-Aziz, Kasimi, Urve, familja e Ebu Bekrit, e Umerit e Aliut dhe Ibn Sirin.

AbdurraLman b. Esved ka thënë: “E kam marrë Abdurrahman b. Jezidin që të punonim bashkë në bujqësi”.

Umeri e jepte token ta punojnë tjerët dhe kur ua sillte Umeri faren merrte gjysmën e prodhimit, e nëse ata e mbillnin me farën e vet edhe ata ashtu e kishin.

Hasani ka thënë: “Nuk ka asgjë të keqe nëse toka është te **njeri prej atyre dyve, por e mirëmbajnë bashkërisht dhe rendimentin** nga ajo tokë e kanë së bashku. **Njëlloj kështu konsideronte edhe Buhriu**”.

Hasani shton: “Nuk është e ndaluar që pamuku te vilet me përgjysmë”, kurse Ibrahim, Ibn Sirini, Hakemi, Zurlliu dhe Latade kane thenë: “Nuk ka pengesë që të jepet me një të tretë ose të katërtë... të vejurit, pëlhura”.

Ma’meri ka thënë: “Nuk ka gjë të keqe që bagëtia të jepet me një të tretën ose të katërtën për afat të caktuar”.

2328. - Na ka treguar Ibrabim b Mindhiri, ketij Encs b. Ijad që transmeton nga Ubejdullahu, kurse ky nga Nufiu se Abdullah b Umer r.a ka kumtuar se Pejgamberi s.a.v.s. **e dha Hajberin të punohet me përgjysmë, çkado që bëhej prej aty, qofshin pemë ose të lashta, bashkëshorteve të veta a jepte nga njëqind barre: tetedhjetë barrë hurma dhe njëzet barre elb.** Më vonë Umeri e ndan Hajberin dhe ndau pjesen grave të Pejgamberit a.s. u dha te drejte te zgjedhin t’u ndahet pjesa e tokës dhe e ujit .po te vazhdojë praktika e mehershme. Disa prej tyre zgjodhen token, kurse tjerat barrët Aisheja r.a zgjodhi token.

---

## PUNIMI I TOKËS ME QESIM PA KUSHTËZUAR SE SA VJET

2329. - Na ka treguar Museddedi, ketij Jahja b. Seicl që transmeton nga Ubjedullahu, këtij Nafiu i transmetoi nga, Ibn Umeri r. a.

“Pejgamberi a.s. e ka dhënë Hajberin ta punojne tjerët me përgjysmë çfarëdo që prodhohej aty qoftë peme ose të lashta”.

2330. - Na ka treguar Alii b. Abdullah, këtij Sufiani se Amri ka thene:

- I kam thënë Tavusit: “ta lësh dhenien e tokës me të **tretë** (qesim) sepse disa konstatojnë se Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar”.

- O Amr, - i tha ai - unë u jap dhe me këtë u ndihmoj, e unë me **siguri e di këtë** çështje **-me mire se ata.**

Më ka kumtuar - mendonte ne Ibn Abbasin r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s.** nuk e ka ndalual këtë, porse ka thënë: “**Sikur dikush prej jush t’i falë, dhurojë, vellait të vet, është më mirë se sa të marrë ndonjë shumë te caktuar**”. (Krahaso: 2342, 2634).

## PUNIMI I TOKËS ME HEBRENJTË

2331. - Na ka treguar Muhamed Ibn MuLatil, këtij Abdullahu, këtij -Ubjebullahu që transmeton nga Nafiu se Ibn Umeri r.a ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ua ka dhënë Hajberin hebrenjve ta punoj në dhe mbjellin dhe ata prej tërë kësaj marrin gjysmën e prodhimit”.

## KUSHTET QE NUK JANE TE PELQYESHME NE PUNIMIN E TOKËS ME PËRGJYSMË

2332. - Na ka treguar Sadala b Faul se i ka transmetuar Ibn Ujejne nga Jahja i cili ka dëgjuar Hanzal ez-Zerehlin që transmeton se Rafiu r.a ka thënë:

- Më së shumti, nga banorët e Medines, ne jemi marrë me punimin e tokës. Disa prej nesh merrnin tokën e tyre me qera (qesim) me marrëveshje: “Kjo pjesë është imja, e ajo pjesë e jotja!”, e nganjëherë ky e punonte e ai tjetri nuk e punonte. Këtë ua ndaloi Pejgamberi s.a.v.s..

### **PUNIMI I TOKES ME KAPITALINE TJETËRKUJT PA LEJEN E TYRE, POR KANË FITIM EDHE ATA**

2333. - Na ka treguar Ibrahim b. Mundhir, këtij Ebu Damre që thotë se Musa b. Ukbe i transmetoi nga Nafiu, ky nga Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Udhëtonin njëherë tre vetë dhe i zuri shiu. Këta u strehuan tek një shpellë në mal. Në hyrje të shpellës u shemb një gur i madh dhe e mbylli derën e shpellës. Dikush prej tyre tha: “Analizoni veprat tuaja të mira që koni bërë për hir të All-llahut dhe në emër të asaj vepre lutjuni All-llahut, ndoshta ua heq këtë nga dera”.

Ateherë njëri prej tyre tha: “O Zot, i kam pasur prindërit të moshuar e të lodhur dhe kisha fëmijët shumë të vegjël e unë ruaja bagëtitë. Çdoherë kur vija në mbrëmje i milja. Njëherë ushqeja prindërit me ta, para se të ushqej fëmijët. Një ditë u vonova dhe nuk arrita derisa ra terri ashtu që i gjeta duke fjetur. Unë i mola bagëtinë, siç veproja edhe më herët, u ndala mbi krye te prindërve, por më erdhi kaq t’i zgjoj, dhe nuk desha t’i ushqej fëmijët që Më lusnin duke qarë, deri në agim.

Nëse këtë e ke pranuar se e kam bërë; per hir tëndin, të fitoj konaqësinë tënde, hape pak që të shohim qiellin!”

---

**Dhe All-llahu xh.sh. bëri që të largohet pak dhe e panë qiellin.**

**Tjetri tha:**

**- O Zot, e kam pasur një vajzë të mixhës dhe e dushuroja siç mund të dashurojë mësë shumti burri në femër. Kërkova prej saj marrëdhënie intime por ajo nuk pranoi pa i dhënë njëgind dukatë. I lypa dhe i mblodha dhe kur u gjenda ndërmjet këmbëve të saj, ajo tha: “O rob i Zotit, frikësoju Zotit! Mos më prish vajzërinë pa paguar çmimin e kurorës! Unë hoqa dorë. O Zot, nëse këtë e pranon se e kam bërë për hir tëndin, të arrij konaqësinë tënde, hape pak hyrjen! U hap edhe pak.**

**I treti vazhdoi:**

**- O Zot, unë mora një punëtor me mëditje për një grusht grurë, dhe kur e kreu punën tha: “Ma jep haLun tim!” Unë ia afrova e ai nuk e mori, s’deshi ta pranojë. Unë atë vazhdimisht e mbolla dhe nga ajo grumbullova lopë dhe i dhashë në loparë. Dikur ai erdhi dhe tha: “Kij dronë All-llahut!”**

**- Shko - i thashë - te ai lopari, te ato lopët atje, dhe merri!**

**- Kij frikon Zotit, dhe mos luaj me mua, ma ktheu ai.**

**- Unë nuk luaj - ia ktheva - shko dhe merri krejt!**

**Ai, pastaj, i mori. Nëse Ti konsideron se këtë punë e kam bërë për hir tëndin, për të fituar konaqësinë Tënde, hapna derën!**

**Në këtë moment hyrja u hap tërësisht.**

**Ebu Abdullahu (Buharju) thotë: Ibn Ukbe ka transmetuar nga Nafiu: “... jam përpjekur (në vend se “kam lypur”). (Krahaso: 2272).**

---

**VAKAFI I SAHABËVE TË PEJGAMBERIT A.S.  
DHE TOKA E HARAXHËVE, MBJELLJA DHE  
PUNA**

Pejgamberi a.s. i tha Umerit: “Lëre vakaf sipas normës, që nuk mund të shitet por vetëm prodhimi që mund të shfrytëzohet. Ai ashtu bëri vakuf”.

**2334.** - Na ka trequar Sadaka, këtij Abdurrahmani që transmeton nga Maliku, ky nga Zejd b. Uslemi, kurse ai nga babai i vet.

Umeri r.a. ka thënë: “Sikur të mos ishin muslimanët e mëvonshëm do t’ua kisha shpërndarë menjëherë çdo vend që e merrnim atyre që kanë të drejtë në fitimin e luftës, ashtu siç e ndau Pejgamberi s.a.v.s. Hajberin.” (Kahaso: 3125, 4235, 4236).

**AI QË E RINGJALL (RIPUNON) TOKËN**

Aliu e konsideronte tokën rreth Meekes si tokë e lënë djerrë, dhe Umeri (b. Avfe) ka thënë: “**Kush e kultivon një tokë që është duke vdekur, ajo është e tij**”.

Gjithashtu transmeton nga Umer b. Avfi se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

“... përveç nëse me ligj është në shfrytëzim te muslimani dhe nuk ka ndonjë të drejtë ndokush që të mbjellë pemë”.

Hadithin e transmeton edhe Xhabiri nga Pejgamberi s.a.v.s..

**2335.** - Na ka treguar Jahja b. Bukejr, këtij Lejthi i transmetoi nga Ubejdullah b. libi Xhaferi, ky nga Muhammed b. Abdurrahmani, ai nga Urve kur ky nga Aisheje r.a. se Pejgamberi s.a.v.a.

“**Kush e ripunon (ringjall) tokon që nuk i takon askujt, ajo është e atij**”.

Urve ka thënë: “**Sipas kësaj ka gjykuar Umeri në kohën**

---

---

**e halifatit të vet”.**

2336. — Na ka treguar Kutjeje, këtij Ismail b. Xhalker, që transmeton nga Musa b. Ukhe, ky: nga Salim b. Abdullah b. Umer, ky nga babai i vet r.a. se Pejgamberin s.a.v.s. e panë në pushimoren e tij në Dhu-Hulejf, në luginën “Batnu-l-di, dhe i thanë: “Ti je në luginën e bekuar e Mekkes”.

Musa ka thënë: “Salimi pusllonte me ne (mrizonte devet) aty ku ,mizonte deveja e Abdullahut. **Ai kërkonte vendpushimin e Pejgamberit a.s. që ishte në anën e poshtme të xhamisë e cila gjendej në mes të luginës. Ai vend ishte disi në rnes të xhamise dhe rrugës”.**

-Na ka treguar Is-hak b. Ibrhaim, këtij Shu’be b. Is-hak që transmelon nga Evzaiu i cili ka thënë se Jahja i ka përcjellë nga Ikrime, ai nga Ibn Abbasi, ky nga Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **Sonte më është shpallur prej Zotit** (në këtë kohë ishte në luginën Akik) - urdhëri: “Falunë në këtë luginë të bekuar dhe vendos... edhe umren për këtë haxh”.

### **KUR PRONARI I TOKËS THOTË:**

**“TE UNË JE SA TË KETË THËNË ALL-ALLAHU”,  
PA E PËRMENDUR AFATIN, ME ÇKA TË DY PALËT  
ISHIN TË KËNAQUR**

2338. - Na ka treguar Ahmed b. Mikdam, këtij Fudajl b. Sulejman i cili thotë se i ka thënë Musa se i ka transmetuar Nafiu nga Ibn Umeri r.a. që thotë:

- **Pejgamberi a.s., i ka zhvendos hebrenjtë, kurse Abdurrezaku ka deklaruar se këtij i ka thënë Ibn Xhurejxhi, të cilit i transmetoi Musa b. Ukbe nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri, se Umer b Hattabi r.a. i zhvendosi hebrenjtë dhe të krishterët nga toka e Hixhazit. Kur e sundoi Hajberin Pejgamberi a.s. deshi t’i zhvendos hebrenjtë, sepse çdo**

---

---

**vend ku hynte ky, i takon All-llahut dhe të Dërguarit të tij dhe muslimanëve.<sup>35</sup>**

Dhe kur deshi t'i zhvendosë hebrenjtë nga Hajberi, hebrenjtë kërkuan që të rrinë aty, të punojnë toLën me për gjysmë të prodhimit. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. u tha: **“Do t’ju mbajmë këtu sa të duam”**. Kështu ata qëndruan aty deri kur i zhvendosi në Tejm dhe Erih.<sup>36</sup>

### **AS-HABËT E NDIHMONIN NJËRI-TJETRIN NË PUNË TË BUJQËSISË EDHE PEMTARISË**

2339. - Na ka treguar Muhammed b. Mukatil këtij Abdullahu, këtij Evazaiu i transmeton nga Ebu Nexhashi, rob i lirnar i Rafi b. Hadixh, i cili thotë:

Kam dëgjuar Rafi b. Hadixhin, ky e ka dëgjuar axhën e vet Zubejr b Rafi se Zuhejri ka thënë: “Pejgamberi a.s. neve na ndaloi një gjë me të cilën ne **ishim shoqëruar**”.

Unë i thashë (rrëfen Rafi) “Ajo çka ka thënë i Dërguari i All-llahut është shumë e saktë”.

- Më thirri Pejgamberi s.a.v.s. - thotë Zuhejri - dhe më tha: **“Çka bëni me arat tuaja?”**

---

<sup>35</sup> Halifi Umer tokën që e merrnin me luftë nuk ua jepte luftëtatëve por ua linte ta punojnë të mundurit, me kusht që rregullisht të paguajnë: tatimin që mund të ishte nga e katërta deri me përgjysmë të prodhimit në tërësi.

Kapitali ka ndikim pozitiv të të mençurit, kurse tek të marrët ushtron ndikim negativ. Për të mençurin është fat a për shkrtpamesinë sill është fatkeqësi. Gjeneratat e para të muslimanëve kanë jetuar në pasuri të pakufishme e më vonë në varferi dhe mjerim, pa kurrfarë ndihme materiale nga ana e bashkësisë. Tatimi i aplikuar me emertimin haraç tatimi tokë, dhe xhizje - tatim për ushtrinë, perbënin fondin për nevojat e përgjithshme shtetërore, shpenzime të ushtrisë dhe ndihme të rezikuarve.

<sup>36</sup> Pronari i pasurisë mund ta japë për shfrytëzim pronën e vet për kohë të caktuar për një ditë, një vjet apo me tepër, kurse qeranë mund ta kontraktoje mujore, disa mujore ose vjetore, në natyrë ose me të holla.

---

---

- I japim me qira - i thashë unë - me një të katërtën ose me barrë **hurماش dhe elbi**.

- Mos bëni ashtu, tha ai. Punone vetë, ose jepne ta punojnë tjerët ose mbane për vete.

Unë i thashë - thotë Rafiu "Dëgjova dhe u binda!" (Krahaso: 2346, 4012).

2340. - Na ka treguar Ubjedullah b. Musa, këtij Evaziu nga At'au, ai nga Xhabiri r.a që ka thënë: "... e **kanë punuar** me një të tretën, një të katërtën dhe me përgjysmë, andaj Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Kush ka tokë le ta punojë ose le t'ia falë tjetrit, nëse nuk do ta punojë le ta mbajë si tokë për vete!" (Krahaso: 2632).

2341. - Rafia b. Nafi Ebi Tevbe ka thënë se i ka transmetuar Muavia nga Jahja, ky nga Ebu Seleme, ky nga Ebu Hurejre r.a. i cili ka thënë:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Kush ka tokë le ta punojë vetë ose le t'ia falë vëllait të vet, e nëse do le ta mbajë tokon e vet për vete!"**.

2342. - Na ka treguar Kabisa, këtij Sufjani i transmetoi nga Amri:

- Ia përmenda, çka u tha më lart, Tavusit, e ai tha: "**Mundet me qera, sepse Ibn Abbasi r.a. ka thënë: Pejgamberi s.a.v.s. nuk e ka ndaluar këtë, por ka thënë: "T'ia falë vëllait të vet është më mirë se sa të marrë ndonjë çmim për të"**.

2343. - Na ka treguar Sulejman b. Harb, këtij Hammadi i transmeton nga Ejubi, ky nga Nafiu se Ibn Umeri r.a. e jepte me qesim tokën vet të punueshme në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., në kohën e Ebu Bekrit, Umerit, të Osmanit dbe në fillim të udhëheqjes së Muaviut. (Krahaso: 2345).

2344. - Më vonë është transmetuar nga Rafi' b. Hadixh se

---

---

Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar qiranë e arave, prandaj Ibn Umeri shkoi te Rafi' u, bashkë me të shkova edhe unë. E pyeti dhe ai iu përgjigj: **“Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar qiranë për tokën e punueshme”**.

**“Ti e di mirë - tha Ibn Umeri - se ne i kemi pas dhënë me qira tokat tona në kohën e Pejgamberit a.s. për një të katërtën dhe diçka kashtë”**

2345. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr, këtij Lejthi, që transmeton nga Ukajli kurse ai nga Ibn Shihabi:

Më ka kumtuar Salimi se Abdullah b. Umer r.a. ka thënë: **“E di mirë se në kohën e Pejgamberit s.a.v.s. toka është dhënë me qesim”**. Më vonë Abdullahu druante mos ka thënë ndonjë send tjetër lidhur me këtë, që ky nuk e di, prandaj hoqi dorë nga dhënia e tokës me qira.

## **QESIMI I TOKËS ME ARI DHE ARGJEND**

Ibn Abbasi ka thënë: **“Ajo që po bëni, është më e përshtatshme që për pastrimin e tokës të kërkoni pagesë nga viti në vit”**.

2346, 2347. - Na ka treguar Amir b. Halid, këtij Lejthi, që transmeton nga Rebia b. Ebi Abdurrahman, ky nga Hanzala b. Kajs, ky nga Refi' b. Hadixh:

**“Më ka treguar mixha im se sahabët e jepnin tokën me qira në kohën e Pejgamberit s.a.v.s., për një të katërtën e frytit që rritej nga ajo, ose me ndonjë çmim tjetër që kërkonte pronari i tokës, prandaj Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar këtë”**.

Mandej - thotë Hanzala - i thashë Rafi' ut: **“Po qiraja me ari dhe argjand si është?”**

- Nuk është e ndaluar - tha Rafi' - as me ari as me argjend.

Lejthi thotë: **“Ajo që ka qenë e ndaluar, është ajo që kur e analizojnë njerëzit e ditur konstruktivë se a është e ndaluar apo e**

---

---

---

lejuar, nuk e lejojnë, ngase aty ka diçka të dyshimt.” (krahaso: 4013).

2348. - Na ka treguar Muhammed b. Sinan, këtij Fulejh, këtij Hilali, e sipas një senedi tjetër ka treguar Abdullah b. Muhammed, këtij Ebu Amr, kurse këtij Fulejh që transmeton nga Hilal b. Allu nga A'ta b. Jesar, ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. një ditë tregonte në praninë e një beduini:

- Një njeri i mirë, xhenetli, e luste pronarin e tij t'i japë leje për mbjellje, e ai i tha: “A nuk e ke marrë atë çka e ke dashur?”

- Gjithsesi po, por unë dëshiroj - u përgjigj ai - ta punoj tokën.

Ai pastaj - tha Pejgamberi s.a.v.s. - e mbolli farën dhe bima u rrit, e korri, e ishte bërë sikur kodër.

Atëherë All-llahu xh.sh. tha: “Merre, o burr, por ty nuk po të ngin asgjë”.

Me këtë rast arabi tha: “Pasha All-llahun, kështu janë vetëm kurejshijt ose ensarët, sepse ata janë bujq, kurse ne nuk e punojmë tokën. Pejgamberi s.a.v.s. qeshi”. (Krahaso: 7519).

### MBËLTIMI I PEMËVE

2349. - Na ka treguar Kutjebe b. Seid, këtij Jakupi, që transmeton nga Ebu Hazimi Tu, ky nga Sehl b. Sa'di r.a.

“Ne zbavitëshim, kishim gezim, ditën e xhuma. Ishte një plakë te ne e cila merrte rrënje ose degëza e gjethe që ne i mbillnim nepër pronat tona. **Ajo i vrënte në një enë dhe mandej fuste** edhe disa kokrra elb. Nuk e di (thotë Takupi) a ka thënë diçka Sahli përve; se në atë enë nuk kishte as dhjam as leng mishi. Sa herë që falnim namazin e vizitonim, ajo na e **ofronte, na shërbente**, prandaj ne gëzoheshim që vjen dita e xhuma dhe nuk hanim drekë e as flinim deri pas xhumaje.

2350. - Na ka treguar Musa b. Ismail, këtij Ibrahim b. Sa'd që transmetoi nga Ibn Shihabi, ai nga A'rexhi kurse ky nga Ebu

Hurjere r.a. i cili ka thënë:

- Sahabët thonë: “Ebu Hurejre transmeton shumë hadithe”, kurse All-llahu ka caktuar vendin se si do të radhiten. Ata thonë: “As muhaxhirët as ensarët nuk sjellin hadithe sa ai vetë. Mirëpo vëllezërit e mi muhaxher i ka mashtruar lëkundja e dorës nëpër sheshe të pazarit, ndërsa vëllezërit e mi ensarët i ka mashtruar puna në pasurinë e tyre. Unë kam qenë njeri i varfër, kam përcjellë të mërguarin e All-llahut dhe ka mjaftuar të kemë barkun plot. Unë kam qenë pranë tij kur ata nuk ishin të pranishëm dhe kam mbajtur mend gjëra që ata nuk i dinë.

Pejgamberi s.a.v.s. një ditë ka thënë: “Askush nga ju që mban shtruar xhyben, derisa unë mbaj ligjërata dhe pastaj e mbështjell dhe e merr në krahëror, nuk do të harrojë asgjë nga ligjërata ime. Unë e shtriva xhyben time të leshtë, nuk kisha tjetër përveç asaj. Kur e kreu Pejgamberi s.a.v.s. ligjëratën e vet, e mbështolla dhe e mora n’grykë dhe, pasha Atë që e ka dërguar me të vërtetën, deri sot nuk kam harruar kurrgjë nga ligjërata e tij. Pasha All-llahun, kurrë nuk do t’u kisha treguar asgjë, sikur të mos ishin në Kur’an këto dy ajete:

“Ata të cilët i fshehin argumentet tona që i kemi shpallur ne; edhe rrugën e drejtë, pasi që ua kemi sqaruar njerëzve me Libër, ata All-llahu i mallkon, madje i mallkojnë edhe ata që mallkojnë, përveç atyre që pendohen dhe përmirësohen edhe atë e shprehin haptas. Atyre unë ua pranoj pendimin se unë jam mëshirëplotë dhe i pranoj pendimet”<sup>37</sup>.

### **ALL-LLAHU XH.SH. THOTË:**

*“Nga uji kemi krijuar çdo gjë të gjallë, e ju, prapë nuk besoni”, “a e shihni ujt që e pini? a e lëshoni ju nga qielli apo ne! Të kishim dashur ne do ta kishim bërë me shije të njelmët apo të idhët! A nuk falënderoni?!”*“Uxhaxh”

---

<sup>37</sup>Kur’an, 2:159-160

---

---

d.m.th., “hidhët”, kurse “almuznu” ka kuptimin “vranësirë”.

## LEJIMI QË TË JAPËSH UJË PËR SADAKA, DHURATË OSE LËNIA E POROSISË (AMANET) QOFTË PËRJETËSISHT OSE SI TËRËSI

Osmani ka thënë: “Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Kush do të blejë bunarin “Rume”, me qëllim që kofa e tij të jetë aty sikurse kofa e muslimanëve të tjerë?”** Këtë e bleu Osmani r.a.<sup>38</sup>

2351. - Na ka treguar Seid b. Ebi Merjem se i ka transmetuar Ebu Gasani nga Ebu Hazimi, ky nga Salih b. Sa’di r.a. i cili ka thënë:

- I sollën Pejgamberit s.a.v.s., një gotë tambël dhe ky piu prej saj. Në anën e djathtë kishte një djalosh, më i **riu në atë mes**, kurse në anën e majtë kishte njerëz të moshuar.

- **Djalosh, a lejon t’ua jap këtyre pleqve, e pyeti Muhammedi a.s.**

- Për hisen time nuk pajtohem për askënd tjetër, veçse për ty, i tha djaloshi dhe ia dha atij. (Krahaso: 2366, 2451, 2602, 2605, 5620)

**2352.** - Na ka treguar Ebu-l-Jeman, këtij Shuajbi i transmeton nga Zuhriu i cili ka thënë se i kumtoi Enes b. Maliku r.a. që Pejgamberit a.s. ia molën një dele të familjes Enes b.

---

<sup>38</sup> Bunari “Ruma” ishte prona e një hebreji që i përkiste fisit Beni Gifar, nga Medina, i cili gjithmonë e mbante atë bunar të mbyllur dhe për një janxhik ujë kërkonte nga një derhem. H. Osmani këtë e bleu për 35.000 dirhemë dhe ia vakuf që populli ta shfrytëzojë pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë për nevoja familjare. Sipas kësaj bunari mund të jetë objekt për shit-blerje, mund të bëhet vakuf për nevojat e familjes së vet dhe muslimanëve të tjerë.

---

---

Malikut dhe tëmbilin e përziën me ujë nga bunari i enesve. Mandej ia dha gotën Pejgamberit a.s. dhe ky piu prej atyre e pastaj e largoi nga buzët. Në anën e majtë ishte Ebu Bekri e në të djathtë një beduin. Umeri, për të mos ia dhënë atij beduinit, tha: “O Pejgamer i All-llahut, jepja Ebu Bekrit, që kur është afër teje!” Mirëpo ai i dha beduinit që e kishte nga ana e djathtë, dhe tha: “Mbanie anën e djathtë, vetëm të djathtën”.<sup>39</sup> (Krahaso: 2571, 5612, 5619).

**THËNIA: “PRONARI I UJIT KA PËRPARËSI TE UJIT  
DERI KUR TË NGIHET” E MBËSHTETUR NË  
DEKLARATËN E PEJGAMBERIT S.A.V.S.  
“NUK NDALOHET TEPRICA E UJIT”**

**2353.** - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, se i ka transmetuar Maliku nga Ebuz Zinadi, ky nga A'rexhi, ky nga Ebu Hurejreja r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **Nuk ndalohet teprica e ujit, e për shkak të kësaj të pengohet bari**”. (Krahaso: 2354, 6962).

2354. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr, këtij Lejthi i transmeton nga Ukajli, ky nga Ibn Shihabi, ky nga Ibn Musejheb dhe Ebu Seleme, kurse ai nga Ebu Hurejre r.a. që Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **“Mos e ndaloni tapricën e ujit dhe me këtë të pengoni rritjan e barit!”**<sup>40</sup>

---

<sup>39</sup>. Në ttakimin që përshkruhet në këtë adith, në anën e djathtë të Muhammedit a s. rrinte Fadl b. Abbasi, e në anën tjetër Halid b. Velidi.

T'i japësh musafirrit tambël me ujë nuk prish punë, por ta shesish është e ndaluar. Njeriu duhet ta vlerësojë realisht veten në shoqëri dhe të sillet sipas kësaj.

<sup>40</sup>. Ibn Maxhe ka cvidencuar me anë të Aishes r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka

---

## AI QË HAP BUNAR NË PASURI TË VET NUK PAGUAN KOMPENZIM

2355. - Na ka treguar Muhammedi, këtij; Ubjedull-llahu që i transmeton nga Israil, ky nga Ebu Hasim, ky nga Fbu Salih, kurse ai nga Ebu Hurejre r.a.

**Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Miniera nuk ka tatim, bunari nuk ka përgjegjësi, vepra e kafshës nga instikti nuk ka kompensim, kurse në pasurinë që e gjen nga mihja është një e pesta”<sup>41</sup>**

### KONTESTI PËR BUNAR DHE VENDIMI PËRKATËS

2356, 2357. - Abdani transmeton nga Ebu Hamza, ky nga A'meshi, ky nga Shekik, kurse ai nga Abdullahu r.a. e **ky nga Pejgamberi a.s. i cili ka thënë:**

**“Kush betohet rrejshëm për të grabitur ndonjë pasuri të dikujt, në Ditën e Kijametit do të takohet me All-llahun,**

---

thënë: “Askujt nuk i ndalohet teprica e ujit dhe nuk pengohet shfrytëzimi i bunarit. Imam Ahmedi në Musnedin e tij ka shënuar fjalët e Alejhisselamit: “Ai që i bën pengesë tjetrit në tepricën e ujit dhe të barit, All-llahu do t'ua ndalë meshirën e vet ndaj tij”. Ka mundësi të ketë thënë Pejgamberi a.s.: “mos ua ndaloni robërve të All-llahut tepricën e ujit, tepricën e barit dhe të zjarrit që i ka krijuar All-llahu xh.sh. që të shërbehen udhëtarët në shkretëtirë dhe të ndihmohen skamnorët”.

Çdokush ka të drejtë të ketë një zjarr dhe kullosë.

<sup>41</sup> Ai që ka në tokën e vet bazën, bunar ose vijë (përrua) uji që nuk shterret asnjëherë, ai mund të ndalojë hyrjen në tokën e tij për nejrëzit që duan të hyjnë aty. Mirëpo, nëse në afërsi nuk ka ujë të lirë për pije, pronari i tokës ose duhet t'ua qesë ujin njerëzve personalisht, ose duhet t'i lejojë të hyjnë dhe të marrin uj vetë. Nëse pronari i tokës nuk do të qesë ujë personalisht, pala e interesuar, që ka nevojë, ka të drejtë të hyjë dhe të marrë ujë, me kusht që mos të bëjë asnjë dëm pronarit: te bimët, rreth bunarit, përronit etj. *Mexhe-le-i abkami sherijje.*

por ky do të jetë i zemëruar në këtë”. All-llahu xh.sh., lidhur me këtë, shpalli: “Ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak, në botën tjetër nuk kanë asgjë. Atyre All-llahu në ditën e kijametit nuk do t’u flasë fare e as do t’i shikojë, dhe nuk i pastrojnë dhe do të vuajnë dënim të dhembshëm”.<sup>42</sup>

Pastaj erdhi Esh’athi dhe pyeti: “Çka ju ka treguar Ebu Abdurrahmani? Ai ajet është shpallur për shkak timin. Kam pasur bunar në tokën e djalit të mixhes tim dhe Pejgamberi s.a.v.s. më tha:

- Silli dëshmitarët tu!

- Nuk kam dëshmitarë - u përgjigja unë.

- Atëherë ai betohet, tha ai

- O Pejgamberi i All-llahut - i thashë unë - e kur të betohet ai e pat puna (e humba bunarin). Në këtë rast Pejgamberi s.a.v.s. ka dhënë deklaratën e lartpërmendur, kurse All-llahu xh.sh. shpalli ajetin e përmendur për ta konfirmuar.<sup>43</sup> (Krahaso: 2616, 2555, 2666, 2673, 2676, 4549, 6659, 6676, 7172, 7445; 2417, 2516, 2667, 2670, 2677, 4550, 6660, 6677, 7184).

---

<sup>42</sup>. Kur’an, 3:77.

<sup>43</sup> Shumë Muhaddithë të njëjtit rast e kanë evidentuar në variante ca të ndryshuar. Muslimi, Nesaiu, dhe Ibn Maxhe me ane të Ebu Umres thonë se Muhammedi a.s. ka thënë: “Kush përveteson ndonjë të drejtë të muslimanit me betim të rrejshëm, All-llahu, me siguri, e dënon me xhehenhem dhe ia ndalon xhehennetin” Një nga të pranishmit, në këtë rast, e pyeti: “Po nëse është diçka e vogël, fare pak, o Pejgamber i All-llahut?”

- Le të jetë edhe një rrem i hardhisë - u përgjigj ai.

Të njëjtin dialog e ka shënuar edhe Hakemi në Mustedrekun e tij, dhe e përfundon me fjalët: “... le të jetë me vleftën e një misvaku”.

Muslimi dhe Tirmidhiu shënojnë deklaratën e Muhammedit a.s.: “tre lloje njerëzish All-llahu as që do t’i shikojë në Ditën e Kijametit, as do t’ua falë gjynahet, por do t’u jap dënim të rëndë”.

- Kush janë ata - Zoti i vraftë - o Pejgamberi i All-llahut? - pycti Ebu Dherri.

---

---

---

## GJYNAHI PËR MOSDHËNIE TË UJIT

2358. - Na ka treguar Musa b. Ismail, këtij i transmetoi Abdu-l-Vakid b. Zijad nga A'meshi i cili ka thënë se ka dëgjuar Ebu Salihun duke thënë: Kam dëgjuar nga Ebu Hurjere r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Janë tre lloj njerëzish të cilët All-llahu xh.sh. nuk do t’i shiqojë në Ditën e Kijametit dhe as gjynahet nuk ua fal, por u përgatit dënim të rëndë: njeriu i cili gjatë rrugës ka ujë të mjaftueshëm e nuk i jep udhëtarit, njeriu që i betohet për besnikëri kujdestarit (tutorit të vet) vetëm për interes të kësaj bote dhe kur i jep diçka ai është i kënaqur, e kur nuk i jep, zemërohet; dhe njeriu që del në pazar (nxjerr tesha për shitje) pas iqindije dhe reklamon: Pasha All-llahun, që nuk ka tjetër si Ai, këtë e kam paguar kaq e kaq!” e dikush i beson Ai pastaj citoi: “Ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak - në botën tjetër nuk kanë asgjë. Atyre All-llahu në Ditën e Kijametit nuk do t’u flasë fare e as do t’i shikojë, dhe nuk i pastron. Ata do të vuajnë dënim të dhembshëm.” (Krahaso: 2369, 2672, 7212, 7446).

### NDALJA E LUMIT

**2359, 2360.** - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Lejthi që thotë se i ka transmetuar Ibn Shihabi nga Urve, ky nga Abdullah b. Zubejri r.a. i cili i ka kumtuar se një Ensar është gjykuar me Zubejrin te Pejgamberi s.a.v.s. për një vijë uji nga shkrepas me të cilin ky ujiste pemishten. Me këtë rast Ensariu i tha: **“Lëshoje ujin të vijë më tej!”**

---

- Ata që shpifin kundër tjerëve, ata që mburren (shesin mend) me veshmbathje dhe ata që shesin me betim të rrejshëm.

Isbahani përmes Umames ka evidentuar deklaratën e Muhammedit a.s.: “Fitimi i mirë për tregtarin është, nëse i ka këto katër cilësi: Kur blen diçka nuk e përqesh (shkagon), kur shet diçka nuk e lavdëron, në shtiblerje nuk mashtron dhe nuk betohet.

---

---

Ai nuk deshi të veprojë kështu dhe paraqitën kontestin para Pejgamberit s.a.v.s. Pejgamberi s.a.v.s. i tha Zubejrit: **“O :Zubejr, ujite, e pastaj lëshoje ujin të fciu yt!”** Ensariu u hidhërua dhe tha: **“A ve: pse është djali i hallës tënde a?”**

Pejgamberi s.a.v.s. u skuq në fytyrë dhe tha: **“O Zubejr, ujit dhe ndale ujin deri sa të mbushet deri në maje!”**.

Zubejri, pastaj ka thënë: **“Më duket se lidhur me këtë është shpallur ajeti: “Jo pasha Zotin tënd, ata nuk janë besimtarë derisa për giykatës në mosmarrëveshjet e tyre nuk të pranojnë ty e pastaj për shkak të giykimit tënd në shpirtërat e tyre nuk ndiejnë aspak peshë, dhe derisa të përulen plotësisht.”**<sup>44</sup> Muhammed b. Abbasi thotë se Ebu Abdullahu ka thënë: askush nuk e përmend Urven dhe Abdullah b. Zubejrin, përveç Lejthit.(Krahaso: 2361, 2362, 2708, 4585).

## **PJESA E SIPËRME UJITET PARA TË POSHTMES**

2361. - Na ka treguar Abdani se i ka kumtuar Abdullahu, këtij Ma'meri nga Zuhriu, ky nga Urve i cili thotë

Një Ensarë kishte një kontest me Zubejrin dhe Pejgamberi s.a.v.s. i tha: **“O Zubejr, ujit, pastaj lëshoje ujin!”**.

- **A vetëm pse është djali i hallës tënde**, tha Ensariu.

- **O :Zubejr, ujite deri kur të arrijë uji deri në maje** - i tha Alejhisselami - mandej ndale!

- **Më duket** - thotë Zubejri - **për këtë shkak është shpallur ajeti “Fe la ve rabbike...”**<sup>45</sup>

## **PJESA E EPËRME VADITET DERI NË NYJE**

2362. - Na ka treguar Muhammedi, këtij Mahledi që thotë se Ibn Xhurejxhi ka transmetuar nga Ibn Shihabi, ky nga Urve b.

---

<sup>44</sup> Kur'an, 4: 65.

<sup>45</sup> Shih fusnotën 44.

---

---

Zubejri i cili ka treguar se një Ensarë kishte kontest me Zubejrin për një vijë uji nga shkrepit, me të cilin ai ujiste pemishten, dhe **Pejgamberi s.a.v.s. tha:**

**- O Zubejri, ujit, e pastaj lëshoje te fqinji yt!”** Ky kështu i urdhëroi sipas traditës.

Ensariu atëherë i tha: **“A vetëm pse është ai djali i hallës tënde?”**

Pejgamberi s.a.v.s u skuq në fytyrë dhe tha: **“Ujit dhe ndale ujin deri kur të mbushet plot!”** Kështu ai i ruajti Zubejrit të drejtën e vet.

Zubejri më vonë ka treguar: **“Pasha Zotin, për këtë shkak është shpallur ajeti: “Fe là ve rabbike...”<sup>46</sup>**

Ibn Shibabi më ka thenë: Ensarijtë edhe njerëzit tjerë deklarantën e lartpërmendur të Pejgamberit s.a.v.s. e kanë komentuar **“Ujit dhe ndale deri kur të mbushen vijat, deri më nyje<sup>47</sup>**

### **SHPËRBLIMI PËR UJËDHËNIE**

2363. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Maliku i transmeton nga Sumejje, ky nga Ebu Salihi, ky nga Ebu Hurejre r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

**- Një njeri ishte nisë në rrugë dhe e kishte marrë etja shumë. Hyri në një bunar dhe piu ujë. Kur doli e pa një qenë i cili me gjuhën lëshuar, nga etja, hante dhe.**

---

<sup>46</sup>. Po aty.

<sup>47</sup> Nga ky hadith rezulton:

- toka ujitet sipas renditjes së rrjedhës së ujit dhe secili e kthen Ujin kur i vjen rendi që të mos i rrafshohet vija dhe pastaj Ujtin e lëshon te kojshiu që është më poshtë,

- ai i pari, pasi të ujisë tokën e vet, tërë ujin që rrjedh e lëshon te fqinji i vet;

- pronarët e tokave buzë ujërave janë të barabartë në ujitjen e tokave të tyre.

---

---

- Këtë e paska gjetur - mendoj ai - ajo që më kishte gjetur mua. E mbushi këpucën me ujë, e kapi me gojë (dhëmbë), doli nga bunari dhe i dha ujë qenit. All-llahu xh.sh. tregoi mirënjohje dhe ia fali gjynahet.

- O Pejgamber i All-llahut - thanë ata - a kemi shpërblim edhe për kafshët?

- Për gjithçka që janë me frymë, ka shpërblim - u përgjigj ai.

Në një version tjetër të transmetuesve Malikun e pason Hammad b. Seleme dhe Rebi' b. Muslim që transmeton nga Muhammed b. Zijadi.

2364. - Na ka treguar Ibn Ebi Merjem, këtij Nafi b. Umeri i cili transmeton nga Ibn Mulejke, ky nga Esmā, e bija e Ebu Bekrit s.a., i cili ka deklaruar se **Pejgamberi s.a.v.s. fali namazin për zënien e diellit e pastaj tha:**

- **Më është ofruar xhehennemi dhe unë thashë: “O Zot, a edhe në këtë kohë kur unë gjëndem në mesin e tyre? Aty ishte edhe një grua - më duket thotë Esmā se tha, të cilën e gërvishte maca.**

-**Çka është me të - pyeti ai.**

- **Ajo e ka mbajtur këtë të mbyllur, i thanë - dhe kjo ka ngordhur nga uria.**

2365. - Na ka treguar Ismaili, këtij Maliku i transmetoi nga Nafiu, ky nga Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **Gruaja është dënuar për shkak të macës të cilën e kishte mbyllur dhe ajo kishte ngordhur nga uria. Për këtë ajo grua është në xhehennem.**

**Rojtari i tha - e All-llahu e di më mirë: “Kur e mbylle nuk i ke dhënë ushqim, nuk i ke dhënë as ujë por as nuk e ke lëshuar të hajë ndonjë bimë”<sup>48</sup> (Krahaso: 3318. 3483).**

---

<sup>48</sup>. Nga këto haditlle del se:

---

---

**MENDIMI SE PRONARI I BUNART OSE  
JANXHIKUT ME UJË KA MË SHUMË TË DREJTË  
PËR UJË**

2366. - Na ka treguar Kutejbe se i transmetoi Abdu-l-Aziz, nga Ebu-l-Hazimi, ky nga Sehl b. Sa'adi r.a.

- Pejgamberit s.a.v.s. i sollën një gotë (me tambël) dhe ky piu prej aty. Në anë të djathtë qëndronte një djalosh, ai ishte më i riu aty, kurse nga ana e majtë ishin burra në moshë.

- Djalosh, iu drejtue ai, a më lejon t'ua jap të moshuarve?

- O Pejgamberi i All-llahut, tha ai, hisen time nuk ia lejoj askujt përveç teje. Prandaj ky ia dha atij.

2367. - Na ka treguar Muhammed b. Beshshar se Gunderi i transmetoi nga Shube, ky nga Muhammed b. Zijadi i cili thotë se ka dëgjuar Ebu Hurejren r.a. që transmeton nga Pejgamberi s.a.v.s.:

**“Pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirti im, do t'i largoj njerëzit nga burimi ashtu siç largohet, përzihet nga burimi devja e panjohur”.**

2368. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se i ka kumtuar Abdurezaku, këtij Ma'meri nga Ejubi dhe Kethir b. Kethir, që e plotësojnë niëri-tietrin, këtij Seid b. Xhubejr, i cili ka thënë se Ibn Abbasi ka thënë:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: All-llahu e mëshiroft nënën e Ismailit! **Sikur ta** linte Zemzemin, ose ka thënë, po të mos e ndalte ujin (Zemzemin) ai do të bëhej lum i madh. Erdhi më vonë

---

-duhet bërë mirë çdokujt, madje edhe kafshëve;

- dhënia ujë të eturve bën pjesë në vepra të mëdha bëmiresie. Sahabët thonin: “Ai që ka shumë gjynahe le t'ua japi ujë të etëshme”. Kur gjynahet i falen atij që i dha ujë qenit të etshëm, merre me mend çfarë shpërblimi e pret atë që u jep ujë njerëzve,

- sadakaja mund t'i jipet edhe atij që nuk është musliman.

---

---

fisi Xhurhum dhe pyeti: A na lejon të vendosemi tek ti?

- Po, u përgjigj ajo, por nuk keni hise te uji.

- Ani, mirë - thanë ata. (Krahaso: 3362 - 3365).

2369. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se i ka transmetuar Sufjani nga Amri, ky nga Ebu Salibu Es-Semmani, ky nga Ebu Hurejre r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Me tre vetë All-llahu xh.sh. nuk do të bisedojë Ditën e Kijametit dhe nuk do t'i shikojë. Ata janë: nejrriu që ka bërë be rrejshem për tesha se i ka paguar më shumë se ç'i ka paguar, njeriu që ka bërë be rrjeshëm për t'ia rrëmbyer pasurinë një muslimani tjetër, dhe njeriu i cili ujin që i ka tepruar nuk e ka shpërndarë. All-llahu xh.sh. do t'u thotë: "Sot nuk do të jem bëmires ndaj teje ashtu sikurse ti që e ke kursyer bëmiresinë të cilën nuk e ke krijuar ti".**

Aliu ka thënë se Sufjani ka transmetuar shumë herë nga Amri i cili ka dëgjuar Ebu Salihin që këtë hadith e vënte në lidhje me Pejgamberin a s.

### **TOKA PA PRONAR I TAKON ALL-LLAHUT DHE PEJGAMBERIT TË TIJ**

2370. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr se i ka transmetuar Lejthi nga Junusi, ky nga Shibabi, ky nga Abdullah b. Abdullah b. Utbe, ky nga Ibn Abbasi r.a se Sa'ad b. Xheththame ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**"Toka pa pronar i takon vetëm All-llahut dhe Pejgamberit të tij".** Ibn Shibabi ka thënë: "Na kanë transmetuar se Pejgamberi i All-llahut mori në mbrojtje "Nekitë" kurse Umeri mbronte "Serefët" dhe "Rebedhët".<sup>49</sup> (Krahaso: 3013).

---

<sup>49</sup>. "Neki", "Seraf" dhe "Rebedhe" janë ngastra pa pronarë jo fort larg Medines.

Të parën e vuri nën mbrojtje Muhammedi a.s. kurse dy tjerat Umeri, për nevoja të përgjithshme shtetërore ku kullotnin bagëtitë e shtetit që konfiskoheshin nga armiqtë në luftë, ose grumbulloheshin nga muslimanët në emër të zekatit.

---

---

---

## DHËNIA UJË NJERËZVE DHE BAGËTIVE NË LUMENJ

2371. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Malik b. Enesi që transmeton nga Zejd b. Eslem, ky nga Ebu Salih es-Semman, ky nga Ebu Hurjera r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**“Kali ndonjëherë i sjell njeriut shpërblim, ndonjëherë është mbrojtje e ndonjëherë është gjynah. Sa për të parën, kur është shpërblim, është atëherë kur e mban për hir të rrugës së All-llahut dhe e kullot në livadhin ose në oborrin tënd. Çka të kollosë sa i mbërrin litari në atë livadh ose oborr, ky ka savap për këtë. Nëse i këputet litari dhe kalon një a dy hapa (apo një përrue), atij për çdo hap e për çdo bagël i llogaritet vepër e veçantë bëmirëse. Nëse pronari e ofron kah lumi e ai pi ujë aty, por ky nuk e ka pasur qëllimin për këtë, edhe kjo këtij i llogaritet bëmirësi dhe do të ketë shpërblim të veçantë.**

**Ai që e mban për punë dhe modesti dhe nuk ka harruar obligimet ndaj Zotit xh.sh. për qafën dhe shpinën e tij (e ka dhënë zekatin) e ka për mbrojtje nga varfëria. Njeriu që e mban për krenari, hipokrizi dhe armiqësi kundër muslimanit, ky është vetëm gjynah për këtë”.**

Kur e pyetën Pejgamberin s. a. për gamarin tha:

**- Për atë nuk më ka ardhur kurrfarë shpallje, përveç këtij ajeti me kuptim universal: “Ai i cili punon mirë sa atomi, e sheh atë, por edhe kush bën keq, qoftë sa atomi, do ta shohë”.<sup>50</sup> (Krahaso: 2860, 3646, 4962, 4963, 7356).**

2372. - Na ka treguar Ismaili se i ka transmetuar Maliku nga Rebi' b. Ebi Abdurrahmani, ky nga Jezidi, rob i liruar i Munbeithit, ky nga Zejd b. Halid r.a. që ka thënë:

Erdhi një njeri te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e pyeti për sendin e gjetur, e ky iu përgjigj:

---

<sup>50</sup>. Kur'an, 99: 7-8.

Mbaje mend lidhësen (zinxhirin) dhe qesen dhe shpalle një vit. Nëse vjen pronari i saj japja, përndryshe bëhet e jotja”.

- Po delja e humbur - e pyeti ai.

- Ajo është e jotja ose e vëllait tënd, ose e ujkut - u përgjigj ky.

- Po deveja e humbur - e pyeti ai.

- Ç’ke ti me të - tha Muhammedi a.s. - ajo e ka ujin me vete edhe mbathjen me vete, e gjan edhe ujin, ha edhe therra e gjethe deri kur ta gjejë pronarin e saj.

### **SHITJA E DRUVE DHE BARIT**

2373. - Na ka treguar Mual-la b. Esed se i ka transmetuar Vuhejbi nga Hishami, ky nga babai i vet, ky nga Zubejr b. Avvani r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **“Për ju është më mirë, kushdo qoftë, të marrë litarin të sjellë një barrë dru dhe t’i shesë, dhe All-llahu t’ia ruajë fytyrën, se sa të bëhet lypës, të lypë prej tiorëve, pavarësisht a i jep ndokush diçka apo jo”.**

2374. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr se i ka transmetuar Lejthi nga Ukajli ky nga Ibn Shihabi, ky nga Ebi Ujedi, rob i liruar i Abdurrahman b. Avfit se ky ka dëgjuar Ebu Hurejren r.a. duke thënë:

**Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Secili nga ju është më mirë të ngarkojë barrën e druve në shpinë, se sa të lypë ndihmë nga të tjerët, i dhanë apo s’i dhanë.**

2375. - Na ka treguar Ibrahim b. Musa se i ka kumtua Hishami, këtij Ibn Xhurejxhi, dulke thënë se i ka transmetuar Ibn Shihabi nga Ali b. Husejn b. Ali, ai nga babai i vet Ali Ebi. Talibi r.a. që ka thënë: Kam qenë me Pejgamberin s.a.v.s. dhe në Luftën

---

në Bedër, nga fitimet e luftës, mua me takoi një deve e vjetër. Pejgamberi s.a.v.s. - thotë Aliu - ma dha edhe një deve tjetër te vjetër, dhe një ditë i ula para derës së një Ensariu me qëllim që të ngarkoj ca kallamë sheqeri (shavar) t'i çoj t'i shes dhe të bëhem gati, me këtë për dasmën e Fatimes. Me mua ishte një farkëtarë nga fisi Benu Kajnuka, kurse në shtëpinë e tij Hamza b. Abdul-Muttalibi ishte duke pirë me një këngëtare, e cila i thoshte: **“O Hamzë, shih sa deve të majme!”** Hamza, atëherë iu vërsul atyre me shpatë, u preu gungat ua shpërtheu, çau pëlhurën e mushkërive dhe ua nxori mushkëritë e zeza”.

- Edhe gungat? - e pyeti Ibn Shihabi, e ai tha: **“U preu gungat të dyjave dhe i mori”**.

Ibn Shihabi ka thënë edhe këtë:

Aliu ka thënë: “E kam shikuar atë skenë që më trishtoi, dhe shkova te Pejgamberi s.a.v.s. Aty ishte Zejd b. Harithi. Unë e informova për rastin që kisha parë. **Ai, pastaj, doli me Zejdin e bashkë me ta dola edhe unë.** Mandej hyri te Hamza dhe i bërtiti, kurse Hamza ngriti vetullat dhe tha: **“Po ju jeni robërit e të parëve të mi?”** Atëhere Pejgamberi s.a.v.s. u kthye prapa, me shpinë, deri kur doli prej aty, por kjo ishte para se të ndalohej alkooli.<sup>51</sup>

2376. - Na ka treguar Sulejman b. Harb se i ka transmetuar Hammadi nga Jahja b. Seid, i cili ka thënë:

- E kam dëgjuar Enesin r.a. që thotë: Pejgamberi s.a.v.s.

---

<sup>51</sup>. Nga ky hadith rezulton:

- ahengu për dasëm është synnet;

- të këndosh dhe të dëgjosh këngë që meritojnë, i kanë hije muslimanit, nuk është e ndaluar;

- lejohet të shfytëzosh shërbimin e tjetrit me kompensim të drejtë.

- kujdestari edhe nëpunësi bisedon me palët në mënyrë të denjë dhe i veshur si ka

hije.

- I dëmtuari mund të heqë dorë nga e drejta e vet ligjore për kompensim.

---

deshi ta ndajë Bahrejnin”.

- **T’u japësh tokë edhe vëllezërve tonë muhaxhirë!** – thanë Ensarët.

- **Do të shihni pas meje, tha ai, egozimin, prandaj duroni deri kur të takoheni me mua!**<sup>52</sup>(Krahaso: 2377, 3163, 3794)

### **NORMAT PËR NDARJEN E TOKËS**

2377. - Leithi ka transmetuar nga Jahia b. Seid, ky nga Enesi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. i thirri Ensarët t’iu ndajë tokë në Babrein.

O Pejgamber i Zotit, thanë ata, nëse bën ashtu atëherë të njejtën gjë bëre edhe me vellezërit tonë kurejshitë!

Kjo nuk qe pranuar nga Pejgamberi s.a.v.s. Ai tha: **“Do të shihni çfarë egoizmi do të ketë pas meje, andaj duroni deri kur të takoheni me mua. (Ditën e Kijametit)”**.

### **DEVJA MILET TE UJI**

2378. - Na ka treguar Ibrahim b. Mundhir, këtij Muhammed b. Fulejh, këtij i transmeton baba i vet nga Halid b. Ali, ai nga Abdurrahman b. Ebi Amr, ky nga Ebu Hure jre r.a. **se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

- **“E drejta e deveve është të millet te uji”**.

### **E DREJTA PËR TË KALUAR NË KOPSHT OSE PEMISHTE DHE E DREJTA NË REND TE UJI**

**Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

- **Ai që i shet pemët (trupat) e pemëve pasi që kanë lidhur fryt, fryti i takon shitësit dhe shitësi ka të drejtë të**

---

<sup>52</sup> Muhammedi a.s. na ofroi tokë punuese në Bahrejnin e nënshtuar ensarëve, ngase ata merreshin krysisht me bujqësi dhe ishin të përgatitur për këtë. Toka, me një fjalë, i takon, në radhë të parë, bujkut. (Çdo degë e ekonomisë është më rentabile nëse e punojnë ata që merren me atë.

---

---

---

**kalojë nëpër pemishte dhe të ujisë deri në vjelje, por këtë të drejtë e ka edhe pronari që ka marrë vetëm disa trupa pemësh.**

2379. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf të cilit i ka thënë Lejthi, këtij i transmetoi Ibn Shihab nga Salim b. Abdullahu, ai nga baba i vet r.a. i cili ka thënë:

**E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë: Ai që e blen trupin e pemës, pasi ka lidhur fryt, ai fryt i takon shitësit përveç në rastin kur blerësi e ka kushtëzuar ndryshe. Ai që blen rob i cili ka pasuri, pasuria e tij i takon atij që e ka shitur robin, nëse blerësi nuk vë kushte tjera. Kështu është transmetuar edhe nga Maliku i cili transmeton nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri, kurse ai nga Umeri.**

2380. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf se i ka transmetuar Sutani, nga Jahja b. Seidi, ai nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri, kurse ai nga Zejd b. Thabiti r. a.

**- Pejgamberi s.a.v.s. ka lejuar të shitet fruti vetëm i disa trupave (në pemishte) me çmim (apo këmbim) për hurma të terura.**

2381. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se i ka transmetuar Ibn Yjejne nga Ibn Xhurejxhi, ai nga A'tau i cili ka dëgjuar nga Xhabir b. Abdullahu r.a.

**- "Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar: Shitblerjen duke prekur (artikullin - objektin e tregtisë), këmbimin e drithit në kallinj për drith të terur, ndërrimin e rrushit të thatë me rrush në hardhi dhe shitjen e frytit pa u pjekur, dhe të tregtohet vetëm me dinarë e dirhem përveç shtiblerjes së frytit të vetëm disa pemëve".**

2382. - Na ka treguar Jahja b. Kazea se i ka transmetuar Maliku nga Davud b. Husain, ky nga Ebu Sufjani, rob i liruar i Ibn Ebi Ahmedit, ky nga Ebu Hurjere r.a

**Pejgamberi s.a.v.s. ka lejuar në tregti dhe për dhurata**

---

---

frytin vetëm nga disa pemë, të vlerësohen (këmbehen) për rrush të thatë në shumën më pak se pesë barrë ose pesë barrë. Davudi dyshon në saktësinë e këtij versioni.

2383, 2384. - Na ha treguar Zekerija b. Jahja se i kumtoi Ebu Usame, duke thënë se e ka informuar Halid b. Kethir, këtij i transmeton Bushejr b. Jesar, rob i liruar i Beni Harithit, se Rafi b. Hadixh dhe Sehl b. Ebu Hasme i ka kumtuar që **Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar ndërrimin e frytit të njomë të pemëve për hurma të terura, duke përjashtuar pronarët e fryteve të blera vetëm nga disa trupa pemësh. Këtë ai atyre ua lejoi.**

Ebu Abdullahu (Buhariu) ka thënë:

Ibn Is-haku ka thënë: **“Këtë, njëlloj, ma ka transmetuar edhe Bushejri”.**

### **Kreu 43.**

*Huaja, krediti, likuidimi i borxhit..*

#### **AI QË BLEN DIÇKA ME KREDI, E PARATË NUK I KA, OSE NUK I KA ME VETE**

2385. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf el-Bekindi se i ka transmetuar Xheriri nga Mugire, ai nga Sha'biu, ky nga Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili ka thënë:

Kam qenë në luftë bashkë me Pejgamberin a.s. dhe më tha:

- **Çka mendon, apo ma shet deven tënde?**

- **Po** - i thashë, **dhe ia shita.** Kur arrita në Medine, të nesërmen u ngrita herët dhe i shkova për deven dhe ai m'i pagoi paratë.

2386. - Na ka treguar Mual-la b. Esed se i ka kumtuar Abdu-l-Vahid i cili thotë se A'meshi ka thënë:

Kemi biseduar te Ibrahimimi për pengun në mungesë të parave, e ai tha: **“Më ka transmetuar Esvedi nga Aisheja r.a. se**

---

---

---

Pejgamberi s.a.v.s. bleu nga një hebrej ca ushqim për një afat të caktuar, dhe për garancë (peng) e la parzomren e hekurt’.

### **KUSH MERR PASURINË E TJERËVE ME QËLLIM QË T’I PAGUAJË OSE T’I ZHDUKË**

2387. - Na ka treguar Abdu-Aziz b. Abdullah El-Uvejsi se i ka transmetuar Sulejarn b. Bilal nga Thevr b. Zejdi, ky nga Ebul-Gajthi, ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**“Ai që merr pasurinë e tjarëve me qëllim që ta paguajë, All-llahu do ta ndihmojë që ta paguajë, por kush e merr me qëllim që ta humbi, shkatërrojë, All-llahu atë do ta shkatërrojë”.**

### **PAGESA E BORXHEVE**

Dhe fjala e All-llahut: *“All-llahu ju urdhëron që gjërat e besuara t’ua jepni atyre që u takojnë, pronarëve të vet, dhe kur të gjykoni ndërmjet njerëzvet, të gjykoni drejt. Me të vërtetë, sa bukur All-llahu ju këshillon! All-llahu njëmend dëgjon dhe sheh shumë”.*<sup>53</sup>

2388. - Na ka treguar Ahmed b. Junus të cilit i transmetoi Ebu Shihabi nga A’meshi, ky nga Zejd b. Vehbi, ky nga Ebu Dherr-ri r.a. i cili thotë:

**Kam qenë me Pejgamberin s.a.v.s. dhe kur e shikoi, mendon ky, Uhudin, tha: Sikur ky mal të ishte i tëri flori imi, nuk do të dëshiroja të mbaj më shumë se tre metelik, përveç atij meteliku me të cilin do të paguaja borxhin. Ka thënë edhe këtë: “Ata pasanikë që nuk shpërndajnë**

---

<sup>53</sup> Kur’an, 4: 58.

pasurinë e vet kështu e kështu - Ebu Shuhabi tregoi me dorë, bëri shenjë, djathtas e majtas, do të kenë pak shpërblim, e të tillë ka pak”.

- Rri në vend tëndin! - tha Pejgamberi s.a.v.s. - dhe u largua pak. Unë dëgjoja një zë dhe dëshirova t’i afrohem, por mu kujtuan fjalët e tij: “Rri në vend tëndin, deri sa të vij unë!”

**Kur erdhi i thashë: O Pejgamber i Zotit, çka dogjova, apo i thashë, çfarë zëri ishte ai që e dëgjova?**

- A e paske dëgjuar? pyeti ai.

- Po, i thashë.

- Më ka ardhur Xhebraili r.a. - vazhdoi ai - dhe më tha: “Kush vdes, nga ymeti yt, pa i bërë shok All-llahut (pa bë kufri), do të hyjë në xhennet”.

- A edhe nëse vepron kështu e kështu, e pyeta unë.

- Po - tha ai.

2389. - Na ka treguar Amed b. Shebib b. Seid, këtij i tregon babai i vet, i cili transmeton nga Junusi se Ibn Shihab ka thënë që Ubjedullah b. Utbe ka thënë: Ebu Hurejre r.a. thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Sikur ta kisha pasurinë sa Uhudi, në flori, nuk do të dëshiroja që pas tri ditësh të kisha më shumë se sa kam nevojë për të paguar borxhin”.

Këtë e kanë transmetuar edhe Saliki dhe Ukajli nga Zuheriu.<sup>54</sup> (Krahaso: 6445, 7228).

---

<sup>54</sup> Nga këto hadithe shihet se:

- për likuidimin e borxhit duhet angazhim maksimal si edhe pasurinë tënde duhet shpenzuar sa më shumë për qëllim bëmiresie;

- borxhi është i rëndë shumë, prandaj duhet që sa më parë ta paguash. Abdullah b. Mes’udi transmeton haditllin: “Shehidit i falen të gjitha gjuhahet përvec borxhit që i ka ndokujt dhe sendit të lenë në besim. Gjynahi më i madh është të shkatërosh pasurinë e huaj që të është lenë në besim, ta ruash. Njeiut të tillë në Ditën e Kijametit do t’i thuhet: “Ktheja filan filanit pasurinë e vet!”.

---

---

---

## DEVEJA ME QERA

2390. – Na ka treguar Ebu-l-Velid, këtij Shu'be, që transmeton nga Seleme b. Kuhejl i cili ka thënë:

- E kam dëgjuar Ebu'Selemen në shtëpinë tonë duke transmetuar nga Ebu Hurejre r.a. se një njeri kërkonte pagesën e borxhit nga Pejgamberi a.s. dhe këtë e bënte me arrogancë, prandaj sahabët e tij deshtën të intrevenojnë, por ai u tha: **“Lëreni atë! ai që ka ndonjë kërkesë, e ka edhe fialën. Blejani një deve dhe japjani!**

- **Kemi vetëm më të moçme se deveja e tij** - thanë ata.

- **Blejani dhe japjani!** - tha ai, **më i miri nga ju është ai që më së miri e paguan borxhin.**

### TË KËRKUARIT E BORXHIT SI KA HIJE

2391. - Na ka treguar Muslimi se i ka transmetuar Shu'be nga Abdu-l-Meliku, ky nga Rebii, kurse ky nga Hudhejfe r.a. se e ka dëgjuar **Pejgamberin s.a.v.s. kur ka thënë:**

**Vdiq një nejri dhe e pytën** (ç'kishte bërë).

- **U kam shitur njerëzve** (tesha). **Të pasurve u merrja çmimin si e meriton, kurse të varfërve ua lëja më lirë, dhe për këtë iu falën gjunahet ndaj All-llahut.**

Ibn Mes'udi ka thënë: **“E kam dëgjuar këtë hadith drejpërdrejt nga Pejgamberi s.a.v.s.”.**

---

- Në çfar mënyre - do të pyes ai - kur unë jam larguar nga toka qysh moti?

- Po të tregojmë - do të marrë përgjigje.

Atëherë do t'ia tregojnë atë artikull në thellësi të xhehennemit dhe do t'i thuhet: **“Zbrit dhe sille këtu!”** Ai do të zbresë do ta ngarkojë në shpinë dhe sa po të afrohet për të dalë, ai i bie prapë atje ku ka qenë. Ai prapë do të zbresë dhe, sapo të afrohet për të dalë, ai prapë do t'i bie në thellësi të xhehennemit. Kjo punë e mundimshme ashtu do të vazhdojë deri në pambarim.

---

---

**A JEPET DEVJA QË ËSHTË MË E VJETËR SE AJO  
QË ËSHTË HUAZUAR**

2392. - Na ka treguar Museddedi, që transmeton nga Jahja, ky nga Sufiani të cilit Seleme b. Kuhejli i transmetoi nga Ebu Hurejre r.a. se një njeri erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. të kërkojë pagesën për deve, dhe **Pejgamberi s.a.v.s. u tha: “Jepjani!”**

- **Ne kemi deve më te madhe dhe më të shtrenjtë se ajo e atij** -thanë ata.

Pastaj ai njeriu tha: **“Paguama, All-llahu ta pagoftë!”**

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Jepjani, ngase më i miri prej njerëzve është ai që e paguan më së miri borxhin”.

**PAGESA E BORXHIT NË MËNYRË TË DENJË**

2393. - Na ka treguar Ebu Nuajm se i ka transmetuar Sufiani nga Seleme, ky nga Ebu Seleme, ky nga Ebu Hurejre r.a.

- Pejgamberi s.a.v.s. i kishte borxh njërit një deve të vogël, të re, dhe ai kishte ardhur t’i bëhej pagesa, dhe Pejgamberi s.a.v.s. tha:

“Jepjani!”

Ata lypën deve siç kishte qenë ajo, ose moshatare, por nuk gjetën, kishin deve por më të vjetër.

Jepjani! - tha ai

Ai njeriu atëherë tha: **“Ti paguama mua, All-llahu ta pagoftë ty!”**

Pastaj Pejgamberi s.a.v.s. tha: “Më i miri nga ju është; ai që paguan borxhin më së miri”.

2394. - Na ka treguar Hlal-ladi, këtij Mis’ar, që thotë se i ka transmetuar Muharib b. Dithar nga Xhabir b. Abdullah r.a

- **Erdha te Pejgamberi s.a.v.s. derisai ishte në xhami, mendoj -tho’ të Mis’ari - se pat thënë në mëngjes.**

- **Fali dy regate!** tha ai. **Unë kisha të marrë një borxh nga ai dhe ai ma pagoi bukur mirë, më dha edhe më tepër.**

---

---

**LEJOHET QË BORXHLIU TË INSISTOJË TË  
PAGUAJË MË PAK SE SA I KËRKOHET OSE QË AI  
T'IA FALË**

2395. - Na ka treguar Abdani se i ka kumtuar Abdull-llahu, këtij i transmeton Junusi nga Zuhriu i cili ka thënë:

Më ka treguar *Ibn Ka'b b. Malik*, i ka kumtuar **xhabir b. Abdullah** r.a. se babai i tij ra shehid në Uhud, por ai kishte borxh. Borxhlinjtë këmbengulnin të realizojnë të drejtën e tyre. Shkova, atëherë, te Pejgamberi s.a.v.s. dhe ai i pyeti a pranojnë hurmat e kopshtit tim dhe ta lirojnë nga borxhi babën tim. Ata nuk deshtën ashtu, prandaj Pejgamberi s.a.v.s. nuk ua dha kopshtin tim.

- **Po ta japim neser në mëngjes** - tha ai.

-Kur gdhiu e nesërmja, na erdhi, e vizitoi pemishten dhe e bekoi frytin që të shtohet. Pastaj unë i vola, ua pagova dhe mbeti edhe për ne diçka nga ato hurma.

**KUR DIKUSH, PËR PAGESË TË BORXHIT,  
LË TJETËR SEND OSE PËR HURMA JEPEN  
HURMA TJERA, ME TAHMIN OSE TJETËR SEND**

2396. - Na ka treguar Ibrahim b. Mundhir se i ka transmetuar Enesi nga Hishami, ky nga Vehb b. Kejsan, ky nga Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili ka kumtuar se kur i vdiq baba, ishte borxh 30 barrë nejrit, (një hebreu) dhe Xhabiri kërkoi që ta presë ca. Ai nuk deshte ta priste, andaj Xhabiri i tha Pejgramberit s.a.v.s. që të ndërmjetësojë te ai.

**Pejgamberi s.a.v.s., erdhi dhe i tha habrejit të marrë frytet e hurmave të tij për aq sa i kishte borxh por ky nuk e pranoi këtë. Pastaj Pejgamberi s.a.v.s. hyri në pemishte shetiti nëpër të dhe i tha Xhabirit: ‘Vili dhe paguaja sa i takon! Kur u kthye Pejgamberi s.a.v.s. ai i voli ia pagoi 30 barrë kurse këtij i mbetën edhe 17 barrë.**

Pastaj Xhabiri erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. ta informojë se çka ishte puna dhe e gjeti duke falur iqindinë. Kur e kreu namazin

i tregoi për tepricën, e ai i tha: “Tregoja këtë Ibn Hattabit!” Atëherë Xhabiri shkoi te Umeri dhe ia kumtoi këtë, kurse ky i tha: “E kam ditur se aty do të ketë fryte më shumë pasi që nëpër të kaloi Pejgamberi s.a.v.s..

### **LUTJA PËR LEHTËSIM TË BORXHIT**

2397. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman, këtij i transmetoi Shuajbi nga Zuhriu, kurse sipas një transmetimi tjetër ka treguar Ismaili duke thënë se i transmeton vëllai i tij nga Sulejmani, ky nga Muhammed b. Ebi Atik, ky nga Ibn Shihabi, ai prapë nga Urve se Aisheja r. a. e ka informuar që Pejgamberi s.a.v.s. lutej në namaz duke thënë: **“O Zoti madhëruar, tek Ti kërkoj ndihmë kundër borxheve dhe gabimeve!”**

Në këtë dikush tha: **“O Pejgamber i All-llahut, sa shumë lyp ndihmë ndaj borxheve!**

- Njeriu, me të vërtetë - tha ai kur hyn shumë borxh, flet shumë dhe gënjen, premtion dhe tradhton.

### **FALJA E XHENAZES SË BORXHLIUT**

2398. - Na ka treguar Ebu l-Velid se i ka transmetuar Shu'be nga Adij b. Thabit, ky nga Ebu Hazimi, ky nga Ebu Hurejre r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- “Kush lë pasuri, ajo i takon trashëgimtarit të tij, e nëse lë ndonjë borxh, borxhi është i joni”.

2399. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed, këtij Ebu Amir, këtij i transmetoi Tufejli nga Halil b. Ailu, ky nga Abdurrhman b. Ebi Amri, kurse ai nga Ebu Hurejre r. a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

**Nuk është besimtar i vërtetë ai për të cilin unë nuk jam më i afërti në këtë botë dhe në botën tjetër. Nëse dëshironi lexoni ajetin: “Pejgamberi duhet të jetë më i rëndësishëm për besimtarët se sa vetvetja e tyre, prandaj cilido besimtar që të vdes dhe lë pas ndonjë pasuri, le ta**

---

trashëgojë familja më e afërt nga ana e babës, por nëse lë borxh ose anëtar të varfër të familjes, le të vijë te unë se unë jam ndihmëtar i tij”<sup>55</sup>

### **ZVARRITJA E LIKUIDIMIT TË BORXHIT NGA ANA E TË PASURIT ËSHTË DHUNË**

2400. - Na ka treguar Museddedi se i ka transmetuar Abdul A’la nga Ma’meri ai nga Hammam b. Munebbih, vëllai i Vehb b. Munebbihut, i cili ka dëgjuar Abu Hurejren r.a duke thënë se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

**Kur i pasuri e zvarrit larjen e borxhit është dhunë.**

### **AI QË TË LYP BORXHIN KA TË DREJTËN E FJALËS**

Transmetohet nga Pejgamberi a.s “ **Kur i pasuri e zvarrit larjen e borxhit ai lejon uljen e nderit të vet dhe dënon veten**”.

Sutani shprehjen “.. e nderit të vet” e shpjegon: “**borxhliu mund t’i thotë: më tradhtove**” kurse “... dënon veten”, “e mbyll”.

2401. - Na ka treguar Museddedi se i ka thënë Jahja nga Sh’be ky nga Seleme, ky nga Ebu Seleme, kurse ai nga Ebu Hurjere r. a. që ka thënë:

- **Erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. për të lypur një bonxh dhe u soll ashpër ndaj tij, prandaj shokët e tij deshën të intervenojnë, por ai tha:**

- **Lereni atë, sepse ai që kërkon diçka ka të drejtë fjale.**<sup>56</sup>

---

<sup>55</sup>. Kur’an, 33: 66.

<sup>56</sup>. Në rast se gjyqi konstaton se borxhliu nuk do ta paguaje borxhin, perkundër mundësisë që ka, borxhlinjtë mund të kërkojnë shiten e pasurisë se tij për të marrë borxhin që u ka ai. Nëse këtë nuk e bën borxhliu vetë, shitjen do ta bëjë gjyqi dhe do të paguajë borxhin e tij. Shitja nis nga sendet që nuk e lënë keq borxhliun dhe borxhlinjtë paguhen proporcionalisht.

---

**NËSE DIKUSH E GJEN PASURINË E VET  
TE FALIMENTUESI, TE AI QË IA KA DHËNË  
TA SHESË, HUA OSE TA RUAJË, AI KA MË SË  
SHUMTI TË DREJTË NË KËTË**

Hasani ka thënë: “Nëse dikush varfërohet dhe kjo argumentohet, nuk është i vlefshëm lirimi i robit nga ana e tij, as shitblerja e gjësendeve tjera”.

Seld b. Musejeb ka deklaruar: Osmani ka sjellë vendim: **“Kush ka nxjerrë borxhin e vet para se të varfërohet borxhliu, atij i takon ajo, por nëse e gjen gjë sendin e vet (te falimentuesi) ai ka më shumë të drejtë aty se të tjerët”.**

2402. - Na ka treguar Ahmed b. Junus, këtij Zuhejri që thotë se i ka transmetuar Jahia b. Seid të cilit i kumtoi Ebu Bekr b. Muhammed b. Amr b. Hazm se Umer b. Abdu-l-Azizi lajmëron se Ebu Bekr b. Abdurrahman b. Harith b. Hisham ka deklaruar se e ka dëgjuar Ebu Hurejren r.a. duke thënë:

- **Pejgamberi a.s. ka thënë** (apo tha e kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë):

- Kush e gjen dhe e njih gjësendin e vet te **ndonjë njeri që është shpallur zyrtarisht si i falimentuar, ai ka të drejtë më shumë se të tjerët në atë”.**

**SHTYRJA E LARJES SË BORXHIT PËR NESËR  
OSE MË VONË DHE KËTË NUK E KONSIDERON  
SHTYRJE TË QËLLIMSHME**

Xhabiri ka thënë: “Borxhlinjtë ishin të vendosur në kërkesën e tyre të borxhit nga babai im, prandaj **Pejgamberi a.s. i luti të pranojnë** frutet e kopshtit tim. Ata nuk deshën kështu dhe ai nuk u dha asgjë nga kopshti im.

- Do të vij nesër në mëngjes - tha Alejhisselami.

- Kur gdhiu dita e nesërme, ai erdhi e bekoj frytin për prodhim më të lartë dhe unë e pagova (borxhin).

---

**SHITËSI I PASURISË SË FALIMENTATORIT  
OSE TË ATIJ QË NUK KA GATI ASGJË,  
DHE KETË UA SHPËRNDAN BORXHLINJVE  
OSE IA JEP ATIJ QË TA SHPENZOJË PËR VETE**

2403. - Na ka treguar Museddedi, këtij Jezid b. Zureji i cili thotë se i ka transmetuar Husejn Mual-limi, këtij A'ta b. Ebu Rebah që transmeton nga Xhabir b. Abdullahu r. a. i cili ka thënë:

- Një njeri i varfër i premtoi lirinë robit të vet, pasi të ndërrojë jetë, e Pejgamberi s.a.v.s. tha:

- Kush do ta blejë nga unë?

Pastaj e bleu Nuajm b. Abdullahu, e ky i mori paratë për atë dhe ia dorëzoi atij.

**TË HUAZUARIT DIKUJT DIÇKA DERI NË AFAT  
TË CAKTUAR OSE CAKTIMI I AFATIT NË RAST  
SHITBLERJE**

Ibn Umeri ka thënë: “Nuk ka gjë të keqe huaja me afat të caktuar, po edhe që t’i jepet borxhliut para më me vlerë se ajo e atij, por ai të mos e lypsi atë”.

A’la dhe Amr b. Dinar ka thënë: “Lejohet huazimi deri në një afat të caktuar”.

2404. - Lejthi thotë: Me ka rrëfyer Xhafer b. Rebi nga Abdurrahman b. Hurmuzi, ky nga Ebu Hurejre r.a. i cili ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. përmendi një njeri nga izraelitët, i cili kërkonte nga një izraelit t’i japë para hua dhe ia ktheu në afatin e caktuar.

**NDËRMJETËSIMI PËR ULJE TË BORXHIT**

2405. - Na ka treguar Musa se i ka transmetuar Ebu Avane nga Mugire, ky nga Amiri, ky nga Xhabiri r.a.

- Abdullahu u godit rëndë ( për vdekje në Uhud). La familje të madhe dhe borxh dhe kërkova nga huadhënësit ta zbresin ca kërkesën për borxhin e tij, por s'deshën. Pastaj shkova te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e luta për intervenim lidhur me këtë.

Pasi që ata nuk e përfillën këtë, **ai tha: Klasifikoj tëra hurmat veç e veç, të mirat veç, të dobëtat veç dhe më të mirat veç, dhe thirri borxhlinjtë, aty do të jem edhe unë.**

E bëra këtë, e pastaj erdhi edhe Alejhisselami, u ul mbi ta dhe secilit ua peshoi deri kur i kreu të gjitha, porse hurmat mbetën siç kishin qenë, si të mos ishin prekur fare.

2406. - Kam qenë bashkë me Pejgamberin a.s. në një luftë me deven tonë e deveja u lodh dhe mbeti prapa. Pejgamberi s.a.v.s. i ra prapa dhe tha: **“Shitma mua, kurse ti shaloje deri në Medine”**. Kur u afruam kërkova leje dhe i thashë: **“O Pejgamber i All-llahut, unë jam i ri dhe i martuar”**.

- **A ke marrë vajzë apo të vejë?** - pyeti ai.

- Të vejë - i thashë unë. Abdullahu e pësoi, la pas veti vajza të vogla. Unë u martova me vejushën që ajo t'i mësojë dhe edukojë.

**Shko në shtëpi te familja jote!** tha Alejhisselami.

Kur arrita i kumtova dajës tim shitjen e deveve, e ai më qortoi. Unë i tregova për lodhjen e deveve dhe për atë se çka bëri Pejgamberi s.a.v.s, se i ra pak. Pasi arriti Pejgamberi s.a.v.s të nesërmen në mëngjes ia çova deven, kurse ai më dha paratë sa kushtonte deveja, ma dha deven edhe pjesën që më takonte sikur të tjerëve.

## **NDALIMI I SHKATËRRIMIT TË PASURISË SË HUAJ NË BAZË TË SHPALLJES SË ALL-LLAHUT**

**“All-llahu nuk e do turbullirën”<sup>57</sup>**

---

57 Kur'an, 2: 205

---

“Sepse All-llahu nuk miraton veprën e të mbrapshtëve”<sup>58</sup>

“kjo e falmja jote a të urdhëron që t’i lëmë ato që i kanë adhurunar baballarët tanë ose të mos veprojmë me pasuritë tona ashtu siç dëshirojmë vetë...”<sup>59</sup>

“Ndërsa të papjekurve (të marrëve) mos ua jepni pasurinë e tyre...”<sup>60</sup>

## SI EDHE KUFIZIMI NGA MASHTRIMI

2407. - Na ka treguar Ebu Nuajm se i ka transmetuar Sufiani nga Abdullah b. Dinari.

E kam dëgjuar Ibn Umerin r.a. kur ka thënë: **“Një njeri i tha Pejgamberit a.s.: Mua në tregti shpesh më mashtrojnë, e ai tha:**

**- Kur të shesësh thuaj: “Nuk ka mashtrim!”** dhe ai këtë e thoshte.

2408. - Na ka treguar Uthmani, këtij Xheriri nga Mensuri, ai nga Shabiu, ky nga Verradi, robi i liruar i Mugire b. Shu’bes, ai nga Mugire b. Shube i cili ka thënë:

**Pejgamberi s.a.v.s. thotë: All-llahu ju ka ndaluar padëgjueshmërinë ndaj nënave (prindërve), varrosjen e vajzave të posalindura dhe moskryrjen e detyrave tuaja, rrëmbimin e pasurisë së huaj, e urren marrjan me “thashë e thëna”, pyetjet e shumta dhe shkatërrimin e pasurisë.**

## ROBI ËSHTË RUAJTËS I PASURISË SË ZOTËRIUT TË VET DHE AI PUNON VETËM ME PËLQIMIN E ATIJ

2409. - Na ka treguar Ebu Jeman se i ka transmetuar Shu’be

---

58 Kur’an, 10: 81.

59 Kur’an, 11: 87.

60 Kur’an, 4: 5.

---

nga Zuhriu, e thotë se i transmetoi Salim b. Abdullahu nga Abdullah b. Umeri r.a. se e ka dëgjuar Pejgamberin e All-llahut që thoshte:

**Secili nga ju është bari dhe mban përgjegjësi për kopenë e vet: sunduesi është bari dhe është përgjegjës për kopenë e vet, burri është bari i shtëpive të vet dhe është përgjegjës për tufën e vet, gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të vet dhe ajo është përgjegjëse për mbrojtjen e saj, shërbëtori është bari i pasurisë së zotëriut të tij dhe ai është përgjegjës për tufën e vet.**

**Kam dëgjuar këtë - ka thënë Abdullahu - nga i Dërguari i Allllahut, por më duket se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë edhe këtë:**

**- Burri është bari i pasurisë së babës së vet dhe ai është përgjegjës për mbrojtjen e asaj.**

Me flalë tjera, shkurt, secili nga ju është bari dhe secili prej jush është përgjegjës për kopenë e vet.

## **Kreu 44**

### ***Mosmarrveshjet***

#### **ÇKA THUHET PËR SJELLJEN E PALËVE TË KONTESTUARA NDËRMJET MUSLIMANIT DHE HEBREIT**

2410. - Na ka treguar Ebu Velid se i ka transmetuar Shu'be, **këtij i kumtoi** Abdu-l-Melik b. Mejsere që thotë se ka dëgjuar nga Nezzal b. Sebrete, kurse ky nga Abdullahu i cili thotë:

E kam dëgjuar një njeri kur e lexoi një ajet ndryshe nga leximi i Pejgamberit s.a.v.s. dhe unë e mora përdore dhe e solla te Pejgamberi s.a.v.s.. Ai për këtë tha: **“Të dy ju jeni të mirë”**.

Shu'be ka thënë:

Më duket se ka thënë edhe këtë: **“Mos u ndani, sepse ata që ishin përpara jush u shpërndan prandaj edhe u shktërruan”**. (Krahaso: 3408, 3414, 3476, 4813, 5063, 6517, 6518, 7428, 7477).

---

2411. - Na ka treguar Jahja b. Kazea se i ka transmetuar Ibrabim b. Sa'adi nga Ibn Shihabi, ky nga Ebu Seleme dhe Abdurrahman Al-A'rexhi, ai nga Ebu Hurejre r.a. i cili rrëfen:

- U zunë dy vetë nder veti, njëri ishte musliman e tjetri hebrej. Muslimani tha: **“Pasha Atë i cili e ka zgjedhur Muhammedin për tërë hotën”**. Kurse hebreji tha: **“Pasha atë i cidi e ka zgjedhur Musën për tërë botën”**. Muslimani, në këtë çast, ngriti dorën dhe i ra hebreut fytyrës (shuplakë). Hebreu shkoi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e informoi për këtë çka i ndodhi me muslimanin. Pejgamberi s.a.v.s. e pyeti lidhur me këtë rast, edhe muslimanin. Edhe ky e informoi ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. tha: **“Mos më konsidero më të mirë se sa Musai. Ditën e Kijametit bota do të jetë në agoni, po ashtu edhe unë. Do të jem i pari që do të më dalë kllapia. Musau atëhere do të jetë duke u mbajtur për një ane të Arshit. Nuk e di a do të ketë qenë edhe ai në mesin e atyre të cilët ranë në kllapi dhe është kthjelluar përpara meje, apo do të ketë qenë prej atyre te cilët All-llahu i kursen nga kllapia.**

2412. - Na ka treguar Musa b. Ismail, këtij Vuhejbi i tha se i transmetoi Amr b. Jahja nga babai i vct ky nga Ebu Seid El Hueri r.a. i cili ka thënë:

**-Pejgamberi s. a.v.s ishte duke ndejtur. Një hebrej erdhi dhe i tha: “O Ebu Kasim, njëri nga shokët tu më ka ra në fytyrë!”**

**- Kush është ai? pyeti ai.**

**-Ishte njëri nga ensarët - u përgjigj ai.**

**-Thirrmani këtu! tha.**

**-A i ke ra? - e pyeti Resulull-llahi.**

**- E dëgjova, tha ai, në pazar duke u betuar “Pasha Atë që e zgjodhi Musën për tërë njerëzit”.**

Pejgamberi s.a.v.s. në këtë moment i tha: **“Mos më konsideroni mua më të mirë se pejgamberët tjerë. Ditën e Kijametit, i tërë njerëzimi do të bien në agoni e unë do të**

**jem i pari që do të vij në veti dhe menjëherë do ta shohë Musën duke u mbajtur për një rën nga shtyllat e Arshit. Nuk mund ta di a ishte edhe ai në agoni apo iu llogarit atij ajo agonia e parë”.**<sup>61</sup> (Krahaso: 2258, 4638, 6916, 6917, 7427).

2413. Na ka treguar Musa se i ka transmetuar Hemmani nga Katade, ky nga Enesi r.a. se një hebrej e përplasi një vaizë me krye për gurësh. E pyetën, kush ta bëri këtë? A ta bëri filani apo filani? Më në fund u përmend një hebrej dhe kjo e konfirmoi me lëkundje të kokës. Pastaj e zunë atë hebrejin dhe ai e pranoi. **Peigamberi s.a.v.s., pas kesaj, urdhëroi dhe e përplasën edhe atë me krye në mes dy gurëve.** (Krahaso: 2746, 529S, 6876, 6877, 6879, 6884, 6885).

### **AI QË REFUZON ÇËSHTJEN E MBRAPSHTANIT DHE TË MENDJEPAKUT (ABNORMALIT) DHE GJYKATËSI NUK E VË NË DISKUTIM**

Tregohet se Xhabiri ka transmetuar nga Pejgamberi s.a.v.s. se ky e ka pezulluar aktin e (lirimit të robit) bëmirësisë përpara se të shqiptohet ndalesa, dhe këtë pastaj e ka ndaluar.

Maliku thotë: **“Nëse dikush ka pasuri të kërkojë nga tjetri i cili ka rob por nuk ka asgjë tjetër, e ai e fal, akti i faljes nuk i lejohet”.**

Nëse shet diçka nga pasuria e anormalit, apo ngjashëm me

---

<sup>61</sup>. Në mesin e të dërguarve ka njëfarë shkallëzirni, por për nga funksioni ata janë të gjithë të barabartë, prandaj lavdërimi i njërit duke lënë anash tjetrin nuk është i mirë” kurse mospranimi i ndonjërit, pavarësisht se cilin, besimtarin e hedh jashtë fesë Islame.

Më Kijamet do të shëmben gjithçka ka në qiej dhe në tokë, përveç atyre që do Allahu t’i mbajë edhe një kohe e ata janë Xhibrili, Israfili, Mikaili dhe Azraili.

---

---

këtë, dhe ato para ia dorëzon atij duke e porositur që t'i ruajë vetëm për nevoja të vetat, e ky prapë bën skandale do ta pengojë, ngase **Pejgamberi s.a.v.s. ka ndaluar shkatërimin e pasurisë, kurse atij që është mashtruar në tregëti i ka thënë:**

- **Kur të shesësh, thuaj: “Nuk ka mashtrime”,** por pasurinë nuk ia ka marrë Alejhisselami.

2414. Na ka treguar Musa b. Ismail, këtij Abdulaziz b. Muslim, këtij Abdullah b. Dinar, që thotë:

E kam dëgjuar Ibn Umerin r.a. se thoshte: **“Njëri gjithmonë dilte i mashtruar në shitblerje, prandaj Pejgamberi s.a.v.s. i tha: Kur të shesish thuaj: Nuk ka mashtrim! Ky kështu vepronte”.**

2415. - Na ka treguar Aism b. Ali se i ka transmetuar Ibn Ebu Dhi'b nga Muhammed b. Munkedir, ky nga Xhabiri r.a. se njëri e liroi robin e vet e përveç **atij nuk** kishte asgjë tejtër, **andaj Pejgamberi s.a.v.s. e tërhoqi (shvleftësoi) këtë dhe nga ky e bleu Nuajm b. Nehham.**

### **KONFRONTIMI I PALËVE NJERËN KUNDËR TJETËRËS**

2416, 2417. - Na ka treguar Muhammedi se i ka transmetuar Ebu Muaviu nga A'meshi, ky nga Shekiku, ky nga Abdullahu r.a. se:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ai që bëri be rrejshëm, me qëllim të grabitjes së pasurisë së një muslimani, kur do të ballafaqohet me All-llahun Ai do të jetë i zemëruar në këtë”.**

Abdullahu ka thënë: Esha'thi ka thënë: Pasha Zotin, kjo është lidhur me mua sepse unë dhe një hebrej kishim një tokë që ai ma mohonte të drejtën për të, dhe unë e çova te Pejgamberi s.a.v. s.

Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. më tha:

- **Ke fakte?**

- **Jo, u përgjigja.**

**Ai pastaj, thotë Esha'thi, i tha hebrejit: "Betohu!"**

**Unë - thotë Eshathi,-i thashë: "O Pejgamber i All-llahut, ky tash do të betohet dhe pasuria ime shkoi!"**

**Në këtë rast All-llahu xh. sh. shpalli: "Ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak - në botën tjetër nuk kanë asgjë, atyre All-llahu në ditën e kijametit nuk do t'u flasë fare e as do t'i shikojë, dhe nuk i pastron -ata kanë për të vuajtur dënim të dhembshëm".<sup>62</sup>**

2418. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se i ka transmetuar Osman b. Umer, këtij i kumtoi Junusi që transmeton nga Zuhriu, ai nga Abdullah b. Ka'ab b. Malik, ky nga Ka'abi r.a. se ky i kërkonte Ibn Ebi Hadredit në xhami, t'i paguajë borxhin që ia kishte. Ata ngritën fjalët aq sa i dëgjoi Pejgamberi s.a.v.s. në dhomën e vet. E hapi perdën dhe doli nga dhoma dhe thirri: "O Ka'ab!"

- **Këtu jam, O Pejgamber!** - u përgjigj ai.

- **Zbrite borxhin tënd për kaq!** dhe me gisht tregoi gjysmën.

- **Këte kam bërë më herët, o i Dërguar** - tha ai.

- **Çohu dhe paguaja!** i tha Alejhisselami.

2419. - Na ka treguar Abdullah bin Jusuf se i ka transmetuar Maliku, ky nga Ibn Shihabi, ai nga Urve b. Zubejri, kurse ky nga Abdurahman b. Abdu-l-kadir i cili ka thënë:

E kam dëgjuar Umer b. Al-Hattabin r.a. duke thënë se e ka dëgjuar Hixham b. Hakimin duke lexuar suren Furkan jo sikur që e lexoja unë, sikur që ma kishte mësuar Pejgamberi a.s., dhe

---

<sup>62</sup> Kur'an, 3:77

---

---

unë desha t'i kundërshtoj, por e lashë deri sa e kreu. Pastaj e kapa për xhabeje dhe e shpura te Pejgamberi a.s. dhe i thashë: E kam dëgjuar këtë duke lexuar ndryshe nga ajo që më ke mësuar ti.

- **Lere atë, më tha. E pastaj iu drejtua atij: Lexo dhe ai lexoi kurse Alejhiselami i tha: Ashtu është shpallur. Pastaj mua më tha: Lexo edhe unë lexova e ai më tha: Edhe ashtu është shpallur. Kur'ani është shpallur në shtatë mënyrë (të shqiptimit) dhe lexonie si u vjen më lehtë".** (Krahaso: 4992, 5041, 6936, 7550).

### **PËRZËNIA E GJYNAHQARIT DHE NGATËRRESTARIT NGA SHTËPIA PASI TE MERRET VESH PËR TA**

Umeri e ka përzënë nga shtëpia motrën e Ebu Bekrit kur ajo vajtoi për Ebu BEkrin (që kishte ndërruar jetë).

2420. - Na ka treguar Muhammed b. Beshshar se i ka transmetuar Muhammed b. Ebu Adij nga Shu'abe, kurse ai nga Sa'ad b. Ibrabim, ky nga Humejd b. Abdurahman, ai nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

Kam vendosur të jap urdhër që të bëhet nijet për të hyrë në namaz, kurse unë të shkoj në shtëpitë e atyre që nuk **marin** pjesë në namaz (në xhami) dhe t'ua ndezi shtëpitë.

### **I AUTORIZUARI ME POROSI MUND TË SHPREH MENDIMIN E TË VDEKURIT**

2421. - Na ka treguar Abdull-llah b. Muhammed se i ka transmetuar Sufiani nga Zuhriu, ai nga Urve, ky nga Aisheja r.a. se Abd b. Zem'a dhe Sa'd b. Ebi Vekas paraqitën një kontest te Pejgamberi a.s. lidhur me djalin e robëreshës Zem'a.

Sa'di tha: **O Pejgamber i All-llahut, vëllai im më ka**

---

---

porositur që kur të vij në Mekke ta shoh djalin e robëreshës Zem'a dhe ta marr, sepse ai është djali im. Pastaj Abd b. Zem'a tha: Ai është vëllai im dhe djali i robëreshës së babës tim edhe është lindur në shtratin e babës tim.

Pejamberi a.s. këtu vërejti një ngjashmëri shumë të qartë, por tha: "O Abd b. Zem'a, ai është i yti, **ngase fëmija i përket shtratit, dhe mbuloju nga ai, oj Sevdi**".

### **DUHET SIGURUAR (MBROJTUR) PREJ ATIJ QË KA RREZIK**

2422. - Na ka treguar Kutejbe se i ka transmetuar Lejthi nga Seid b. Ebu Seid se ka dëgjuar Ebu Hurejren r.a. duke thënë:

Pejgamberi a.s. nisi për në Nexhd një grup kalorsish dhe ata sollën një njeri nga fisi Benu Hanife, i cili quhej Thumame b. Uthal, kujdestari i banorëve të Jemames, dhe e lidhën për një shtylle të xhamisë.

Doli, mandej, **Pejgamberi a.s dhe tha: Çka është me ty Thumame. Mirë është, o Muhammed,** u përgjigj ai.

Mandej Ebu Hurejre e paraqiti rastin në tërësi dhe Pejgamberi a.s. tha: **Lëshone Thumamen.**

### **LIDHJA DHE MBYLLJA NË HAREM (NË QABE)**

Nafi'a b. Abdu-l-Harith bleu një shtëpi në Mekke për burg (për 4000 dërhëm) nga Safvan b. Umejje me kusht që nëse halifi Umer është i kënaqur pazari do të jetë i vlefshëm, i plotfuqishëm, por nëse Umeri nuk është i kënaqur, Safvanit i takojnë vetëm 400 dërhëm qira. Ibn Zuberi i mbyllte (fajtorët) në Mekke.

2423. - Na ka trequar Abdull-llah b. Jusuf, këtij Lejthi, që thotë se i ka deklaruar Seid b. Ebi Seid se ka dëgjuar Ebu Hurejren r.a. kur ka thënë:

---

**Pejgamberi a.s. ka nisur disa kalorës për në Nexhd dhe ata sollën një njeri nga fisi Benu Hanife që qubej Thumame b. Uthal dhe e lidhën për një shtylle të xhamisë.**

### **KËMBËNGULËSIA NË LYPJEN E BORXHIT**

2424. - Na ka trequar Jahja b. Bukejr, këtij Lejthi, këtij Xhafer b. Rebi'a, por edhe të tjerë që thonë se Lejthi ka transmetuar nga Xhafer b. Rebia' nga Abdurrahman b. Hurmuzi, ky nga Abdullah b. Ka'b b. Malik Ensariu, Ka'bi nga Ka'b b. Maliku r.a. se ky kishte te Abdullah b. Ebu Hadred El-Eslemi një borxh personal dhe gjithmonë e kërkonte. Në këtë mënyrë duke biseduar e ngritën zërin në një çast kur atypari kalonte Pejgamberi a.s. Ai tha:

**- O Ka'b, duke bërë shenjë me dorë, "përgjysmë"!**

- Atëherë Ka'bi mori gjysmën e borxhit e gjysmën tjetër e

la.

### **TË PAGUARIT E BORXHIT**

2425. - Na ka treguar Is-haku, këtij Vehb b. Xherir b. Hazim se i ka transmetuar Shube nga A'meshi, ky nga Ebud-Duha, ky nga Mesruku, kurse ai nga Habbabi i cili ka thënë:

- Në periudhën xhahilije punoja si farkëtar dhe As b. Vaili më kishte borxh disa derhem dhe shkova t'ia lypsi që të m'i paguajë. Ai tha: **"Nuk do t'i paguaj deri kur të lësh besimin në Muhammedin"**.

**- Jo, pasha Zotin, kurrë - i thashë - nuk do të lësh besimin në Muhammedin a.s., deri kur All-llahu të ta marr shpirtin dhe prapë të ringjallesh.**

-Atëherë, pra, më lër, tha ai, derisa të vdes dhe të ringjallem, do të më jepet ndonjë pasuri e ndonjë fëmijë, dhe pastaj po të paguaj. Pas këtij rasti është shpallur: "A e ke parë atë i cili ka përgënjeshtuar argumentet tona dhe ka thënë: 'gjithsesi do të më jepet pasuri dhe fëmijë'!"<sup>63</sup>

---

<sup>63</sup> Kur'an, 19: 77.

## **Kreu 5.**

### *Sendi i gjetur*

## **NËSE PRONARI I SENDIT TË GJETUR E PËRSHKRUAN SAKTËSISHT, AI DO T'I DORËZOHET ATIJ**

2426. - Na ka treguar Ademi, këtij i tregoi Shu'be, por më ka transmetuar edhe Muhammed b. Beshshari se i ka kumtuar Gunderi të cilit i ka transmetuar Shu'beja përmes Selemes i cili thotë:

- E kam dëgjuar Suvejd b. Gafelin kur ka thënë: **“E kam takuar Ubejj b. Ka'bin r.a. duke thënë: e kam gjetur kuletën me njëgind dukatë dhe shkova te Pejgamberi s.a.v.s.”**.

**Ta lajmërosh një vit - me tha ai..**

Unë e lajmërova një vit të tërë por pronari i saj nuk u paraqit. Përsëri shkova te Pejgamberi a.s. e ai prapë më tha: **“Lajmëroje një vit”**. Unë e lajmërova, por pronari prapë nuk u paraqit, nuk u gjet. Unë shkova për të tretën herë dhe ai më tha: **“Mbaje mend çfarë kulete është, numrin dhe lidhësen e kuletës, dhe, nëse ven pronari i saj ta dorëzosh, në të kundërtën mund ta përdorësh”**. Dhe unë e kam përdorur.

Dikur më vonë e takova Ubejjin në Mekke dhe më tha: **“Nuk jam i sigurt a më tha tri vjet (ta lajmëroj sendin e gjetur) apo një vit»**.<sup>64</sup> (Krahaso: 2437)

---

<sup>64</sup>. Nga ky hadith rezulton:

- nëse pronari nuk gjendet brenda një viti, gjetësi duhet të mbajë mend, përveç sendit të gjetur edhe mbështjellësin, e pastaj mund ta shfrytëzojë.
- nëse pronari vjen dhe e përshkruan sendin e humbur dhe betohet, gjetësi ia kthen, dorëzon menjëherë. Kështu mendon Maliku, Ahmedi, Davudi dhe Lejth b.Sa'adi, ndërsa Ebu Hanife dhe Shafiu konsiderojnë se dorëzimi i sendit të gjetur nuk është i domosdoshëm deri kur ta argumentojë pronësinë ai që e lyp sendin konkret;
- nëse sendi i gjetur i dorëzohet atij që e lyp në bazë të përshkrimit të këtij sendi, kurse më vonë paraqitet tjetri dhe krahas përshkrimit e argumenton

---

---

## DEVEJA E HUMBUR

2427. – Na ka treguar Amr b. Abbas se i ka thënë Abdurrahmani i cili transmeton nga Sufjani kurse ky nga Rebi'u: Më ka rrëfyer Jezidi, rob i liruar nga Munbeithi i cili transmeton nga Zejd b. Hali l El-Xhuheniye r.a. i cili thotë:

Erdhi një nomad te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e pyeti për send të gjetur, e ai iu përgjigj: **Lajmëroje një vit, pastaj mbaje mend**

---

në mënyrë të pakontestueshme pronësinë e vet, sendi i merret atij të parit dhe i dorëzohet këtij të dytit. Nëse sendi është shkatërruar te i pari, pronari i vërtetë merr dëmshpërblirin, sipas Shafiut, nga gjetësi sepse nuk e ka dorëzuar në duar të pronarit. Sipas mendimit të Ebui Kasimit dëmshpërblimin ia paguajnë pronarit në mënyrë të barabartë gjetësi dhe ai që e ka pranuar sendin e gjetur, kurse Maliku e liron gjetësin nga përgjegjësia, nëse ka vepruar sipas hadithit të përmendur.

Dijetarët e shkollës Hanefite thonë: “Nëse gjetësi ia dorëzon sendin e gjetur pronarit i cili e ka përshkruar ashtu siç është evidentuar në hadith, por me vonë personi tjetër sjell edhe argumente për të dëshmuar pronësinë, ai send i takon personit të fundit. Nëse, ndërkaq, sendi i gjetur është dëmtuar te ai i pari, pronarit i paguan dëmshpërblimin ose gjetësi ose personi që e ka pranuar këtë send si të vetin. Në qoftë se dëmshpërblimin e paguan gjetësi, ky ka të drejtë të kërkojë kompenzim të plotë nga personi i cili e mori, pranoi këtë nga ky;

- nëse pronari nuk paraqitet brenda një viti pasi që është shpallur sendi, sipas Ebu Hanifes, gjetësi i varfër mund ta shfrytëzojë atë send për nevoja të veta, por sipas mendimit të imamëve të shkollave tjera juridike njëloj mund të veprojë edhe gjetësi i pasur;

nëse sendi i gjetur dëmtohet, shkatërrohet te gjetësi para se të kalojë një vjet, gjetësi nuk i paguan pronarit dëmshpërblim, nëse dëshmon me argumente se sendin e gjetur e ka marrë me qëllim që ta ruajë dhe t'ia kthejë pronarit të vet, dhe nëse nuk mund ta argumentojë këtë duhet të paguajë dëmshpërblim. Ky është mendim i Ebu Hanifes dhe Muhammed b. Hasanit, kurse Ebu Jusufi, Shafiu dhe Ahmedi nuk e kushtëzojnë dëshminë dhe argumentimin e qëllimit të vërtetë. Për shembull nëse gjetësi gjatë procedurës gjyqësore konfirmon se sendin e gjetur e ka marrë me qëllim që t'ia dorëzojë pronarit, e pronari nuk e pranon këtë, përfilllet fjala e pronarit ashtu që gjetësi duhet t'ia paguajë dëmshpërblim;

-Nëse sendi i gjetur shkatërrohet te gjetësi, pasi të kalojë një vit, pronarit nuk i takon kurrfarë dëmshpërblimi.

çfarë ishte me të gjitha hollësitë, dhe nëse vjen dikush dhe e përshkruan saktësisht është send i tij, jepja, në të kundërtën mbaje për vete”

- O peygamberi i All-llahut, iu drejtua nomadi, po nëse është dele e humbur.

- Ajo, delja, është e jotja, ose e vëllait tënd, ose e ujkut - u përgjigj ai.

- Po deveja e humbur? e pyeti ky prapë. Peygamberi as. ndërroi çehren në fytyrë dhe i tha: “Çka ke ti me të? ajo ecën vetë, pi ujë vetë dhe ushqehet vetë ha gjethe.”

### **DELEJA E HUMBUR**

2428. - Na ka treguar Ismail b. Abdullah i cili thotë se i ka thënë Sulejman b. Bilal, sipas Jahjasë, kurse ky transmeton nga Jezidi, rob i liruar nga Munbeithi, se e ka dëgjuar Zejd b. Halidin r.a. që thotë se Peygamberi, kur e kanë pyetur për sendin e gjetur, është përgjigjur:

- “Mbaje mend enën edhe lidhësen, pastaj lajmëro një vit” Zejdi shton edhe këtë: “Nëse nuk i dihet, paraqitet, pronari, ta shfrytëzojë ai që e ka gjetur dhe të trajtohet si send i ruajtur”.

Jahja ka thënë: “Kja është çështje që nuk di se a janë këto fjalë të Peygamberit a.s. apo janë fjalë të Jezidit.” Pastaj pyeti: Çka thua për delen e humbur?”

- “Merre” tha Peygamberi i All-llahut. Ajo është e jotja, ose e vëllait tënd ose e ujkut.

Edhe kjo, thotë Jezidi, gjithashtu do të lajmërohet një vit.

**Po çka mendon - pyeti ai - për devenë e humbur?**

Jezidi transmeton se ka thënë: “Lëre atë” Ajo ecën vetë, ka këpucët e veta, pi ujë vetë, ha krاند deri kur ta gjejë pronari i vet”.

---

---

## NËSE PRONARI I SENDIT TË GJETUR NUK GJENDET EDHE PAS NJË VITI AI SENDI TAKON GJETËSIT

2429. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf të cilit i transmeton Maliku nga Rebi b. Abdurrahman, kurse ky nga Jezidi, rob i liruar nga Munbeithi, ndërsa ai nga Zejd b. Halidi r.a.

- Erdhi një njeri te Pejgamberi i All-llahut dhe e pyeti për sende të gjetura, e ky i tha:

**“Mbaje mend kuletën dhe lidhësen e saj, dhe shpalle se e ke gjetur një vit. Nëse vjen pronari, jepja, nëse jo, mbetet e jotja.”**

- Po delja e humbur - pyeti ai.

- Ajo është e jotja, u përgjigj Pejganberi a.s. ose e vëllait tënd ose e ujkut.

- Po deveja e humbur? e pyeti prapë.

- Çka ke ti me të? Ka këpucët e veta, ujin e vet, pi vetë, ha lëvore të lisave deri kur ta gjejë i zoti i vet.<sup>65</sup>

---

65 Deveja për në shkretëtirë është sikurse anija për në det. Merr ujë një herë për disa ditë, kurse për ushqim i mjaftojnë filizat e therrave. Jeta në shkretëtirë për të nuk paraqet ndonjë rrezik, prandaj gjetësi nuk duhet ta kapë atë. Kështu mendon Maliku dhe Evzaiu. Dijetarët e Kufës dhe Shaf'iu konsiderojnë se më mirë është që ta kapë ngase kështu siguria e saj është më e madhe.

Me lopën duhet vepruar sikurse edhe me devenë. Kështu mendojnë Tavusi, Evzaiu, Shafiu dhe disa dijetarë të shkallës maliikitë. Maliku dhe Shafiu thonë: “Nëse ka ndonjë rrezik për lopën, ajo trajtohet sikur delja, por nëse nuk ka rrezik; e ka statusin e devesë, trajtohet si deveja”.

Lopa e humbur që ka brinj për t'u mbrotjur, nga disa dijetarë, trajtohet sikur deve e humbur, kurse ajo që nuk ka brinj trajtohet si dele.

Kalin, mushkën dhe gomarin, sipas mendimit të Ibn Kasimit lejohet t'i kapësh, ndërsa Eshhebiu dhe Ibn Kinane kanë mendim të kundërt. Ibn Xhevziu thotë: “Udhëheqësit të bashkësisë i lejohet t'i zërë kalin, mushkën, devenë, lopën, gomarin, delen dhe kaprollin që t'i sigurojë deri kur t'u dorëzohen pronarëve”.

---

---

**NËSE GJEN NË DET (UJË DRU KAMXHIK  
OSE DIÇKA TË NGJASHME MERRE**

2430. - Lejthi thotë: “Më ka treguar Xhafer b. Rebi”, ky transmeton nga Abdurrahman b. Hurmuzi, kurse ai nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi a.s. ka përmendur një njeri nga izraelitet, e ka shtruar disa herë tërë rastin, që ka dalë të presë ndonjë barkë e cila, ndoshta, do t’i sillte barrën, pasurinë e tijë. E pa një dru dhe e mori për t’i ngrohur femijët e vet dhe kur e copëtoi aty gjeti pasurinë e vet dhe një letër.<sup>66</sup>

**GJETJA E HURMËS NË RRUGË**

2431. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf të cilit i transmetoi Sufjan nëpërmes të Mensurit, ky nga Talba kurse ai nga Enesi r.a. që thotë:

---

Në *Tevhib* është thënë: “Pasuria e gjetur bashkë me shtimin, qoftë i bashkuar apo i ndarë, i takon pronarit të vet, qoftë të paraqitet brenda vitit ose pas një viti, duke llogaritur nga dita e shpalljes së sendit të gjetur, përveç nëse ai shtim ka lindur përpara se të fitojë gjetësi të drejtën e pronësisë ndaj asaj pasurie.”

<sup>66</sup> Druri që noton mbi ujë, kapistra, kamxhiku dhe të ngjashme me to, mund të shfrytëzohen nga gjetësi edhe pa e shpallur gjetjen e tyre, dhe nëse më vonë paraqitet pronari atij i paguhet dëmshpërblim. Këtë qëndrim e mbajnë Umeri, Ibn Umeri, Aliu, Aisheja, A’tau, Nehaiu dhe Tavusi.

Ibn Mundhiri transmeton nga Aishja: “Sendin e gjetur që nuk ka vlerë më shumë se një derhem, nuk është e ndaluar ta marrësh dhe përdorësh për nevoja personale”.

A’tau ka thënë: “Nuk ka gjë të keqe nëse shfrytëzon kamxhikun e gjetur, shkopin, kapistrën, këpucën dhe të ngjashme me këto”.

Në *“El-Hidaje”* thuhet: “Lejohet përdorimi i sendit të gjetur, pa e shpallur gjetjen, për ato gjera për të cilat zakonisht dihet se pronari nuk do t’i lypë, si për shembull bërthama e kumbullave, lëvorja e krrocave, dhe të tjera, por duke e ditur se edhe ajo është pasuri e huaj e jo e gjetësit.”

Sendet që prishell dhe sendet që dëmtohen, nëse rrinë në rrugë, siç janë; molla, dardha, kumbulla dhe të ngjashme me këto, gjetësi mund t’i hajë dhe për këto nuk i jep dëmshpërblim pronarit.

---

**- Pejgamberi a.s. kaloi pranë një hurmeje në rrugë dhe tha: Kam frikë mos është sadaka se do ta kisha ngrënë.**

2432. - Jahja thotë se i ka treguar Supani, këtij Mensuri e këtij Xaide kurse këtij Talba, të cilit Enesi i ka thënë se ka dëgjuar nga Muhamed b. Mukatil, e ai nga Abdullahu kurse këtij i ka kumtuar Ma'mer përmes Hammarm b. Munebbih kurse ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi a.s. thotë:

- U ktheva te shtëpia, në familje, dhe gjeta një hurme që kishte rënë në shtrojen time. E mora ta ha por u **frikësova mos është sadaka dhe e hudha.**

### **SI E LAJMËROJNË MEKKASIT SENDIN E GJETUR**

Tavusi transmeton nga Ibn Abbasi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. tha:

- Sendin e gjetur në Mekke do ta marrë vetëm ai që e proklamon. Halidi transmeton nga Ikrime, kurse ky nga **Ibn Abbasi** r.a. ndërsa ai nga Pejgamberi s.a.v.s..

Sendin e humbur në Mekke lejohet ta marrë vetëm ai që e proklamon.

2433. - Ahmed b. Sa'd thotë se i ka transmetuar Revhi, këtij Zekerija, këtij Amr b. Dinar nga Ikrimeja, kurse ky nga Ibn Abbasi r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

**- Në Harem nuk priten therrat, nuk gjahtohet dhe nuk lejohet ta marrësh sendin e humbur, këtu në Harem, përveç atij i cili e lajmëron a edhe bari nuk pritet.**

Ibn Abbasi mandej ka thënë: O Pejgamber i All-llahut përjashto het shavari? Me përjashtim të shavarit - tha Pejgamberi a s.

2434. - Na ka treguar Jahja b. Musa i cili thotë se i ka transmetuar Velid b. Muslim, këtij Evaziu, se i ka thënë Jahja b.

Ebi Kethir:

Më ka treguar Ebu Seleme b. Abdurrahman se Ebu Hurejreja r.a thotë: **“Kur ia bëri All-llahu xh.sh. të mundshme Muhammedit a.s. çlirimin e Mekkes, ai u ngrit në mes të njerëzve, falënderoi All-llahun dhe tha: All-llahu xh.sh. e largoi nga Mekka elefantin (ushtrinë e tij) dhe ia dha pushtetin ndaj Mekkes, si e shihni, Pejgamberit të vet dhe besëdrejtëve. Askush përpara meje nuk e kishte të lejuar. Mua më është lejuar vetëm për një moment, dhe, pas meje nuk i lejohet më kurrkujt. Kafshët e gjahut këtu nuk gjatohen, nuk ndiqen, therrat këtu nuk priten, sendi i humbur këtu i lejohet ta marrë vetëm ai që e lajmëron, kurse ai të cilit i është vrarë ndokush mund të zgjedhë prej këtyre dyjave të kërkojë kompenzim ose hakmarrje.**

Abbasi atëhere i tha: **Duke përjashtuar shavarin, sepse këtë e përdorim për varreza dhe shtëpitë tona?**

**Duke përjashtuar shavarin - u përgjigj Pejgamberi s.a.v.s.**

U ngrit, pastaj Ebu Shah, një burrë nga Jemeni dhe tha:

**Ma shkruani këtë o Pejgamber i All-llahut.**

Shkruajani Ebu Shahut urdhëroi Pejgamberi i Zotit.

E pyeta Evaziun çka do të thotë “Ma shkruani këtë o Pejgamberi i Zotit”. Kjo do të thotë,: Ma shkruani fjalën që e dëgjoji nga Pejgamberi s.a.v.s. - u përgjigj ky.

### **KAFSHA E HUAJ NUK MILET PA LEJËN E PRONARIT**

2435. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se i ka transmetuar Maliku nga Nafiu, ky nga Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Askush nuk guxon të mjelë kafshën e huaj pa marrë lejen e pronarit. A dëshiron dikush prej jush që t’i vijë njeriu e t’ia thejë enët e qumshtit dhe t’ia marrë ushqimin. Kafsha e ruan në gjiun e vet ushqimin për ju, dhe askush të mos e

---

**mjelë kafshën e askujt pa i marrë leje pronarit të saj.**

**NESE PRONARI I SENDIT TË GETUR VJEN PAS NJË VITI, GJETËSI DO T'IA KTHEJË, SEPSE AI SEND TE KY KA QËNË VETËM PËR TA RUAJTUR**

2436. - Na ka treguar Kutejbe b. Seid se i ka transmetuar Ismail b. Xhafer përmes te Rebi b. Abdurrahmanit, ky nga Jezid, rob i liruar i Munheithit, kurse ky nga Zejd b. Halid El-Xhuhenie r.a. se një njeri e ka pyetur Pejgamberin a.s. për sende të gjetura e ai i është përgjigjur:

- **“Lajmëroje një vit pastaj mbaje mend formën me të gjitha hollësitë dhe mund ta shfrytëzosh, e nëse paraqitet pronari i atij sendi jepje’.**

Po delja e humbur, o Peigamber i All-llahut, e pyeti ai.

-Merre i tha Pejgamberi. Ajo është e jotja, e vëllait tënd ose është e ujkut.

Po deveja e humbur, o Pejgamber i All-llahut, e pyeti prapë,

Pejgamberi a.s. u zemërua - thotë Zejdi - aq shumë sa që u mërdhez, u skuq, në fytyrë dhe i tha:

**“Çka ke ti me të? Ajo bart me vete mbathjen e vet, fumizmin me ujë deri kur ta gjejë pronari i vet.”**

**AI QË GJEN E MERR SENDIN E GJETUR DHE NUK E LË TË DËMTOHET OSE TA MARRË NDOKUSH QË NUK ËSHTË I DENJË**

2437. - Na ka treguar Sulejman b. Harb se i ka transmetuar Shu'abe nga Seleme b. Kuhejl i cili ka deklaruar:

E kam dëgjuar Suvejd b. Gafelin që ka thënë: “Kam qenë me Selman b. Rebi'in dhe Zejd b. Suhanin në një betejë dhe e gjeta një kamxhik e ai më tha: jema mua! Jo, i thashë, sepse nëse e gjej pronarin e tij do t'ia jap, në të kundërtën do ta përdor për vete.

Pasi që u kthyem, shkuam në haxh' u ndala afër Medinës dhe lidhur me këtë e kam pyetur Ubejj b. Ka'abin r.a. e ai më tha: Në **kohën** e Pejgamberit a.s. e gjeta një kuletë dhe njëqind dukatë brenda. Ia çova Pejgamberit a.s., e ai më tha:

**- Këtë shpalle një vit**

Unë e shpalla një vit dhe pastaj përsëri erdha te ai, e ai më tha: **“Shpalle një vit”**

Unë e shpalla edhe një vit dhe për së treti herë erdha te ai, e ai më tha: **“Shpalle një vit”**

Unë e shpalla një vit dhe pas një viti prapë për së katërti herë erdha te ai. Këtë herë më tha: **“Mbaje mend sa ishin, kuletën dhe lidhësen dhe nëse vjen pronari jepja, përndryshe mund të shërbehesh me ato.”**

Abdan na ka treguar se ka dëgjuar nga babai i vet që Shu'be ka transmetuar nga Seleme edhe këtë:

Suvejd b. Gafele ka thënë: Më vonë e kam pas takuar në Mekke Ubejj b. Ka'bin dhe më tha: **“Nuk e di, ta shpall tri vjet apo një vit”**

### **SHPALLJA E SENDIT TË GJETUR PA IA DORËZUAR ORGANIT-PUSHTETIT**

2438 - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf se Sufjani i ka transmetuar nga Rebi'i, kurse ky nga Jezidi, rob i liruar i Munbeithit, ndërsa ky nga Zejd b. Halid r.a., se një nomad e ka pyetur Pejgamberin a.s. për sende të gjetura **dhe ai i ka dhënë përgjigjen:**

Shpalle një vit, dhe, nëse vjen dikush dhe e pershkruan kuletën me gjithë lidhëse, jepja, në të kundërtën shfrytëzoje vetë.

Mandej e pyeti për deven e humbur, e ky u mërdhez nëfytyrë e tha:

**Çka ke ti me të?! Ajo ka me vete ujin dhe mbathejen e vet, ha gjethe lërë le ta gjejë pronari i vet.**

E: pyeti edhe për delen e humbur, dhe ai iu përgjigj: **“Kjo**

---

---

është e jotja, e vëllait tënd ose e ujkut.”

2439. – Më ka treguar Is-hak b. Ibrahim na ka lajmëruar Nadri i cili thotë se ia ka transmetuar Israili nga Eibu Is-haku, kurse këtij i tregon Bera'a fjalët e Ebu Bekirit r.a., ndërsa sipas një varianti tjetër të transmetuesve ka treguar Abdullah b. Rexha se i ka rrefyer Israili përmes Ebu Is-hakut, kurse ky nga Bera'i ndërsa ai nga Ebu Bekri r.a. që thotë:

Duke udhëtuar e pashë një bari që ruante kopenë e tij dhe e pyeta:

**“I kujt je ti” I një Kurejshi** - u pergjigj ai. Më vonë më tha edhe emrin e atij, e unë e njoha atë.

- **A mund të ketë ca tëmbël te kjo kopeja jote?** e pyeta unë.

- **Po**, më tha.

- **A po i mjel?** e pyeta unë.

- **Po**, u përgjigj ai.

Unë pastaj i thashë dhe ai e zuri një dele dhe mbante për këmbësh. I thash t'ia shkundi gjirin nga pluhuri, të shkund edhe duart e veta dhe ai ashtu veproi: i shkundi shuplakat njëra me tjetërën. E moli një vorbë me tëmbël dhe unë e futa në një enë të ujit për Pejgamberin a.s. e cila ishte mbyllur me një leckë. Unë ia çova Pejgamberit s.a.v.s. dhe i thashë: **“Pi o Pejgamber i All-llahut” Ai piu** dhe unë u qetësova. (Krahaso: 3615, 3652, 3908, 3917, 5617).

## **Kreu 46**

### **ALL-LLAHU XH.SH. THOTË:**

**“Dhe ti kurrsesi mos- mendo se Allllahu është indiferent ndaj asaj se çka bëjnë mosbesimtarët. Ai i lëshon ala vetëm deri në atë ditë, kur do t'u mbesin sytë hapur dhe kur të vrapojnë me kryet lart...”..**

(Kur'an 14: 42-43)

El-mukin'u ve-l-mukmihu është njëllor, dhe do të thotë **“me krye lart”**.

### **DËNIMI PËR DHUNË**

Muxhahidi thotë: **“muhti'in”** do të thotë **“lëshojnë shiqimin e vet”** por thuhet edhe **“shpejtojnë”**.

Shikimet e tyre nuk do t'i ikin anash, kurse zemrat e tyre janë zbrazët që do të thotë pa mend, thatë.

**“Ti tërhiq vërejtjen njerëzve për ditën kur do t'u vijë dënimi, e të thonë, ata të cilët kanë bërë mizori: “O zoti ynë, na lë vetëm edhe pak kohë, do t'i përgjigjemi thirrjes tënde dhe do të pasojmë profetët”. “A nuk patët bërë be pak rënë parë se nuk ka për ju shkatërrim?”**

**“Dhe u vendosët në shtapitë e atyre të cilët kishin bërë krim ndaj vetvetës, dhe u është sqaruar se si kemi vepruar me ata, madje ju kemi sjellë edhe shembuj”**.

**“Dhe ata kurdisnin kurthat e tyre. Edhe te All-llahu i gjejnë kurthat e tyre, qofshin ato edhe për të shkatërruar kodrat.”**

**“Dhe kurr mos llogarit se All-llahu do ta mohojë premtimin e vet për profetët e vet. All-llahu është, me të vërtetë, i fortë dhe i ashpër”** <sup>67</sup>

2440. - Na ka treguar Is-hak b. Ibrahim se Muadh bin Hisham i transmeton:

- Më ka treguar babai im që transmeton nga Katade e ai nga Ebu-l-Mutevekkil en-Naxhij, kurse ky nga Ebu Seid El-Huderij r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Kur të shpëtojnë besimtarët nga xhehennemi do të ndalen në një urë ndërmjet xhennetit dhe xhehennemit dhe

---

<sup>67</sup> Kur'an, 14: 44

---

---

do t'i pleqërojnë nderveti dhunën që i kanë bërë njari-tjetrit në këtë botë, dhe pasi që t'i pastrojnë punët nga haku i huej, atëherë do t'u lejohet hyrja në xhennet. Pasha Atë, në dorën e të cilit është shpirt i Muhamedit, secili prej tyre do ta dijë vendin, banimin, në xhennet sipas masës së vendit që e ka pasur në këtë botë.

Junus b. Muhamed ka thënë se kështu i ka transmetuar Shejbani nga Katade të cilit i ka transmetuar Ebu-l-Mutevekkili. (Krahaso: 6535)

### **PËRKITAZIME FJALËNE ALL-LLAHUT “MALLKIMI I ALL-LLAHUT QOFTË MBI ZULLUMQARËT-MIZORËT”**

2441. - Na ka treguar Musa b. Ismail nëpërmjet të Hammamit:

Më ka transmetuar Katade, përmes Safvan b. Muhriz El-Mazinit si vijon:

- Udhëtoja me Ibn Umerin r.a. dhe e mbaja për dore kur na doli një njeri dhe tha: (Çka ke dëgjuar nga Pejgamberi a.s. lidhur me bisedën e All-llahut xh.sh. në Ditën e Kijametit-gjykimit?)

E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. - tha ai - duke thënë: “All-llahu do t'i afrohet besimtarit, do ta mbulojë me një perde dhe do ta pyes: E di ti këtë e këtë gjynah?” Po, O Zot im, do të përgjigjet ky. Dhe kur t'i pranojë para Tij të gjitha gjynahet dhe të mendojë se puna e tij mbaroi, **All-llahu xh.sh. do t'i thotë: Unë t'i kam mbuluar ato edhe kur ke qenë në jetë, në dynja, porse sot edhe po t'i fali**”, e pastaj do t'i jepet libri i veprave të mira. Sa i përket mosbesimtarit dhe hipokritëve dëshmitarët do të thonë:

**“Këta janë të cilët kanë thurë gënjeshtër për Zotin e vet!” A nuk është mallkim i All-llahut kundër mizorëve**”.<sup>68</sup> (Krahaso: 4685, 6070, 7415).

---

68. Kur' an, 11-18

---

**MUSLIMANI MUSLIMANIT NUK DO T'I BËJË  
DHUNË POR AS DO T'IA FALË**

2442. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr se i ka transmetuar Lejth nga Ukajli, kurse ai nga Ebu Shihabi që Salimi i ka transmetuar se Abdullah b. Umer e ka informuar se Pejgamberi i All-llahut ka thënë:

**- Muslimani është vëlla i muslimanit dhe nuk do t'i bëjë dhunë'por as do t'ia falë. Ai që i gjendet në ndihmë vëllait të vet, All-llahu do t'i gjëndet në dnihmë atij kur ka nevojë; ai që ia heq muslimanit ndonjë problem, mundim, All-llahu do t'ia heqë atij një mundim në Ditën e Gjykimit, dhe kush ia mbulon muslimanit**

**Përmbajtja e hadithit tregon se gabimi nuk të nxjerrë jashtë fesë Islame dhe gjynahqari mund të shpresojë se do t'ia falet gjynahi, duke lënë anash gjynahet e mëdha dhe cenimin e të drejtës së tjetrit (të metën) All-llahu do t'ia mbulojë atij në Ditën e Gjykimit.” (Krahaso 6951).**

**NDIHMOI VËLLAIT TËND KUR BËNË DHUNË  
APO KUR I BËHET ATIJ DHUNA**

2443. - Na ka treguar Osman b. Ebi Shejbe se Hushejmi i ka thënë që Ubejdullah b. Ebi Bekr b. Enes dhe Humejd et-Tavil i kanë transmetuar se Enes b. Maliku r. a ka thënë:

**- Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ndihoje vëllain tënd, qoftë ai zullumqar apo që i bëhet zullum”. (Krahaso: 2444, 6952)**

2444. - Na ka rrëfyer Museddedi se Mu'temiri dhe Humejdi transmetojnë nga Enesi r.a. që: **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ndihoje vëllain tënd, qoftë ai zullumqar ose që i bëhet zullum”.**

**“O Pejgamber i All-llahut, i thanë të pranishmit, do t'i ndihmojmë atij që i është bërë dhunë, por si do ta ndihmojmë atë që bën dhunë”.**

**- T'ia mposhtni duart e tij, ta pengoni, - tha ai.**

---

---

## NDIHMIA PËR ATË QË I SHKELET E DREJTA

2445. - Seid b. Rebi'a na ka treguar se Shu'abe i transmetoi që Esh'ath b. Sulejmi ka thënë: E kam dëgjuar Muavi b. Suvejdin kur ka deklaruar: Kam dëgjuar Bera'a b Azib r.a duke thënë si vijon:

- **Pejgamberi s.a.v.s. na ka urdhëruar shtatë (gjëra) dhe na ka ndaluar shtatë të tjera, duke i renditur: vizitën e të sëmurit, përcjelljen e xhenazes, t'i dëshirosh të mirë-urosh atë që teshtin, të kthesh përshëndetjen, të ndihmosh atë që i shkelet e drejta, të përgjigjesh në thirrjen e mikut dhe t'i bësh mirë atij që lutet me përbetim.**

2446. - Muhammed b. El-A'la na tregon se Ebu Usame dhe Burejda i kanë transmetuar nga Ebu Burde i cili përmes Ebu Musës r.a. rrëfen se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Besimtari me besimtarin janë sikur ndërtesa, shtëpia, pjesët e të cilës janë të përforcuara ndërmjet veti, dhe i lidhi gishtat<sup>69</sup>

### KUNDËRVËNIA ZULLUMQARIT NË BAZË TË FJALËVE TË ALL-LLAHUT

**“All-llahu nuk dëshiron që për të këqiat të flitet me të madhe, përveç atij të cilit i është bërë e padrejta. All-llahu dëgjon dhe është shumë i dijsëm” (4: 148)**

**Edhe ata të cilët kur i godet padrejtësia i rezistojnë” (42: 39)**

Ibarhim Nehaiu ka thënë: **“Ata e kishin mërzi të jenë të nënshtruar dhe kur ishin të fuqishëm falnin, tregonin mirësi”<sup>70</sup>**

---

<sup>69</sup>. “Të ndihmosh të shtypurin, të mbrosh nga dhuna dhe autokritika dhe të përcjellësh xhenazen, është detyë kolektive e shkallës së parë; t'u kthesh përshëndetjen njozëve, të ndihmosh personin që lutet duke bërë be, t'i përgjigjesh thirrjes së miqve, duke përjashtuar ahengun e dasmës, bën pjesë në obligimet e muslimanit, në shkallë të dytë.

<sup>70</sup>. T'i bësh mirë individit që na përbeton duhet të jetë në kufijtë e ligjshëm, në interes të bashkësisë dhe mundësisë ndividuele.

**TË FALËSH TË SHTYPURIN NË BAZË  
TË FJALËVE TË ALL-LLAHUT**

I bëtë veprat e mira haptazi ose fshehurazi, apo falni të padrejtën, ani, edhe All-llahu fal dhe është i plotfuqishëm. (4. 149) “Shpërblim i së keqes është e keqja në të njëjtën masë, por kush fal dhe pajtobet, shpërblimi i tij është tek All-llahu. Ai, me të vërtetë, nuk i do kriminelët.”

Nuk do të përgjigjet ai i cili e kthen me të njëjtën masë dëmin e pësuar.

Por ka rrugë (për dënim) ndaj atyre që dhunojnë njerëzit dhe pa të drejtë bëjnë çrregullime në tokë. Për ata ka dënim të

**dhembshëm.**

Por kush duron dhe falë ajo është nga punët e mençura.

Ai, të cilin All-llahu e lë në humbje, ai nuk ka ndihmës pos atij. Dhe ti do të shohësh përdhunuesit kur ta përjetojnë vuajtjen se si do të thërrasin: “A ka rrugë për kthim?”<sup>71</sup>

**DHUNA ËSHTË TERR I DITËS SË GJYKIMIT**

2447. - Na ka treguar Ahmed b. Junus se i ka transmetuar Abdu-l Aziz al-Maxhishun, të cilit Abdullah b. Dinar i ka transmetuar nga Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: - **“Dhuna është terri i Ditës së gjykimit”**

**RUAJTJA DHE KUJDESI NGA MALLKIMI I ATIJ  
TË CILIT I ËSHTË BËRË DHUNË**

2448. - Jahja b Musa tregon se ka dëgjuar nga Veki'i të cilit i ka transmetuar Zekerija b. Is-hak El-Mekki me anë të Jahja b. Abdullah b. Sajfij, kurse ky nga Ebu Ma'abedi, rob i liruar i Ibn Abbasit r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. e ka dërguar Muadhin

---

71. Kur'an, 42: 40-44.

---

në Jemen dhe i ka thënë:

“Ruaju mallkimit (beduvasë) të personit ndaj të cilit është ushtruar dhuna, ngase midis asaj name dhe All-llahut nuk ka pengesë, perde”.

### USHTRIMI I DHUNËS NDAJ DIKUJT QË E FAL

2449. - Na ka treguar Adem b. Ebi Ijas, atij i tregoi Ibn Ebi Dhi'bi i cili transmeton nga Seid El-Makburi nga Ebu Hurejre r. a. i cili ka thënë se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

- **Ai që i ka bërë ndokuj dhunë në aspektin e nderit apo diçka tjetër, le t'i kërkojë atij falje sot (në këtë botë) para se të vijë dita kur nuk do të ketë as dinar e as derhem, sepse atë ditë, ai që do të ketë vepra të mira, do t'i mirren aq sa të paguhet dhuna që ka bërë, por nëse nuk ka vepra të mira atcherë do të mirren nga i dëmtuari vepra të këqia dhe do t'i ngarkohen këtij.”**

Ebu Abdullah thotë: Sipas Ismail b. Ebi Uvejs “Makburij” (varrmihës) (E ka marrë këtë llogar për shkak se ka banuar afër varreve). Ebu Abdullahu ka thënë edhe sa vijon: “Seid al-Makburi është rob i liruar i Benu Leithit, ky pra është Seid b. Ebi Seld, kurse emri i Ebi Seidit është Kejsan. (Krahaso: 6534).

### FALJA E PADREJTËSISË QË I BËHET INDIVIDIT

2450. - Na ka transmetuar Muhammedi të cilit i ka thënë Abdullahu se Hisham bin Urve i ka transmetuar nga babai i vet se h. Aisheja r.a. lidhur me ajetin “... **Nëse gruaja frikësohet nga sjellja e keqe apo injorimi nga burri i saj...**” ka thënë:

- Kjo i referohet burrit i cili e ka gruan, por pasi që nuk dëshiron të ketë shoqërim me të, dëshiron të ndahet, e ajo i thotë: “**Je i liruar, i falur, nga detyrat bashkëshortore ndaj meje**”, për ç'arsye edhe është shpallur ky ajet.<sup>72</sup>

---

<sup>72</sup> “Në qoftë se ndonjë grua frikësohet nga kryeneçësia e burrit apo se do ta lërë pas shpine, atëherë nuk është mëkat nëse ata dy bëjnë marreveshje ndërveti, pajtimi është më i mirë. Njerëzit janë krijuar grykësa, e në qoftë se ju

---

---

---

**FALJA, LEJIMI I NDONJË ÇËSHTJE DIKUJT  
PA E SQARUAR HOLLËSISHT**

2451. - Abdullah b. Jusuf tregon se Maliku përmes Ebu Hazim b. Dinar i ka transmetuar, e ky nga Sehl b. Sa'd Es-Saidij r.a., se Pejgamberit të All-llahut ia sollën një lëng dhe ai piu. Në anën e djathtë kishte një djalosh e në anën e majt burra pleq me dinjitet. **Pejgamberi i thaatij djalit.**

- **A po më lejon që këtë që mbeti t'ua jap këtyre?**

- **Jo, O Pejgamber i Zotit, u përgjigj djaloshi. Pjesën time nuk ia jap askujt përveç teje, Pejgamberi a.s. ia dorëzoi në dorë.**

**GJYNAHI PËR GRABITJEN E TOKËS SË HUAJ**

2452. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman se i ka transmetuar Shuajbi me anë të Zuhriut, i cili thotë se i ka treguar Talha b. Abdullahu se e ka informuar Abdurrahman b. Amr. b. Sehl se Seid b. Zejdi r.a. ka thënë:

- **E kam dëgjuar Pejgamberin e All-llahut duke thënë: “Ai që grabit ndonjë tokë të huaj, atij do t'i varet ajo në qafë nga shtatë kat tokë.”<sup>73</sup> (Krahaso: 3198).**

2453. - Na ka treguar Ebu Ma'mer, këtij Abdu-l-varithi se Jahja b. Ebu Kethiri, përmes Husejnit, i ka transmetuar:

---

silleni mirë dhe ruheni, All-llahu është i informuar shumë mirë për veprat tuaja”. (Nisa: 128)

Disa muhaddithë kanë deklaruar se Sevda, bashkëshortja e Pejgamberit, hetoi një farë ftohie ndaj saj, prandaj i tha: “O Pejgamber i All-llahut, mos më ler pas dore, kurse unë rendin tim që e kam me ty ia lë Aishes”, gjë të cilën Muhammedi a.s. e pranoi, e pas kësaj është shpallur ajeti i lartpërmendur.  
<sup>73</sup> Duket se Alejhisselami ka thënë: “Ai që grabit një pëllëmbë tokë të huaj, All-llahu xh.sh. në ditën e kijametit do ta çojë të rmihë deri kur të arrijë në katin e shtatë të tokës e pastaj e ngarkon me atë barrë deri sa të zgjasë gjykimi i njerëzve, tërë botës.”

---

Më ka rrëfyer Muhamed b. Ibarabim se Ebu Seleme i kishte treguar se ndërmjet tij dhe disa njerëzve kishin pasur një kontest (për tokë) dhe kjo i ra në vesh Aishes r.a., e ajo tha: “Hiq dorë nga ajo tokë, o **Ebu seleme, se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**  
- **Kush uzurpon një pëllëmbë tokë të huaj, ajo do t’i varet në qafë në sasi prej shtatë katësh tokë.**” (Krahaso: 3695).

2454. - Na ka treguar Muslim b. Ibrahim se Salimi, përmes Musa b. Ukbes dhe Abdullah b. Mubarekut, i ka transmetuar se babai i tij r.a. ka thënë:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ai që merr diçka nga toka e huaj, te e cila nuk ka hise, të drejt, do të thejë qafën me gjithë të në Ditën e Gjykimit nëpër shtatë kat tokë.”**

Abu Abdullahu thotë: “Ky hadith nuk ka qenë në librin e **Ibn Mubarekut, që është shkruar, në Horasan; ai ua diktoi këtë në Basër, më vonë.**” (Krahaso: 3196).

### **NËSE NJERIUT T JEPET LEJE E KA HALLALL (TË LEJUAR)**

2455. - Na ka treguar Hafs b. Umer se Shu’be, përmes Xhebelit, i ka transmetuar:

- **“Ishim në Medinë në mesin e disa njerëzve nga Iraku. Ishte një vit me uri, skamje, dhe Ibn Zubejri na furnizoi me hurma. Kaloi pranë nesh Ibn Umeri dhe tha: “Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar t’i bëni dy (hurma) çift nëse dikush prej jush nuk ia lejon vëllait të vet.”** (Krahaso: (2489, 2490, 5446).

2456. - Na ka treguar Ebu Nu’man se i ka transmetuar Ebu Avane, këtij Ameshi, ky ka dëgjuar nga Ebu Vaili, ky nga Fbu Mes’udi se një njeri të cilit i thoshin Ebu Shuajb e kishte një djalosh kasap, dhe, Ebu Shuajbi i tha: **“Përgatite ushqimin për pesë vetë. Ndoshta e thërras Pejgamberin s.a.v.s. të**

**jetë i pesti. Më duket nga pamja që Pejgamberi a.s. është i uritur.** Pastaj e thirri, por atij iu bashkua edhe njëri i paftuar. Pejgamberi a.s. pat thënë: “Ky na u bashkua vetë, a po e lejon?”

- E lejoj - tha ai.

**FJALËT E TË LARTMADHËRISHMIT ALL-LLAH:  
“... E AI ËSHTË ARMIK I PËRBETUAR” (2: 204)**

2457. - Na ka treguar Ebu Asim që transmeton nga Ebu Xhurejxh, kurse ky nga Ebi Mulejke, dhe ai nga Aisheja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. tha:

**“Njerëzit më të urrejtur të All-llahut janë armiqtë e përбетuar”.**<sup>74</sup> (Krahaso: 4523, 7188).

**GJYNAHI I ATIJ QË KONTESTON DIÇKA  
DUKE E DITUR SE NUK KA TË DREJTË**

2458. - Na ka treguar Abdu-l-aziz b. Abdullah, të cilit Ibn Shihabi, përmes Salihut dhe Ibrahim b. Sa'dit, i ka rrëfyer:

Më ka kumtuar Urve b. Zubejr se e bija e Ummi Selemes, e ka informuar se nëna e saj Ummi Seleme r.a. bashkëshorte e Pejgamberit a.s. i ka treguar kësaj se si Pejgamberi a.s. dëgjoi para dyerve të veta një farë diskutimi dhe doli u tha:

- **“Unë jam vetëm njeri. Më vijnë palët me konteste, e dikush prej tyre mund të jetë më gojëtar se tjetri ashtu që më bind se e thotë të vërtetën, dhe unë i jap të drejtë, vendos në dobi të tij. Mirëpo, le ta dijë, ai të cilit unë i jap të drjetën e ndonjë muslimani, se ajo është një copë zjarr i**

---

<sup>74</sup> Muhammedi a.s. deklaratën e lartpërmendur e ka dhënë në pajtim me ajetet 204-206 të suresë Bekare ku thuhet: “Ka njerëz, fjalët e të cilëve për jetën e kësaj bote të çudisin dhe mendojnë se All-llahun e kanë dëshmitar për atë çka kanë në zemrat e tyre, mirëpo, ai është kundërshtar i përбетuar. Sapo kthehet, dikush prej tyre, shpejton të bëjë turbullim në tokë’ duke asgjësuar të mbjella e grigje, por All-llahu nuk e do turbullirën”.

---

---

---

xhehennemit, e ai le ta marrë, në dasht, ose le ta lërë”<sup>75</sup>  
(Krahaso: 2680, 6967, 7169, 7101, 7185).

### **RRENACAKU NË KONTEST**

2459. - Na ka treguar Bishr b. Halid, këtij Muhamedi nga Shu'be, ky ka dëgjuar nga Sulejmani, ai nga Abdullah b. Murra, i cili transmeton përmes Mesrukut dhe Abdullah b. Amrit r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

**“Ai që ka këto katër cilësi është dyfyrësh, munafik, ose ai që ka njërin prej katër cilësive ai ka një veti të munafikut, derisa ta lërë atë. Ato katër cilësi janë: kur flet rren, kur premtion nuk mban fjalën, kur merr ndonjë obligim nuk e realizon, kur ka ndonjë kontest nuk e flet të vërtetën.”**

### **KOMPENZIMI NDAJ TË DËMTUARIT NËSE DËMTUESI KA PASURI**

Ibn Sirini ka thënë: “Do t’i kompensohet” dhe citoi ajetin “... e nëse dënoni, dënoni ashtu siç keni qenë ju të dënuar...”<sup>76</sup>

---

<sup>75</sup> Muhammedi a.s. është largpamës, njeri i zgjedhur nga All-llahu xh.sh. me shqisa dhe cilësi njerëzore dhe ai nuk i dinte fshehtësitë e askujt. Gjykonte dhe merrte vendime sipas argumenteve që i prezantoheshin dhe gjykimi varej nga këto argumente. Ka informata se me një rast ka thënë: “Unë gjykoj sipas argumenteve që më prezantohen”. Argumenti i palës është vendimtarë në sjelljen e vendimit përfundimtar dhe duke u mbështetur në argumente, është e mundur që gjykatësi të gabojë. Prandaj palëve në kontest gjithmonë u jepet e drejta për anekse dhe të kërkojnë përsëritjen e gjykimit, procesit gjyqësor.<sup>76</sup> “Nëse duani të merrni hak, atëherë bëne atë vetëm aq sa u është bërë juve; po nëse duroni, kjo është me të vërtetë më mirë për durimtarët.

Jij i durueshëm! Por, i durueskëm do të jesh vetëm me ndihmë të Allllahut. Dhe mos të vijë keq për ata, as mos të vijë rëndë nga kurthat e tyre, All-llahu është me të vërtetë në anën e atyre të cilët frikësohen dhe largohen prej mëkateve, dhe në anën e atyre që bëjnë vepra të mira, janë bamirës.” (Nabl: 126-128).

2460. - Ebu-l-Jeman tregon se Zuhriu, përmes Shu'bes, e ka transmetuar: Urveja më ka transmetuar se Aisheja r.a. ka thënë: Erdhi Hinda, e bija e Utbe b. Rabias dhe pyeti:

**“O Pejgamber i All-llahut, Ebu Sufjani është njeri koprrac, e unë a e kam gjynah nëse ushqej familjen tonë nga pasuria e tij?”**

**- Nuk e ke - u përgjigj ai - por t'i ushqesh normalisht.**

2461. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se i ka transmetuar Lejthi, këtij Jezidi, ndërsa këtij Ebu-l-l Hajr që ka dëgjuar Ube b. Amirin i cili thotë: **“I kemi thënë Pejgamberit a.s. Ti na dërgon me punë dhe ne te ata njerëz rrimë por nuk na japin të hamë. Çka thua për këtë?”**

**“Kur të rrini te ata njerëz dhe ju ofrohet çka i duhet musafirit, do të thotë ata e pranojnë këtë, mirë është, por nëse nuk veprojnë kështu atëherë merrni prej tyre çka i takon musafirit”<sup>77</sup>**

### **TUBIMI NËN HIJE**

Pejgamberi s.a.v.s. dhe as-habet e tij kanë ndejtur në hijen e Benu Saideve.

**2462.** - Jahja b: Sulejman na ka treguar se si i thotë Ibn Vehbi i cili transmeton nga Maliku, kurse sipas një varianti tjetër

---

<sup>77</sup> Lejthi, duke iu referuar hadithit të përmendur, mikpritjen dhe gostitjen për musafirin e konsideron vaxhib, kurse Imam Ahmedi e pranon këtë mendim vetëm për regjion të nomadëve.

Ebu Davudi ne Sunenin e tij ka evidentuar se Muhammedi a.s. ka thënë: “Ta strehosh udhëtarin një nate është detyrë për çdo musliman, dhe nëse i bën konak, e strehon, edhe në oborrin e vet, nëse dëshiron ka të drejtë të kërkojë kompensoim e nëse do heq dorë nga kjo.” Ndërkaq Tahaviu, duke u mbështetur në Ebu Hurejren, shënon: “Nëse një udhëtar strehohet tek ndonjë shtëpi dhe ajo shtëpi, nikoqire, nuk i ofron mikëpritje, ai ka të drejtë të kërkojë kompenzim në vlerën e shërbimit që është dashur t'i afrohet, e nuk i është ofruar.

---

---

të rrëfimtareve, më ka transmetuar Junusi nga Ibn Shihabi si vijon:

- **“Më informoi Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe se Ibn Abbasi i transmetoi nga Umeri r.a.”**

- Kur ndërroi jetë Pejgamberi i All-llahut, Ensaret u tubuan në hijet e Benu Saideve dhe unë i thashë Ebu Bekrit: Eja me ne, dhe erdhëm të rrimë në hijen e Beni Saideve. (Krahaso: 3445, 3928, 4021, 6829, 6830, 7323).

## **FQINJI NUK KA TË DREJTË TA PENGOJË FQIUN TË MBJELLË PEMË AFËR RRETHOJES SË TIJ**

**2463.** - Na ka treguar Abdullah b. Mesleme që transmeton nga Malikiu, ai nga Ibn Shihab, ky nga A'arexhi kurse ai nga Ebu Hurejre r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Fqinji fqinjin mos ta pengojë të mbjellë pemë afër rrethojës së tij”.**

Ebu Hurejreja me vonë ka thënë: “çka u bë kështu? **Si po shoh unë këtë nuk e përfillni ju. Pasha Zotin unë do t'ua kisha mbjellë në shpinë**”. (Krahaso: 5627, 5628).

## **DERDHJA E VERËS - ALKOOLIT - NËPËR RRUGË**

**2464.** - Na ka treguar Muhammed b. Abdurrahan Ebu Jahja të cilit Affani i ka transmetuar përmes Hammad b. Zejdit se Thabiti i ka transmetuar nga Enesi r.a.:

- U kam dhënë ujë disa njerëzve në shtëpinë e Ebu Talhas, në kohën kur vera ishte një lëng prej hurmave të kuqe në të portokallt. Pas kësaj **Pejgamberi a.s. i dha urdhër kasnecit të lajmërojë: “Ta dini se vera është e ndaluar”.** Atëherë, thotë Enesi, Ebu Talha më tha: **“Dil dhe derdhe”** Unë pastaj dola dhe e derdha ashtu që rrëke shkonte rrugëve të Medines. Më vonë dikush pat thënë: Si është puna që disa njerëz kanë vdekur me verë në bark, për çka All-llahu xh.sh. shpalli ajetin: *“Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira nuk ka*

*gjynahe se çka kanë ngrënë... ”<sup>78</sup> (Krahaso: 4618, 4620, 5580, 5582, 5583, 5584, 5600, 5622, 7253).*

## **OBORRET E SHTËPIVE, VENDOSJA NËPËR TO DHE NDEJA NËPËR MALE**

Aisheja r. a. ka thënë: “Ebu Bekri ndërtoi xhaminë në oborrin e shtëpisë së vet dhe aty falej dhe kondonte Kur’an, kurse gratë e politeistëve me fëmijët e tyre ngarronin, grumbulloheshin aty e habiteshin. Pejgamberi a.s. në atë kohë ishte në Mekke.” 2465. - Na ka treguar Muadh b. Fedale, këtij Ebu Umer Hafs b. Mejsere, i cili transmeton nga Zejd b. Fslime kurse ai nga A’ata b. Jesar, ndërsa ky nga Ebu Seid Huderiu r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**-Shmanguni ndejës nëpër rrugë.**

**- Për këtë, i thanë ata, ne kemi nevojë shtumë. Aty janë vendtakimet tona ku ne bisedojmë, ndërrojmë mendime.**

**- Pasi që nuk bën ndryshe, tha ai, dëshironi të qëndroni aty, atëherë jepjani edhe rrugës hakun e vet.**

**- Po çfarë haku e drejtë i takon rrugës? e pyetën ata.**

**- Ulni kryet (mos shioni lart e poshtë) përmbahuni nga shqetësimet, ktheni Përshëndetjen, urdhëroni për punë të mira dhe pengoni nga punët e këqia - tha ai. (Krahaso: 6229).**

## **BUNARËT AFËR RRUGËVE QË NUK PENGOJNË**

2466. - Na ka treguar Abdullah b. Mesleme i cili transmeton nga Maliku kurse ky nga Sumejje, rob i liruar i Ebu Bekrit, ndërsa ai nga Ebu Salih Semmani dhe ky nga Ebu Hurejre r. a. se

---

<sup>78</sup> Kur’an, 5: 33, ajeti në tëresi është:

*“Ata, të cilët kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, nuk kanë mëkat për atë me çka janë shqyer, nëse ruhen (nga e ndaluara) dhe besojnë edhe bëjnë vepra të mira, pastaj i frikësohen All-llahut dhe besojnë, dhe prapë frikësohen dhe bëjnë punë të mira. All-llahu i do punëmirët”. (Mairdetu: 93)*

---

---

---

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Një udhëtar e mori etja, derisa ishte në udhëtim, dhe hasi në një bunar. Zbriti aty dhe piu ujë. Kur doli e pa një qen duke dihatur dhe nga etja hante dhe.

- Sigurisht, mendoj ai qenin e ka marrë etja sikur që më kishte marrë edhe mua, dhe hyri prapë në bunar e mbushi këpucën e vet me ujë dhe ia dha qenit të pijë, e All-llahu e mëshiroi dhe ia fali gjynahet.

- O Pejgamber i All-llahut, i thanë të pranishmit, a kemi edhe për kafshët ndonjë shpërblim?

- Për gjithçka, për tëra gjallesat, ka shpërblim, tha ai.

### HEQJA E PENGESAVE NGA RRUGA

Hammami transmeton nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi a.s. tha:

- Heqja e pengesave nga rruga është sadakë.

### DHOMA ME KAT, PAPAFIGOT E NGRITUR (MANSARDAT) NËN ÇATIA DHE TJERA

2467. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se Ibn Ujejne i ka kumtuar përmes Zuhriut, ky nga Urve kurse ai nga Usame b. Zejdi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. hypi në një rën nga kalatë e Medines dhe tha:

- A shihni ju çka shoh unë? Shoh vende ngatërresash te shtëpitë tuaja sikurse pikat e shiut.

2468. - Jahja b. Bukejr tregon se Ibn Shihabi, përmes Ukajlit dhe Lejthit ka transmetuar: Më ka thënë Ube Adullah b. Ebu Thevr se Abdullah b. Abbasi r.a. ka treguar:

- Gjithmonë kam dëshiruar ta pyes Umerin për dy gratë e Pejgamberit a.s., për ato për të cilat All-llahu xh.sh. ka thënë: *“Nëse ju të dyja pendoheni te All-llahu zemrat tuaja janë përrulur...”* (Kur’an, 66: 4).

Atëherë kam qenë në haxh bashkë me atë. Ai u shmang nga

---

---

rruga dhe u shmanga edhe unë pas tij me ënën e lëkurës me ujë. Mbeti vetëm dhe ënë iu afrova dhe i shtiva me enën time me ujë të lajë duart, dhe pasi mori abdes, i thashë:

- O sundimtar i besëdrejte, cilat janë ato dy bashkëshorte të Pejgamberit të All-llahut për të cilat All-llahu ka thënë: “Nëse ju të dyja pendoheni te All-llahu zemrat tuaja janë përrulur...” (Kur’an, 66: 4)

- Po më habit o Ibn Abbas! Ato janë Aisheja dhe Hafsa. Umeri pastaj ia filloi ta shpjegojë tërë rastin dhe tha:

- Unë dhe një fqinj imi nga ensarët kemi qenë te fisi Benu Umejje b. Zejd që është një lagje rrëzë një kodre të Medines dhe ne, herë njeri herë tjetri, shkonim te Pejgamberi a.s. Një ditë shkante ai, tjetrën ditë shkoja unë. Kur shkoja unë i sillja lajme të asaj dite, urdhëra ose informata tjera, e kur shkante ai edhe ai vepronte njëlloj. Ne, bashkësia kurejshite, i mbanim nën sundim të rreptë gratë, por kur erdhëm te ensarët, ata janë njerëz që komandohen, sundohen, nga gratë, edhe gratë tona filluan të marrin tradita të grave ensarite. Unë i bërtita gruas time - nuk desha që ajo të ma kthejë - por ajo ma ktheu duke thënë:

- Pse po të vjen rëndë që ta ktheva? Pasha All-llahun, edhe gratë e Pejgamberit as. ia kthejnë atij, derisa njëra prej tyre e la tërë ditën, deri në mbrëmje.

U frikësova prej këtij rrëfimi dhe thashë: “Ajo që ka bërë këso shkelje të rëndë ka humbur shumë keq.” Pastaj mblodha çaklat e mia dhe hyra te Hafsa dhe e pyeta: “A është e vërtetë se ndonjëra prej jush është zemëruar me Pejgamberin e All-llahut gjatë gjithë ditës?”

- Po u përgjigj ajo.

E ka gjetur belanë, ka humbur keq. A je e sigurt se nuk do të hidhërohet All-llahu xh.sh. për shkak të hidhërimit të Pejgamberit dhe të gjesë belanë, të shkatërroresh. Mos lypni shumë sende nga i dërguari i All-llahut dhe mos i

---

---

drejtoheni për çfarëdo, për gjëra të thjeshta; mos ia kthe shpinën por lyp nga unë çka të keshë nevojë. Mos u mashtro që ajo fqinja jote - mendonte në Aishen - mos të nxitë se është më e bukur dhe më e dashur e Pejgamberit s.a.v.s..

Kemi trequar se si fisi Gassan bënte patkoi për kafshët kalëruese për raste të luftërave tona. Atëhere, tregon Umeri, shkoi shoku im, sipas radhës, u kthye në mbrëmje dhe duke i mëshuar me sa forcë që kishte deres time, bërtiste:

- **A po flen ai?**

- U frikësua, dola e ai më tha: “Ka ndodhur diçka e madhe”

- **Çka është, e pyeta unë;. A ka ardhur Gassani?**

- **Jo, u përgjigj, por diçka me e madhe se kjo. Pejgamberi a.s. i ka lëshuar gratë e veta. Hafsa ka gjetur belanë dhe ka humbur shumë keq.**

Dyshova se mund të ketë ndodhur edhe kjo, prandaj mblodha teshat e mia dhe namazin sabahut e fala me Pejgamberin s.a.v.s. Pastaj hyri në mursandrën e vet dhe u tërhoq aty, kurse unë hyra të Hafsa, e ajo qante.

- **Çka ke që po qanë, e pyeta unë. A nuk ta tërhoqa vërejtjen? A u ka lëshuar Pejgamberi i All-llahut?**

- **Nuk e di, tha ajo, Ja ku është ai, në musandër.**

**Unë pastaj dola dhe erdha te minderi rreth së cilit ishte një grup njerëzish. Disa qanin. U ula pak te ata. Mandej me kapi një ndjenjë e shqetësuar dhe shkova atje ku ishte Pejgamberi s.a.v.s. dhe i thashë shërbëtorit të tij, atij zezakut: “Kërkoji leje për Umerin”**

Ai hyri dhe i tha Pejgamberit a.s. Mandej doli dhe tha: **“I thashë, kërkova leje për ty por ai heshti”**. Unë u ktheva të rri me atë grupin që rrinte te minderi. Pastaj prapë më kaploi ajo ndjenja që e kisha dhe shkova dhe Umeri e përmendi si më parë, e pastaj u ul me atë grupin te minderi. Më vone më kaploi prapë ajo ndjenja që kisha në vete dhe shkova te shërbëtori dhe i thashe: **“Kërko leje për Umerin”** e ai bëri njëllonj si më parë. Unë,

---

pastaj u ktheva dhe u nisa, kurse robi më thirri: **“Pejgamberi a.s. të ka lejuar të hysh”**. Unë hyra, kurse ai rrinte i shtrirë në hastren e thurur. Ndërmjet atij dbe asaj nuk kishte shtrojë, ndërsa në trup i dukeshin vijat e hastrës, dhe ishte i mbeshtetur në një jastëk nga lëkura e rexhur e mbushur me berqe, pejze.

I dhashë selam dhe duke qëndruar në këmbë e pyeta: **“I ke lëshuar gratë tuaha?” A drerjttoi hiqimin nga unë dhe tha: “Jo”**.

Unë, atëherë në këmbë i thash: O Pejgamber i All-llahut, nëse më lejon, ne bashkësia Kurejshjte, i kemi sunduar gratë, por kur erdhëm te populli që e sundojnë **gratë e tyre, kur i përmenda** këtë Pejgamberi a.s. buzëqeshi – e unë vazhdova:

- Nese më arsyeton, unë hyra te Hafsa dhe i thashë:

-Ty mos të brengosë ajo, që ajo fqinja jote mendonte në Aishen, se është më e bukur dhe më e dashura e Pejgamberit a.s.. Në këto fjalë ai prapë buzëqeshi. Kur e pash se po buzëqesh, u ula, shiqova rreth e rrotull nëpër dhomën e tij dhe, pasha zotin nuk pash kurrë gjë aty që të ma tërheq vëmendjen përveç tri lëkurave të papërpunuara.

- Lute All-llahun, i thashë - le t’i pasurojë pasardhësit tu. Persianëve dhe grekëve u është dhënë pasuri sdhe u është dhënë kjo botë por ata nuk e adhurojnë All-llahun.

Ai ashtu si ishte i mbështetur’ tha: **“Po ti a dyshon o Ibn Umer? Ata janë popul1 të cilëve u është shpejtësuar e mira në këtë botë.”**

- **Më fal, o Pejgamber i All-llahut**, i thashë:

Pejgamberi s.a.v.s. është larguar nga bashkëshortet e veta për shkak të rastit që ia transmetoi Hafsa Aishes, kur ai për shkak të zemërimit të madh ndaj tyre tha: **“Nuk do të shkoj të ato një muaj”**, për çka All-llahu xh.sh. e qortoi. Kur u bën 29 ditë, ky shkoi te Aisheja, filloi te ajo, e ajo iu drejtua: **“Ti ke bërë be se nuk vjen te ne një muaj, a sot është dita e njëzetënëntë që unë e di me siguri?”**

Peigamberi a.s. i tha: **“Ky muaj është me 29 ditë.”**

---

---

---

Në këtë kohë, thotë Aisheja, është shpallur ajeti për të drejtën e zgjedhjes, dhe ai filloi, prej grave të veta, nga unë dhe tha:

- **Po të porosisë diçka që ka dobi, jo me dëm, mos u ngut deri kur të marrësh urdhër, leje, nga prindërit tu.**

- **E di**, i tha ajo, prindërit e mi nuk thonë të prish niqahin.

Mandej lexoi ajetin: **“O Pejgamber, thuaju bashkëshorteve tua: “Nëse dëshironi jetën në këtë botë dhe stolitë e saj, atëherë ejani t’iu përgatis dhe t’ju lëshoj si është më mirë, Po në qoftë se doni All-llahun dhe Profetin e tij edhe botën tjetër, ani, All-llahu me të vërtetë atyre, bamirësive nga mesi juaj u ka përgatitur shpërblim të madh “** (Kur’an, Ahzab: 28-30).

- **Për këtë të kërkoj lejen e prindërve? thash. Unë dëshiroj kënaqësinë e All-llahut, të Pejgamberit të Tij dhe botën e ardhshme.**

Pastaj u afroi të drejtën të zgjedhin edhe bashkëshorteve të tjera por edhe ato i thanë njëiloi sikur i tha Aisheja.

2469. Ibn Selami tregon se i ka transmetuar El-Fezari dhe Humejd Et-Tavili nga Enesi r.a. që:

- Pejgamberi u betua që të përmbahet nga bashkëshortet e veta një muaj. Ishte ulur në ballkon me këmbët shtrirë kur erdhi Umeri dhe e pyeti: **“A i ke lëshuar gratë?”**

- Jo, u përgjigji ai, **por jam betuar që një muaj të tërhiqem prej tyre. Ashtu u përmbajt 29 ditë, e pastaj zbriti dhe vazhdoi jetën si më përpara me bashkëshortet e veta.<sup>79</sup>**

---

79 Rasti i lartpërmedur ka ndodhur në vitin e 9 pas hixhretit dhe Shumë qartë po tregon për përmirësimin e standardit të shokëve të Muhammedit a.s., për çka edhe bashkëshortet e Pejgamberit a.s. filluan të medndojnë për komoditet me të Jartë e ky këtë e refuzoi kategorikisht. Shtëpia e tij ka qenë model i modestisë edhe pse ka pasur mundësi të behet më luksozja dhe më komodja.

Dialogu i përmendur është komenti më i mirë për pesë ajetet e parë te sures Tahrim, ku thuhet: **“O Profet, përse ia ndalon vetvetes atë që ta**

---

---

---

---

**LIDHJA E DEVESE PËR GURIT OSE PËR DERE TË  
XHAMISË**

2470. - Na ka treguar Muslimi, këtij Ebu Akili të cilit i ka thënë Ebu-l-Mutevekkil en-Naxhi:

-Erdha te Xhabir b. Abdullahu r.a. dhe ai më tha:

Pejgamberi a.s. ka hyrë në xhami. Edhe unë hyra te ai, kurse devenë e lidha për një ploqë te rrëzuar dhe i thashë: **“Këtu e ke devenë tënde”**. Ai doli, u soll rreth devesë dhe tha: **“Deveja është e jotja me gjithë çka ka”**.

**TË QËNDRUARIT GJATË KRYERJES  
SË NEVOJËS SË VOGËL NË PLEHËRISHTE**

2471. - Sulejman b. Harb na ka transmetuar nga Shu'be, ky nga Mensuri, kurse ai nga Ebu Vaili se Hudhejfe r.a. ka thënë:

- **E kam parë Pejgamberin e All-llahut - ose tha - Pejgamberi a.s. u afrua te një pleh dhe kreu nevojën e vogël, duke qëndruar në këmbë.**

**PASTRTMI I RRUGËS NGA SENDET QË  
PENGOJNË NJERËZIT**

2472. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se e ka lajmëruar Maliku i cili transmeton nga Sumejja, ky nga Salihu ndërsa ai nga Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

---

*ka lejuar All-llahu, atë që të është lejuar për të kënaqur gratë tuaja? All-llahu fal dhe është mëshirëplotë. All-llahu ua ka përcaktuar kompensimin për betimet tuaja. All-llahu është Zoti juaj, Ai është shumë i dijshtëm e i urtë. Kur Profeti njërës nga gratë e veta i kumtoi një fshehtësi porse ajo e shpalli atë, mirëpo All-llahu këtë ia tregoi këtij. Ai një pjesë ia kumtoi, kurse tjetrën e heshti, dhe kur e njoftoi atë (gruan) lidhur me këtë lajm ajo tha: “Po ty kush ta tha këtë”? Ai i tha: “Më lajmëroi mua i gjithëdijshtëmi, i informuari”. Nëse ju të dyja pendoheni tek All-llahu, zemrat tuaja janë përrulur, e nëse paraqiteni të dyja kundër tij, ani, All-llahu është mbrojtës i tij, edhe Xhibrili edhe besimtarët e ndershëm; e pas kësaj paraqiten edhe të tërë ëngjëjt (si ndihmëtar). (Tahrim 1 :4)*

---

---

---

All-llahu më siguroi se ia kishte falur gjynahet një njeriu i cili e kishte larguar një rrenj ferre nga rruga që e kishte hasur duke ecur.

**KUR SHTOHEN NJERËZIT E SHPËRNDAHEN  
DHE KUR DËSHIROJNË TË NDËRTOJNË PËR  
RRUGËS, TË LËNË VENDIN E RRUGËS  
NE GJERËSI SHTATË KUTË (METRA)<sup>80</sup>**

2473. - Na ka treguar Musa b. Ismail se i ka transmetuar Xherir b. Hazim, i cili përcjell nga Zubjer b. Harriti që ka dëgjuar nga Ikrime i cili thotë:

- E kam dëgjuar Ebu Hurejren r.a. kur ka thënë: “Pejgamberi a.s. ka gjykuar, ka dhënë vendim:

- Nëse konfrontoheni për gjerësinë e rrugës, lini hapësirë prej sëpaku shtatë kuti.

**MARRJA, PLAÇKITJA, E SENDEVE  
PA LEJEN E PRONARIT**

Ubade ka thënë: “I kam dhënë besën (fjalën) Pejgamberit s.a.v.s. se nuk do të plaçkisim.”

2474. - Na ka trequar Adem b. Ebu Ijas, të cilit i transmetoi Shu’be nga Adij b. Thabiti, i cili e ka dëgjuar Abdullah b. Jezid Ensariun duke thënë se gjyshi i tij nga nëna ka thënë:

“Pejgamberi a.s. e ka ndaluar plaçkitjen dhe dënimin me prerje të pjesëve të trupit.” (Krahaso: 5516).

2475. - Seid b. Ufejri tregon se i ka transmetuar Lejthi, këtij i transmetoi Uhalji përmes Ibn Shihabit, kurse ky përmes Ebu Bekr b. Abdurrahmanit ndërsa ai nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

---

<sup>80</sup> Dhira “zira”, masë për gjatësi, i ka 0,75 m (Kuti heneze)

---

- **“Kurvari nuk bënë kurvëri derisa është besimtar musliman dhe nuk pi alkool, deri sa është musliman, as nuk vjedh derisa është musliman dhe nuk do të grabisë kurrgjë”** e t’u tëreheq vëmendjen njerëzve, derisa është musliman.”

I njëjti hadith transmetohet nga Seidi Ebu Selemeja. Këta e kanë dëgjuar nga Ebu Hurejreja kurse ai nga Pejgamberi a.s., përveç fjalës **“grabitje.”**

### **THYERJA E KRYQIT DHE MBYTJA E THIUT**

2476. - Na ka treguar Ali b. Abdullahu, Sufjani edhe Zuhriu të cilin e informoi Seid b. Musejeb se ka dëgjuar Ebu Hurejren r.a. që transmeton nga Pejgamberi a.s. që ka thënë: Nuk do të vijë Dita e Kijametit deri kur t’u vijë juve i biri i Merjemes, të gjykojë me drejtësi, të thyhet kryqi, të mbytet thiu, të caktohet xhizja edhe të shumohet (teprojë) pasuria, aq sa askush nuk do ta pranojë (nuk i del zot).

### **TË THYERIT E ENËVE ME ALKOOL DHE GRISJA E CALIKËVE ME VENË**

Shurejhit i paraqitet një rast të gjykojë për thyerjen e një gitare e ai nuk i preu kurrfarë dënimi.

2477. - Na ka treguar Ebu Asim Dahhak b. Mahled i cili transmeton nga Jezid b. Ebu Ubejde, ky nga Seleme b. Ekve’e r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ditën e çlirimit të Bedrit ka parë zjarre të ndezur dhe pyeti:

- **Për çka, në emër të çkahit janë ndezur këto zjarre?”**

- **Në emër të gomarëve të vendit - u tha.**

- **Thyeni dhe ndizni, u tha.**

- **A nuk bën t’i derdhim dhe t’i lajmë?** pyetën këta.

- **Lani, u tha ai.**<sup>81</sup> (Krahaso: 4196, 5497, 6148, 6331, 6891).

---

<sup>81</sup> Alkooli është i ndaluar për pije, por nuk është mirë as të mbahet enë alkooli. Alkooli për muslimanin është pa kurrfarë vlere, kurse për të tjerët ka vlerë monetare dhe nese dikush i’a then jomuslimanit enen në shtetin islam i pahuan dëmshpërblim.

---

---

---

2478. - Na ka treguar Ali b. Abdullah, këtij i treguar Sufjani, të cilit i transmetoi Ibn Ebi Nexhib nga Muxhahidi, kurse ai nga Ebu Ma' meri se Ahdullah b. Mes' udi r.a. ka thënë:

- Hyri Pejgamberi a.s. në Mekke, ndërsa rreth Haremit - Qabes - kishte 360 idhuj dhe filloi t' u mëshojë me një dru që e kishte në duar, duke kënduar ajetin: "Erdhi e vërteta kurse e pavërteta u zhduk..."<sup>82</sup> (Krahaso: 4287, 4720).

2479. - Na ka treguar Ibrahim b. Mundhir, këtij Enes b. I'jad i cili transmeton nga Ubejdullahi, ky nga Abdurrahman b. Kasim ndërsa ky nga babai i vet, se Aisheja r.a. e mori si perde një mbulojë të qëndisur me figura të ndryshme, por Pejgamberi a.s. e grisi, kurse ajo prej tyre mori e bëri dy këllefe për jastekë që i mbante në dhomën ku rrinin. (Krahaso: 5954, 5955, 6109).

### AI QË LUFTON PËR PASURINË E VET

2480. - Na ka treguar Abdullah b. Jezid se Seidi - djali i Ejubit - i ka thënë:

Më ka rrëfyer Ebu Esvedi nga Ikrime, kurse këtij Abdullah b. Umeri r.a. i ka thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin s.a.v.s. duke thënë:

- **"Ai që humb jetën duke mbrojtur pasurinë e vetë është shehid."**

### THYERJA E ENËS SË HUAJ

2481. - Na ka treguar Museddedi, të cilit i transmetoi Jahja b. Seidi, ndërsa këtij Humejdi prcj Enesit r.a. se një herë Pejgamberi ishte te njëra nga bashkëshortet e veta. Njëra nga nënat e besëdrejtëve dërgoi shërbëtorin me një enë me ushqim të cilën enë kjo me një të rënë e theu. Ai e mblodhi dhe e ngjiti,

---

<sup>82</sup> "Dhe thuaj: "Erdh e vërteta dhe u zhduk gënjeshtër. Me të vërtetë gënjeshtër është e paqëndrueshme". (Kur'an, Isra': 81)

---

---

e tuboi ushqimin në të dhe tha “Hani”! Pejgamberi enën e ruajti dhe kur e kryen e dorëzoi enën e mirë, kurse atë të thyeren e mbajti për vete.

Ibn Ebi Mejremi ka thënë:

Neve na ka informuar lidhur me këtë Jahja b. Ejub, këtë e informoi Humejdi ndërsa atë Enesi i cili e ka dëgjuar drejtpërdrejt nga Muhammedi a.s. (Krahaso: 5225).

### **NËSE DIKUSH SHEMB MURIN E TJETRIT LE T’IA NDËRTOJË NJËLLOJ SI E KA PASUR**

2482. - Na ka treguar Muslim b. Ibrahim të cilit Xherir b. Hazim i transmetoi nga Muhammed b. Sirin se Ebu Hurejre r.a. ka thënë, që Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Ishte një njeri te izrealitët i cili quhej Xhurejxh dhe derisa ishte duke u falur, erdhi nëna e tij dhe e thirri, por ky nuk iu përgjigj. Mendoj ky: A t’i përgjigjem apo, më mirë, të falem?**

Më vonë erdhi dhe tha: “O Zot, mos ia merr shpirtin pa e provuar me moral (me ndonjë lavire)”.

Xhurejxhi banonte në një manastir dhe një femër vendosi ta sprovtojë. “Do ta sprovtoj, tha, Xhurejxhin”. Më vonë i paraqiti propozimin konkret, por ai nuk e pranoi. Kjo pastaj shkoi te një bari dhe iu dorëzua vullnetarisht dhe pas kësaj ajo lindi djalë për të cilin deklaroi: “Ky është djalë i Xhurejxhit”. Erdhën banorët e vendit, ia thyen manastirin, e nxorën porjashta dhe e poshtëruan, e bën horë. Ai mori abdest dhe u ul, fali namazin, e pastaj iu afrua fëmijës (në djep) dhe tha: “Kush është babai yt, or fëmi?”

**-Bariu - u përgjigj ai.**

**-Do ta ndërtojmë manastirin prej ari - i thanë.**

**-Jo, u përgjigj ky - vetëm prej dheu.**

---

## Kreu 47

### *Bashkimi i mjeteve*

#### **TË SHOQËRUARIT NË USHQIME, SHPENZIME TË UDHËTIMIT DHE TESHA**

Si duhet të ndahet materia që matet me vëllim ose me peshë, kuturu apo një nga një me grusht. Muslimanët e parë nuk e konsideronin gabim që nga ushqimi i përbashkët njëri të hajë ndryshe nga tjetri, e gjithashtu edhe këmbimin e arit me argjend si dhe barazimin e hurmave.<sup>83</sup>

2483. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf që i ka transmetuar Maliku nga Sehl b. Kejsani, ky nga Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili tregon se:

---

<sup>83</sup> Sheriketun do të thotë bashkim, shoqërim i shumë vetave në një bashkësi në bazë të pasurisë që kanë duke i bashkuar ato me kushte të caktuara, ose në punë tregtie, trashëgimie, pranim të dhuratave dhe të ngjashme me këto. Mund të bëhet me marreveshje të ndersjelltë të palëve, por mudet edhe bashkësia ku çdo pjesëmarrës mund të fitojë të drejtë pronësie në pasuritë natyrore të cilat nuk janë në pronësi të asnjë njeriu, si për shembull për shfryrëzimin e ujërave natyrore, energjisë së diellit etj.

Bashkimi i pronësisë bëhet atëherë kur ajo pasuri, bëhet pasuri, pronë e përbashkët e disa indiviëve që mund të arrihet sipas mënyrës së përmendur më parë, ashtu që ajo pronë nuk mund të ndahet e te dallohet ndërmjet. Për shembull kur dy veta bashkarisht e blejnë një pasuri, osë ajo mund t'u takojë në mënyrë tjetër, si me anë të trashëgimit ose dhuratë, ajo është pasuri e tyre e përbashkët dhe ata janë bashkëpronarë - ortakë. Ashtu është edhe nëse dy veta e bashkojnë drithin, ai është pasuri e përbashkët e tyre.

Nëse një dukat i njërit përzihet me dy dukatë të një tjetri të njëjtit llojë e vlerë sikur dukatët e atij tjetrit, e pastaj dy dukatë humbasin, dukati që ka mbetur u tako te dyve në përpjestim me aq sa kanë pasur, f.v. pronarit të dy dukatëve i takojnë 2/3 kurse atij tjetrit 1/3.

Shoqërizimi, bashkimi i pasurisë mund të jetë në pasuri të patundshme dhe të tundshme, sikurse drithi, plaçka, bagëti si lopë, dhenë etj. po mund të jetë edhe në forma tjera si kreditë etj.

---

- Pejgamberi a.s. dërgoi një njësit (luftëtarësh) kah bregdeti dhe u caktoi për komandant Ebu Ubejd b. Xherrahhin. Ishin treqind veta, ndër të cilët edhe unë. U nisëm, por, derisa ende ishim në rrugë, filloi të na mungojë ushqimi dhe Ebu Ubejdi urdhëroi që të gjitha shujtat individuale të ushtrisë të bashkohen, dhe kur u bashkuan u mbushën dy torba me hurma dhe na ushqeun për çdo ditë nga pak. Kur u afrua fundi na tajkoi vetëm nga një hurmë. Atëherë i thashë: **“çka të bëj me një hurme?”** Ai u përgjigj:

**“E kemi ndier mungesën qysh atëherë kur filloi pakësimi.”**

Mandej, shton Xhabiri, arritëm në det dhe qe një peshk sa nje kodër me çka ushtria është ushqyer trembëdhjetë netë, e pastaj urdhëroi Ubejdi t'i vëmë në shkopinj nja dy brinj të peshkut dhe dha urdhër të nisemi. Atëherë jemi nisur nën hijen e tyre pa i prekur<sup>84</sup> (Krahaso: 2983, 4363, 5493, 5494).

2484. - Na ka treguar Bishr b. Merhum se i ka transmetuar Hatim b. Ismaili nga Jezid b. Ebi Ubejde, kurse ai nga Seleme r.a.:

- Një herë u zbrazen rezervat dhe njerëzit ishin shumë nevojë dhe erdhën te Pejgamberi a.s. të thernin devet e Pejgamberit a.s. dhe ky ua lejoi. Këta e takuan Umerin dhe ia shpjeguan rastin, e ai u tha: **“E çka pastaj pa devet tuaja?”** Shkoi pastaj e hyri te Pejgamberi a.s. dhe i tha: O Pejgamber i Al'-llahut, çka oo të

---

<sup>84</sup> Ebu Ubejdit iu kërkua uria, por duke ditur se të tjerët kishin ende ushqim zbatoi veprimin si më lart dhe me këtë të gjithë ia dolën ta përballojnë urinë, gjë të cilën edhe Alejhisselam shpesh e zbatonte. Këtë praktikë kujdestari i bashkësisë mund ta zbatojë në çfarëdo kohe qoftë të urisë, por me kompenzim të drejtë për ushqimin e marrë.

Rasti i larpërmendur flet për guximin dhe durimin e çetës prej 30 vetash që të nisen në aksionin e vet pa asnjë fjalë dhe pa rrezik për jetë.

Në shoqërim të njerëzve të ndershëm, në çkado qoftë është e ardhmja më e mirë.

---

---

bëjnë ata pa deve, si do të veprojnë? Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj:

- **Thirrni njerëzit të sjellin çka u tepron nga ushqimi.** Mandej shtrinë një lëkurë dhe aty grumbullua ushqim, kurse Pejgamberi a.s. u ngrit, bëri dua dhe e bekoj atë ushqim. Pastaj lypsi enët e tyre dhe ata morën të gjithë. Mandej Pejgamberi a.s. foli këtë: **Nuk ka Zot tjetër përveç All-llahut, e unë jam, sigurisht i dërguari i Tij**". (Krahaso: 2982).

2485. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf se i ka transmetuar Evaziu se Ebu Nexhashi e ka dëgjuar Rafi b. Hadixhin r.a. kur ka thënë:

**"E falëm namazin e iqindisë me Pejgamberin a.s. dhe ai theri një dele që e ndau pastaj në dhjetë pjesë nga e cila hëngrëm mish të zier para se të perëndonte dielli"**.

2486. - Na ka treguar Muhammed b. A'ala të cilit i transmeton Hammad b. Usame nga Burejdi, e Ky nga Ebu Burde, ai nga Ebu Musa i cili ka deklaruar se Pejgamberi a.s. ka thënë:

- Fisi Esh'ari, kur mbeteshin pa ushqim në kohë të luftës ose u pakësohej ushqimi i familjeve të tyre në qytet, e grumbullonin tërë çka kishin në një çarçaf dhe pastaj e ndanin sipas antërëve të familjes me një enë në mënyrë të barabartë. Ata janë të mitë e unë jam i tyre.

### **DY PRONARË TË PASURISË SË PËRBASHKET KANË TË DREJTË KERKSE TË NDËRSJELLË PËR ZEKATIN**

2487. - Na ka treguar Muhammed b. Abdullah b. Muthenna të cilit babai i vet i ka treguar: Më ka kumtuar Thumame b. Abdullah b. Enesi nga Enesi të cilit Ebu Bekr es-Siddiku r.a. ia shkroi normat e zekatit ashtu siç i kishte caktuar **Pejgamberi i All-llahut dhe tha:**

Në rastin kur në një pasuri marrin pjesë dy veta, ata janë të barabartë në kërkesat e tyre të ndërsjella.

### **NDARJA - PJESËTIMI - I DHENVE (KAFSHËVE)**

2488. - Na ka treguar Ali b. Hakem Ensariu të cilit i ka treguar Ebu Avane nga Seid b. Mesruk, kurse ky nga Abaje b. Rifa'a b. Raf'i b. Hadixh, kurse ky ka dëgjuar nga gjyshi i vet si vijon:

“Kemi qenë në Dhu-l-Hulejfe me Pejgamberin a.s. kur njërezit ishin të uritur dhe u vërsulën mbas deveve dhe dhenëve.

Pejgamberi a.s. ishte në grupet e fundit. Ata, shpejt e shpejt, i prenë ato, i vunë kazanat, por **Pejgamberi a.s. urdhëroi të derdhen kazanat. Pastaj i vuri dhjetë dele baras me një deve dhe i shpërndau.**

Me këtë rast u iku një deve dhe ata iu vunë ta zënë por u lodhën. Në mesin e tyre ishin disa kalorës dhe njëri ndër ata **deshi ta gjuajë me shigjetë**, por deshti All-llahu e pengoi. Pejgamberi a.s. tha:

“**Këto kafshë shtëpiake janë egërsuar, janë bërë sikur kafsh të egra, prandaj, nëse nuk mund t'i zini, atëherë veproni kështu (gjuani)**”.

Gjyshi im atëherë i tha: “**Ne shpresojmë, përkatësisht frikësohemi, për të nesërmen tonë nga armiku e thika nuk kemi, a bën ta presim me “kasab” gjethe shavari?**”

- **Me kusht që të rrjedhë gjaku** - tha ai.

Atëherë përmendet emri i All-llahut dhe “**hane të tërë, përve dhëmbëve dhe thundrave. Ja, po ju them pse; sa për dhëmbë ato janë asht, kurse thundrat janë brisqe për etiopiasit.**”<sup>85</sup> (Krahaso 2507, 3075, 5498, 5503, 5506, 5509, 5543, 5544).

---

<sup>85</sup> Muhammedi a.s. në vitin e 8 hixhrij ndërmori një aksion vezhgues kah Jemami dhe u vendos në Du-l- Hulejfe.

Nga shembulli i përmendur mund të nxirren përfundimet:

- mallin që zihet rob ushtarët mund ta hanë para se të jetë kryer ndarja dhe të jetë dorëzuar udhëheqesit:

---

---

---

## TË BASHKUARIT E HURMAT PA LEJE TË BASHKËPRONARIT

2489. - Na ka treguar Hallad b. Jahja se i ka transmetuar Sufjani, i cili thotë se i ka thënë Xhebela b. Suhejm: Kam dëgjuar Ibn Umerin r.a. duke thënë: **“Pejgamberi s.a.v.s. u ka ndaluar njerëzve të marrin nga dy hurma përnjëherë (duke ngrënë) pa marrë leje nga shokët e vet.”**

2490. - Na ka treguar F, bu-l-Velid se Shu’beja i ka transmetuar nga Xhebela si vijon:

- Kemi qenë në Medinë kur ishte viti i urisë dhe Ibn Zubejri na dha hurma. Pranë nesh kaloi Ibn Umeri dhe tha: **“Mos i bashkoni (mos i merrni nga dy) sepse Pejgamberi a.s. e ka ndaluar këtë, përveç në rast se ndokush prej jush merr leje nga vëllai i vet.”**

## VLERËSIMI I DREJTË I SENDEVE MIDIS BASHKËPRONARËVE

2491. - Na ka treguar Imran b. Mejser se Abdu-l-Varithi i ka thënë se ka dëgjuar nga Ejubi, ky nga Nafiu kurse ky nga Ibn Umeri r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **“Ai që heq dorë nga pjesa që i takon te robi, ose nga një pjesë”, ose ka thënë: “nga pjesa që i takon”, dhe ka pasuri që e mbulon në tërësi vlerën e vërtetë, robi është i liruar, por nëse nuk**

---

- ndarja e fitimit të luftës mund të kryhet ndërmjet luftëtarëve pa konstatim preciz të vlerës me të holla për secilin send nëse pajtohen me këtë, porse imami Shafiu këtë nuk e miraton;

- kafsha shtëpiake që ka ikur dhe nuk mund të kapet mund të vritet me armë gjuetie;

- para së të prehet kafsha duhet përmendur emri i All-llahut. Nëse nuk përmendet me qëllim emri All-llahut ai mish nuk është i lejuar për ta ngrënë por nëse harrohet rastësisht atëhere mund të hahet. Gjithësesi ushqimi fillohet me Bismil-lah;

- kafshët duhen prerë me thikë të mprehtë e jo me ndonjë mjet që nuk pret. Teknika e prerjes duhet të jetë bashkëkohore pa dhembje...

---

---

ka shumën që arrin këtë, ai ka lirur vetëm pjesën që e ka falur”

Ejubi ka thënë:

- **Nuk e di a është citim i Nafiut: “... ai ka liruar vetëm pjesën që e ka falur, apo është kjo fjalë e Pejgamberit a.s. (Krahaso: 2503, 2521 - 2525).**

2492. - Na ka treguar Bishr b. Muhammed se e ka informuar Abdullahu, këtë Seld b. Ebi Arube nga Katade, kurse ky nga Nadr b. Enesi, e ai nga Bishr b. Nehik i cili përcjellë nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

- **“Kush heq dorë, nga pjesa e robit të vet, e ka detyrë ta lirojë plotësisht për vlerën e pasurisë së vet, por nëse nuk ka pasuri, atëherë do të caktohet vlera reale e robit, dhe ai do të përpiqet që të mos jetë i stërngarkuar.” (Krahaso: 2504, 2526, 2527).**

### **NDARJA ME SHORT DHE TËRHEQJE TË SHIGJETAVE**

2493. - Na ka treguar Ebu Nuajm se Zekerija ka dëgjuar Amirin duke thënë: Ka dëgjuar Nu'man b. Beshirin r.a. që transmeton se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

Ai që kryen urdhërat e All-llahut dhe ai që i then ato i ngjan njerëzve që hoqën short në anije, dhe disave u ra pjesa e epërme e disave pjesa e poshtme. Kur ata të pjesës poshtme frikësoheshin nga uji, kalonin te ata përmbi dhe thoshin: “Nëse ne bëjmë vrima në pjesën tonë nuk i dëmtojmë ata që janë përmbi ne.” Nëse këta lejojnë të realizojnë këtë qëllim, shkatërrohen të gjithë, por nëse i pengojnë, i ndalin, shpëtojnë edhe ata edhe të gjithë tjerët.” (Krahaso: 2686).

---

## TË SHOQËRUARIT E JETIMIT DHE TRASHËGUESIT (MIRAXHINJTË)

2494. Na ka treguar Abdu-l-Aziz b. Abdullah el-Amiriju-l-Uvejsi se i ka transmetuar Ibrahim b. Sa'd nga Salihu, e ky nga Ibn Shihabi që thotë: Më ka lajmëruar Urve se e ka pyetur Aishen r.a. kurse Lejthi ka thënë se i ka rrefyer Jenusi nga Ibn Shihabi: Më ka informuar Urve b. Zubejri se e ka pyetur Aishen r.a. për fjalët e All-llahut:

**“... Nëse keni frikë se...” deri te fjala ... “... me katër ...” Ajo është përgjigje” “ O nipi im, ajo është jetimja nën mbikqyrjen e kujdestarist të vet të cilit i pëlqen edhe pasuria edhe bukuria e saj dhe ai shoqërohet në këtë, prandaj kujdestari i vet dëshiron ta kurorëzojë pa e caktuar mehrin real, duke i dhënë asaj aq sa i japin edhe tjerët, dhe kjo u ndalohet për kurorëzim,, përveç në rast se janë të drejtë dhe u japin më tepër se mehri i zakonshëm. Është urdhëruar që të martohet me gratë që u pëlqejnë”<sup>86</sup>**

Urve ka deklaruar se Aishja ka thënë:

-Pas shpalljes së këtij ajeti njerëzit kërkonin shpjegim (fetva) nga Pejgamberi s.a.v.s., prandaj All-llahu xh.sh. shpalli : “ Prej teje kërkojmë fetva lidhur me gratë...” deri te fjalët “... e ju dëshironi t’i kurorëzoni” dhe ajo që ka përmendur All-llahu “... që t’ju lexohet në libër...” është ai ajeti i përmendur ku thuhet “... e ndërse frikësoheni se ndaj bonjakëve nuk do të jeni të drejtë, merni për gra ato që u pëlqejnë...” Fjalët e All-llahut në ajetin tjetër. “... e dëshironi t’i kurorëzoni...” kanë kuptimin: se dikush prej jush e dëshiron jetimen që e ka nën mbikqyrje dhe ka pak pasuri dhe bukuri, kurse është ndaluar të bëjnë kurorë me ato gra të varfëra të cilat i duan vetëm për shkak të pasurisë dhe

---

<sup>86</sup>. “Nese keni frikë se ndaj Bonjakëve nuk do të jeni të drejtë, atëherë martohuni me ato gra që u lejohet, me nga dy, tri dhe katër. Por në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë, atëherë vetëm më nga një; ose ,ja, i keni ato me të cilat dispononi. Ashtu është më lehtë të ruheni nga e padrejta” (Nisa: 3)

bukurisë, përveç se me drejtësi dhe kjo për shkak të simpatisë ndaj tyre<sup>87</sup> (krahaso 2763, 4573, 4574, 4600, 5064, 5092, 5098, 5131, 5140, 6965).

## **BASHKËPRONËSIA NË TOKË DHE SENDE TJERA**

2495. –Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se Hishami i ka transmetuar nga Ma'meri, ky nga Zuhriu, ky nga Ebu Seleme se Xhabir b. Abdullah ka thënë:

**-Pejgamberi a.s. ka rregulluar të drejtën e përparësisë për blerje për të gjitha gjërat që nuk ndahen, kurse në rast të vendosjes se kufijve dhe ndërtimit të rrugëve, atëhere nuk ka të drejtë përparësie<sup>88</sup>.**

---

<sup>87</sup> “Kërkojnë prej teje norma për gratë. Thuaj: “All-llahu do t’ua sqaroje normat për ato, edhe për atë që është komunikuar në libër në femrat bonjake, të cilave nuk u jipet ajo që u takon me ligj dhe dëshironi të martoheni me to, edhe për fëmijët e pafuqishëm, edhe që me bonjakët të veproni me drejtësi. Ndërkaq, All-llahu me siguri di shumë mirë për të mirat që bën.

<sup>88</sup>. Anëtari i kësaj bashkësie-ortaku, pasurinë e vet ia shet ortakut të vet, në radhë të parë por mundet edhe tjetërkujt, nëse ortakut nuk i plotëson kushtet e nevojshme. Mirëpo nëse pasuria është përzier rastësisht ose me qëllim dhe sipas pronarëve nuk mund të ndahet, atëherë njëri ortak, pa pëlqimin e tjetrit nuk mund ta shesë hisen e vet palës së tretë.

Pronari prezent tokën e përbashkët mund ta mbjellë vetë dhe ta punojë, nëse kjo nuk ia ul vlerën tokës, dhe kur të vijë pronari që nuk ka qenë prezent, ai ka të drejta të punojë dhe ta shfrytëzojë atë sa ka shfrytëzuar i pari, por nuk ka të drejtë të kërkojë pjesën e prodhimit siç është traditë e vendit, qesim, psh  $\frac{1}{2}$ ;  $\frac{1}{3}$ ;  $\frac{1}{4}$  etj.

Nëse njëri nga bashkëpronarët e vreshtës së përbashkët, nuk është prezent, pronari që është prezent mund të punojë dhe shpënzojë pjesën e vet, kurse pjesën e bashkëpronarit të tij mund ta shesë dhe t’ia ruajë paratë dhe kur të vijë ai ka të drejtë qëta lejojë atë shitje dhe paratë e kursyera t’i pranojë, ose mund të mos e lejojë dhe të kërkojë komopenzim për hisen e vet në tjetër vlerë.

Nëse trashëgimtarët e një toke të përbashkët e mbjellin tokën e të gjithëve, me pajtimin e të gjithëve, fryti, pasi të hiqet shpenzimi i punës, ndahet në mënyrë të barabartë për të gjithë trashëgimtarët.

---

---

**NËSE BASHKEPRONARET NDAJNË SHTËPINË  
OSE DIÇ TJETËR NUK KANË TË DREJTË NË  
SHFUQIZIM, AS TË DREJTË PËRPARESIE PËR  
BLERJE**

2496. - Na ka treguar Museddedi, të cilit i tregon Abdu-l-Vahidi që Muameri i transmeton nga Zuhriu, ky nga Ebu Seleme b. Abdurrahmani, kurse ky nga Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili ka thënë:

**“Pejgamberi s.a.v.s. ka rregulluar të drejtën e përparësisë në blerje për të gjitha gjërat që janë të pandashme, por kur ndreqen kufi ose rrugë, nuk ka të drejtë përparësie në blerje”.**<sup>89</sup>

**BASHKËPRONËSIA NË ARI, ARGJEND  
DHE NË ATO SENDE QË LEJOHET KËMBIMI**

2497, 2498. - Na ka treguar Amr b. Ali se Ebu Asimi i transmetoi nga Osmani, d.m.th. Ibn Esvcdi, të cilin e informoi Sulejman b. Ebi Muslim, që tha:

---

<sup>89</sup> Njëlloj sikurse pronari i pavarur i një pasurie “nuk” që mund të disponojë sipas dëshirës së vet, ashtu edhe pronarët e një pasurie të përbashkët të pandarë, pasuri “mulli” e përdorin lirisht, por me marrëveshje ndërmjet tyre. Bashkëpronarët e një shtecie mund të banojnë bashkarisht aty, por nëse ndonjëri prej tyre dëshiron që aty të vendosë ndonjë të huaj, bashkëpronarët tjerë këtë mund t’ia kontestojnë.

Njëri nga pjesëtarët e pasurisë “mulk” të përbashkët që mund të disponojë me tërë pasurinë, i pavarur, nëse ia kalojnë të tjerët këtë, përveçse nëse ia përdorin shkon në dëm të pjesëtarëve të tjerë.

Asnjëri nga pjesëtarët nuk mund ta detyrojë tjetrin që t’ia shesë hisen e vet e as që ta lejë hisen e këtij. Mirëpo, nëse pasuria e tyre mund të ndalet ndërmjet tyre dhe pronari tjetër është prezent, njëri hisëtar mund ta ndajë, por nëse ajo pasuri dhe mund të ndahet, atëherë caktohet shfrytëzimi me radhë i asaj pasurie.

Frytet e pasurisë “mulk” në pronësi të përbashkët ndahen nëpërmjet bashkëpronarëve përpjesëtimi sipas asaj që kanë hise në atë pasuri.

---

---

- E kam pyetur Ebu-l-Minhalin për ndërrimin e parave nga dora në dorë, e ai më tha: “Unë dhe shoku im kemi blerë diçka me pagesë të gatshme, në dorë, por edhe me pritje. Erdhi te ne Bera b. Azib dhe ne e pyetëm për këtë, e ai tha: **“Kështu ka vepruar edhe shoku im Zejd b. Ekrem dhe lidhur me këtë e pyetëm Pejgamberin s.a.v.s., e ai tha: “Çka është me të gatshme, në dorë, merreni, e ajo që vonohet lëreni”**”.

**SHOQËRORIZIMI NË BUJQËSI ME  
JOMUSLIMANIN NË SHTETIN ISLAM DHE  
JOMUSLIMANIN TE CILIT I ËSHTË OFRUAR  
STREHIM - AZIL**

2499. – Na ka treguar Musa b. Ismail se e ka transmetuar Xhujejrij b. Esmā nga Nafiu kurse ky nga Abdullahu r.a.

**Pejgamberi s.a.v.s. u ka dhënë Hebrenjëve të Hajberit të punojnë dhe ta mbjellin tokën dhe të marrin gjysmën e prodhimit të asaj.**

**NDARJA E BAGËTIVE DHE DREJTËSIA NË  
NDRAJRE**

2500. - Na ka treguar Kutejb b Seid, të cilit i transmetoi Lejthi nga Jezid Ebu Habib, ky nga Ebu-l-Hajri, kurse ky nga Ukbe b. Amiri r. a. që Pejgamberi s.a.v.s. i dha njërit një tufë bagëtish t’ua ndajë shokëve të vet për kurbanë, dhe këtij i mbeti një gjedh. Ky i tregoi për këtë Pejgamberit a.s. dhe ky i tha: “Preje ti - there”.

**PJESËMARRJA NË USHQIME DHE TË TJERA**

Transmetohet se një njeri bënte pazar për çmimin e diçkaje, kurse tjetri i dha shenjë me sy, dhe Umeri e trajtoi sikur të jetë pjesëmarrës.

2501, 2502. - Na ka treguar Esbeg b. Ferexh se e ka informuar Abdullah b. Vehb i cili thotë se i ka transmetuar Sa’di nga Zühr b. Ma’abed, kurse ky nga gjyshi i vet Abdullah b. Hisham

---

---

i cili e mban mend Pejgamberin s.a.v.s. kur nëna e tij Zejneb b. Humejd e solli te Muhammedi a.s. dhe i tha:

- **O Pejgamberi All-llahut, le të japi bësën për besim.**

- **Ky është ende i ri, tha Pejgatnheri a.s. dhe e lëmoi kresë duke e uruar për të mirë.**

Nga Zuhr b. Ma'bed transmetohet se gjyshi i tij Abdullah b. Hisham e mori në treg dhe blenë ushqime. Atje e takojnë Ibn Umeri dhe Ibn Zubejri dhe i thanë:

- **Merrna edhe neve si bashkëpronarë ngase Pejgamberi All-llahut ty të ka dëshiruar përparim (të ka uruar) dhe ky pranoi.** Shpeshherë i mbetej fitim nga udhëtimet me karavane dhe ky e shpinte këtë në shtëpi.<sup>90</sup> (Krahaso: i 7210, 6353).

### **BASHKËPRONËSIA TE ROBI**

2503. - Na ka treguar Museddeni se Xhujejrij b. Esmā i ka transmetuar nga Nafiu, kurse ky nga Ibn Umeri r.a. se **Pejgamberi a.s. ka thënë:**

- Ai që heq dorë nga hisja e vet në një rob, është i detyruar ta lirojë plotësisht nëse ka pasuri që arrin në tërësi vleftën e tij reale, duke ua dhënë bashkëpronarëve hisen e tyre, dhe robin e liron”.

2504. - Na ka treguar Ebu Nu'aman, këtij i transmeton Xhebir b. i Hazimi nga Katade, kurse ky nga Nedr b. Enes, ky nga Beshir b. Nehik dhe ai nga Ebu Hurejreja r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- “Ai që liron një pjesë të robit, është plotësisht i lirë, nëse pronari i tij ka ndonjë pasuri. Në të kundërtën robi do të bëjë përpjekje që kjo të mos i rëndohet këtij.”

---

<sup>90</sup>. Nëse blerësit i thuhet, gjatë blerjes së ndonjë malli, më peano për ortak, dhe ai nuk reagon, konsiderohet se ai pranon pjesëmarrjen tënde të barabartë në atë pasuri.

I mituri nuk ka aftësi juridike për afarizëm të pavarur dhe të marrë mbi vete obligime.

---

---

**BASHKPRONËSIA NË KURBANË DHE DEVE  
DHE BASHKANGJITJA TJETRIT NË KURBAN  
PASI QË AI TA KETË NISUR PËR NË MEKKE**

2505, 2506. - Na ka treguar Ebu n-Nu'man, këtij Hammad b. Zejd i cili transmeton nga Abdu-l-Melik b. Xhurejxhi, ky nga A'atau, ky nga Xhabiri kurse Xhabiri nga Tavusi se Ibn Abbasi r.a. ka thënë:

- Pejgamberi s.a.v.s. ka ardhur në Mekke në mëngjesin e katërt të dhu-l-hixhes, duke kënduar telbijen vetëm për haxh. As ky as të tjetrit nuk e ngatërronin këtë me asgjë tjetër, dhe kur hymë në Mekke na dha urdhër dhe ne kryem Umeren, na lejoi raporte të lira me gratë tona dhe dikush e përhapri gojarisht këtë.

A'atau ka thënë se Xhabiri ka treguar kështu: **“Atëherë dikush në mbrëmje shkoi në Minne, ndërsa menia i dukej haptazi”** dhe Xhabiri këtë e ilustroi me dorë, shuplakë të dorës.

E njoftuan për këtë **Pejgamberin s.a.v.s. dhe u ngrit e tha:**

- **Kam marrë vesh se disa njerëz flasin kështu e kështu. Pasha Zotin unë, me të vërtetë, jam më i mirë dhe më i devotshëm se ata dhe këtë çështje e kan ditur më heret, as që e kisha planifikuar kurbanin që e kam gati, dhe sikur të mos kisha kurban unë do të dilja (lirohesh) prej ihramit.**

Atëherë u ngrit Suraka b. Malik b. Xhu'shum edhe e pyeti:

- **O Pejgamber i All-llahut, është kjo vetëm për ne apo përgjithmonë.**

- **Jo, por është për përherë - U përgjigj ai.**

Atëherë, thotë A'atau, erdhi nga Jemeni Ali b. Ebu talibi dhe njëri prej tyre (A'atau apo Tavusi) ka thënë se Aliu r.a. tha: **“Të përgjigjem o Zot ashtu siç ka vepruar Pejgamberi i All-llahut”** kurse tjetri ka thënë: **“Të përgjigjem me haxhin e Pejgamberit të All-llahut”**. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s.

---

---

urdhëroi të vazhdojë të jetë në ihram dhe e bëri ortak në kurban.

### **BARAZIMI I KAFSHËVE - GJATË NDARJES - DHJETË TË IMTA ME NJË LOPË**

2507. - Na ka treguar: Muhamedi se e ka informuar Veki i cili transmeton nga Sutani, ky nga babai i vet, ky nga Abaje b. Rifa'a kurse ky nga gjyshi i vet Rafi' b. Hadixhi r.a.

- Kemi qenë në Dhu-l-Hulejfe me Pejgamberin a.s. në Tiham dhe për te prerë kurbanë patëm zgjedhur dele e deve ndërsa njerëzit shpejtonin të përgatisnin kazanat. Atëherë erdhi Pejgamberi a.s. dhe urdhëroi të derdhen kazanat e pastaj i ndau dhjetë kafshë të imta në një anë e në anën tjetër një kafshë të trashë, për t'i prerë. Në këtë moment u iku një deve. Në mesin e tyre kishte kalorës dhe njëri prej tyre e mori në shenjë me shigjetë, por dashti Zoti e pengoi, ndërsa Pejgamberi a.s. tha:

- Në të vërtetë këto kafshë shtëpiake janë egërsuar, janë bërë si të egra. Nëse nuk mund ta mposhtni, atëherë veproni kështu”.

Gjyshi im, shton Rifai, ka thënë:

- O Pejgamberi i All-llahut, ne shpresojmë, gjegjësisht kemi frikë nga ballafaqimi me armik, e ne nuk kemi thika, a ta presim me fije shavari?

- Shpejto, nxito, me çka derdhet gjaku - u përgjigj ai. Me atë rast është permendur emri i All-llallut, prandaj: “Hanie, përveç dhëmbëve dhe thundrave”, për arsye se dhëmbët janë eshtra, e sa i përket thundrave ato janë thika për etiopiasit.

**PENGU - GARANTIMI NË PREZENCË**

All-llahu xh.sh. thotë: **“Nëse jeni në rrugë dhe nuk gjeni shkrues, merrni garantues...”**<sup>91</sup>

2508. - Na ka treguar Muslim b. Ibrahim, këtij Hishami, kurse atij i ka transmetuar Katadeja nga Enesi r.a.:

- Pejgamberi a.s. e la peng (si garancë) parzmoren e vet për një sasi elb. Unë i dërgova Pejgamberit a.s. bukë të elbit dhe tlyen të tretur dhe e dëgjova duke thënë: **“Në shtëpinë e Muhamedit kurrë nuk ka gdhirë e as nuk është ngrysur më tepër se një sa’e (ushqim), e aty jetojne nëntë veta”**.<sup>92</sup>

**LËNIA PENG E PARZMORES**

2509. - Na ka treguar Museddedi, këtij Abdul-Vabidi se A’ameshi tha:

- Ra fjala për pengun dhe garantin te Ibrabîmi, e ai tha: **“Na ka rrëfyer Esvedi i cili transmeton nga Aisheja r.a. se Pejgamberi a.s. pat blerë diçka ushqim prej një hebreji veresi, dhe, për garanci, i dha parzmoren e vet”**.

---

<sup>91</sup>. *“Nëse jeni në rrugë e nuk gjeni shkrues, atëherë merrni peng (kapar)! Dhe nëse njëri te tjetri siguron diçka, ai le ta arsyetojë besimin e shprehur dhe le t’i frikësohet All-llahut, Zotit të vet. Dhe mos e fshehni dëshminë, se kush e fsheh atë, ai ka zemër mëkatare, kurse All-llahu e di çka punoni”*. (Bekare: 2X?3)

<sup>92</sup>Kjo ka të bëjë me procedurën kur një pasuri dorëzohet pengut në mënyrë që ai të nxjerrë ndonjë send nga ajo. Akti i pengut (garantit) lidhet me anë të propozimit dhe pranimit ndërmjet të atij që jep garancë dhe atij që pranon garancën, dhe kjo bëhet e plotëfuqishme me pranim-dorëzimin e objektit që lihet peng.

Kushtet për vlefshmërinë e aktit të garancës janë: të dy palët të jenë të mençur, por jo edhe të moshërritur; që sendi i lënë peng, si garancë të jetë i gatshëm për shitje, në momentin kur lidhet marrëveshja të jetë i pranishëm, të ketë vleftë qarkullimi dhe që shitja e atij malli të jetë e mundshme për shitje.

---

---

## LËNIA PENG E ARMËS

2510. - Na ka treguar Ali b. Abdullah, këtij Sutani se Amri i ka thënë se e ka dëgjuar Xhabir b. Abdullahun r.a. duke thënë: Pejgamberi a.s. ka thënë:

- Kush është për ekzekutimin e Ka'ab b. Eshrefit, ngase ai fyen Zotin dhe të Dërguarin e Tij?

Pastaj Muhamed b. Mesleme ka thënë: "Unë". Më vonë shkoi dhe i tha: **"Kërkojmë të na japësh hua një, a dy barrë (vesake)."**

- **M'i lëni peng gratë tuaja** u tha ai.

- **Si t'i lëmë peng gratë tona**, u përgjigjën ata, **kur ti je arabi më i bukur?**

- **Atëherë lini peng djemtë tuaj**, u tha.

- **Po si t'i lëmë peng djemtë tonë** - i thanë ata - **e tu thuhet ndonjërit: "Ja ky është peng për një a dy barrë vleftë". Kjo është turp, por ne do të lëmë peng parzmoren.**

Sufjani ka thënë: "Ka menduar në armë".

Atëherë i premtoi se do të vijë. Më vonë e vranë dhe shkuan te Pejgamberi s.a.v.s. dhe e informuan për këtë. (Krahaso: 3036, 3037, 4037).

## LËNIA PENG E KAFSHËVE QË MILEN

Mugireja transmeton nga Ibrahim si vijon: **"Kafsha e zënë, që e zë si peng, kalërohet aq sa ka vleftë ushqimi i saj, millet, gjithashtu, aq sa kushton ushqimi, po aq e ka vleftën edhe pengun, garancia e saj."**

2511. Na ka treguar Ebu Nuajme se i ka thënë Zekerija nga Amiri kurse ky nga Ebu Hyrejreja r.a se Pejgamberi a.s. ka thënë:

- **"Kafsha e marrë peng kalërohet për vetëmbajtjen, ushqimin, edhe qumshti i pihet derisa është peng."** (Krahaso: 2512).

2512. - Na ka treguar Muhamed b. Mukatil se i ka kumtuar Abdullah b. Mubarek, të cilit i transmetoi zekeri nga Sha'biu kurse ai nga Ebu Hyrejreja r.a se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Garanca e kafshës sa është peng është që të kalërohet për vlerën e ushqimit, kurse tamblu i asaj që milet pihet derisa është peng, dhe kush do që e shalon ose pi tamblin ngarkohet që ta ushqejë atë.**<sup>93</sup>

### **TË GARANTUARIT TE HEBREJTË DHE TË TJERËT**

2513. - Na ka treguar Kutejbe se i ka transmetuar Xheriri nga A'amesh ky nga Ibrahim, ndërsa ai nga Esvedi se Aisheja r.a. ka thënë:

**- Pejgamberi s.a.v.s. bleu prej një hebreji diçka ushqim, dhe si garancë i dha parzmoren e vet.**

---

<sup>93</sup>. Pranuesi i pengut (garancës) e ruan në mënyrë të veçantë personalisht ose me anë të besueshmit të vet, që mund të jetë anëtar i familjes së vet, ortaku, shërbëtori dhe tjerë. Shpenzimet për ruajtje të pengut dhe shpenzimet tjera i takojnë pranuesit të pengut.

Shpenzimet për mirëmbajtjen për një artikull që nuk mund të shfrytëzohet nga pranuesi i pengut, si për shembull renovimi i objektit, ujitja e tokës, pastrimi i kanalit, mbajtja e kafshës shterpë, etj, bie barrë e pengdhënësit kurse mbajtja e kafshës që sjell dobi siç është përmendur në hadithin e lartpërmendur i bart pengmarrësi. Pengmarrësi mund ta ndërpresë kontratën në mënyrë të ngjashme, kurse pengdhënësi këtë mund ta bëjë vetëm me pëlqimin e pengmarrësit.

Ndërprerja e marrëveshjes për peng (garancë) behet rregullisht me marrëveshjen e palëve, por pas ndërprerjes së marrëveshjes pengmarrësi ka të drejtë ta mmajë pengun deri kur t'ia paguajë pengdhënësi shumën për sa është lënë pengu. Marrëveshja e pengut nuk zhvleftësohet me vdekjen e pengdhënësit ose të pengmarrësit, as që mund ta shesë ndonjëri prej tyre pa pëlqimin e tjetrit, përveçse me leje të gjyqit. (Mexhele-i abkami sher'ije).

---

---

---

**NËSE GARANTUESI DHE I GARANTUARI, NUK  
PAJTOHEN, DETYRA E PROKURORIT ESHTË TA  
ARGUMENTOJË KURSE I AKUZUARI TË  
BETOHET**

2514. - Na ka treguar Hal-lad b. Jahja se i ka transmetuar Nafi' b. Umeri nga Ebi Mulejke:

-I kam shkruar Ibn Abbasit dhe ai m'u përgjigj se **Pejgamberi a.s. ka prurë vendim që i padituri të betohet.** (Krahaso: 2668, 4552).

2515, 2516. – Na ka treguar Kutejbe b. Seid se i ka transmetuar Xheriri nga Mensuri, ky nga Ebu Vaili se Abdullah b. Mesudi ka transmetuar : “Ai që betohet me qëllim që të fitojë të drejtë prone në ndonjë pasuri duke gënjyer, do të takohet me All-llahun por Ai do të jetë i hidhëruar

Si dëshmi për këtë All-llahu xh.sh. ka shpallur” **Me siguri ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e ...” deri te fjalët : “ dënim të dhembshëm”** (Kur'ann, 3: 77).

Pastaj doli Esh'ath b. Kajsi dhe tha: çka ju thonë Ebu Abdurrahman?

**Ia treguam çka tha- të Ebu Vaili - e ai tha:**

**Ka thënë të vërtetën. Pasha Zotin, ky ajet është shpallur për shkak timin. Unë dhe një tjetër kishim një kontest rreth një bunari dhe shkuam që ta gjykojë, vendosë”, këtë Pejgamberi a.s. Ai pyeti: “A ke dëshmitarë apo do të hetohesh?”**

**Dhe kur ai u betua - thashë – ky s'ka gajle (e humba). Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. ka lexuar këtë ajet: “Ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak - në botën tjetër nuk kanë asgjë, atyre All-llahu në ditën e kijametit nuk do t'u flasë fare e as do t'i shikojë, dhe nuk i pastron - ata kanë**

*për të vuajtur dënim të dhëmbshëm.” (Kur’an, 3 77)*

**Kreu 49**

**LIRIMI I ROBIT DHE RËNDËSIA E LIRIMIT**

I Lartmadhërishtmi Zot thotë: “... *Të falësh robin, të ushqesh, në kohë të urisë, jetimin të afërmin...*”<sup>94</sup>

2517. - Na ka treguar Ahmed b. Junus, këtij Asim b. Muhamed, këtij Vabid b. Muhamed të cilit i tregon Seid b. Merxhan, shok i Ali b. Huseinit, se i ka transmetuar Ebu Hurejreja r.a. që **Pejgamberi a.s. ka thënë:**

**- Kushdo që e liron një rob, musliman, All-llahu për secilën pjesë të trupit të tij do ta shpëtojë prej zjarrit të xhehennemit pjesët e tij të trupit.”**

Pastaj - thotë Seid b. Merxhan - shkova te Ali b. Huseini dhe ai u nis për te robi i vet dhe e liroi për çka tani me Abdullah b. Xhaferi ia kishte paguar për këtë dhjetë mijë dirhemë, përkatësisht dinarë. (Krahaso: 67153).

**CILIN ROB ESHTË ME MIRE TE LIROSH**

2518. Na ka treguar Ubjedullah b. Musa që transmeton nga Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, kurse ai nga Ebu Muravihu, ndërsa ky nga Ebu Dheri r.a. i cili ka thënë:

**-E kam pyetur Pejgamberin s.a.v.s. cila punë është më e lavdëruar?**

**--Besimi në All-llahun dhe lufta në rrugën e Atij - u përgjigj.**

**- Po cilin rob është më së miri ta lirosh - e pyeta unë.**

**- Ai që është më i shtrenjtë dhe më i vlefshëm te zotëriu i vet, tha.**

---

94 “*Është lirim i një të robëruari, ose ushqen atëherë kur mbretëron uria, ndonjë bonjak të afërt.*” (Kur’an, 90: 13-15)

---

---

- Nëse nuk mund ta bëj këtë, e pyeta.

- Të ndihmosh të varfërin ose t'i bësh mirë atij që nuk është i aftë për punë, më tha.

Po nëse nuk mund të bëj as këtë - i thashë.

- Kursei njerëzit nga e keqja, sepse edhe kjo është sadakë e madhe që po e jep për vete - u përgjigj.

### **LIRIMI I ROBËRVE KUR ZIHET DIELLI APO NDODH NDONJË FENOMEN TJETËR**

2519. - Na ka treguar Musa b. Mes'ud të cilit i transmeton Zaid b. Kudame nga Hisham b. Urve, kurse ky nga Fatimeja - e bija e Mundhirit - ndërsa kjo nga Esmā, e bija e Ebu Bekrit r.a.:

- Pejgamberi s.a.v.s. ka urdhëtuar lirimin e robërve në kohën kur terrohej, zihej dielli.

Në një varg tjetër të transmetuesve Musa b. Mes'udi pason Aliun i cili e transmeton hadithin nga Deravardi kurse ai nga Hishami.

2520. - Na ka treguar Muhamed b. Ebi Bekr se i ka kumtuar Athami, të cilit i ka thënë Hishami fjalët e Fatimes, bijës së Mundhirit, e cila ka dëgjuar Esmān, bijën e Ebu Bebrit r.a. duke thënë:

- Na është dhënë urdhër të lirojmë robërit me rastin e zënies së diellit.

### **LIRIMI I ROBIT OSE ROBRESHËS QË E KANË DY PRONARË**

2521. - Na ka treguar Ali b. Abdullah se i ka transmetuar Sufjani nga limri, ky nga Salimi, dhe ai nga babai i vet r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

- Ai që liron robin e dy pronarëve, e është i pasur, do t'i llogaritet vlera e mbetur dhe robi do të lirohet."

2522. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf dhe thoshte se

---

Maliku i ka transmetuar nga Nafiu, ky nga Abdullah b. Umeri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

**- Ai që liron hisen e vet të robit, kurse ka pasuri sa që arrin vlerën e robit, do të caktohet vlera reale e robit dhe ky bashkëpronarëve të vet do t'u japë pjesën që u takon kurse robit lirinë, por nëse është i varfër, robi lirohet vetëm nga ajo hise që e ka falur ky”.**

2523. - Na ka treguar Ubjed b. Ismail që transmeton nga Ebu Usame, ky nga Ubjedullahu, ky nga Nafi, kurse ai nga Umeri r.a. që thotë:

**- Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që e fal hisen e vet te robi obligohet ta lirojë tërsisht, nëse ka pauri që e arrin vlerën e tij. Nëse nu ka pasuri, robit i caktohet vlera reale sipas liruesit, ndërsa nga robi është e lirë hisja që falet.”**

Këtë hadith e tregon Museddedi, i cili transmeton nga Bishri ndërsa ai nga Ubjedullallu në version më të shkurtër.

2524. - Na ka treguar Ebu Nu'man se i ka transmetuar Hammadi nga Ejubi, ky nga Nafiu, kurse ky nga Ibn Umeri r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

Ai që liron hisen e vet te një rob, gjegjësisht bashkëpronësinë e vet dhe ka pasuri edhe për të mbuluar vlerën e caktuar reale, ai është i lirë.

**Nafiu ka shtuar ... në të kundërtën ai ka liruar te robi atë pjesë që e ka falur.”**

**Ejubi ka shtuar: “Nuk e di a është kjo diçka e thënë nga Nafiu apo është pjesë e vetë adithit?”**

2525. - Na ka treguar Ahmed b. Mikdam se i ka transmetuar Fudajl b. Sulejman, këtij Musa b. Ukbe, këtij Nafiu nga Ibn Umeri r.a. se ai kur merrte vendim për robin ose robëreshën, në rastin kur kishte shumë bashkëpronarë dhe njëri prej tyre e lironte hisen e vet, thoshte:

---

**E ka detyrë ta lirojë tërësisht, nëse ai që e liron ka pasuri të mbulojë shumën e caktuar reale me vlerësim të drejtë dhe bashkëpronarëve t'u japë hiset e tyre, kurse robin ta lërë të lirë."**

**Këtë e ka transmetuar nga Pejgamberi a.s. Ibn Umeri.**

Hadithin e lartpërmendur e kanë transmetuar në version të shkurtër: Lejthi, Ibn Ebi Dhi'b, Ibn Is-hak, Shuvejri, Jahja b. Seid, Ismail b. Umejje nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri r.a. kurse ky nga Pejgambcri a.s.

## **LIRIMI I PJESËRISHËM I ROBIT**

Nëse dikush e liron robin pjesërisht, një pjesë të robit, dhe nuk ka pasuri tjetër, robi do të angazhohet në punë me fitim, pa e ngarkuar tejmasë sikur rob të kontraktuar.

2526. - Na ka treguar Ahmed b. Ebi Rexha' i cili transmeton nga Jahja b. Ademi të cilit Xherir b. Hazimi i ka kumtuar:

- E kam dëgjuar Kataden kur tregonte se i ka transmetuar Nadr b. Enes b. Malik, i cili transmeton nga Beshir b. Nehik se Ebu Hurejre r.a. ka thënë: **"Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Ai që liron një pjesë të robit..."**.

2527. - Museddedi thotë se i ka transmetuar Jezid b. Zurej', këtij Seidi me anë të Katades, ky nga Nadr b. Enesi, ky nga Beshir Nehik, kurse ai nga Ebu Hurejreja t.a. se **Pejgamberi a.s. ka thënë:**

- **Ai që fal një hise të robit obligohet ta lirojë në tërësi me pasurinë e tij tjetër, nëse ka pasuri, në rast se nuk ka, do të caktobet vlera e robit dhe ai për këtë vlerë do të angazhobet të punojë, por jo në punë të rënda."**

Me një send tjetër Seidin e pason Haxh-xhash b. Hash-xhashi, Ebani dhe Musa b. Halefi, i cili transmeton nga Katade hadithin të cilin Shu'be e ka transmetuar në version të shkurtuar.

---

**GABIMI DHE HARRESA NË FJALËN E ROBIT,  
LËSHIMIN E GRUAS DHE TË NGJASHME**

Falja e robit bëhet vetëm për të arritur kënaqësinë e Zotit.

Pejgamberi a.s. ka thënë: Secilit i takon ajo që e ka pasur për qëllim, por nuk ka qëllim ai i cili bën diçka nga harrea ose gabimisht.

2528. - Na ka treguar Humejd, këtij i ka transmetuar Sufjani nga Mis'ari, e ky nga Katade r.a. që ka thënë:

**Pejgamberi a.s. ka thënë: "All-llahu, për hatër timin, secilin pasues timit nuk ia evidenton veprën që e ka ndërmend ta bëjë (e nxit epshi) deri kur ta kryejë ose ta shprehë bindshëm."** (Krahaso: 2569, 6664).

2529. - Na ka treguar Muhamed b. Kethir i cili transmeton nga Sufjani, ky nga Jahja b. Seidi, ky nga Muhamed b. Ibrabim Tejmiu e ky nga Alkame b. Vekkas Lejthiu që ka thënë: "**E kam dëgjuar Umer b. Hattabin r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: Punët janë të lidhura me qëllimin dhe secilit i takon ajo, çka e ka për qëllim. Ai që hixhretin (nga Meka në Medinë) e ka bërë për hir të All-llahut dhe të Pejgamberit të Tij, hixhreti i tij do të jetë për :Zotin dhe të Dërguarin e Tij, kurse ai që e ka bërë këtë për të fituar ndonjë pasuri të kësaj bote ose me qëllim që të marrohet, hixhreti i tij është për atë çka e ka pasur qëllimin."**

**NËSE DIKUSH THOTË PËR ROBIN E VET: AI I  
TAKON ALL-LLAHUT DHE KA NDËRMEND TA  
LIROJ TË MARRË DËSHMITARË PËR TA LIRUAR**

2530. - Na ka treguar Muhamed b. Abdullah b. Numejr që transmeton nga Muhamed b. Bishar, ky nga Ismaili, ky nga Kajsi kurse ai nga Ebu Hurejre r.a. se ky bashkë me një rob të vetin, pasi ishte nisur me qëllim që të pranojë fenë Islame, e humbën njëri tjetrin, ashtu që robi erdhi kurse Ebu Hurejreja rrinte me

---

Pejgamberin a.s. i cili tha: “O Ebu Hurejre, ja ku e ke robin tënd”  
Ky tha: “Sigurisht të kam dëshmitar që ai është i lirë”.

Atëherë, thotë rrëfimtari, Ebu Hurejre thoshte:

**“Oh natë e gjatë! e mundimshme! Përfundimisht më shpëtove nga shtëpia e mosbesimitarit”.** (Krahaso: 2531, 2532, 4393).

2531. - Na ka treguar Ubejdullah b. Seid, na ka treguar Ebu Usame dhe Ismaili, ai nga Kubejsi e ky nga Ebu Hurejreja r.a. i cili ka thënë: **“Kur dola para Pejgamberit a.s., thash, në rrugë: Oj natë e gjatë, e mundimshme, më shpëtove nga shtëpia e mosbesimitarit. Robi im ka ikur nga unë giatë rrugës dhe kur erdha te Pejgamberi a.s. iu betova, dhashë fialën, për besnikri dhe derisa isha ende te ai, erdhi robi im, kurse Pejgamberi a.s. tha: “O Ebu Hurejre, ja robi yt.”**

**- I lirë është - i thashë - për hir të kënaqësisë së All-llahut.**

**Dhe, që atëherë e lirova. Ebu Abdullahu thotë:**

**Ebu Kurejbi, flalën “... i lirë është ...” nuk e ka transmetuar nga Ebu Usame.**

2532. - Na ka treguar Shihab b. Abhad se i ka transmetuar Ibrabimi nga Humejdi, ky nga Ismaili, kurse ai nga Kaisi, i cili ka thënë:

**- Kur u nisën Ebu Hurejre dhe robi i atij të pranojë fenë Islame, njëri prej tyre e humbi shokun e vet dhe Ebu Hurejre tha: “Sigurisht ty të kam dëshmitar që ai i takon All-llahut.”**

### **ROBËRESHA - NËNË FËMIJË**

Ebu Hurejre deklaroi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Parashenjat e shkatërrimit të botës janë:... kur robëresha lind për vete sundues, zotëri.**

2533. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman se i ka transmetuar

---

Shnajbi nga Zuhriu, i cili thotë që i ka transmetuar Urve b. Zubjeri se Aisheja r.a. ka thënë: Utbe b. Ehi Vekkas i preferoi vëllait të vet Sa'ad b. Ebi Vekkasit të marrë për djalë birin e robërshës Zem'ate. Utbe tha: **“Ai është djali im”**.

Kur erdhi Pejgamberi s.a.v.s. në Meke, kur u çlirua Mekka, Sa'di mori djalin e robërshës Zem'ate dhe bashkë me të shkoi te Pejgamberi a.s. Baskië me të shkoi edhe Abb. Zem'a. Sa'di tha: “O Pejgamberi i All-llahut, ky është i biri i vëllait tim, më ka ngarkuar si me djalë të vetin. Me këtë rast Abd b. Zem'a ka deklaruar: **“O Pejgamberi i Zotit, ky është vëllai im, porse djali i Zem'ates, robërshës u lind në dyshekun e tij.”**

- Pejgamberi i All-llahut e shikoi djalin e robërshës Zem'ate dhe vuri re se ai më shumë i ngjante Abd b. Zem'as. **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: O Abd b. Zem'a, ai është i yti për shkak se ka lind në dyshekun e babait tënd**”. Atëherë Pejgamberi i All-llahut, pasi që e pa se ai i ngjan Utbes, tha: “Oj Sevdije e **bija e Zem'ates, mbulohu, fshehu, prej tij.** Sevdija ka qenë bashkëshorte e Pejgamberit s.a.v.s.”<sup>95</sup>

### **SHITJA E ROBIT QË PRONARI I KA PREMTUAR LIRIMIN PAS VDEKJES SË TIJ**

2534. - Na ka treguar Adem b. Ebu I'jas të cilit Shu'be i ka kumtuar nga Amr b. Dinari:

- Kam dëgjuar xhabir b. Abdullahin r.a. kur ka thënë: **“Njëri nga ne e ka liruar robin, por pas vdekjes së tij, dhe Pejgamberi a.s. e thirri atë rob dhe e shiti. Ai rob thotë Xhabiri**

---

<sup>95</sup> Nuk i lejohet zotërisë të shesë robërshën e vet e cila lind fëmijë më të. Ky është qëndrimi i Ebu Bekrit, Umerit, Osmanit dhe Aliut dhe i shumë ashabëve të tjerë. Këtë mendim e ka pranuar Maliku, Thevriu, Evaz-ju, Lejthi, Ebu Hanife dhe juristë të tjerë të shkollës së tij.

Me anë të Ibn Abbasit është transmetuar deklarata e Muhammedit a.s. “Secila robërshë që lind fëmijë me zotëriun e vet, ajo është e lirë, kurse Umeri e ka komentuar. “... lirohet madje edhe në qoftë se ajo shtatëzëni është e dështuar”.

---

---

vdiq vitin e parë”.

## **SHITJA OSE KUJDESI NDAJ ROBIT TË LIRUAR**

2535. - Na ka treguar Ebu-l-Velid se i ka transmetuar Shu'be, këtij i kumtoi Adullah b. Dinar: E kam dëgjuar, Abdullah b. Umerin r.a. duke thënë: **Pejgamberi i All-llahut e ka ndaluar shitjen ise dhurimin e robit të liruar.**

2536. - Na ka treguar Osman b. Ebi Shejbe, këtij Xheriri, që transmeton nga Mensuri, ky nga Ibrahim, ky nga Esvedi se Aisheja r.a. ka thënë:

- E pata blerë Beriren, porse pronari i saj vuri si kusht që ai të kujdeset për të. **Ia paraqita këtë Pejgamberit a.s. dhe ai tha: “Liroje, kurse kujdesi i takon atij që jep paratë për të.”**

Mandej unë e lirova. E thirri Pejgamberi a.s. dhe i la në dipsozicion të zgjedhë, të jetojë me burrin e saj (rob) e ajo tha: Sikur të më paguante kaq e kaq, nuk do të rrija te ai, dhe kështu zgjodhi pavarësinë.

## **NËSE ZIHET ROB VELLAI OSE AXHA, A DO TË KOMPENZOHE (LIROHET) NË SE AI ËSHTË POLITESIT**

Enesi ka deklaruar: Abbasi i ka thënë Pejgamberit a.s.: “E **kam kompenzuar, blerë, veten por e kam blerë edhe Akilin**”, kurse kjo ishte pjesa e Aliut në plaçkën e luftës që i takonte nga vëllai i tij Akili dhe axha i tij Abbasi.

2537. - Na ka treguar Ismail b. Abdullah, këtij Ismail b. Ibrahim b. Ukbe që i transmeton nga Musa, kurse ky nga Shihabi i cili tha:

Më ka rrëfyer Eenesi r.a. se disa E'nsarij kërkuan nga Pejgamberi i All-llahut leje dhe thanë: **“Iejova që djalit të motrës tonë, Abbasit t'ia lëmë kampenzimin e vet.”**

---

---

- **Mos i lini asnjë derhem** - u përgjigj ai. (Krahaso: 3048, 4018).

### **LIRIMI I POLITEISTIT**

2538. - Na ka treguar Ubejd b. Ismail, këtij Ebu Usame, i cili transmeton nga Hishami:

Më ka kumtuar babai im se Hakim b. Hizami r.a. në kokën e xhahilijetit, ka liruar njëqind robër dhe u dhuroi njëqind deve për kalërim, por kur pranoi fenë Islame, i flijoj njëqind deve dhe liroi njëqind robër dhe tha: E kam pyetur Pejgamberin e All-llahut: O Pejgamber i Zotit, çka mendon për punët që kam bërë në periudhën xhahilije, dije që i kam bërë nga devotshmëria?

Hishami konsideron: “... **i kam bërë nga bëmirsia**”.

- **Atëherë** - thotë Hishami - **Pejgamberi a.s. ka thënë:**

- **Ke pranuar fenë Islame dhe për çdo të mirë nga e kaluara do të kesh dobi.**

### **AI QË KISHTE ROB NGA ARABËT, DHE E LIROI, E SHITI, MBAJTI MARRËDHËNIE MARTESORE OSE E KA LIRUAR, POR EDHE PASARDHËSIT I KA ROBËRUAR**

All-llahu xh.sh. thotë: “*All-llahu u sjell si shembull robin në posedim, të huajin i cili nuk ka asgjë dhe atë, të cilin Ne e kemi furnizuar mirë dhe që jep nga ajo fsheburazi dhe haptazi, - a janë ata të barabartë? Lavdërnar qoftë All-llahul, por shumica sish nuk dinë*”. Kur'an, Nabl: 75).

2539, 2540. - Na ka treguar Ibn Ebi Merjem që thotë se i ka transmetuar Lejthi nga Ukajli se Ibn Shibabi ka thënë:

Urve përkujton se e kanë informuar Mervani dhe Misver b. Mahreme që kur i erdhi Pejgamberit a.s. delegacioni i fisit Havazin dhe kërkuan prej tij t'u kthëjë pasuritë dhe robërit e tyre, ai u ngrit në këmbë e tha:

**Te unë është kjo që e shihni, kurse unë më së shumti e**

---

---

---

**dua fjalimin e singertë, që është më i singerti, prandaj zgjidhni njerën prej këtyre dyjave: pasurinë ose robërit, e unë këtu jam (po ju pres).**

Pejgamberi a.s. i priti dhjetë e më tepër netë, deri sa u kthye nga Taifi dhe kur e panë se Pejgamberi s.a.v.s. nuk do t'ua kthejë, përveç njërës prej të dyjave, i thanë: **“Po zgjedhim robërit tonë”**. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. u ngrit në mes të njerëzve, shprehi falënderim-lavdërimin All-llahut, ashtu si i ka hije dhe tha **“Tash u erdhën vëllezërit tuaj të penduar (pranuan fenë Islame), dhe kam vendosur t'ua kthej robërit e vet. Kush dëshiron këtë ta bëjë vullnetarisht, le ta bëjë, por kush do të mbetet në mendimin e vet të parë, derisa ne t'ia paguajmë nga fitimi jonë i parë nga lufta që do të na dhurojë All-llahu, le të mbetet. Atëhere e pranuan duke thënë: “Këtë do ta bëjmë menjëherë vullnetarisht”**.

**Ne nuk e dimë - ka thenë Pejgamberi a.s. - kush e ka lejuar nga ana juaj, e kush nuk e ka lejuar, prandaj kthehuni, le të na sjellin këtë vendim tuajin paria juaja.**

Mandej u kthyen të pranishmit dhe biseduan me parinë dhe pastaj erdhën te Pejgamberi a.s. dhe e informuan se këte e kanë bërë vullnetarisht edhe ata, dhe e kanë lejuar.

Ja, kjo është e tëra që na është transmetuar për robërit e Hevazinit.

Enesi ka deklaruar:

Abbasi i ka thënë Pejgamberit a.s. **“E kam paguar veten dhe Akilin”**.

2541. - Na ka treguar Ali b. Hasan se i ka transmetuar Abdullahu, këtij Ibn Avni i ka thënë:

I kam shkruar Nafiut dhe ai m'u përgjigj se Pejgamberi a.s. sulmoi Benu Mustalikët kur ata nuk e pritnin, befasisht, derisa u jepnin ujë kafshëve të tyre. Ai që kundërshtoi u vra, kurse familja iu zu rob. Në atë rast është robëruar edhe Xhujejrija. Këtë ma ka kumtuar Abdullah b. Umer i cili ka marrë pjesë në atë betejë.

2542. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se i ka transmetuar Maliku nga Rebi' b. Ebi Abdurrahman, ky nga Muhammed b. Jahja b. Habban , kurse ky nga Ibn Muhajriz si vijon: E pashë Ebu Seidin r.a. dhe e pyeta për këtë rast (të lartpërmendur) dhe ai më tha:

Dolëm me Pejgamberin a.s. në luftë kundër Esit Benu Mustalik, dhe nga arabët fituam plaçkë, gra që na rrëmbyen zemrat, por na ndrydhte vetmia dhe ne më shumë dëshironim të përmbahemi nga ai rrëmbim (lakmi ndaj tyre).

E pyetëm Pejgamberin a.s. lidhur me këtë, **për çka ai u përgjigj: Nuk ka gjë edhe nëse nuk mund ta bëni këtë, sepse nuk ka qenie që ekziston deri në ditën e Kijametit, që nuk është krijesë e tillë.**

2543. - Na ka treguar Zuhejr b. Harb se i ka transmetuar Xheriri nga Umara b. Ka'aka'a, ky nga Ebu Zur'a, ndërsa ai nga Ebu Hurejre r.a.

Gjithmë e kam dashur fisin Benu Temin.

Edhe Ibn Selami më ka thënë se i transmetoi Xherir b. Abdul-Hamidi nga Mugire, ky nga Harithi, ai nga Ebi Zur'a, se Ebu Hurejre ka thënë::

Fisin Bebu Temim kam nis ta dua, simpatizoj prej para tri netësh, kur e dëgjova Pejgamberin e All-llahut duke folur për atë. **Dëgjova se thoshte Këta do të jenë më të ashpër, nga pasardhësit e mi, ndaj Dexhalit.**

Kur arritën sadakat e tyre, Pejgamberi i a.s. - thotë Ebu Hurejre - Ka thënë: **“Këto janë sadaka të popullit tonë”, kurse një robëreshë e tyre ishte te Aisheja dhe ai tha: “Liroje atë sepse është nga bijtë e Ismailit.”** (Krahaso: 4366)

---

---

## SHPËRBLIMI PËR EDUKIM DHE ARSIMIM TË ROBËRESHES

2544. - Na ka treguar Is-hak b. Ibrahim që ka dëgjuar nga Muhammed b. Fudajli, ai nga Mutarrifi, ky nga Sha'biu se kumtoi nga Ebu Burde se Ebu Musa r.a. ka deklaruar: Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **Kush ka robëreshë dhe e mbanë mirë e edukon pastaj e liron dhe bën kurorë, do të ketë dy shpërblime.**

### FJALËT, DEKLARATA E PEJGAMBERIT A.S.

**“Robërit janë vëllezërit tuaj, prandaj ushqeni me çka hani vetë ju”** dhe fjalët e All-llahut: *“Adhuronte All-llahun dhe asnjë send mos e trajtoni të barabartë me Të! Jini të mirë me prindërit dhe të afërmit edhe Bonjakët, edhe të varfërit e mjerë, edhe me fqinjët e afërm, edhe me fqinjët e largët, edhe me shokët për rreth, edhe udhëtarët, edhe ata që janë nën kujdesin tuaj All-llahu, pa dyshim, nuk don ata që janë mëndjemëdhenj dhe arrogantë”*. (Nisa, 36).

2545. - Na ka treguar Adem b. Ebi I'jasi se i ka transmetuar Shu'be të cilit i kumtoi Vasilu-l-Ahded: “E kam dëgjuar Ma'rur b. Suvejdin duke thënë:

E kam parë Ebu Dher al-Gifiarin r.a të veshur me të njëjtin xhelabi si të robit të tij, dhe e pyeta për këtë, e ai tha: “E qortova njërin (një rob) dhe u ankua te Pejgamberi a.s për sjelljen time. **Pejgamberi a.s. i tha: ‘Pse e ke turpëruar te nëna e vet’** Mandej shtoi: **“Vëllezërit (robërit) tuaj janë shërbëtorët tuaj. All-llahu i ka vënë në disponimin tuaj dhe kush ka kësi vëllai nën sundim të vetin, le ta ushqejë me çka han vetë dhe le ta veshë ashtu siç vishet vetë, dhe mos i rëndoni t'i lodhni, po nëse i rëndoni atëherë ndikmonu”**.

---

**ROBI QË I LUTET ALL-LLAHUT SI E MERITON  
DHE ZOTRIUT TË VET SINGERISHT MIRË I  
NENDON**

2546. - Na ka treguar Abdullah b. Mesleme që transmeton nga Maliku, ky nga Nafiu, ai nga Ibn Umeri r a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Nëse robi ia mendon të mirën singerisht zotëriut të vetë dhe i lutet Zotit për mirë, do të ketë dy shpërblime të veçanta. (Krahaso: 2550)**

2547. - Na ka treguar Muhammed b. Kethir se i ka transmetuar Sufjani nga Sa'biu, ky nga Ebu Musa el- Esh'ariu r.a. i cili thotë se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Kushdo që ka robëreshë, tregon kujdes dhe e edukon mirë, pastaj e liron dhe bën kurorë me të, do të ketë dy shpërblime. Por edhe secili rob që i kryen obligimet e veta ndaj All-llahut xh.sh. dhe detyrat ndaj zotëriut të vet, i ka dy shpërblime.**

2548. - Na ka treguar Bishr b. Muhamed se i ka transmetuar Abdullahu, këtij Junusi nga Zuhriu, i cili ka dëgjuar Said b. Musejebin duke thënë se Ebu Hurejreja deklaroi se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Robi i mirë në posedimin e tjetrit ka dy shpërblime. Pasha atë në dorën e të cilit është shprti im, sikur të mos ishte lufta për hir të rrugës së All-llahut, haxhxi dhe bëmiresia ndaj nënës time (mendeshes) do të kisha dëshiruar të vdes në posedim të dikujt.**

2549. - Na ka treguar Is-hak b. Nasr se i ka transmetuar Ebu Usame nga A'ameshi, këtij Ebu Salihu nga Ebu Hurejreja ra sipas të cilit Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**- Sa bukur është kur dikush prej robërve i lutet denjësisht krijuesit të vet All-llahut dhe singerisht i mendon**

---

---

**të mirën zotëriut të vet.**

## **URREJTJA E PROLONGIMIT TË LIRIMIT TË ROBIT DHE FJALËT: “... ROBI IM ROBËRESHA IME...”**

All-llahu i lartmadhërishëm thotë: “... dhe të mirët..<sup>96</sup>” robi në...<sup>97</sup> “... të zotëriut të tij...”<sup>98</sup> “... vashat...”<sup>99</sup>

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:”Ngrihuni në këmbë për zotërinjtë tuaj dhe pastaj citoi ajetin: “... zotëriut të vet...”<sup>100</sup>

2550. - Na ka treguar Museddedi se i ka transmetuar Jahja nga Ubejdullahi që ka deklaruar se i ka kumtuar Nafiut nga Abdullahu r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

Nëse robi i mendon të mirën singerisht zotëriut të vet dhe lutet denjësisht All-llahut, për këtë ka dy shpërblime.

---

<sup>96</sup> “Martoni të pamartuarit prej jush, edhe robërit e shërbëtorët tuaj të mirë, nëse janë të varfër. All-llahu do t’i pasurojë nga mirësia e Tij, sepse All-llahu është i gjithëdijshtëm”. (Nur: 32).

<sup>97</sup> “All-llahu u sjell si shembull robin në posedim, të huajin i cili nuk ka asgjë dhe atë, të cilin Ne e kemi furnizuar mirë dhe që jep nga ajo fshehurazi dhe haptazi, - a janë ata të barabartë? Lavdërnar qoitë All-llabu!, por shumica sish nuk dinë”.(Nabl: 75).

<sup>98</sup> “Dhe ata të dy vrapuan kah dera, prandaj ajo ia grisi këmishën nga shpina - dhe afër derës e hasi burrin e vet: “ciarë dënimi meriton ai i cili dëshiron t’i bëjë keq familjes tënde”, - tha ajo, - “në mos burgosje a dënim të dhembshëm?” (Jusuf: 25).

<sup>99</sup> “E kush nuk ka pasur mundësi të martohet me grua besimtare - ja ku janë ato me të cilat dispononi ju, shërbëtoret tuaja besimtare - e All-llahu e di më mirë besimin tuaj. Ju jeni si njëri-tjetri, Andaj martohuni me ato, me lejen e familjeve të tyre dhe jepnu dhuratat e tyre të kurorës sipas normave për gratë e pastra, jo amorale dhe që çojnë dashuri fshehtazi; Po nëse bëjnë kurvëri e janë të martuara, le të dënohen me gjysmën e dënimin të përcaktuar për gra të lira. Ajo është për atë i cili i frikësohet kurvërisë, por më mirë është për ju të përmbaheni. Ndërkaq All-llahu fal dhe është shumë i mëshirshëm”. (Nisa: 25).

<sup>100</sup> “Dhe atij nga ata të dy, për të cilin mendonte se do të shpëtojë, i tha, lajmëroje zotërin tënd për mua Mirëpo djalli ia mori mendjen dhe ky harroi ta përmend tek zotëriu i vet dhe ai(Jusufi) mbeti në burg disa vjet”. Jusuf. 42).

---

---

2551. - Na ka treguar Muhammed b. A'la se Usameja i transmetoi nga Burejdi, ky nga Ebu Burda, kurse ai nga Ebu Musa r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Individi në posedim të tjetrit i cili i lutet All-llahut në mënyrë të denjë, ia jap zotëriut të vet obligimin, është i dëgjueshëm dhe i sinqertë, do të ketë dy shpërblime.**

2552. - Na ka treguar Muhammedi, këtij Abdurezaku të cilit i transmetoi Ma'meri nga Hammam b. Munebbih, i cili ka dëgjuar Ebu Hurejren që përcjell nga Pejgamberi s.a.v.s..

**- Askush prej jush mos të thotë: Ushqeje zotëriun tënd! Jepi abdest zotëriut tënd! Jepi ujë zotëriut tënd!, por le të thotë: Zotëriu im, kujdestari im, dhe askush nga ju mos të thotë: robi im, robëresha ime, por le të thotë: djaloshi im, vasha ime dhe djali im.”**

2553. - Na ka treguar Ebu-n-Nu'man, këtij Xherir b. Hazim i transmetoi nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri r.a. i cili ka thënë Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Ai që e liron hisen e vet te robi, por ka akoma pasuri aq sa arrin vlerën e caktuar realisht, është i liruar tërësisht nga ajo pasuri e vet, në të kundërtën ai ka fituar te ai atë pjesë, hise, që e ka falur.**

2554. - Na ka treguar Museddei se i ka transmetuar Jahja të cilit i kumtoi Ubjedullahu nga Nafiu, ky nga Abdullahu r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Secili prej jush është bari dhe është përgjegjës për kopenë e tij: ai që urdhëron botën, njerëzit, është bari i tyre dhe përgjigjet për ata, secili është bari ndaj shtëpiakëve të vet dhe përgjegjës për ata, gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të vet dhe fëmijëve të tij dhe është përgjegjëse për ata; robi është bari i pasurisë së zotëriut të vet dhe për këtë është përgjegjës. Ta dini se çdonjeri**

---

---

prej jush është bari dhe secili prej jush do të merret në pyetje për tufën e vet.

2555, 2556. - Na ka treguar Malik b. Ismail, këtij Sufjani i transmeton nga Zuhriu, të cilit Ubjedullahu i kumtoi:

E kam dëgjuar Ebu Hurejren r.a. dhe Zejd b. Halidin që transmetojnë nga Pejgamberi s.a.v.s.:

- Nëse robëresha bën amoralitet flakareshja, dhe nëse prapë bën amoralitet flakareshja, po nëse prapë bën amoralitet, prapë dhezja shuplakë. Kurse pas herës së tretë apo të katërt, shite, qoftë edhe për një kërpes.

### **KUR SHËRBËTORI SJELL USHQIM**

2557. - Na ka treguar Haxhxhaxh b. Minhal se i ka transmetuar Shu'be, të cilit i ka kumtuar Muhammed b. Zijad kështu: E dëgjova Ebu Hurejren r.a. kurse ai Pejgamberin s.a.v.s. kur ka thënë:

- Kur dikujt prej jush i sjell ushqim shërbëtori, e ai nuk ulet të hajë me të, le t'i japë nja dy-tri kafshata, gjegjësisht një a dy gërçama, fyta, ngase shërbëtori është kujdesur për punën e tij. (Krahaso: 5460).

### **ROBI ËSHTË ROJE E PASURISË SË ZOTËRIUT TË VET**

2558. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman se i ka transmetuar Shuajbi nga Zuhriu i cili thotë se i kumtoi Salim b. Abdullahu nga Abdullah b. Umeri r.a. se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. kur tha:

**Secili prej jush është bari dhe përgjegjës për tufën e vet: udhëhaqësi është bari dhe përgjegjës për ata që i udhëheq, njeriu është roje e shtëpiarëve të vet dhe është përgjegjës për kopenë e vet, gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit të vet dhe përgjegjëse për tufën e vet; shërbëtori është roje e pasurisë së zotëriut të vet dhe është**

**përgjegjës për tërë çka i janë besuar për t'i ruajtur.”**

Këtë e kam dëgjuar - ka thënë Abdullahu - nga Pejgamberi a.s. Më duket se Pejgamberi a.s. ka thënë edhe këtë: “Njeriu është roje e pasurisë së babait të vet dhe është përgjegjës për të. Secili nga ju është bari dhe roje, dhe secili do të merret në pyetje për atë çka iu ka besuar që ta ruajë.”

**NËSE RRIHENI RUAJENI FYTYRËN  
(SHMANGIUNI TË MËSHUARIT NË FYTYRË)**

2559. - Na ka treguar Muhammed b. Abdullah, këtij Ibn Vehbi që thotë i ka kamtuar Malik b. Enesi, këtij Ibn Fulan nga Seid al-Makburi, ky nga babai i vet, kurse ky nga Ebu Hurejreja r.a. ndërsa ky nga Pejgamberi s.a.v.s.; por sipas senedit të transmetuesve të tjerë ka treguar Abdullah b. Muhammed, këtij Abdurezaku, këtij Ma'meri që transmeton nga Hammami, e ky nga Ebu Hurejre r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

**“Nëse dikush prej jush rrihet me dikë, le t'i shmanget fytyrës”,** (mos sillni fytyrës).

**Kreu 50.**

**ROBI I KONTRAKTUAR, GJYNAHI I ATIJ QE  
QORTON ROBIN E VET, KISTET E KONTRAKTUA  
VJETORE DHE FJALËT E ALL-LLAHUT**

**“Le të përmbahen ata që nuk kanë mundësi të martohen, derisa All-llahu t'i pasurojë me mirësi të vet! Ata të cilët nga ju kërkojnë aktlirimin shkruani atyre me marrëveshje, nëse i dini se janë të mirë. Jepuni nga pasuria që u ka dhënë juve All-llahu. Mos i detyroni shërbëtoret tuaja të bëjnë kurvëri – e ato dëshirojnë të jenë të pastërtanë mënyrë që ta shijoni kënaqësinë e kësaj bote. Nëse dikush i detyron ato, po All-llahu**

**ato do t'i falë, sepse kanë qenë të detyruara, dhe do të**

---

---

**ketë mëshuirë ndaj tyre.” (Nur, 33) <sup>101</sup>**

Revhi ka transmetuar nga Ibn Xhurejxhi:

A'ataut i kam thënë: **“A jam i obliguar, kur e di se robi ka pasuri, t'i lejoj kompenzim, shmangim?”**

Kjo nuk mund të jetë asgjë tjetër përveçse detyrë, u përgjigj ai. Ndërsa Amr b. Dinar tregon: E kam pyetur A'ataun-: **«Këtë e thua nga dikush tjetër?»** Ai u përgjigj, Jo.

Mandej më kumtoi se e ka informuar Musa b. Enes se Sirini e ka pyetur për kompenzim, sepse ky kishte mjaft pasuri dhe Enesi nuk tha gjë, por shkoi te Umeri r.a. kurse ai i tha: **Lejoja kompenzimin”. Ai nuk desh të veprojë ashtu dhe Umeri i ra me kamxhik dhe lexoi: “Shkuajani (kontratën e kompenzimit) nëse e dini se janë të mirë...”** dhe pastaj i mundësoi kompenzimin.

2560. - Lejthi deklaroi: Më ka treguar Jonusi që transmeton nga Ibn Shihabi se Urve i ka deklaruar.

Aisheja r.a. ka thënë se hyri te ajo Berira dhe kërkoi ndihmë materiale për kompenzimin e vet (të shpaguej veten) që arrinte pesë vjet kurse

Aisheja i tha, e asaj i erdhi mirë, **Çka mendon, a thua të shsin poseduesit tu nëse unë ua përgatis dhe ua paguaj njëherësh, ty të fali dhe kujdesi ndaj teje të kalojë te unë?”**

Atëhere Berira shkoi te zotërinjtë e vet dhe u parashtoi këtë por ata i thanë: **“Jo përveç se kujdesi na mbetet neve”**.

Mandej hyra thotë Aisheja, te Pejgamberi i All-llahut dhe ia

---

<sup>101</sup> Kur'an, 24: 33.

Islamizmi e obligon zotëriun e robit që ta lirojë robin kur i ofron kompenzimin e meituar, kurse e ka urdhëruar që këtë ta bëjë pa pagesë për ta liruar nga përgjegjësia para All-llahut xh.sh. nëse me qëllim e ka lenë agjërimin e Ramazanit, namazin, then betimin ose kur bën ndonjë gjynah tjetër të madh. Islamizmi i ka proklamuar parimet e lartpërmendura në një kohë kur popujt tjerë as që mendonin për këtë madje edhe i vrisnin, mbytnin, masovikisht robërit. Kjo është shembull i humanitetit të lartë dhe shembull, mësim, për popujt e qytetëruar të cilët me armët e tyre korrnin robërit sikurse barin në livadhe, ose me armët e rënda i shkelnin sikurse mizat e dheut.

---

---

rrëfeva këtë, kurse Pejgamberi a.s. tha: - Bleje dhe liroje, ndërsa kujdestaria i përket vetëm atij që e liron robin". Pastaj Pejgamberi i All-llahut u ngrit ( në xhami) dhe tha:

**Çka është puna me njerëzit që vënë kushte, çka nuk ka në libër të All-llahut! kush vë kusht që nuk gjëndet në Libër të All-llahut, ai është i pavlefshëm. Kushti i All-llahut është më i vlefshmi dhe më i detyrueshmi.**

### **KUSHTET QË LEJOHEN NE KONTRAKTIMIN E KOMPENZIMIT TË ROBIT**

Edhe lidhur me atë që vuri kusht pa qenë në Libër të Zoitt, sipas transmetimit të Umerit nga Pejgamberi a.s.

2561. - Na ka treguar Kutejbe, këtij i transmetoi Lejthi, Enga Ibn Shihabi, ky nga Urve, se, Aisheja r.a. e ka informuar se kësaj i erdhi Berira dhe lypi nga kjo ndihmë materiale për kompenzim, akoma nuk kishte paguar asgjë dhe Aisheja i tha:

- Kthehu te zotërinjtë e tu dhe nëse ata Janë të mendimit që unë të paguaj kompenzimin për ty dhe për kujdesja ndaj teje të jetë e imja, e paguaj.

Berira këtë ua tha zotërinjve të vet, por ata e refuzuan këtë. Nëse dëshiron të bëjë për shpërblim nga Zoti, për ty, le ta paguaj, porse kujdesin do ta kemi ne ndaj teje.

Aisheja ia tha këtë Pejgarnherit a.s. Kurse Ai i tha:

**- Bleje dhe liroje, sepse kujdesja i përket vetëm atij që e liron robin.**

Më vonë - thotë Urve - Pejgamberi i All-llahut u ngrit (në xhami) dhe tha: **“Çka është me njerëzit që vënë kushte të pagena në libër të All-llahut. Kushdo që vë kushte që nuk janë në libër të All-llahut, nuk i bën dobi, madje nëse e vë edhe njëqind herë. Kushti i All-llahut është më i rëndësishmi dhe më i detyrueshmi.”**

2562. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij i kumtoi Maliku

---

---

se Abdullah b. Umeri ka thënë:

- Aisheja r.a. nëna e besëdrejtëve, dëshironte ta blejë një robëreshë për ta liruar, porse zotërinjtë e asaj i thanë: “Kujdestaria ndaj saj të jetë e jona.” Në këtë rast Pejgamberi a.s. tha: **“Kjo mos të pengojë fare, sepse kujdesja i takon vetëm atij që e liron robin”**.

## **ROBI I KONTRAKTUAR MUND TË KËRKOJË NDIHMË MATERIALE EDHE NGA TË TJERËT**

2563. - Na ka treguar Ubjed b. Ismail, këtij i transmetoi Ebu Usame nga Hishami, ky nga babai i vet, kurse ai nga Aisheja r.a. që thotë:

Berira më erdhi dhe më tha: Unë kam bërë marrëveshje për kompenzim me zotërinjtë e mi për nëntë okë, dhe këtë nga një okë për vjet, prandaj më ndihmo.”

Aisheja iu përgjigj: **“Do ta bëj këtë nëse ata dëshirojnë që unë t’ua jap përnjëherë, të liroj ty dhe kujdesi ndaj teje do të jetë i imi.”**

Berira pastaj shkoi te zotërnijët e vet por ata nuk e lejuan me këto kushte, dhe ajo tha: **“Unë ua sqarova atyre por ata nuk duan ndryshe, këkrojnë që të mbeten kujdestarë të mi”**. Këtë e dëgjoji edhe Pejgamberi a.s., më pveti lidhur me këtë dhe unë e informova Ai tha: **“Merre dhe liroje, kujdestarinë lëja vetës, sepse kujdesi i përket vetëm atij që liron robin”**.

Pastaj - thotë Aisheja - u ngrit Pejgamberi i All-llahut në mes të njerëzve dhe falënderoi All-llahun dhe tha: **çka është puna me njerëzit, vejnë kushte që nuk janë në Libër të All-llahut. Kushtet që nuk janë në Libët të Zotit nuk vlejnë, qofshin edhe njëqind. Normat e All-llahut janë më të vlefshme dhe kushti i All-llahut është më i domosdoshmi. Çka është puna me disa prej jush që thonë: “Hej ti, filan, liroje robin e unë të kuidesem për të.”** Kujdesia, tutoria, i

---

---

**takon atij që e liron robin.**

**SHITJA E ROBIT TË KONTRAKTUAR  
NËSE EDHE AI ËSHTË I KENAQUR**

Aisheja ka thënë: “Ai është rob derisa të ketë borxh, kurse Zejdi b. Thabiti thotë: “... **qoftë edhe një derhem borxh.**”

Ibn Umeri ka deklaruar: “... **Ai është rob, qoftë i gjallë a i vdekur ose edhe nëse bën ndonjë skandal, deri sa të ketë borxh**”.

2564. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij i transmeton Maliku nga Jahja b. Seid, kurse ai nga Amra e bija e Abdurrahmanit, se Berira erdhi te Aisheja r.a., nëna e besëdrejtëve dhe kërkoi ndihmë materiale, e ajo i tha:

- **Do ta bëja këtë, nëse zotërinjtë tu pajtohen që t’ua paguaj verën tënde me një kist dhe ti të jesh e lirë. Berira këtë ua paragiti zotërnijve të saj. Ata i thanë:**

- **“Jo, vetëm, nëse ne kujdesemi për ty”.**

Maliku ka deklaruar:

- **Amra, sipas Jahjasë, ka konfirmuar: “Aisheja këtë ia parashtrroi Pejgamberit a.s. e ai tha: Bleje dhe liroje, sepse tutoria, kujdesi i takon atij që e liron robin”.**

**NËSE ROBI I KONTRAKITUAR I THOTË DIKUJ:  
“MË BLEJË DHE MË LIRO”  
DHE KY PËR KËTË SHKAK E BLEN  
(KOMPENZON)**

2565. - Na ka treguar Ebë Nuajm se i ka transmetuar Abdul-Vahid b. Ejmen nga Ebu Ejmeni:

- Hyra te Aisheja r.a. dhe i thashë: Unë jam rob i Utbe b. Ebi Lehebit, ai ka vdekur. Më kanë trashëguar djemtë e tij dhe më kanë shitur te Ibn Ebi Amri dhe Ibn Amri më ka liruar, kurse djemtë e Benu Utbes kanë vënë kusht për t’u kujdesur për mua.

Aisheja, atëherë, tha: Hyri te unë Berira, kjo ishte robëreshë

---

---

e kontraktuar për kompenzim, dhe më tha: **“Më blejë dhe më liro”**.

- **Mirë** - tha Aisheja.

**Por ata nuk më shesin pa e kushtëzuar kujdesin e tyre për mua, tha Berira. Për këtë nuk kam nevojë - u përgjigj Aisheja.**

E dogjoi këtë Pejgamberi a.s. apo ia transmetuan, dhe lypsi nga Aisheja e ajo ia paraqiti rastin si i kishte thënë Berira. Ai i tha: **Bleje dhe liroje, e ata lëri të vejnë kushte sa të duan”**.

Atëherë Aisheja e bleu dhe e liroi Beriren, kurse zotërinjtë e saj e kushtëzuan kujdesjen, tutorinë, për çka **Pejgamberi a.s. tha:**

- **Kujdesja i takon atij që e liron robin, e ata mund të vejnë kushte njëqind herë.**

## **Kreu 51**

### **DHURATA, RËNDËSIA DHE NXITJA PËR TË DHËNË DHURATA**

2566. - Na ka treguar Asim b. Aliu se i ka transmetuar Ibn Ebi Dhi'bi nga Makburi, i cili ka dëgjuar nga babai i vet, ky nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**Oj gra muslimane, asnjëra mos ta nënçmojë fqinjën e saj (për skamje) sikur ajo të jetë vetëm me një thundër të deles. (Krahaso: 6017).**

2567. - Na ka treguar Abdu-l-Aziz b Abdullah al-Uvejsi, këtij i tregoi Ibn Ebi Hazim që transmeton nga babai i vet, ky nga Jezid b. Ruman, ndërsa ai nga Urveja se Aisheja r.a. ka thënë:

- O djali i motrës, nipi im, ne kemi shikuar hënën e re, tri herë me radhë brenda dy muajve, dhe në shtëpinë e Pejgamberit të All-llahut nuk është ndezur zjarri.

**Oj tezja ime, - i thashë: “Me çka ju ushqente juve?”**

Me dy kokrra hurme të zeza dhe me ujë, u përgjigj ajo.

---

---

Pejgamberi i All-llahut kishte fqinj ensarë (të Medinës) që kishin deve dhe i dhuronin Pejgamberit të All-llahut ngapak tambël e me këtë na ushqente.<sup>102</sup>

### **DHURATA E VOGËL**

2568. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij i transmetoi Ibn Ebi Adij nga Shu'be, ky nga Sulejmani, ndërsa ai nga Ebu Hazimi se Ebu Hurejreja r.a. transmeton nga **Pejgamberi a.s. që ka thënë:**

**Sikur të më thërrasin në gosti me shpatull ose me një koc këmbe, unë do të përgjigjesha, por edhe nëse më dhurohet një shpatull ose një asht, koc këmbe, do të kisha pranuar.**<sup>103</sup> (Krahaso: 5178).

### **AI QË KËRKON DHURATË NGA SHOKËT E VET**

Ebu Seidi ka deklaruar:

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ma caktoni një pjesë edhe mua bashkë me ju.”

2569. - Na ka treguar Ibn Ebi Merjem se i ka transmetuar Ebu Gassan:

- Më ka thënë Ebu Hazimi i cili transmetonte nga Sehli r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. i çoi flalë një gruajë muhaxhire e cila kishte një djalosh zdrughtar e i tha: **“Urdhëroje djaloshin tënd të na ndreq, punojë, disa parmakë të drunjte për minder”**. Ajo i

---

<sup>102</sup> Hazreti Aisheja e pa hënën e re në fillim të një muaji, edhe në fillim të muajit të dytë e pa hënën e re, edhe në fillim të tretit e pa hënën e re, kështu që ajo për dy muaj, gjegjësisht për 60 ditë ka parë tri herë hënën e re, e në këtë periudhë në shtëpinë e Pejgamberit a.s. nuk është ndezë zjarr ngase nuk kishte se çka të ziej, të përgatisë për ushqim asgjë.

<sup>103</sup> Dhurata i afron njerëzit dhe i forcon miqësitë ndërmjet tyre, prej armikut mund të bëjë mik, prandaj duhet me e pranuar me mirënjohje, madje edhe në qoftë e vlefshme sa një lajthi.

---

urdhëroi. Ai shkoi, preu plepin dbe e bëri minderin. Pasi e kreu punën, kjo iu paraqit Pejgamberit a.s. se ai e ka kryer këtë. Pejgamberi a.s. tha. **“Dërgoma këtëj”**. Ata e sollën dhe Pejgamberi i All-llahut e mori dhe e vendosi, ja, si e shihni.

2570. - Na ka treguar Abdu-l-Aziz b. Abdullah i cili thotë se i ka treguar Muhammed b. Xhaferi nga Hazimi, ky nga Abdullah b. Katade el-Eslemij, kurse ky ka dëgjuar nga babai i vet i cili ka thënë:

Një ditë isha duke ndejtur me disa nga shokët e Pejgamberit s.a.v.s. në një vend në rrugën që shpie për në Mekke, kurse Pejgamberi a.s. ishte ndalur, rrinte përpara nesh, pak më larg. Të tjerët ishin në ihram kurse unë isha pa ihram. E panë një magar të egër. Unë isha i zënë duke ndrequr këpucën time dhe ata nuk më lajmëruan për këtë, dhe më mbeti merak ta shihja edhe unë. Pastaj u ktheva, e pashë atë, shkova te kali im e shalova dhe i hipa, por e harrova kamxhikun dhe shigjetën dhe thirra: **“Ma jepni kamxhikun dhe shigjetën.”**

- **Jo, pasha All-llahun, për këtë nuk të ndihmojmë aspak.**

Unë u hidhërova, zbrita nga kali, i mora dhe prapë i hipa dhe u vërsula drejt magarit, e vrava dhe e solla pa shpirt. Sahabet hanin mishin e tij. Pastaj u ankuan, u erdhi keq, pse e kanë ngrënë duke qenë në ihram. Mandej u nisëm, unë mora kofshën e parë, arritëm te Pejgamberi i All-llahut dhe e pyetëm lidhur me këtë. Ai pyeti:

**A keni hala diçka nga ai?**

- **Po, i thashë dhe ia zgjata kofshën e parë. Ai hëngri derisa e mbaroi. Edhe ai ishte në ihram.**

Hadithin e lartpërmendur ma ka transmetuar edhe Zejd b. Eslem nga Jesari i cili përmes Katades e ka transmetuar nga Pejgamberi a.s.

**TË KËRKUARIT UJË PËR PIJE**

Sehli thotë se Pejgamberi a.s. i ka thënë: **“Më jap ujë të pij emri i tij është Abdullah b. Abdurrahman”**.

2571. - Na ka treguar Halid b. Mahled të cilit Sulejman b. Bilal i ka thënë: Më ka transmetuar Ebu Tuvale emri i tij është Abdullah b. Abdurrahman i cili thotë që ka dëgjuar Enesin r.a. dake thënë: **“Erdhi te ne Pejgamberi i All-llahut, pikërisht në këtë shtëpi, dhe lypi ujë për pije. Ne molëm për të një dele, tamblin e përzieva me ujë të bunarit tonë dhe ia dhashë. Ebu Bekri ishte në anë të majtë të tij, Umeri përpara tij, edhe një beduin tjetër nga ana e djathtë i rrinte. Pasi piu, Umeri tha: **“Këtu është Ebu Bekri”**. Mirëpo, Ai ujin që teproi ia dha bedunit, duke shtuar:**

**- Kanë përparësi ata në anë të djathtë. Kanë përparësi ata nga ana e djathtë. Kujdes, filloni nga e djathta”**.

Enesi ka thënë tri herë: **“Kjo ishte praktikë e Pejgamberit”**.

**PRANIMI I GJAHUT SI DHURATË**

Pejgamberi a.s. ka pranuar nga Katade kafshën e parë të lepurit të zënë në gjah.

2572. - Na ka treguar Sulejman b. Harb të cilit i transmeton Shu'be se Hisham b. Zejd b. Enes b. Malik r.a. ka thënë:

Në Merri Zahran e nxorëm një lepur nga strofulli. Njerëzit vrapuan të gjithë por u lodhën, kurse unë e zura, e kapa dhe e solla te Ebu Talha. Ai e preu dhe kofshët ia dërgoi Pejgamberit të All-llahut.

Në shprehje nuk ka dyshim **“dy kofshët e tij”**, dhe **“ai i pranoi”**.

**Edhe ka ngrënë prej tyre? e pyeta.**

**Ka ngrënë prej tyre - tha dhe shtoi: “i pranoi ato”**.  
(Krahaso: 5489, 5535)

2573. - Ismaili tregon si vijon:

---

- Maliku më ka transmetuar nga Ibn Shihabi, ai nga Ubjedullal b. Utbe b. Mes'ud, kurse ky nga Abdullah b. Abbas, ai nga Sehl b. Xhethameja r.a. se ai i ka dhuruar Pejgamberit të All-llahut magar të egër kur ka qenë në Ebva', gjegjësisht në Veddan dhe ky ia ktheu. Mirëpo pasi vërejti në fytyrën e tij një dëshprim i tha:

**“Ne, me siguri, ta kemi kthyer vetëm për shkak se jemi në ihram.”**

## PRANIMI I DHURATËS

2574. - Më ka treguar Ibrhaim b. Musa se i ka transmetuar Abda, këtij Hishami nga babai i vet se Aisheja r.a. ka thënë që njerëzit kujdeseshin shumë për dhuratat e tyre ndaj Pejgamberit a.s. në kohën kur ai gjendej te ajo, dhe me këtë dëshironin të arrinin kënaqësinë e All-llahut xh.sh. (Krahaso: 2580, 2581, 2770)

2575. - Na ka treguar Ademi i cili thotë se i ka transmetuar Shu'be kurse këtij Xhafer b. Ijas:

- E kam dëgjuar Said b. Xhubejrin duke transmetuar nga Ibn Abbasi r.a. këtë deklaratë: Ummi Hufejde, tezja e Ibn Abbasit, i dhuroi Pejgamberit a.s. djathë të thatë, tlyen dhe një hardhucë. **Peigamberi a.s. e hëngri djathin dhe tlyenin kurse hardhucën e la sepse e konsideroi të keqe.**

Ibn Abbasi thotë: **“Çka ka pasur në tryezë e Pejgamberit a.s. është ngrënë, por nëse ajo që gjandej në tryezë ishte e ndaluar, nuk do të hahej”**.<sup>104</sup> (Krahaso: 5386, 5402, 7258)

---

<sup>104</sup> Lejohet të hash mish bolle. Maliku transmeton se Pejgamberi a.s. i ka therrë Ibn Abbasit dhe Halid b. Velidit në dhomën e Mejmunes që të hanë bollen. Në vrejten e tyre pse nuk han edhe ai, ai u përgjigj: “Momentalisht i kam afer engjujt. Era e mishit të bollës është e pakëndshme, prandaj kam frikë mos po i shqetësoj”. Autori i *El-Hidajes* konsideron se është mekruh ngrënia e bollës, por **ka juristë që e ndalojnë dhe ngulin këmbë që ky rast te Buhariu është evidentuar por ai hadith është dërguar më vonë me hadithin që e sjell Tahaviu në variantin vijues::**

2576. - Na ka treguar Ibrahim b. Mundhir se i ka rrëfyer Ma'ni:

- Ibrahim b. Tahmani më ka rrëfyer përmes Muhammed b. Zijadit se Ebu Hurejre r.a. ka thënë: “Kur i sillnin ushqim Pejgamberit të Allllahut ai pyeste: **“A është dhuratë apo sadaka?”** dhe nëse i thuhej është **“sadaka”**, ai u thoshte shokëve të vet: **“Hani”**, kurse vetë nuk hante. Por nëse i thuhej **“është dhuratë”**, **Alejhisselami** shtrinte dorën dhe hante bashkë me ata.”

2577. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij Gunder ndërsa këtij i ka transmetuar Shu'be nga Katade, kurse ai nga Enes b. Maliku r.a. i cili ka thënë: I sollën Pejgamberit a.s. një copë mish dhe i thanë:

- **Kjo sadaka është për Beriren.**

**Për atë është sadaka kurse për ne është dhuratë - u përgjigj.**

2578. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar se i ka transmetuar Gunderi, këtij Shu'beja nga Abdurrahman b. Kasimi i cili ka thënë:

- Hadithin e kam dëgjuar prej tij (Shu'bes) ai nga Kasimi, kurse ky nga Aishéja r.a. që ka thënë se ka dëshiruar të blejë Beriren, porse zotërinjtë e saj e kushtëzonin me patronat ndaj saj dhe kjo iu bë me dije Pejgamberit a.s. i cili për këtë tha:

- **Bleje dhe liroje. Patronati i përket vetëm atij që e liron.** Asaj (Berires) i kishin dhuruar një copë mishi, dhe Pejgamberi a.s.

---

Sahabët me një rast zunë shumë bolla i futën në një enë (kazan) dhe duke i zier erdhi Muhammedi a.s. dhe pyeti çka po ziejnë ata. Kur i thanë se çka po zjenin ai u pat thënë: “Izrealitëve u është ndaluar, me vonesë, të hanë mishin e **zvarranikëve** rrëshqitësye, dhe kam frikë mos është edhe për ju e ndaluar, prada j më mirë hiqni dorë”.

---

---

---

Çka është kjo?

**Sadakë për Beriren - i thanë.**

**Kjo për atë është sadaka, kurse për ne dhuratë,** tha ai. Berira kishte të drejtë të zgjedhë (të prish apo jo niqabin).

Abdurrahmani ka thënë: **“Burri i saj ka qenë njeri i lirë ose rob”**.

Shu'be thotë: E kam pyetur Abdurrahmanin për burrin e saj dhe më tha:

**- Nuk e di a ishte njeri i lirë apo rob.”**

2579. - Na ka treguar Muhammed b. Mukatil Ebi Hasan, të cilin e informoi Halid b. Abdullah i cili transmeton nga Halid el-Hadha, ai nga Hafsa, bija e Sirinit, e ajo nga Ummi Atije që ka thënë: - Pejgamberi a.s. hyri te Aisheja r.a. dhe pyeti:

**- A keni diçka nga ushqimi? - Nuk ka asgjë tjetër përveç pak mish që e ka sjellë Umm: Atija porse asaj ia kanë dhënë për sadakë - u përgjigj kjo. E ka arritur, qëllimin e vet, - tha Muhammedi a.s.**

### **DHURATA PËR SHOKUN DHE PËR PJEKJA MË E THEKSUAR PËR DISA BASHKËSHORTE SE SA PËR DISA TJERA**

2580. - Na ka treguar Sulejman b. Harb se i ka transmetuar Hammad b. Zejbi nga Hishami, ky nga babai i vet, kurse ai nga Aisheja r.a. e cila ka thënë:

**- Njerëzit kujdeseshin për dhuratat e tyre në rendin tim (kur Pejgamberi a.s. ishte te ajo) edhe Ummi Selemeja i ka thënë Pejgamberit a.s. “Shoqet e mia janë tubuar te unë”**. Mirëpo kur ia përmendi këtë ai ktheu shpinën.

2581. - Ismaili rrëfen:

**- Më ka treguar vëllai im i cili transmeton nga Sulejmani, ai nga Hisham b. Urve, ky nga babai i vet, kurse ai nga Aisheja r.a. se bashkëshortet e Pejgamberit a.s. kanë qenë në dy grupe: në**

njërin grup ishin Aisheja, Hafsa, Safija dhe Sevda, kurse në grupin tjetër Ummi Selemja dhe gratë tjera të Pejgamberit a.s.<sup>105</sup>

Muslimanët e dinin simpatinë e Pejgamberit a.s. ndaj Aishes, prandaj nëse dikush prej tyre kishte ndonjë dhuratë për Pejgamberin e mbante deri kur Pejgamberi të shkojë te Aisheja, sipas rendit. Atëherë dhuruesi i dërgonte dhuratën Pejgamberit në dhomën e Aishes, prandaj grupi e Ummi Selemes e bënë këtë bisedë dhe i thanë **Ummi Selemes**;

- Thuaj Pejgamberit a.s. që kur t'ju drejtohet njerëzve t'u **thotë**: Kush dëshiron t'i dhurojë diçka Pejgamberit a.s., le t'ia japë atë dhuratë pavarësisht se te cila bashkëshorte është.

Ummi Seleme ia përcolli çka thanë ato, por ai nuk iu përgjigj asgjë. Ato më vonë e pyetën për këtë dhe ajo u tha:

- **Nuk më është përgjigjur fare.**

- **Thuaj përsëri** - i thanë ato.

- Kjo përsëri i tha, si më përpara, kur shkoi te Aisheja, por prapë nuk i dha përgjigje. Ne e pyetëm për këtë e ajo na tha:

- **Nuk më është përgjigjur fare.**

- **Thuaj vazhdimisht deri kur të të japë ndonjë përgjigje;** i tha në ato. Kur, pastaj, shkoi te Aisheja, Ummi Selemeja i tha, e ai u përgjigj:

- **Mos më shqetëso me Aishen, sepse shpallje nuk më ka ardhur kur kam qenë te ndonjëra, përveçse te Aisheja”.**

E lus All-llahun të më falë që të shqetësova, o Pejgamberi i Zoiit, thotë Ummi Selemja.

Më vonë, dikur, ato thirrën Fatimen, bijën e Pejgamberit a.s. dhe e dërguan te Pejgamberi s.a.v.s. që t,i thotë:

Bashkëshortet tua të bëjnë be në All-llahun për barazi me bijën e Ebu Bekrit. Ajo ia përcolli këtë, dhe ai u përgjigj: “o bija ime a ti nuk do atë çka dua unë?,,

---

<sup>105</sup> Grupin e dytë të bashkëshorteve të Pejgamberit a.s. e përbëjnë: Ummi Selem, Zejnebja, e bija e Xhahshit, Mejmuna, e bija e Harithit, Ummi Habiba—Remal, e bija e Ebu Sufjanit dhe Xhurvejna e bija e Harithit nga fisi Mustalik.

---

---

- **Pa dyshim** - tha ajo. U kthye te ato dhe i informoi, por ato i thanë, kthehu përsëri te ai.

Meqenëse kjo nuk dëgjoi të shkojë përsëri, ato dërguan Zejneben, bijen e Xhahshit. Ajo erdhi dhe u soll ashpër duke i thënë: -"Bashkëshortet tua të përbejnë në All-llahun që të jesh i drejtë, për barazi, me bijen e Ibn Ebi Kuhafes. Pastaj e ngriti zërin, ia zgurdulloi . sytë Aishes e cila ishte ulur dhe i bëruti, çka nuk i tha, kurse Pejgamberi s.a.v.s. shikonte Aishen a do t'i thotë ndonjë fjalë.

Mandej Aisheja, thotë Urve, foli, ia ktheu Zejnebes dhe ajo heshu. i Pejgamberi s.a.v.s. thotë Fatimja - e shikoi Aishen dhe tha se ain është, me të vërtetë e bija e Ebu Bekrit, me të gjitha virtytet.

Buhariu thotë:

Pjesa e fundit e fjalimit është e Fatimes që transmetohet Hisham b. Urve të cilin ai e përciell nga një njëri, e ai nga Zuhnu ndërsa ai nga Muhammed b. Abdurrahman. Ebu Mervani përsëri transmeton nga Hishami, ky nga Urve: **"Njerëzit kuideseshin për dhuratat e tyre kur ishte rendi te Aisheja"**, kurse ky nga Hishami, ai nga një nga mesi i Kurejshitëve dhe nga niëri prej mevalive, e këto nga Zuhriu ndërsa ky nga Muhammed b. Abdurrahman b. Harth b. Hisha\* Aisheja ka thënë:

- **Kam qenë te Pejgamberi s.a.v.s. kur kërkoi Fatimja leje të hyjë te ai.**

## **DHURATA QË NUK REFUZOHET**

2582. - Na ka treguar Ebu Ma'mer, këtij; i transmetoi Abdul-Varith të cilit Azret b. Thabit al-ansari i ka thënë: Më ka treguar Thumame b. Abdullah se Azre ka thënë:

Hyra te Thumame dhe ai më ofroi një morace (not. anethum graveolens) dhe tha:

Enesi r.a. nuk refuzonte parfumin, erërat e mira. Enesi ka thënë dhe ka konsideruar se **Peigamberi s.a.v.s. nuk e ka refuzuar moraçon e dhuruar.,** (Krahaso: 5929).

---

---

---

**AI QE KONSIDERON SE DHURATA I LEJOHET  
EDHE ATIJ QË NUK ËSHTË I PRANISHËM**

2583, 2584. - Na ka treguar Seid b. E.bi Meriem, këti, Lejthi i ka thënë:

- Më ka transmetuar Ukajli që Ibn Shihabi i ka thënë:

- Urve ma ka permendur se kanë informuar Misver b. Mahreme r. a. dhe Mervani se **Pejgamberi s.a.v.s. kur i erdhi delegacioni Hevazin u ngrit ndër burra, lavdëroi dhe falenderoi All-llahun si i ka hije e pastaj tha:**

- **Vëllezënt tuaj na kanë ardhur të penduar dhe unë mendoj se duhet tua kthejmë robënt, pastaj kush dëshiron që këtë të bëjë vullnetarisht, le ta bëjë, por kush dëshiron të mbajë hisen, kërkon pagesë, do t'ia japim nga fitimi i luftës nga fitimi i parë që të na caktojë All- llahu xh. sh.**

Të gjithë pastaj thanë: **“Po ti falim vullnetarishtë”**.

**KOMPENZIMI PËR DHURATË**

2585. - Me ka treguar Museddedi se i ka transmetuar Isa b. Junus nga Hishami, ai nga babai i vet se Aisheja r.a. ka thënë:

- Pejgamberi s.a.v.s. pranonte dhuratë dhe për atë shpërblente. Isa b. Junus nuk e ka përmendur, thotë Buhariu, se hadithin e transmetojnë edhe Vekitu dhe Muhadiri nga Hishami, kurse ky nga babai i vet, ndërsa ai nga Aisheja.

**DHURATA FËMIJËS**

Nuk është e lejuar, nëse prindi ka shumë fëmijë, t,i dhurojë diçka vetëm njërit fëmijë, por duhet të sillet me drejtësi ndërmjet tyre dhe t'u japë niëlloj të gjithëve, për çka nuk ka nevojë për dëshmitarë.

**Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Në dhurata të jeni të drejtë ndaj fëmijëve tuaj”.**

A mundet që prindi të kthejë dhuratën dhe a mund të hajë nga pasuria e fëmijës së vet, çka është e zakonshme, por të mos e teprojë këtë?

---

Pejgamberi s.a.v.s. bleu nga Umeri deve dhe menicherë ia dhuroi Ibn Umerit duke thënë: **“Bën çka të duash me këtë.”**<sup>106</sup>

2586. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf të cilit i ka transmetuar Maliku nga Ihn Shihabi, ai nga Humejd b. Abdurahman dhe Muhamed b. Nu' amn b. Beshir, se këta dy i kanë transmetuar nga Nu' man b. Beshir se babai i ii; e solli te **Pejgamben s.a.v.s. dhe i tha: Këtij djalit tim i kam dhuruar një rob. A u ke dhuruar edhe fëmijëve tjerë njëllojë,** e pyeu Muhammedi a.s.

-**Jo-** u pergjigj.

- **Atëherë ktheje për vete i tha Muhammedi a.s.** (Krahaso: 2587, 2650).

Juristët e shkollës hanefite konsiderojnë se ai që jep dhuratë nuk mund ta kthejë dhuratën që i ka dhënë ndonjorit nga anëtarët e afërt të familjes sipas gjakut, si për shembull djalit, vllaut, motrës,

---

<sup>106</sup>Imam Ahmedi thotë:

“Ai që i dhuron diçka ndonjërit prej fëmijëve të vet, do t’i urdhërohet që ta kthejë. Nëse pranuesi i dhuratës vdes para se t’ia kthejë dhuratën, dhurata është në pronësi të auj që jep dhuratën, nëse është personi juridik i aftë.’. Ky qëndrim mbështetet në deklaratën e Nu’ man b. Beshirit, të cilën Tahaviu e përcjellë në këtë variantë:

- Im atë më dhuroi një rob, kurse nëna ime i tha që të më shpinte te Pejgamberi a.s. që ai të dëshmojë dhe ai e pyeti: “A u ke dhënë edhe fëmijëve të tjerë kso dhuratash?”

- Jo, u përgjigj ky.

- Anuloje, ktheje prapë këtë dhuratë, i tha Muhamrnedi a.s.

Buhariu të njëjtin rast e ka evidentuar në pika më të shkurta. Mirëpo Thevriu, Lejtlii b. Sa’ di, Kasim b. Abdurrahmani, Muhammed b. Munkedir. Ebu Hanife, Ellu Jusuf, Muhamrned, Shafiu, e sipas një versioni edhe Imam Ahrnedi lejojnë të dhorohej njërit fëmi e tjetrit jo. Në rast se njëri nga fëmijët i ushqen prindërit nga të ardhurat e veta me shpenzime të veta, mund të bëhet **nië llogari për ato shpeuzime dhe** ajo shumë t’i kompenzohet, qoftë me pasuri të tundshem ose të patundshme është një zgjidhje me kompromis në kundërshtim me juristët e përmendur’

---

mixhës, hallës, babait.

Prindërit e kanë të lejuar të ushqehen nga pasuria e fëmijëve të tyre por me masë (mos teprojnë).

Hakimi transmeton hadithin: “Ushqimi më i mirë është ai që fitohet me punë individuale. Fëmiu është fitim i prindit dhe hani nga pasuria e fëmijëve të tu”.

Ebu Hanifeja e lejon që prindi i varfër të shesë pasuri të tundshme të djalit të vet që nuk është i pranishëm për të siguruar ushqim për vete, kurse libu Jusufi dhe Muhammedi nuk e lejojnë këtë veprim.

Umeri kishte menduar që deven e përmendur t’ia dhurojë djalit, Abdullahut. Për të mos i prekur ndienjet e fëmijëve të tjerë Muhammedi a.s. këtë deve e bleu nga Umeri dhe menjëherë ia dhuroi Abdullahut, të birit të Umerit. Me këtë janë zgjidhur dy probleme, janë plotësuar dëshirat e të dyja palëve.

### **TË DËSHMUARIT NË DHURATË**

2587. - Na ka treguar Harnid b. Umer se i ka transmetuar Ebu Avane nga Husajni, ai nga Amiri i cili ka deklaruar:

- Kam dëgjuar Nu'man b. Beshirin r.a. në minber duke thënë: **“Baba im ma dhuroi një dhuratë, kurse Amra, bija e Revahut, tha: Nuk jam e kënaqur derisa kjo të dëshmohet para Pejgamberit të All-llahut,,**

Ai erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe tha:

Unë djalit tim me Amren, bijen e Revahut, i dhashë një dhuratë, e ajo më urdhëroi që ty o Pejgamber i All-llahut të të marr dëshmitar.

**A i ke dhuruar njëloj edhe fëmijëve të tjerë, pyeti Muhammedi a.s.**

Jo, u përgjigji ai.

**Kije frikë All-llahun dhe jini të drejtë ndaj fëmijëve tuaj, i tha Muhammedi a.s.**

Ai pastaj u kthye në shtëpi, thotë, Nu,aman dhe ktheu dhuratën për vete.

---

---

**DHURATA E NDËRSEJII TË BASHKSHORTËVE  
(BURRI GRUAS DHE E KUNDËRTA)**

Ibrabim Nehaiu thotë: “Kjo është e lejuar,, kurse Umer b. Abdul-Aziz shton: “**Ata nuk mund ta tërheqin këtë,,**

Pejgamberi s.a.v.s. kur është sëmure ka kërkuar lejen e bashkëshorteve që rrije në dhomë me Ajishen

**Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Ai që e kthen dhuratën e vet i ngjan qenit që kthehet në marrëzi të vet,,**

Zuhnu ka thënë për atë që i thotë gruas së vet: “**Më dhuro një pjesë të merit ose në tërësi,**”, e pas pak kohe ai e lëshon, kurse ajo e mohon do t’ia kthejë atë asaj - thotë Zuhriu - nëse me këtë e ka mashtruar, kurse në rast se ia ka dhënë me vullnet, ia ka lejuar, nuk ia kthen sepse All-llahu xh.xh. ka thënë: “***Dhe jepuni grave, me gjithë zemër, dhuratat e kurorës, por nëse ato me dëshirën e vet ju dhurojnë diçka nga ato, merrne dhe, e ngrënshi me skëndet.***” Nisa, 4).

2588. - Na ka treguar Ibrahim b. Musa të cilit Hishami i transmetoi nga Ma’meri, ky nga Zuhriu, si vijon:

- Më ka kumtuar Ubjedullah b. Abdullah se Aisheja r.a. ka thënë:

“Kur u sëmure Pejgamben s.a.v.s. dhe iu shtua sëmundja, kërkoj leje nga bashkëshortet tjera të dergjej në dhomen ume. Ato ia lejuan dhe ai njëherë doli (në xhami) dy vetë e mbanin, kurse këmbët i hiqte zvarr për toke. E mbante Abbasi edhe një as-habë tjetër.”

Ubejdullahu më vonë ka thënë:

Unë ia përmenda më vonë këtë Ibn Abhasit tha Aisheja. Ai më pyeti: “**A e di kush ishte ai njeriu të cilin nuk e përmendi Aisheja me emër?**” Jo, i thashë.

- **Ai ishte Aliu, i biri i Ebu Talibit** - tha ai.

2589. - Na ka treguar Muslim b. Ibrahim, këij i transmeton Vuhëjbi nga Ibn Tavusi, ai nga babai i vet se Ibn Abbasi r.a. ka

deklaruar:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:** Ai që e kthen dhuratën e vet (pendohet) i ngjan qenit i cili i kthehet vjellësinës së vet”.

(Krahaso: 2621, 2622, 6975).

**GRUAJA MUND TË JAPË DHURATË PA LEJEN E BURRIT SI EDHE TË LIROJË ROIN, EDHE PSE E KA BURRIN, ME KUSHT QË TË JETË NORMALE (JO E MARRË)**

Nëse është e marrë, nuk i lejohet, sepse All-llahu xh.xh. ka thënë: *“Ndërsa të papjekurve intelektualisht (të marrëve) mos ua jepni pasurinë e tyre, të cilën All-llahu ua ka besuar juve ta drejtoni, por ata t’i furnizoni me ushqim e veshmbathje dhe foluni atyre fjalë të mira”*. (Nisa:S)

2590. - Na ka treguar Ebu Asim i cili transmeton nga Ibn Xhurejxhi, ai nga Ibn Ebi Mulejke, ky nga Abbad b. Abdullahu se Esmar.a. ka thënë:

- o Pejgamberi i All-llahut, i thashë: **“Unë kam pasunnë që ma ka dhënë Zubejri, vetëm këtë kam, prandaj a mund të jap si sadakë?”**

- **Jep, ndaj sadakë, më tha, dhe mos e fut në torbe, sepse edhe ti ashtu do të futesh.**

2591. - Na ka treguar Ubjedullah. b Said se i ka treguar Abdullah b. Numejr, këtij Hisham b. Urve nga Fatimja kurse ajo ka dëgjuar nga Esmar.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- **Ndaj sadaka dhe mos e numëro, se edhe All-llah ta numëron; mos e mbyll në torbë (kuletën) sepse edhe ty All-llahu ty ta bën ashtu (të kufizon).**

2592. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr që transmeton nga Lejthi, ai nga Jszidi, ky nga Kurejbe, rob i liruar i Ibn Abbasit, të cilin e ka informuar Mejmuna, bija e Harithit r.a., se si e ka liruar robëreshën pa kërkuar leje nga Pejgamberi a.s. dhe kur

---

Muhammedi a.s. sipas radhës erdhi te kjo, kjo i tha:

**:- A e di o Pejgamberi i All-llahut se unë e kam liruar robëreshën.**

**- A e ke bërë me siguri këtë, e pyet**

- Po, i tha kjo.

**Po t'ua kishe falur dejave tu, me siguri, do të kishe pasur me shumë sevape, shpërblim më të madh** - i tha ai.

Bekr b. Mudar thotë, sipas Amrit, Bukejrit dhe Kurejnit, se Meim na e ka lituar këtë. (Krahaso: 2594).

2593. - Na ka treguar Hibban b. Musa se i ka transmetuar Abdullahu, këtij Junusi nga Zuhriu, ndërsa ai nga Urve dhe ky nga Aisheja r.a. e cila ka deklaruar.:

- Kur dëshironte të marrë rrugë Pejgamberi a.s. u hidhte short bashkëshorteve dhe kuit i binte shorit (i dilte emri me shigjetë) ai shkante me atë. Ai secilës nga bashkëshortet i ndante rendin ditën dhe natën, përveç Sevdës, bijës së Zematit, e cila rendin e vet ia linte Aishes -bashkëshortes së Pejgamberit s.a.v.s., duke dëshiruar me këtë ta përfitojë kënaqësinë e të Dërguarit të All-llahut. (Krahaso: 2637, 2661, 2688, 2879, 4025, 4141, 4690, 4749, 4750, 4757, 5212, 6662).

## **PREJ KU FILLON ME DHURATË**

**2594.** - Bekri i cili transmeton nga Amri kurse ky nga Kurejbi, ka thënë se Mejmuna - bashkëshorte e Pejgamberit - e ka liruar robëreshën e vet-kurse ai i tha: "Po t,ia kishe dhuruar ndonjërit nga dajët tu, do të kishe shpërblim më të madh.

2595. - Më ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij i transmeton Muhammed b. Xhafer, këtij Shu,beja nga Ebu El-Xhevnije, ai nga Talha b. Abdullahu, një burrë nga Beni Tetrum b. Murre, i cili thotë se Aisheja r.a. tha:

**- O Pejgamber i All-llahut unë i kam dy robëresha (shërbëtore) kujt t,ia dhurojë? A tyre me të cilët e ke derën**

---

**më afër - i tha ai.**

**KUSH NUK DËSHIRON TË PRANOJË  
DHURTATËN PËR NDONJË ARSYE**

Umer b. Abdu-l-Aziz ka thënë: “Dhurata në kohën e Pejgamberit a.s. ka qenë me të vërtetë dhuratë, kurse sot është ryshfet.<sup>107</sup>

2596. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman i cili transmeton nga Shuajbi, ai nga Zuhriu se ka thënë:

- Më ka transmetuar Ubejdullah b. Abdullah b. Uthe se e ka informuar Abdullahu b. Ahbasi r.a. që e ka dëgjuar Sa'ab Hathami El-Lejthin e ky është njeri nga shokët e Pejgamberit a.s. s' i ka dhuruar Pejgamberit a.s. një magar të eger kur ishte në Ebva. gjegjësisht në Veddan në ihram dhe ky ia ktheu' nuk e pranoi.

Pasi që e hetoi në fytyrën time - thotë Sha,abi - se nuk më erdhi krurë që ma ktheu dhuraten, tha: “**Ta kam kthyer vetëm per shkak se jemi në ihram,**”

2597. - Na ka treguar Abdullah b.Muhammed i cili transmeton nga Sufjani ky nga Zuhrii ky nga Unre b. Zuberi: se Ebu Humejd as-Saidi r.a. ka thënë:

- Pejgamberi s a.v. s. caktoi si nepunes për mbledhjen e zekatit një nga fisi Azd i cili quhej Ibun-l-Utbijje, dhe kur u kthyen i tha: “**kjo është e jueja e kjo me eshte dhuruar mua.**”

- Pse jo, tha Muhammedi a.s. U vendos, në shtëpinë e babës

---

<sup>107</sup> Halifi Umer b. Abdu-l-Aziz dëshironte një mollë, por nuk kishte me çka ta blejë! Dikur u nis rrugës me Ferrat b. Muslimin në shoqëri, dhe hasën në disa fëmijë me një koshe (kofin) me mollë. Halifi, me pëlqim] të fëmijëve e mori një mollë, i mori erë dhe e la prap në shportë. Ferrati i tha se ajo mollë është dhuruar që e kanë pas pranuar edhe Pejgamberi, halifi Ebu Beker dhe Umeri, kurse ky iu përgjigj: “Nuk e dua. Për ata dhurata njëmend ka qenë dhuratë, hedije, porse udhëheqësit e mëvonshëm këtë e kanë rushvet (korrupsion).

---

---

dhe të nenes së vet dhe shikoje a do. ti dhurohet ndonjë send apo jo... Pasha atë në duart e te cilit është jeta ime, kush merr diçka nga zekati, në ditën e Kijametit do ta sjellë në; qafe të vet, varuar për qafe. Nëse është deve do të murmuris, nëse është lopë do të pëllet e nëse është dele do të blegëroje. Pastaj ngriti doren e vet ashtu që i shihej sqetulla e bardhe dhe thirri tri herë tha: **O Zot a e kumtova drejt?"**

### **NËSE DIKUSH DHURON OSE VETEM E PREMTON DHURATEN DHE VDES PRA SE TA REALIZOJE ATE PREMTIM**

Ubejdi ka thënë: **“Nëse dhuruesi ka vdekur dhe durata është pranuar dhe pranuesi i dhuratës është gjallë, durata i takon trashëgimtarëve të pranuesit të dhurates, por nëse nuk është dorezuar u mbetet trashëgimtarëve të atij që ka premtuar dhuraten.”**

Hasan Basriu thotë: **“Nga ata dy, cili do që të vdele, durata i takon trashëgimtarëve të dhuratëmaresit, qofte te kete pranuar ndermjetesi.**

2598. - Na ka treguar Ali b. ALduLI-llah që i ka transmetuar Sufjan këij Ibn Munkediri i cili thotë:

- E kam degjuar Xhabirin r.a. kur ka thënë: **më ka thënë Pejgamberi a.s.: “Nëse më vjen diçka (pasuri) nga Bahreini, do të isha dhënë kaq e kaq (një grusht derhem) duke treguar me shenjë tri herë. Pejgamben a.s. ndërroi jete e ajo pasuri nuk arriti, prandaj Ebu Bekri nisi lajmëtarin të shpallë. “Kush ka pasur te Pejgamberi a.s. ndonjë premtim ose ndonjë borxh le të vijë te na,,.**

Unë shkova dhe i thashë:

Pejgamberi i All-llahut më ka premtuar (këtë e këtë), dhe Ebu Bekri më mbushi tre grushta derhem.<sup>108</sup>

---

<sup>108</sup> Ata që erdhën pas Pejgamberit, pra pas Ebu Bekrit, nuk e kanë pasë detyrë të domosdoshme ta plotësojnë atë premtim, por Ebu Bekri këtë e ka bërë nga respekt ndaj Pejgamberit a.s.

---

---

---

---

**MENRYRA E PRANIM-DOREZIMIT TE TESHAVE E  
GJESENDEVE TJERA**

Ibn Umeri ka thënë:

- Isha në një deve te ngathet qe e bleu Pejgamberi a.s. dhe mandaj tha: **O Abdullah, kjo eshte e jotja.**

2599. - Na ka treguar Kutejbe b. Seid, ketij Lejthi i cili transmeton nga Ibn Ebu Mulejke, ai nga Misver b.Mahremi r.a. qe ka thene: Pejgamberi i All-llahut shpërndante mallota (xhylamn) dhe asnje nuk i dha Mehrmijt, prandaj Mahremi tha: “Eja djali im të shkojë deri te Pejgamberi i All-llahut. Unë, thotë Meisveri, thirra dhe ai **doli** kurse kishte vu mbi -supe një nga ato mallota. Ai tha: kete e kemi ndare per ty”, Mahremi – thote Misveri – e shikonet malloten, e Pejgamverit a.s. tha:

- **Mahremi eshte i kenaqur** - thotë Misveri (Krahaso: 2657, 3127, 6132).

**KUR I DHURON DIKUJT DIÇKA E AI  
E PRANON PA THËNË “E PRANOVA”**

2600. - Na ka treguar Muhammed b.Mabub. ketij Abdul-l-vahidi, ketij i transmetoi Ma’meri nga Zuhriu, ai nga Humejd b. Abdfurrahmani, kurse ky nga Ebu Hurejra r.a. i cili ka thënë:

- Erdhi te Pejgameri a.s.nje njerin dhe tha: «**Une mbarova krejt:**

- **Çka ke e pyeti Alejhisselami.**

- **Kam prish agjerimin (ramazinin) me qellim me marrëdhënie seksuale me gruan time,** u pergjigj ky.

- A ke rob, e pyeti Pejgamberi a.s.

Jo, nuk kam, u përgjigj ky:

- A ke mundësi të agjërosh dy muaj pa ndërprerje, e pyet Alejhsselami. Jo u përgjigj ky.

**Po a mund te ushqesh një ditë 60 varfanjakr i tha** Pejgamberi a.s. Jo, tha ky.

Në këtë moment njeri nga Ertsanlie ia solli nje shportë me

---

---

hurma dhe Pejgamberi s.a-v s. i tha: “Meri keto dhe shperndaji sadaka».

- **Me te nevojshënive ne mes tone o Pejgamber i Zotit,** e pyti ky. Pasha ate qe e ka derguar te Verteten, ndermjet ketyre dy maleve nuk ka me nevojtare se ne

- Shko dhe me kete ushqej familjen tende, i tha Muhammedi a.s.<sup>109</sup>

## **KUR DIKUSH IA FAL BORXHIN E VET BORXHLIUT**

Shu,be, duke transmetuar nga Hakemi, ka thënë: “**Kjo është e lejuar,,**

Hasan b. Ali r.a. ia dhuroi borxhin e vet një njeriu. Pejgamberi a.s. tha: “**Ai që ka te ky ndonjë të drejtë të vet, le t,ia japi, ose le të kërkojë ty prej tij që t,ia falë**”.

Xhabiri ka thënë: “Më është vrarë babai, e ai kishte borxh, dhe Pejgamberi a.s. kërkoi nga borxhlinjtë e tij të pranojë frytet e pemëve të mia dhe ta falin, lirojnë babain tim nga borxhi.

2601. - Na ka treguar Abdan se i ka deklaruar Abdullahu:

Na ka informuar Junusi, edhe Leithi e **ka konfirmuar:** “**Junusi** më ka transmetuar nga Ibn Shihabi se ai ka **thënë: Mua më ka kamtuar Ibn Ka,b b. Maliku** se e ka informuar Xhabir b. ALdullahu r.a. se babai i tij është vrarë, ka rënë shehid në Uhud. **Borgjlinje vërshuan me kerkesat e tye dhe unë -** thotë ai - erdha te Pejgamberi a.s.dhe ia tregova gjendjen Ai i luti të pranojnë frytet e pemve të mia dhe ta lirojnë babain tim

---

<sup>109</sup> Dhurata realizohet me aktin e ofrimit dhe te pranimit të paleve, por quhet e kryer me te pranuar te duhrates.

Oferta behet me fjalet qe trgojne se e jep ndonje pasuri falas tjetrit, si per shembull Une ta fala, Une ta dhurava dhe te tjera shprehje. Dhurata mund te kryhet me dorezim pranimin e sendit, dhurates, soe me dergimin e dhurates atij qe ia dhuron.

Per vlefshmerine e dhurates duhet qe sendi i dhuruar te jet e aty ne kohen kur dhurohet. Ne baze te kesaj nuk eshte e vlefshme durata e rushti qe do te piqet dikur ne vjeshte, ose viçi te cilit do ta beje lopa me vone

---

---

nga borgji. Ata nuk e pranuan këtë dhe Pejgamberi a.s. nuk ua dha pemishten time dhe nuk i la ta vjelin frytet por tha.. Po vij nesër në mengjes.

Dhe njemend erdhi te nesërmen, në agim, e vizitoi pemishten dhe luti All-llahan, beri dua, për bereqet më të madh Unë pastaj i vola pemët, ua pagava borxhlinive borxhet e tyre, madje edhe neve na mbeten mjaft fryte. Pastaj erdha te Pejgamberi as. ai ishte ulur rrinte, dhe ia kamtova këtë. Pejgamberi i All-llahut i tha Umerit

**- Dëgjio o Umer!**

- Umeri si ishte duke ndejur i tha “Si ka mundësi të mos behet? **Ne e dimë me siguri se nje Pejgamber i All-llahut’ Pasha All-llun ti, njemend, je Peigamber i All-llahut»**

### **DHURATA E INDIVIDIT PËR GRUPIN**

Esmā i ka thënë Kasim b. Muhamedit dhe Ibn Ebi Atikut:

Kam trashëgira nga motra ime Aisheja një ngastër mali. Muaviu më ka dhënë për atë nieqind mijë dethem, ja po ua jap juve të dyve dhurate.

2620 - Na ka treguar Jahia b. Kazea të cilit i ka transmetuar Maliku nga Ebu Hazimi, ky nga Sehl b. Sa’di r.a. që Pejgamberit a.s. i sollën pije, (tambel). dhe ai e piu. Në anën e djathtë kishte një djalosh e në majtën njerez te moshuar. Ai i tha dialoshit: “**Nëse më lejon, këtë që mbeti, t’ua jap ketyre?”**

- **Për hisen time nuk i jap përparësi askujt përveç teje, o Pejgamberi i All-llahut, i tha djaloshi. Dhe ky ia la në dorë (enën me tambël).**

### **DHURATA E PRANUAR DHE E PAPRANUAR, E SHËNUAR DHE E PASHËNUAR**

Pejgamberi a.s. dhe ashabët e tij i dhuruan fisit Hevazin atë çka e patën fituar prej tyre në luftë, e kjo akoma nuk ishte e ndarë dhe shënuar për luftëtarët.

---

---

2603. - Më ka treguar Thabiti të cilit i ka transmetuar Mis,ari nga Muharibi, ky nga Xhabiri r.a. që ka thënë:

- **I shkova Pejgamberit a.s. në xhami dhe më pagoi (borxhin) madje edhe më tepër se sa ishte lartësia e borxhit real.**

2604. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij Gunder të cilit i transmetoi Shu,beja nga Muharibi:

- E kam dëgjuar Xhabir b. Abdullahun r.a. që thotë: Ia kam shitur Pejgamberit s.a.v.s., deven gjatë një udhëtimi, dhe kur erdhëm në Medine, ai tha: **“Eja në xhami dhe fali dy reقاتë,, Pastaj më pagoi borxhin.**

Shu’beja thotë: Më duket se fjalët e tij: **“Pastaj më pagoi” - do të thonë “dhe ma tejkaloi,,.**

Nga ajo, diçka kam pasur deri kur ma-rrëmbyen disa sinan nga Shami. ditën e Heratiti <sup>110</sup>

2605. - Kutejbe transmeton nga Maliku, kurse ai nga El-u Hazimi, ky nga Sehl b. Sa,adi r.a. se Pejgamberit a.s. i sollën pije, tambël. Në anën e djathtë kishte një djalosh kurse nga ana e majtë njerëz të moshuar dhe ai i tha djaloshit: **“Më lejo që çka mbeti t’ua jap këtyre?”**

**Pasha All-llahun, jo-tha djaloshi. Hisen time nuk ia jap askujt përveç teje.** Prandaj Muhammedi a.s. ia dha pijen në dorë. <sup>111</sup>

2606. - Abdullah b. Uthman b. Xhebel na rrëfen:

- Babai im më ka transmetuar nga Shu’be se Seleme ka

---

<sup>110</sup> Lufta në Herrat, jo larg Medines, është zhvilluar në vitin 63 sipas hixhreit nërmjet luftëtarëve nga Siria - ithtarë të Jezid b. Muaviut dhe banorëve të Medines.

<sup>111</sup> Sendi i dhuruar duhet të jetë patjetër pronë e atij që e dhuron, sendi i caktuar dhe i njohur, i emërtuar. Deklarata e përgjithshuar e dhuruesit, jo precize, nuk është e vlefshme, si për shembull: “Po ta fali njëren nga dy veturat e mia”.

---

---

thënë:

- E kam dëgjuar Ebu Selemen, kurse ai Ebu Hurejren r.a. që ka thënë:

- Njëherë njëri ia kërkoi borxhin, me ashpërsi, Pejgamberi a.s. u tha: **Lëreni atë, ngase ai që ka të drejtë, ka të drejtë edhe të flasë. Blejani një deve njëyeçare dhe jepjani.**"

- **Nuk kemi të asaj moshe** - i thanë sahabet - **por kemi vetëm një më të vjetër se ajo e atij.**

- **Blejeni dhe jepjani** - u tha ai - **sepse më i miri nga mesi juaj është ai që gjykon më së miri.**

### **KUR NJË GRUP I DHURON POPULLIT**

2607, 2608. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr, këtij i transmetoi Lejthi nga Ukajli, ai nga Ibn Shihabi, ky nga Urve se Mervan b. Hakemi dhe Misver b. Mehreme e kanë informuar që Pejgamberi s.a.v.s. me rastin kur i erdhën delegacione të fisit Hevezin, dhe si muslimanë kërkuan prej tij t'ua kthente pasurinë e tyre dhe robërit, u ka thënë:

- Unë kam këtë që e shihni (ushtri), por për mua më e dashur është biseda që është më e sinqerta. Zgjidhne njëren prej këtyre dyjave, : robërit ose pasurinë, unë do t'ju pres një kohë."

Pejgamberi a.s. priti më tepër se dhjetë netë pas kthimit nga Taifj, dhe kur atyre iu mbush mendja se Pejgamberi a.s. nuk ndërron mendie, është i vendosur për njëren prej dyave, thanë:

- **Kemi zgjedhur robërit tanë.**

- Atëherë Muhammedi a.s. u ngrit në mesin e muslimanëve, falënderoi dhe lavdëroi All-llahun si i ka hije dhe tha: **"Këta janë, vërtetë, vëllezërit tuaj. Kanë ardhur të penduar dhe unë konsideroj se duhet t'u kthejmë robërit e tyre. Cili prej jush dëshiron ta bëjë këtë vullnetansht, le ta bëjë, por kush dëshiron të mbajë hisen e vet deri kur t,ia paguajmë, nga fitimi i parë që do të na sjellë Allllahu xh.sh., le të veprojë kështu.,,**

Atcherë njerëzit thanë: "O Pejgamberi i All-llahut, këtë po

---

---

e bëjmë vullnetarisht - i kthejmë robërit. Pastaj Pejgamberi s.a.v.s. tha:

**- Ne nuk e dimë se cili prej jush e lejon këtë, e cili nuk e lejon, prandaj kthehuni që neve të na informojnë për këtë çështje tuajën udhëheqësit tuaj.**

Atëherë njerëzit u kthyen dhe udhëheqësit biseduan me ata. Mandej u kthyen te Pejgamberi a.s. dhe i kumtuan se kjo u pëlqen edhe atyre dhe se e kanë lejuar.

- Kjo është krejt çka dimë për robërit e Hevazinit.

- Kjo e fundit, d.m.th. “Kjo është krejt çka dimë...”, është deklaratë e Zuhriut.

### **TË JAPËSH DHURATË DIKUJT DERISA ËSHTË NË SHOQËRI ME DIKEND**

Ai ka më shumë të drejtë në atë dhuratë, ndërsa Ibn Abbasi transmeton deklaratën ku thuhet se shokët që e shoqërojnë janë bashkëpjesëmarrës, por kjo nuk është e plotëbesueshme, autentike.<sup>112</sup>

2609. - Na ka treguar Ibn Mukaiil që i ka transmetuar Abdullahu, këii; Shu,beja nga Seleme b. KuRejli, ai nga Ebu Seleme kurse ky nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. bleu një deve njëvjeçare dhe i erdhi pronari që t,i paguaj paratë. Sahabët e kritikuan, kurse Muhammedi a.s. u tha:

**- Pronari, ai që ka të drejtë, ka të drejtë të flasë.**

Pastaj e çmoi me vlerë më të lartë se deveja niëvieçare dhe tha: **Më i miri nga ju është ai që gijkon, vlerëson më së miri.”**

---

<sup>112</sup> Dhuratat që sillen në rastin e synetisë ose dasme tjeter i **takojnë** atij që i dedikohen, qoftë fëmijë, nuse, babai apo nëna. Nëse nuk janë të skënnara, se për kënd janë dhe nuk ka mundësi që të konstatohet, atëherë ato dhurata do të mbeten sipas traditës së vendit.

---

---

2610. - Më ka treguar Abdullah b. Muhammed, këij Ibn Ujejne nga Amri, ai nga Ebi Umeri r.a. se ky ka qenë me Pejgamberin a.s. në një rrugëtim dhe kalëroi me një deve të ngathtë të Umerit. Pastaj e tejkaloj Pejgamberin a.s. kurse babai i vet i tha: “Abdullah, Pejgamberin a.s. askush nuk e tejkalon.,’

- Me këre rast Pejgamberi a.s. i ka thënë: **“Shitma - o Umer,,**

- **E jotja qoftë** i tha Umeri.

- Pejgamben pastaj e bleu dhe tha: **“o Abdullah, tash është jotja dhe bën çka të duash me të.”**

### **LEJOHET T,IA DHUROSH DEVEN NJERIUT I CILI ËSHTË DUKE KALËRUAR**

2611. - Humejdi ka thënë: “Na ka informuar Sufjani se i ka thënë Amn përmes Ibn Umerit r.a.: Kemi qenë me Pejgamberin a.s. në një udhëim. Unë isha i hipur në një deve të ngathtë, të ngadalshme të Umerit dhe Pejgamberi a.s. i tha Ument: “Shitma këtë.,,

- Pejgamberi a.s. mandej e bleu dhe tha: **“o Abdullah, tesh është e jotja.,,**

### **DHURATA QË ËSHTË E PAPËLQYESHME TA VESHËSH**

2612. - Na ka treguar Abdullah b. Mesleme i cili transmeton nga Maliku, ky nga Nafiu, ndërsa ai nga b. Umen r.a. që ka thënë:

- Umer b. Hattabi e pa para dyerve të xhamisë një mallotë të mëndafshtë dhe tha: **“o Pejgamberi i All-llahut, sikur ta blesh dhe ta veshësh ditëve të xhumaja dhe kur i pret delogacionet.”**

- **Këtë e vesh vetëm ai që nuk dëshiron të ketë hise në boten tjetër** tha Muhammedi a.s. :

Më vonë erdhën mbulesa, mallota tjera dhe Pejgamberi

---

s.a.v.s. njërën prej tyre ia dha Umerit, e ai i tha: **“Pse po më vesh me këtë kur the atë çka the për malloten Utaride?,, Unë nuk ta veshi këtë ta bajsh ti** - i tha Alejhisselami - dhe Umeri ia dërgoi atë mallotë në Mekke vëllait të vet politeist.

2613. - Na ka treguar Muhammed b. Xhafer Ebu Xhafer se Ibn Fudajli i ka transmetuar nga babai i vet, ky nga Nafiu që Ibn Umeri ka thënë:

- Pejgamberi a.s. erdhi te shtëpia e Fatimes, bijes së vet, por nuk hyri brenda. Kur erdhi Aliu kjo i tregoi për këtë. Ai këtë ia përmendi Pejgamberit a.s. dhe ai, atëherë i tha:

- **Mbi derë të saj e pashë një perde të qendisur, dhe shtoi: “Çka më ka mbetur për këtë botë.,,**

Aliu shkoi dhe i tregoi Fatimes, e ajo tha: **“Le të më urdhërojë si të dojë të veproj me të.,,** Le t’ua dërgojë filan famlijes që kanë nevojë, tha Muhammedi a.s.

2614. - Na ka treguar Haxhxhaxh b. Minhal se i ka transmetuar Shu,be:

- Më ka transmetuar Abdu-l-Melik b. Mejser: “Kam dëgjuar Zejd b. Vebabin, ai ka dëgjuar Aliun r.a. se ka thënë:

- Pejgamberi a.s. më dhuroi një mallotë. Unë e veshja por në fytyrën e tij vëreja një dëshprim, Unë pastaj këtë e preva dhe ua shpërndava grave të familjes sime.,<sup>113</sup> (Krahaso: 5366, 5840).

## **PRANIMI I DHURATËS NGA POLITEISTI**

Ebu Hurejre transmeton nga Pejgamberi a.s.:

- Ibrahim i a.s. ka udhëtuar me Sarën dhe hyri në një

---

<sup>113</sup> Aliu r.a. e preu xhyben e vet në katër rriska dhe ua dhuroi: Fatimes, bashkëshortes së vet, Fatimes, bijës së Esedit, Fatimes, bijës së Hamzës të birit të Muttalibit b. dhe Fatimes, të bijës së Shejbe b. Rebiut - bashkëshortes së Ukajlig vëllaut të Aliut. Kurse sipas një versioni tjetër ia dha Fatimes, bijës së Ebu Talibit e njohur me emrin Ummi Hane (Imihane).

---

vendbanim ku ishte një sundimtar, i njohur për mazor, i cili tha:  
“Jepni kësaj një shërbëtore.”<sup>114</sup>

Pejgambetit a.s. i dhuruan një dele të helmuar.

Ebu Humejdi thotë: “Sundimtari i Ejles i dhuroi Pejgamberit a.s. një mushkë të bardhë, e veshi me cohë dhe i shkroi aiij në formën poeuke me memn bahr në të cilin i shprebu fisnikërinë dhe bujarinë e tyre.

2615. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed, këij Junus b. Muhammed të cilit i ka transmetuar Shejbariu nga Katade, i cili ka deklaruar se Enesi r.a. ka thënë:

2616. - Seidi transmeton nga Katade, ky nga Enesi:  
**“Ukejdin nga Dume dhuratën e përmendur ia dha Pejgamberit.”**<sup>115</sup>

2617. - Na ka treguar Abdullah b. Abdu-l-Vehab dhe Halid b. Harith, këtij Shube nga Hisham b. Zejdi i cili ka dëgjuar nga Enes b. Maliku r.a. se një hebreje i solli Peigambent a.s. dele të helmuar dhe hëngri pak nga ajo.

Më vonë e sollën atë (e arrestuan) dhe thanë: Sigurisht do ta mbysim, **“Jo, u tha Muhammedi a.s. Dhe këtë e kam hetuar vazhdimisht në shakatë, mahitë e Pejgamberit të All-llahut - thotë Enesi.**

2618. - Na ka treguar Ebu Nu,man të cilit i transmetoi

---

<sup>114</sup> Shih më gjerësisht kapitullin “Bleria e robit nga jomuslimani”.

- Pejgamberit a.s. i dhuruan një xhybe nga një lloj mëndafshi, derisa ai u ndalonte mendafshin meshkujve. Njerëzit u çuditën për këtë dhe Pejgamberi tha: **“Pasha Atë në duar e të cilit është shpirti im, faculeta e Sa,d b. Muadhrit në xhennet është më e mirë se kjo xhybe.,** (IKrahaso: 2616, 3248).

<sup>115</sup> Ukajdiri ishte kryetar i Dumetu-l-Xhendelit, qytet jo fort larg nga Tebulcu. Muhammedit a.s. i solli në Medinë si dhuratë një xhalabi të mëndafshtë dhe e pranoi fenë islame.

---

---

Mu'temir b. Sulejman nga babai i vet, ai nga Ebu Uthmani, ky nga Abdurrahman b. Ebi Bekri r.a. i cili ka thënë:

- Ne kemi qenë njëqind e tridhjetë veta me Pejgamberin a.s. Pejgamberi s.a.v.s. pyeti: **“A ka ndokush diçka nga ushqimet për të ngrënë?,”** Njëri kishte një sa, ushqim ose për afërsisht aq dhe këtë e gatoi. Mandej erdhi një njeri me flokë të giata që ruante bagëtinë, kope, dhe Pejgamberi a.s. e pyeti: **“Shitië apo dhuratë?,”** ose i thâ: “...për të falur.,,

Jo, i tha ai, **por për shitje.**

Pastaj Muhammedi a.s. bleu prej tij një dele dhe e theri. Pejgamberi s.a.v.s. urdhëroi që të piqen mushkëritë. Pasha All-lahun, prej njëqind e tridhjetë vetëve asnjë nuk mbeti pa i dhënë një copë mushkëri; kush ishte prezente ia jepte, e kush nuk ishte aty momentalisht ia ruante. Atë çka mbeti e vendosi në dy enë dhe këtë e hëngrën të gjithë së bashku. Ne u ngimë dhe mbeti akoma në kazana dhe atë e ngarkuan në deve “Edhe Abdurrahmani ka transmetuar version të ngjashëm sikur ky.

### **DHURATA POLITEISTËVE**

All-llahu i lartmadhërishtëm thotë: **“All-llahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe me drejtësi ndaj atyre që nuk ju luftojnë për shkak të fesë dhe nuk ju përzënë nga shtëpitë tuaja. Me të vërtetë All-llahu i do të drejtët.,<sup>116</sup>**

2619. - Na ka treguar Halid b. Mahled, këuj Sulejman b. Bilal, të cilit i ka transmetuar Abdullah b. Dinar Ibn Umer r.a. që ka thënë:

- Umeri e pa te një njeri një xhybe që po shitej dhe i tha

---

<sup>116</sup> *Kuran*, 60: 8, dhe në vazhdim thotë:

“Vetëm se All-llahu ju ndalon t’i konsideroni miq ata që luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe u përzënë nga shtëpitë tuaja dhe ndihmonë të jeni të përzënë. Pra ata që i konsiderojnë këta për miq, ata janë kriminel.» (Mumtabana, 8-9)

Pejgamberit s.a.v.s. **“Bleje këtë xhybe që ta veshësh ditëve të xhumaja dhe kur të vjen ndonjë delegacion,,,”** kurse ai iu përgjigj: **“Atë e vesh vetëm ai që nuk dëshiron të ketë hise në botën tjetër.,,”**

Më pastaj Pejgamberit s.a.v.s. i sollën disa xhybe të tilla, dhe ai, njërin ia dërgoi Umerit. Umeri tha: Si ta veshi unë kur i ke thënë atë që ke thënë?

- Unë nuk ta dhurova - i tha ai - që ta veshësh ii, por ta shesësh ose ta dhurosh, t,ia falësh dikujt.

Umeri, dikur, ia dërgoi vëllait të vet që banonte në Mekke derisa ishte akoma pa e pranuar fenë Islame.

2620. - Na. ka treguar Ubejd b. Ismail, këtë Ebu Usame i transmetoi nga Hishami, ky nga baba~ i vet, kurse ai nga Esma - vajza e Ebu Bekrit r.a. e cila ka deklaruar:

- Nëna ime më solli dhurata derisa ishte politeiste në kohën e Pejgamberit a.s. dhe unë për këtë kërkova mendimin e Pejgamberit a.s. duke i sqarnar: Më ka ardhur nëna ime, dëshron të mbajmë lidhje, a bën të kem lidhje me nënën time?,’

- **Po mbaji lidhjet me nënën tënde dhe bëri mirë asaj tha ai.** (Krahaso: 3183, 5978, 5979).

### **ASKUJT NUK I LEJOHET TA TËRHEQË DHURATËN DHE SADAKEN**

2621. - Më ka treguar Muslim b. Ibathim të cilit Hishami dhe Shu’be i kanë thënë: Neve na ka transmetuar Katadeja nga Seid b. Musejjebi, at nga Abbasi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“Ai që kthen prapë, e tërheq sadakon e vet i ngjan atij që i kthehet vjelljes së vet.,,”**

2622. - Më ka treguar Abdurrahman b. Mubarek të cilit i ka transmetuar Abdu-l-Varithi, kë’aj ia përcolli Ejubi nga Ikrimeja kurse ai nga Ibn Abbasi r.a. i cili ka thënë:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Nuk na ka hije vesi,**

---

---

**tradita e**

**tij që tërheq dhuratën që e ka dhënë sikurse qeni që i kthehet të hajë vjellësirën e vet.**<sup>117</sup>

2623. - Na ka treguar Jahja b. Kazea, këtij Maliku me anë të Zejdi b. Esleme, kurse ai nga babai i vet i cili ka thënë:

- E kam dëgjuar Umer b. Hattabin r.a. i cili ka thënë: “E kam dhuruar një kalë në emër të All-llahut, por ai që e mori gati se e bëri për të ngordhur dhe më desha ta blejë prapë prej tijë, duke menduar se do ta shesë me çmim më të ulët dhe për këtë e pyeta Pejgamberin a.s. Ai më tha: **“Mos e blej, madje edhe nëse ta jepë për një dethem, sepse ai që kthehet te sadaka e vet i ngjan qenit i cili kthehet te vjellësina e vet.**<sup>117</sup>

2624.—Më ka treguar Ibrahim b. Musa të cilit i transmeton Hisham b. Jusuf, kurse këta i informoi Ibn Xhurejxhi që thotë:

- Më kumtoi Abdullah b. Ubejdullah b. Ebi Mulejk se djemtë e Suhejbit, rob i liruar i Xhud,anit, ngulnin këmbë për dy dhoma dhe një pjesë tjetër në shtëpinë e Pejgamberit, se Pejgamberi s.a.v.s. ia ka dhënë Suhejbit, prandaj Mervani (komandant i

---

<sup>117</sup> Ai që dhuron duhet të jetë pa tjetër i mençur dhe moshërritur. Sipas kësaj dhurata nuk është e vlefshme nga i mituri, nga i marri, por t,u japish dhuratë këtyre është e vlefshme. Ai që e pranon dhuratën bëhet pronarë i saj kur e pranon në dorë atë.

Ai që jep dhuratë mundet që ta tërheqë dhuratën personalisht para se të kryllet dorëzim-pranimi, kurse pas dorëzimipranimit këtë mund ta bëjë vetëm nëse e bind atë që e ka pranuar dhuratën. Në rastë se dhuruesi e kthen prapë dhuratën me vetinisiativë, pasi që e ka dorëzuar, trajtohet si përvehtësues dhe nëse ai send dëmtohet apo humbas nga duart e t’j, ky është i detyruar që t’ia kompenzojë dhuratëmarrësit.

Nuk mund të merret prapë, dhurata që i jepet **farefisit qoftë për të trashëguarit apo për trashëgimtarët, ose nga vllau e motra, apo femijve të tyre, ose nga vllau apo motra e babes dhe nënës.** Sadaka pas dorëzim-pranimit nuk mund të tërhiqet në asnjë mënyrë. (*Mexhel-le-i ah kam-i ster’ye*).

Medines) pyeti:

- **Kush do t,ua dëshmojë juve këtë?**

- **Ibn Umeri**, thanë ata.

Mervani pastaj e thirri Ibn Umerin dhe ai dëshmoi se me të vërtetë Pejgamberi a.s. i ka dhënë Subejbit dy dhoma dhe një pjesë, prandaj Mervani e zgjodhi, gjykoi, këtë sipas dëshmisë së Ibn Umerit.

**DHURATA NË SHFRYTËZIM TË PËRJETSHËM  
DHE DHURATA NË PËRDORIM TË PËRJETSHËM,  
ME KUSHT QË PASURIA TË JETË PRONË E TË  
GJALLIT**

“E kam marrë në shtëpi përjetë: dhe “ Ajo i është dhuruar përjetë,, do të thotë ia kam dhënë atij. “Ju kam vendosur aty,, do të thote ju kam bere njerez te shtepise.

2625. - Na ka treguar Ebu Nuajm se i ka transmetuar Shejbani nga Jahja, ai nga Ebu Seleme, ky nga Xhabiri r.a. i cili thotë:

- Pejgamberi s.a.v.s. për dhuratën e falur përjetë ka vendosur, që t,i takojë atij që i dhurohet.

2626. - Na ka treguar Hafs Umer, këiti i transmetoi Hemmam të cilit Katade i deklaroi:

- Më ka informuar Nadr b. Enes i cili transmeton nga Beshir b.. Nehik, ky nga Ebu Hurejreja r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

- Dhurata e përshetshme është e lejuar.

- A,tau ka deklaruar: “Të njëjtin ma ka transmetuar mua Xhabiri nga **Pejgamberi s.a.v.s.**<sup>118</sup>

<sup>118</sup> Kjo dhuratë është e kushtëzuar me afat jetësor, që do të thotë kur dhuruesi i thotë pranuesit: “po ta iap këtë shtëpi tmen, ose vereshtë apo tokë, deri sa të jeshë gjallë, dhe pas vdekjes tënde u takon trashëgimtarëve të tuaj, ose farefisit tënd të ahërt. “Me këtë deklaratë të dhuruesit ai që pranon dhuratën bëhet pronarë i sendit të theksuar, e pas atij bëhen trashëgimtarët e tij. Ky

---

---

## MARRJA E KALIT HUA

2627. - Na ka treguar Ademi, këtij Shu,he i transmetoi nga Katade i cili ka thënë:

- E kam dëgjinat Enesin duke thënë: Na kapi friLa, paniku (nga sulmi i armiLut) në Medine dhe Pejgamberi s.a.v.s. mori hua kalin nga Ebu Talha, i cili quhej Mendub, dhe i hipi, por kur u kthye tha:

- **Nuk kemi parë askënd, por me kalin e kemi ndier vetën si të jemi në det.** (Krahaso: 2820, 2857, 2862, 2866, 2867, 2908, 2568, 2969, 3040, 6033, 6212).

### TI JAPËSH HUA NUSES (VAJZËS SË RE) PËR T,U ZBUKURUAR NË DASMË

2628. - Na ka treguar Ebu Nuajm se Abdu-l-Vahid b. Ejmeni ka thënë:

Babai im më ka transmetuar si vijon: Hyra te Aisheja r.a. e ajo kishte një këmishë të pambukut me vlerë prej pesë dërhëmë. Ajo më tha:

“Ngrite kokën dhe shiqoje këtë vajzën time. Asaj i vjen marre ta veshë në shtëpi, kurse unë e kam pasur një kërnishë sikur kjo qysh në kohën e Pejgamberit a.s. dhe nuk mbetej groa që deshironte të zbukurohej ne Medinë pa ma kërkuar ato që t,ia jap hua,,.

### RENDËSIA E DHURATAVE

2629. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr se i ka transmetuar Maliku ngi Ebu Zinadi, ky nga A,rexhi, ai nga Ebu HureJreja r.a. se Pejgamben s.a.v.s. ka thënë:

---

është mendim unanim i juristëve të shkollave tradicionale islame. Por nëse dhuruesi në deklaratën e tij nuk i ka përmendur trashëgimtarët e dhuftatpranuesit, ata sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe Shafiut do të jenë përsëri trashëgimtarë legalë pas vdekjes së dhuratmarrësit.

---

---

- Dhuratë e mirë është deveja, ajo që milet, si shpërblim; delia, malore që shkon në mëngjes në kullosë dhe milet mëngjes e mbrëmje.

Na ka treguar Abdullah b. Jusuf dhe Ismaili që transmetojnë nga Maliku i cili ka thënë:

**“Sa sadakë e mirë është,,!. (Krahaso: 560).**

2630. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Ibn Vehi i transmetoi nga Junusi, ky nga Ibn Shihabi se Enes b. Maliku ka deklaruar:

- Kur erdhën muhaxherët nga Mekka në Medinë nuk kishin kurrgjë në dorë. Populli i Medinës ishte bujqësorë dhe kishin pasuri të patundshme. Medinasit u ndanë e u dhanë pjesë të tokës dhe fryte të pasurisë së vet, që për çdo vjet ata ta punojnë dhe të mbajnë veten. Nëna e Enesit, Ummi Sulejma është edhe nëna e Abdullah b. Ebu Talhes, pra nëna e Enesit i ka dhënë Pejgamberit a.s. frytet e pemëve, kurse Pejgamberi a.s. ia ka dhënë Ummi Ejmenit, robëreshë e tij e liroar, e nënë e Usame b. Uejdit.

Ibn Shihabi thotë: Më ka kumtuar Enes b. Maliku:

Kur e përfundoi Pejgamberi a.s. luftën kundër banorëve të Hajberit dhe u kthye në Medinë, Muhaxhirët ua kthyen ensarëve dhuratat e tyre që këta ua kishin dhuruar nga frytet e tyre. Prandaj edhe Pejgamberi a.s. ia ktheu nënës së Enesit trupat e pemëve e në vend të tyre Ummi Ejmenit Pejgamberi a.s. i ka dhënë një pjesë nga pemishtja, hisja e vet.,,

**Ahmed b. Shihabi thotë: “Kështu na ka kumtuar edhe babai im i cili transmetonte nga Junusi duke shtuar: “... në vend të tyre nga pasuria e vet e pastër.,, (Krahaso: 3128, 4030, 4120).**

2631. - Na ka treguar Museddedi se i ka transmetuar Isa b. Junus, këtij E:vaziu që i transmeton nga Hassan b. A,uje, ai nga Ebu Kebsh Es-seluli i cili ka thënë: Kam degjuar Abdullah b. Amirin r.a. duke thënë, ' Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

---

- Ekzistojnë katërdhjetë veti fisnike, e prej tyre më së shumu kanë të bëjnë me dhurimin e qumshtit të dhisë. Kushdo që ka njëren nga këto veti, duke shpresuar me bindje në premtimin e tij All-llahu do ta fusë në xhennet.

Hasani ka thënë: Edhe ne i kemi numëruar edhe ato veti që nuk kanë të bëjnë me dhuratën prej dhisë, siç janë: kthimi i përshëndetjes, urimi për shëndet kur teshet, të largosh nga rruga por atë që pengon kalimtarët dhe të tjera sikur këto, nuk arritëm t'i bëjmë as pesëmbëdhjetë veti”

2632. - Na ka treguar Muhammed b. Jusuf se i ka treguar Evaziu: A,tau më ka transmetuar nga ihabin r.a. se disa njerëz kishin tokë shumë dhe thanë:

**- Do ta japun me qesim, me të tretë, me të katërt dhe për giysmë. Pejgamberi atcherë ka thënë: “Kush ka tokë le të punojë vetë ose le t’ia falë vëllait të vet. E nëse nuk do kështu, le ta mbajë tokën e vet (për kullosa).**

2633. - Muhammed b. Jusuf thotë se Evaziu i ka transmetuar nga Zuhriu, këtij A’ta b. Jezid se Ebu Seidi ka thënë:

- Pejgamberit a.s. i erdhi një beduin dhe e pyeti për t,u shpërngulur në Medinë. Ai iu përgjigj: **“I mjeri ti, i mjeri ti! Të shpërngulesh është problem. A ke ti deve? Kam tha ai.**

- **A jep zekat për ato?** e pyeti Muhammedi a.s.. Po, u përgjigj ai.

- **A ke dhuruar diçka prej tyre?** E pyeti Muhammedi a.s.. Po, tha ai.

- **A i mjel kur i çon tu japësh ujë** - e pyeti ky.

- Po, u përgjigj Deaulm.

- **Atëherë vazhdo edhe më tej kështu, prapa deteve se All-llahu, me siguri, nuk ka me ta zvogëluar shpërblimin për mundin tënd.**

2634. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij Abdu-l-

---

Vehabi, këtij Ejubi nga Amri se Tavusi ka thënë:

- Për këtë më ka treguar ai që di më së shumti prej tyre, mendonte në Ibn Abbasin r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. doli te një tokë, arë, ku valvitej bereqeti dhe pyeti: E kujt është kjo? Filan fisteku e ka dhënë me qesim - i thanë të pranishmit. Po ta kishte falur, t,ia dhuronte me siguri do të ishte më mirë se sa të marrë prej asaj një shumë të caktuar si shpërblim, për qesim.

### **SHPREHJA “PO TË JAP KETË VAJZË TË SHËRBEJ,, SI TRADITË QË ËSHTË BËRE, LEJOHET**

Disa thonë kjo është turp. Kjo është huazim pa kompnezim kurse dhuratë është nëse thuhet: **“Po ta veshi këtë teshë falas.,,**

2635. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman të cilit i ka kumtuar Shuajbi se ia ka transmetuar Ebuz-Zinadi nga A,rexhi, e ai nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

Ibrahimi udhëtonte me Sarën dhe asaj i falën një shërbëtore. Sara pastaj tha: “E din se All-llahu e ka nënçmuar atë mosbesimtarin, kurse mua më ka dhënë shërbëtore-robëreshë?”

Ibn Sirini transmeton nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “... asaj i ka dhënë për shërbun Haxheren.,,

### **DHURIMI I KALIT TË LUFTËTARIT**

Ai bëhet dhuratë e përjetshme dhe sadaka. Mirëpo diKush thotë: **‘dhuruesi ka të drejtë ta tërheqë.’**

2636. - Na ka treguar Humejdi se i ka thënë Sufjani: Kam degjuar Malikun duke e pyetur Zejd b. Eslemen, i cili iu përgjiigi:

- E kam degjuar babain tim duke thënë se Umeri r.a. ka thënë: E kam falur një kal për hir të All-llahut. Më vonë e kam parë se po shitet, dhe e pyeta Pejgamberin a.s. që ta blejë, e ai më tha:

“Mos e blej dhe mos u kthe më te sadaka jote.,,

---

---

## DËSHMIA I TAKON PROKURORIT—PADTTËSIT

Në bazë të shpalljes së All-llahut:

*“O besimtarë! Kur merrni bua njëri nga tjetri për afut të caktuar shkruante! Dhe një shkrues nga ju le të shkruajë drejt dhe le të mos ngurrojë të shkruaj asAtu si e ka mësuar All-llahu. Ai le të shbrnajë, kurse ai që ka obligim (boexhi”) le t’i diktojë dhe le t’i frikësohet All-llahut. Zotit të vet, dhe asgjë le të mos lërë mangut prej asaj. Po ai që ka obligim nëse është mendjemangët (am) ose i dobët, ose nëse nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diltojë kujdestari i tij, por drejt, me besuilëri. Dhe sillni dy dëshmitarë, dy meshkuj nga ju, e nëse nuk ka dy meshkuj, atëherë një mashkull e dy femra me dëshminë e të cilave jeni të kënaqur. Nëse njëra prej atyre harron le ta përFujtojë tjetra. Dëshmitarët dubet të përgjegjen në çdo thirrje. Gjithashtu mos keni drojë që ta detajizoni me shkrim; qoitë pak ose sbumë, me stënim të afutit për kthim. Ajo është më e drejtë të All-llahu dhe më e fortë për të dëshmnar, dhe ka më pak mundësi për të dyshnar, përveçse nëse është tregti e ditës - me sende që i përfitoni dorë më dorë - atëherë nuk keni mëkat edhe nëse nuk i skënoni. Merrni dëshmitarë kur lidbni kontrata të shitElerjes dhe të mos jetë i dëmtuar as shkruesi as dëshmitari. Por nëse e bëni atë, ajo është me siguri gabim nga ana juaj. Frikësohuni All-llahut, All-llahu, u ju mëson, All-llahu për çdo send di.” (El-BeLare, 282).<sup>191</sup>*

dhe fjalëve të Tij: *“O besimtarë, jini përberë të drejtë, dëshmoni për All-llahun, qoftë edhe në dëmin tuaj ose në dëm të prindërve dhe të apërmve, qoftë i pasur a i varfer, All-llahu është të kujdeset për ato! Prandaj që të jeni të drejtë mos pasoni epshet. Po në qofe se dëshmoni padrejtësisht ose i shmangeni dëshmisë, ani, All-llahu vërtet*

---

<sup>191</sup> Kur,an, 2: 282.

*është i njoftuar se çka punoni <sup>121)</sup>*

## **KUR DIKUSH VERIFIKON DREJTËSINË E DIKUJT PËRMES NDONJËRIT QË I PËRGJIGJET**

**“E dimë për të mirë,, ose thotë: ‘ Vetëm mirë di prej tij.,,121**

2637. - Na ka treguar Haxhxhashi se i ka transmetuar Abdullah b. Umer En-Numejn, këtij Thevbani që Lejthi thotë:

Më ka thënë Junusi i cili transmeton nga Ibn Shihabi i cili ka thënë:

Më ka kumtuar Urve b. Zubejr, Ibn Musejjebi, Alkame b. Vekkas dhe Ubjedullah b. Abdullah që transmetojnë daklaraten e Aishes r.a. kurse një version verifikon tjetrin, **se si kanë folur shpifisit** për të çka u ka rënë në mend, çka kanë dashur të flasin. Atëherë Pejgamberi i All-llahut e thirri Aliun dhe Usmen (shpallja ishte ndalur) që të konsultohet me këta lidhur me ndarjen e famijes së ect (bashkëshorten) Usameja i tha: ‘Mbaje mos e lësho njeriun e shtëpisë. Ne dimë mirë për të.,, Kurse Berira ka thënë: «Kurr gjë nuk kam parë te ajo që do t,i shihej për të madhe, përveç që është vajzë e re, e zë gjumi afër brumit bukëve që gatuhet për shtëpiarët dhe v len delja e shtëpisë dhe e ha brumin.,, Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Kush na e arsyeton njeriun, e mua më ka arritur shqetësimi i antarëve të mi të shtëpisë, që pasha All-llahun unë di për njerëzit e mi vetëm mirë.,,

## **DËSHMIA E INDIVIDIT QË E FSHEH PLOTËSISHT DËSHMINË**

Amr b.Hurejth e lejon kete me fjalet: “Ashtu veprohet edhe me rrenacakun që ka gabuar.”

---

<sup>121</sup> Sipas mendimit të Ebu Jusufit dëshmia e dëshmitarit me fjalët e përmendura pranohet, kurse sipas mendimit të Muhammedit dëshmitari duhet të përdoren “është e drejtë”.

---

---

Sh'abiu, Ibn Sirin, A'tai dhe Katade kanë thënë: "Të dëgjosh vetëm ti mjafton si dëshimi"<sup>122</sup>

Hasan -Basriu ka thënë: "... **Nuk jam thirrur. të dëshmoj për ndonjë send, porse unë kam dëgjuar kështu e kështu.....**,,123

2638. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman, këtij Shuabi i transmetoi nga Zukriu se Salimi ka thënë: E kam dëgjuar Abdullah b. Umerin që ka thënë:

- Pejgamberi s.a.v.s. dhe Ubej b. Ka'b Ensariu u nisen me qëllim që të shkojnë në pemishten ku ishte Ibn Sajjadi dhe kur hyri Pejgamberi s.a.v.s. aty, filloi të fshehet pas pemëve, paniave për të dëgjuar ndonjë send, përpara se ta shihte Ibn Sajjadi. Ibn Sajjadi ishte mbështetur në shtrojen e vet të mëndafshhtë dhe diçka rënkonte e përshpëriste. Derisa Pejgamberi s.a.v.s. fshihej pas trupave të pemëve, e pa nëna e Ibn Sajjadit dhe tha: "oj **Safi, ai është Muhammedi,,**

Atëherë Ibn Sajjadi pushoi, u ndal. Pejgamberi s.a.v.s. tha: **Ta kishte lejuar, të vazhdonte, do të ishte krejt e qartë.,,**

2639. - Më ka treguar Abdullah b. Muhammed, këtij Sufjani nga Zuhriu kurse ai nga Ume, e ai nga Aisheja e cila ka thënë:

-Erdhi te Pejgamberi a.s. gruaja Rifa'a Kureziu e tha: Kam qenë për Rifa'an dhe ai më ka lëshuar. Lëshim ka qenë i parrevolueshëm, prandaj u martova me Abdurrahan b. Zubejrin, porse ai e ka si fije nga tesha.

- **A dëshiron që menjëherë të kthehesh te Rifa,ati? Jo, derisa të shijosh ëmbëlsinë e ti, e ai të shijojë ëmbëlsinë tënde** - i tha Alejhisselami.

Në këtë kohë te Pejgamberi s.a.v.s. rrinte Ebu Bekri, ndërsa

---

<sup>122</sup> Shurejhi,i, Sh'abui ,Ebu Hanife dhe Shafi' u nuk e miratoj dëshminë e dëshmitarit i cili fsheh detajet në porcedurën penale

123 Hasan Basriu ka deklaurat: "Nëse njeriu dëgjon dëshmimin nga njerëzit dhe vjen te gjykatësi dhe i thotë: "Nuk më kanë pranuar për dëshmitar, dhe unë kam dëgjuar kështu e kështu.." që do të thotë se Hasan Basriu e miraton dëshminë e këtillë.

në hyrje priste Halid b. Seid b. As që t'i lejohet hyrja, e ai pastaj tha: "o Ebu Bekr, a nuk e dëgjove këtë për çka fliste me zë të lartë te Pejgamberi a.s."<sup>124</sup> (Krahaso: 5260, 5261, 5265, 5317, 5792, 5825, 6084).

**KUR DËSHMOJNË NJË A MË TEPËR  
DËSHMITARË, E TË TJERET THËNË: NE KETË  
NUK E DIMË, VENDËSET  
SIPAS DEKLARATËS SË ATIJ QË DËSHMON**

Humejdi ka thënë: Ijo është sikurse rasti kur Bilali konfirmonte se Pejgamberi s.a.v.s. është falur në Qa,be, kurse Fadili thoshte: "**Nuk është falur,** dhe njerëzit pranuan dëshminë e Bilalit. Njëlloj është kur dëshmojnë dy dëshmitarë se dikush i ka borxh ndokujt një mijë derhem, kurse tjetër dëshmojnë se borxhi është një mijë e pesëqind derherr, vendoset kah shuma më e madhe."<sup>125</sup>

---

<sup>124</sup> Emri i vajzërisë së Rifatës ishte Temime e bija e Vehbit dhe Rifati e lëshoi atë me shkurorëzim të parevokushem (bejtin). Ky lloj shkurorëzimi ndodhë atëherë kur bashkëshorti i thotë bashkëshortes:

"po të lëshoj përgjithmonë, nuk mund të jeshë më gruaja ime; shko prej nga ke ardhë" dhe të ngjashme, ose i thotë: "Nëse shkon këtu e këtu, gjegjësisht nëse vepron kështu e kështu, je e lëshuar nga unë" dhe pastaj ajo përkundër këtyre kushteve vepron ashtu, me vullnet të vetin, kryenveti, lidhja e kurorës menjëherë ndërpritet. Nëse palët dëshirojnë të vazhdojnë jetën nën kurorë, kjo grua duhet të kalojë periudhën e idetit, prej pritjes katërmujshe dhe nëntë ditë, nëse nuk është shtatëzën, e nëse është shtatëzanë të presë deri kur të lind fëmijën. Mandej martohet me burrë tjetër, realisht - me marrëdhënie të plota intime, dhe pastaj nëse ky e lëshon ose ndrron jetë, ajo mund të martohet pasi të kalojë kohën e pritjes prej katër muajsh.

<sup>125</sup> Dëshmi do të thotë deklarimi i individit para gjyqit në prani të palëve, me qëllim të argumentit të të drejtës që ka njëra palë kundruall tjetrës, duke shqiptuar: "dëshmoj", "konstatoj", ose me shprehjet tjera ekuivalente me këto. Për dëshmi duhen dy mashkull; ose një mashkull e dy emra. Në rastet kur mashkulli nuk mund të dëshmojë ndonjë send vlen dëshmia e femrave, vetëm femrave.

---

2640. - Na ka treguar Hibbani se i ka kumtuar Abdullahu, këtij Umer b. Seid b. Ebi Husein që thotë: Mua më kumtoi Abdullah b. Ebi Mueljk i cili transmeton nga Ukhe b. Harithi se ky u martua, vuri kurorë me bijen e Ebu Ihab b. Azizit, kurse një grua tjetër erdhi dhe i tha:

- **Unë të kam dhënë gji ty (Ukbe) edhe asaj që ke vënë kurorë.**

- **Unë nuk e di - tha Ukbe - se në më ke dhënë gji, deri tash nuk ma ke thënë këtë.**

Ky dërgoi, pastaj njerëz te pyesin te familja e Ebu Ihabit, e ata përgjigjen: Nuk dimë gjë nuk kemi dijeni që t'i ketë dhënë gji ajo.

Pasaj ky i **hypi atit dhe** shkoi në Medinë te Pejgamberi s.a.v.s. ta pyesë për këtë **çeshtje, kurse Peigamben s.a.v.s. tha: Si nuk e di për këtë flitet se po?** Pastaj ky e lëshoi dhe ajo u martua me tjetër kend.

## DREJTËSIA E DËSHMITARËVE

*All-llahu xh.sh.* thotë:

“Merrni për dëshmitarë dy vetë të drejt nga ~mesi juafj.(65:2)

“me dëshminë e të cilëve jeni të kënaqur: (2: 2829

264 Na ka treguar Hakem b. Nafiujse i **ka-transmemar** Shuajbi nga Zuhriu i ka thënë: Mua më ka treguar Humejd b. Abdurrahmani b. Avf se Abdullah b. Uthe ka deklaruar., se ka

Gjatë dëshmisë paraqiten kushtet sipas aftësisë së dëshmitarit dhe dëshmitari nuk ka arsye që me dëshminë e vet të heqë nga vetja ndonjë obligim ose të fitojë me këtë ndonjë privilegjë. Në bazë të kësaj nuk pranohet dëshmia e farefisit në dëshmi të farefisit qoftë nga linia e të trashëguarit apo e trashëgimitarit, e kjo do të thotë se nuk është e vlefshme dëshmia e gjyshit, gjyshes... për fëmijë a nipat e tyre, siç nuk pranohet dëshmia e fëmijëve apo nipave për vepra të prindërve dhe gjyshërve të tyre, gjysheve etj.

Nuk është e vlefshme dëshmia e njërit bashkëshort për veprën e bashkëshortit tjetër, kurse dëshmia e farefisit tjetër, njëri për tjetrin, është e vlefshme.

Ndërmjet dëshmitarit dhe atij në llogari të cilit dëshmohet nuk guxon të ketë armiqësi apo ndonjë pakënaqësi.

---

dëgjuar nga Umer b. Hatabin duke thënë:

“Njerëzit në kohën e Pejgamberit a.s. i përmbaheshin Shpalljes, porse Shpallje nuk ka dhe ne tash i përmbahemi asja çka keimi më të qartë nga veprimet tuaja, prandaj kush na dëshmon të vërtetën e konsiderojmë të besueshëm dhe të singjetët, dhe për qëllimet e tij nuk dimë asgjë. Për qëllimet e tij do të marrë në pyetje All-llahu. Kush na dëshmon diçka për keq, atje nuk i besojmë, qoftë edhe të na thotë e e ka qëllimin e mirë.

### **SA DËSHIMTARË DUHET QË TË KONSTATOHET KORREKTËSIA E DIKUJT**

2642. - Na ka treguar Sulejman B. Harb, këtij Hmejd b. Zejdi i transmetoi nga Thabit, ai nga Enesi r.a. i cili ka thënë:

- Kur kaloi një xhenaze kah Pejgamberi s.a.v.s» të pranishmit folën fjalë të mira për të e Muhammedi a.s. tha: “Ka nevojë”. Pastaj kaloi xhenazja tjetër e njerëzit thanë keq për të , çka nuk thanë, e Muhammedi a.s. tha: “Ka nevojë”

**O Pejgamber i All-llahut, i thamë, për atë the: “Ka nevojë”, edhe për këtë prapë the “Ka nevojë,,.**

**- Dëshmia e njerëzve përfillet. Besedrejtë janë dëshmitarë të All-llahut në tokë - u përgjigj Alejhisselami**

2643. - Na ka treguar Musa b. Ismail se i ka transmetuar Davud b. Ebi e l-Furat, këtij Abdullah b. Burejdi nga Ebu-l-Esvedi i cili ka thënë:

- Pata ardhur në Medinë kur kishte rënë një sëmundje aty nga e cila njerëzit vdisnin shumë shpejt. Unë rrija te Umen r.a. Në atë moment kaloi një xhenaze, për të cilën u folën fjalë të mira, kurse Umeri r.a. tha: “ka nevojë: Kaloi pastaj, edhe një tjetër edhe për atë u fol mirë, e ky tha: Ka nevojë,,. Mandej kaloi xhenazja e tretë për të cilën u fol keq, e ky tha “Ka nevojë,,.

**- O sundimtar i besëdrejtëve, çka do të thotë kjo “Ka nevojë,, pyeta.**

---

- Ai tha, siç ka thënë Pejgamberi a.s. se çdo musliman për të cilin katër vetë dëshmojnë se është i mirë, All-llahu do ta shtjerë në xhennet.

- Po nëse dëshmojnë tre, e pyetëm ne.
  - Edhe tre - tha Muhammedi a.s.
  - Po nëse dëshmojnë dy veta? e pyetëm.
  - Edhe dy - u përgjigji ai.
- Për një nuk e pyetëm.<sup>126</sup>

### **DËSHMIA E FAREFISNISË, E NJOHUR SI GJIDHËNIE, VDEKJA E MOÇME E DIKUJT DHE KONFIRMIMI I ASAJ**

Pejgamberi a.s. ka thënë: Mua dhe Ebu Selemit na ka dhënë gjë Suvejba.

2644. - Na ka treguar Ademi, këtij i transmetoi Shu,be, këtij Hakemi i cili përcjell nga I'rak b. Maliku, ai nga Urve b. Zubejri se Aisheja r.a. ka thënë:

- **Eflehu kërkoi leje të hyjë te unë por nuk i lejuan.**
- **A fshehesh prej meje, pyeii ai, unë jam mixha i yt.**
- **Si është e mundur kjo, e pyeta unë.**
- **Të ka dhënë gjë gruaja e vëllait tan, ku ka pi edhe im vëlla.**

- **Për këtë e kam pyetur Pejgamberin a.s. - thotë ajo - e ai u përgjigji:**

**“Eflahu ka folur të drejtën. Lejoje të hyjë”.** (Krahaso: 4796, 5103, 5111, 5239, 6156).

2645. - Na ka treguar Muslim b. Ibrhaim, këtij Hammam të cilit i transmetoi Katade nga Xhabir b. Zejdi, ai nga Ibn Abbasi

---

<sup>126</sup>Besnikëria e dëshmitarëve hulumtohet ose në mënyrë sekrete tek ata njerëz profesionist të cilëve u përket thirrja dhe niveli i dëshmitarëve. Verifikimi për besnikëri bëhet në formë të shkruar, në mënyrë sekrete, kurse publikisht bëhet në gjyq ose në vendin e ngjarjes në prani të palëve në kontest. (*Mexgebel-le i ubkami sherijji.e*).

---

r.a. që ka thënë:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë për vajzën e Hamzës: “Nuk je e lejuar (për niqah me mu). Sipas tambëli të ndalohej ajo çka është e ndaluar sipas gjakut. Ajo është e bija e vëllaut tim nga gjiri. (Krahaso: 5100).**

2646. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf se i ka transmetuar Maliku që përcolli nga Abdullah b. Ebi Bekri, ky nga Amra, bija e Abdurrahmanit se Aishieja r.a. bashkëshortja e Pejgamberit a.s. asaj i ka kumtuar që Pejgamberi s.a.v.s. ka qenë te ajo, kur ajo kishte dëgjuar zërin e një njeriu që: dëshronte të hynte, kërkonte leje, në dhomën e Hafses, e unë - thotë Aisheja - i thashë: **“O Pejgamber All-llahut më duket se a’ është filan fisteku (axha i Hafses për nga tambëli).**

Aisheja r.a. pastaj shtoi: o Pejgamberi i All-llahut, ai është nejrri që kerkon leje të hyjë në shtëpinë tënde.

Atëherë - thotë Aisheja r.a. - Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: **“më duket se ai është filan fisteku, axha i Hafses për nga tambëli sikur të ishte gjallë filan fisteku, axha i sajë për nga tambli do të hynte te une, th Aisheja.**

Pejgamberi s.a.v.s. pastaj shtoi: **“Po, gjithçka është e ndaluar sipas lindjes është e ndaluar edhe sipas tamblit.,”<sup>127</sup>**

---

127 Afersia sipas tëmbilit është atëherë kur fëmiut të huaj i jep gjë deri në moshën dy vjeçare, sipas mendimit të Ebu Jusufit, Muhamedit, Malikut, Shafiut dhe Ahmedit, Lurse Ebu Hanife këtë afat e zgjat deri në 30 (tridhjetë) muajt e parë të jetës së foshnjës, dhe kjo duhet të bëhet aq herë sa ka pas nevojë foshnja të shuaj urinë. Imam Zufferi mendon se ky afat duhet të ketë zgjatur tri vjet pas lindjes së foshnjës.

Afersia sipas tëmbilit - gjidhënies - sipas Shafiut dhe Ahmedit konsiderohet atëherë nëse foshnja është ushqyer në periudhën e theksuar së paku pesë herë. Sipas qëndrimit të juristëve të shkollave tjera juridike islame afersia sipas gjidhënies konsiderohet qoftë edhe me një herë të gjidhënies së foshnjës. Ky mendim është përkrahur, ka mbështetje, edhe nga; Aliu. Ibn Mesudi, Ibn Umeri, Ibn Abbasi, Tavusi, Seidi, Hasan Basriu, Mekhuli, Zuhriu, Katade, Maliku, Evaziu, Thevriu dhe Ebu Hanife. për periudhën trivjeçare janë deklaruar: Ebu Thevre, Ebu Ubjed, Ibn Mundhir, b. Sulejman b. Jesar, Seid b. Xhubejr, Ibn Hamza dhe disa bashkohorik të tyre.

---

(Krahaso: 3105, 5099).

2647. - Na ka treguar Muhammed b. Kethir atij transmeton Sufiani nga Esh,ath b. Ebish-sha'thai, ky nga babai i vet, kurse ky nga ruku qe Aisheja r.a. ka thënë:

- Kur hyri Pejgamberi a.s. te unë te unë ishte një njeri.

- **Aishe, kush është ky? - pyeti**

- **Vëllai im nga tambli - i thashë.**

- **Aishe, më tha, kini kujdes cilët kani vëllezër.**

**Gjidhënia është vetëm për shkak të urisë.**

Në variantin tjetër të transmetimit të Muhammed h. Kethint pason Mehdiu që e transmeton hadithin nga Sufiani. (Krahaso: 5102).

## **DËSHMIA E SHPIFESIT, VJEDHËSIT DHE LAVIRIT**

All-llahu xh.sh. thotë: “... *Atyre kurrë mos ua pranoni dëshminë se ata janë njerëz të prishur...*”<sup>128</sup>

Umeri i rrahu me kamxhik Ebu Bekreitn, Shibal b. Ma, bedin dhe Nafiun për shkak se i shpifën Mugires, e pastaj kërkoi falje nga ata dhe tha:

“Kush pendohet do t,ia pranoj dëshminë.” Këtë e ka lejuar Abdullah b. Utbe Umer b. Abdu-l-Aziz, Seid b. Xhubejr, Tavus, Muxhahidi, Sha,biu, Ikrimeja, Zuhriu, MuhariL b. Dithar, Shurejhi dhe Muavi b. Kurre.

Ebu Zinadi ka thënë: “Te ne në Medinë qëndron kështu: nëse shpifësi pendohet, dëshmia e tij pranobet për më vonë, në bazë të fjalëve të All-llahut xh.sh. “... **dhe kërkoi falje nga Zoti...**”

---

128 “Ata të cilët fajësojnë gratë e ndershme e pastaj nuk e argumentojnë këtë me katër dëshmitarë, t’i rrihni tetëdhjetë herë me kamxhik dhe kurrë më mos e pranoni dëshminë e tyre. Ata janë njerëz të prishur”.

“Me përjashtim të atyre që, pastaj, pendohen dhe përmirësohen, sepse edhe All-llahu fal dhe është shumë i mëshirshëm”. Kur’an, 24: 45)

Sha,biu dhe Katade thonë: Nëse dikush shpif për vete, do të rrihet me kamxhik dhe pastaj do t,i pranohet dëshmia, kurse Thevriu thotë: “Nëse njeriu rrihet dhe më vonë lirohet, pas kësaj dëshmia i pranohet, madij edhe nëse dikush që ka qenë i dënuar caktohet për gjykatës, vendimet e tij janë të lejuara, të plotfuqishme.

Dikush (Ebu Hanifeja) thotë: **“Nuk lejohet dëshmia e shpifësit, qoftë edhe të jetë penduar dhe përmirësuar më vonë.,, Pastaj ka shtuar: “Lidhja e kurorës (niqahit) nuk lejohet pa dy dëshmitarë, kurse lejohet që dikush të lidhë kurorë me dëshminë e dy të dënuarve, por nuk lejohet të lidhet kurorë me dëshminë e dy robërve - njerëzve jo të lirë.,,**

Dëshmia e robit të dënuar edhe robëreshës lejhoet, merret parasysh, për të konstatuar hënën e re për Ramazan.

Si mund të jetë i vlefshëm pendimi i shpifësit (thotë Buhariu), kur Pejgamberi s.a.v.s. i ka përzënë nga qyteti lavirët, një vjet Peggamberi s.a.v.s. u ndaloi muslimanëve bisedat me Ka,ab b. Malikun dhe dy shokët e tij për pesëdhjetë ditë.<sup>129</sup>

**2648.** - Na ka treguar Ismaili, të cilit i transmetoi Ibn Vehbi nga Junusi, kurse Lejthi ka thënë se i kumtoi Junusi nga Ibn Shihabi:

- Më ka kumtuar Urve b. Zubejr se një grua, ditën kur u çlitua Mekka, kishte vjedhur diçka dhe e sollën te **Pejgamberi a.s. dhe ai urdhëroi e iu pre dora.** Aisheja ka deklaruar: “Pendimi i saj ishte pranuar, u përfillë, ajo më vonë është martuar, mandej erdhi dhe unë kërkesën e saj ia përcolla Pejgamberit a.s. (Krahaso: 3475, 3732, 3733, 4304, 6787, 6788, 6800).

**2649.** - Na ka treguar Jahja b. Bukejr se i ka transmetuar

---

129 Ka,ab b. Malik, Mirare b. Rebi, dhe Halil b. Umejje në betejën e zhvilluar në Tebuk kundër Bizantinëve në vitin e 9 sipas hixhretit (630), u ndalën në shtëpit e tyre në Medinë. Muslimanët tjerë pasi u kthyen nga lufta në Medine i bojkotuan dhe i konsideronin si dyfyrsha.

---

---

Leithi nga Ukajli, ai ka dëgjuar nga Ibn Shihabi, ky nga Utujedullah b. Abdullahu, ai nga Zjed b. Halidi r.a. se Pejgamberi a.s. për atë që ka bërë kurvëri, dhe është i pamartuar, ka urdhëruar të rrihet me njëqind kamxhikë dhe të ndiqet (të përzënet) nga vendi për një vjet.

## **DËSHMITARI NUK DO TË DËSHMOJË PADREJTËSISHT**

**2650.** - Na ka treguar Abdan se Abdullahu i ka thënë: Ebu Hajjan et-Tejmi na ka transmetuar nga Sha,biu, ky nga Nu,man b. Beshiri r.a. që tha:

- Nëna ime e pyeti babën tim për një dhuratë, të ma jepi, nga pasuria e tij. U mendua dhe dikur ma dha, e ajo i tha: Nuk jam e kënaqur deri kur ta marrësh Pejgamberin a.s. për dëshmitarë. Atëherë ai më mori për dore, unë isha ende i vogël, më çoi te Pejgamberi a.s. dhe tha:

- Nëna e këtij, e bija e Rebbahit, më lypiti një dhuratë për këtë.

- **A ke fëmijë tjetër përveç këtij,** pyeti ai.

- **Po** - u përgjigj ai.

**Unë mendoj,** tha Alejhisselami, **se ti nuk më merr dëshmitarë për padrejtësi.**

**2651.** - Na ka treguar Ademi i cili transmeton nga Shu,be se Ebu Xhemre ka thënë: E kam dëgjuar Zehdem b. Mudarribin duke thënë: "Imran b. Husejni r.a. ka deklaruar se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

- **Gjenerata ime është më e mira, pastaj ajo që vjen pas kësajë, e pastaj ajo që e pason këtë gjeneratë.,,**

Imrani thotë: Nuk e di a ka përmendur Pejgamberi a.s. edhe ndonjë përveç këtyre dy brezave.

**Pejgamberi a.s. ka thënë:**

- **Pas jush do të ketë disa njerëz që do të gënjejnë dhe ndaj tyre nuk do të konë besim; ata do të dëshmojnë por**

---

nuk duhet të merren për dëshmitarë, do të japin premtune por nuk do t,i mbajnë dhe te ata do të jetë e shprehur shumë grykësia (do të jenë të pangishëm). (Krahaso: 3650, 6428, 6695).

**2652.** - Na ka treguar Muhammed b. Kethir se i ka transmetuar Sufiani nga Mensuri, ai nga Ibrahimimi, ky nga Ubejdi, ky nga Abdullahu r.a. se **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:**

**- Njerëzit më të mirë janë brezi im, gjenerata ime, pastaj ajo që vjen pas tyre, e mandej ajo që pason atë. Pas kësaj do të vijnë njerëz që disave prej tyre më shumë u pëlqen të betohen se sa të dëshmojnë, kurse betimi i tyre e tejkalon dëshminë.**

Ibrahimimi Nehbiu) thotë: **“Neve si fëmijë na rrihnin për shkak të dëshmisë dhe të betimit”** (Krahaso: 3651, 6429, 6658).

## **Ç’KA THUHET PËR DËSHMINË E RREJSHME**

I Lartmadhërishtmi All-llah thotë: *“... Dhe mos e fshehni dëshminë se kush e fsheh atë, ai ka zemër mëkatore, kurse All-llahu e di çka punoni”*. (Kur’an, 2: 283).

**2653.** Na La treguar Abdullah b. Munir se ka dëgjuar Vehb L. Xheririn dhe Aldu-I-Melik b. Ibrahimin që kanë thënë: Neve na ka treguar Shu’be se i ka transmetuar Ubjedullah b. ELi Bekr b. Enes, ky nga Enesi i cili ka thënë:

- Kur e pyetëm Pejgamberin a.s. për gjynahet e mëdha u përgjigj: **“Gjynahet më të mëdha janë t,i bësh shoq All-llahit, mosdëgjimi i prindërve, vetevrasja dhe dëshmia e rrijshe,,** Sipas një versioni tjetër Vehbin e infromoi Gunder Ebu Amir, Bekri dhe Abdusamedi i cili hadithin e transmeton nga Shu’beja. (Krahaso: 5977, 6871).

**2654.** - Na ka treguar Museddedi, këtij Bishr b.

---

---

Mufaddali, **këtij** i transmetoi Xhurejri nga Abdurrahman b. Ebu Bekr, kurse ky nga babai i vet i cili ka deklaruar: Pejgamberi a.s. ka thënë tri herë: **“A doni t’ju informoi për gjynahet e mëdha?”**

- **Duam, o Pejgamber i Zotit**, i thanë të pranishmit.

- **T’i përshkruash All-llahut shoq, mosdëgjimi i prindërve** - pastaj u ul sepse ishte i mbështetur, dhe vazhdoi: **Ta dini se edhe rrena është gjithashtu. Dhe këtë** - thotë- Ebu Bekri - **e përsëriste vazhdimisht, aq sa nisëm të thomi, a do të ndalet njëherë më.**

Ismail b. Ibrahim i ka thënë se të njëjtin hadith ia ka transmetuar Xhurejri nga Abdurrahmani. (Krahaso: 5976, 6273, 6274, 6919).

### **DËSHMIA E TË VERBËBËRIT, VLEFSHMËRIA JURIDIKE, MARTESA E TIJ DHE A MUND TË MARTOJË TJETËR KËND, SHITBLERJA E TIJ DHE A MUND TË KËNDOJË EZANIN DHE TË TJERA SI IKAMET, TË BËHET IMAM ETJ.**

Dëshminë e te verbërit e lejojnë: Kasimi, Hasani (Bastiu) Ibn Siriri, Zuhriu dhe A’tau.

Shabiu ka thënë: **“Dëshmia e tij lejohet nëse është i mençur.”**

Hakemi ka thënë: **“Lejohet, në disa punë.”**

Zuhuri thotë: **“A e ke parë Ibn Abbasin, kur dëshmonte për ndonjë çështje, a e ka refuzuar atë? Ndërsa Ibn Abbasi e solli një njeri (të verbër) të vrojtojë dhe bënte iftar (kur i lajmëronte ky), madje e pyeste edhe për agrimin, dhe kur i thuhej, u bë sabah, ai falte dy reqate.”**

Sulejman b. Jaseri thotë:

-Iu drejtova Aishes r.a. të marrë lejë të hyjë. Ajo pasi ma njohu zërin më tha: **“Sulejman, hyr o Sulejman, ti ke qenë rob**

dhe nuk të ka mbetur asgjë (borxh)<sup>130</sup>

Semure b.Xhunde b ka lejuar të dëshmojë gruaja me fytyrë të mbylur.

**2655.** Muhammed b.

Mejmun na ka thënë: na ka transmetuar Isa b.Junus nga Hishami, ky nga babai i vet kurse ai nga Aisheja r.a. e cila ka thënë: Pejgamberi s.a.v.s. dëgjoi një njeri duke kënduar Kur'an në xhami dhe tha: "Zoti e mishëroftë! Ma kujtoi filan ajetin nga filan sureja që gati e kisha harruar"

Abbad b.Xhunde b ka lejuar të dëshmojë gruaja me fytyrë të mbuluar.

**2655.** Muhammed B.Ubjed b.Mejmun na ka thënë: na ka transmetuar Isa b.Junus nga Hishami, ku nga babai i vet kurse ai nga Aisheja r.a. e cila ka thënë: Pejgamberi s.a.v.s. dëgjoi një njeri duke kënduar Kur'an në xhami dhe tha: "Zoti e mëshiroftë! Ma kujtoi filan ajetin nga filan sureja që gati e kisha harruar."

Abbad b.Abdullah, duke transmetuar nga Aisheja, shton:

Pejgamberi a.s. e kaloi natën në dhomën time dhe e dëgjoi zërin e Abbadit i cili falte namazin në xhami dhe tha: "**Oj Aishe, a është ky zëri i Abbadit?**"

Po, u përgjigja unë.

- **O Zot, mëshiroje Abbadin** – tha Pejgamberi. (Krahaso: 5037, 5038, 5042, 6325)

**2656.** Na ka treguar Malik b.Ismail se i ka transmetuar Abdul-l-Aziz b. Ebi Selem, Këtij i kumtoi Ibn Shihab nga Salim b.Abdullah, kurse ai nga Abdullah b.Umeri r.a. që ka deklaurar se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë.

-Bilali e këndon ezanin kur ende është natë, prandaj hanin dhe pinin deri kur ta këndojë ezanin – ose ka thënë – deri kur ta dëgjoni ezanin e Ummi Mektumit. Ibn Ummi Mektum ishte njeri i verbër dhe nuk këndonte ezanin deri kur t'i thoshin njerëzit tjerë, agoi".

---

<sup>130</sup> Sulejman b.Jesar ishte rob i Mejmune b.Harithit dhe kjo e liroi me anë të marrëveshjes për kompezim, kurse ai këtë kompezim ia pagoi me kiste, kohë pas kohe.

---

---

**2657.** Na ka treguar ZIjad b.Jahja, këtij i transmetioi Hatim b.Verdan nga Ejjubi, ky nga Abdullah b. Ebin Mulejke, ky nga Misver b.Mahremi r.a. i cili ka deklaruar:

- Pejgamberi s.a.v.s. i erdhën disa xhybe dhe Abdullah b. Mulejk më tha: O Ebu Mehrem, eja deri te Alejhisselami, ndoshta në jep ndonjë të tjetër prej këtyre..” Babai i m u ndal në hyrje, të dera, foli diçka dhe Pejgamberi ia njohu zërin. Atëherë Pejgamberi a.s. doli me një xhybe dhe duke folur për kualitetin e saj, ai i thoshte: “Këtë e kam ndarë për ty. Këtë e kam ndarë për ty.”<sup>131</sup>

### **DESHMIA E GRAVE**

All-llahu xh.sh. thotë: “... *E nëse nuk ka dy burra, atëherë një burrë dhe dy gra...*” (Kur’an, 2: 282).

**2658.** - Na ka treguar Ibn Ebi Merjem se i ka transmetuar Muhammed b. Xhaferi Më ka kumtuar Zejdi nga Ljad b. Abdullahu, ky nga Ebu Seidi Huder r.a. që Pejgamberi a.s. ka thënë:

- **A nuk është dëshmia e gruas e barabartë me një gjysmë dëshmi të burit**<sup>132</sup> **Po, si jo, tha ai, ndodh për shkak se ajo ka mangësi në të menduar.**

---

<sup>131</sup> Përkitazi me dëshminë e të verbërit ka mendime të ndryshme. Dëshmia e të verbërit është e plotë fuqishme sipas mendimit të Ibn Hazmit, Ibn Abbasit, Zuhriut, A’Ataut, Kasimit, Sha’biut, Shurejhit, Ibn Sirinit, Hakemit, Ibn Utejbës Rebi’as, Malikut, Lejthit, Ahmedit, Is-hakut dhe disa bashkekohënikëve të tyre, kurese Ebu Jesufi, Shfiu dhe Hasan Basriu sipas një verzioni, dëshimnë të verbërit e lejonë vetëm për lëndët që janë në kontekst të cilat ia ka njohur përpara se të verbohen, kurse për ato konteste që kanë lindur më vonë, pas verëbërimit të tij, nuk i lejojnë. Ibrahim Nehaiu e lejon dëshminë e të verbërit për disa konteste, kurse sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe Zuferit i verbëri nuk mund të dëshmojë në asnjë mënyrë.

<sup>132</sup> Për dëshminë e femrave ka mendime të ndryshme. Dëshmia e femrave nuk lejohet në rastet e veprave penale, posaccërisht nëse ajo vepër trajtohet e rëndë për denim me vdekje. Ibn Musejjeb. Nehaiu, Hasan

---

## DËSHMIA E ROBËRESHËS DHE ROBËREVE

---

Enesi ka thënë: dëshmia e robit është e plotfuqishme, me kusht që të jetë i drejtë.”

Robin e lejojnë të dëshmojnë: Shurejh, Zurare b. Evfa, kurse Ibn Sirin ka thënë: **“Dëshmia e tij lejohet, me përjashtim të robit i cili do të dëshmonte për ndonjë gjë në dobi të zoteriut të vet.”** kurse Hasani (Basriu) dhe Ibrhaimi (Nehaiu) i lejojnë dëshmi për ndonjë çështje me pak rëndësi, për ndonjë çështje të parëndësishme.

Shurejhi ka deklaruar: “Të gjithë ju jeni bij të robërve dhe robërshave.

**2659.** - Na ka treguar Ebu Asim që transmeton nga Ibn Xhurejxhi, ky nga Ibn Ebi Mulejke, ai nga Ukbe b. Harith, kurse sipas një versioni tjetër të transmetuesve ka treguar Ali b. Abdullah se i ka transmetuar Jahja b. Seid nga Ibn Xhurejxh i cili ka deklarur:

- E kam dëgjuar Ibn Ebi Mulejken duke thënë: Më **ka treguar Ukhe** b. Harith, gjegjësisht kam dëgjuar prej tij se ai është martuar me Ummi Jahian, të bijën e Ebu Ihabit dhe **erdhi - thotë ai - një robërshë e zezë** dhe tha: “Unë të dy juve ju

---

Basriu, Zuhriu, REbi, Maliku, Lejthi, Shafiu, Ahmedi, Ebu Thevr dhe një numër i madh nga juristët e mëvonshëm.

Mendimet janë të ndara edhe përkitazi me lëndën, kontestin, endarjes së bashkëshortore. Në tërë kontestet e përmendur femrave nuk u lejohet të dëshmojnë, nëse mund të gjenden mashkuj. Maliku, Shafiu, Rebi, dhe Ebu tHevr, kurë jauristë e Kurfes e lejojnë.

Dëshmia e femrave lejohet nga të gjithë juristët islamë., njerësit, Për rastet kur meshkujt nuk kanë mundësi të nonë ndonjë gjë send të sigur, sic është rasi me mensturacionin, lindjen, gjidhënia e fëmiut të huaj, të meta të femrave dhe të ngjashme, në rastet kur nuk ka mami e gjinekolog. Për këto raste duhet të dëshmojnë se paku katër femra, sipas mendimit të Ibrahim Nehaiut, A'ata b. Ebi Rebahut, SHafiut dhe Ebu Thvrit, kurse mund të dëshmojnë vetëm dy femra siaps mendimit të Malikut, Ibn Ebi Lejla, Kurse SHafiu e pranon edhe dëshminë e vetëm të një femre.

---

---

---

---

kam dhënë gji.” Këtë ia paraqim Pejgamberit a.s. Ai u kthye në anën tjetër – thotë Ukbe- kurse unë e përshëndeta dhe prapë ia përmenda këtë çështje, e ai tha:

- Po si mun dtë kurorëzoheni kr konatatohet se ajo u dha gji.

- Ai këtë ua ndaloi.

## DËSHMIA E MËNDESHËS

**2660.**-Na ka treguar Ebu Asimi që transmemton nga Umer b.Seidi, ky nga Ibn Mulejke, se Ukbe b.Harith ka deklaruar: “Unë u kurorëzova me një femër, dhe erdhi nga grua e na tha, unë jube të dyve ju kam dhënë gji. Unë bëhet kjo kur për këtë dihet? Lërë atë, apo tha diç të ngjashme.

## VERIFIKIMI I VLEFSHMËRISË SË DISA GRAVE ME ANË TË TJERAVE

**2661.** - Na ka treguar Ebu Rebi Sulejman b. Davud, por ma ka kujtuar edhe Ahmedi një pjesë të kësaj, duke thënë:

Neve na ka transmetuar Fulejh b. Sulejman nga Shihab Zubriu, ai nga Urve b. ZuEriu, Seid b. Musejeb, Alkame b. Vebkas dhe Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe, këto nga Aisheja r.a., bashkëshorte e Pejgamberit a.s. kur shpifësit folën për të çkamos, kurse All-llahu xh.sh. e shmangu atë shpifje nga ajo. Zuhriu ka thënë:

- Të gjithë ata më kanë transmetuar nga një pjesë të diskutimit të saj. Disa rrëfime i kam mbajtur mend. më mirë se të tjerat dhe i kam të ngulitura në mendje. Nga secili prej tyre veç e veç kam mbajtur mend diskutimin që ma kanë kamtuar nga Aisheia. Diskutimet e njëres palë i vererifikojnë diskutimet e të tjerave. Ata konstatojnë se Aisheja ka thënë:

- Pejgamberi a.s. kur dëshironte të marrë rrugë, i çonte gratë

---

---

e veta të heqin short, dhe kur i binte shorti ai atë e meme në rrugë. Kështu që ai me rastin e nisjes në luftë (kundër fisit Beni Mustalik) na dha të heqim short. Shorti më ra mua dhe unë u nisa me të në rrugë. Pasi që ishte shpallur ajti për mbulesën e grave u vendosa dhe ndejta në pajton (në atë thoshin për transport njerëzish). Pejgamberi a.s. e mbaroi luftën dhe u kthye prapë. Ne ishim afruar në Medine. Kur u lëshua urdhëri për t,u nisur ishte natë. Kur u shpall nisia, jam ngritur dhe kam shkuar ca larg ushtrisë. Pasi kreuva nevojat e mia nisa të mbledh sendet e mia. Në atë moment preka krahërorin dhe e pashë se qaforja me xhevahire të çmueshëm (azifarite) më ishte këputur dhe kishte rënë. U ktheva prapë të kërkoja qaforen. Kërkimi i qafores më vonoi kurse ata që ishin me mua në atë udhëtim u nisen, e vonë koshin tim në deve dhe shkuan me gjithë deve duke menduar se edhe unë jam në bartësen e ngarkuar mbi deve.

Femrat ishin të lehta, sepse hanin pak ushqim, nuk ishin të majme e të rënda, prandaj meshkujve nuk u dukej e rëndë barra. Kur i ngarkonin lartëset në deve. Ashtu edhe koshin tim e vanë në deve. Unë kam qenë shumë e re.

Pasi ata e ngarkuan deven dhe shkuan, unë e gjeta qaforen. Kur erdha unë te vendi ku kishim qenë të vendosur ushtria kishte shkuar. Nuk ishte askush aty. Pastaj unë shkova te vendi ku kishim qënduar duke menduar: pasi që ata më kanë humbur do të kthehen pas meje, dhe derisa rrija aty, m,u mbyllën sytë dhe më kishte zënë gjumi.

Pas ushtrisë kishin mbetur Sefvan b. Mua,ttal Es-Sulemi dhe Dhekvan, duke kaluar aty pari hetoi një njeri që po flinte. Pastaj më është afruar, ai më ka parë kur kam qenë akoma pa u mbuluar, dbe unë u zgjova kur dëgjova thirrjen **“Të gjithë jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehem”,**. Ai pastaj urdhëroi deven dhe ajo u ul, e vuri dorën mbi të dbe unë hipa në deve. Deven e mbante për kërpeshi ai deri kur arritëm te ushtria, e cila ishte shmangur nga rruga dhe ishie ndalur, afer kohës së drekës. U shkatërru ai që duhej të shkatërrohet për shkak të kësajë shpifje.

---

---

---

Përhapjes së kësaj shpifje i printe Abdullah b. Ubej b. Selul. Mandej arritëm në Medine. Unë kam qenë e sëmurë një muaj, kurse njerëzit përhapin rrëfimet e shpifësit. Dyshoi për sëmundjen time dhe unë nuk e gëzoja kujdesin e Pejgamberit a.s. që e kisha herat tjera kur kam qenë e sëmurë. Ai hynte, jepte vetëm selam dhe pyeste, “Si je?” Unë nuk dija asgjë për këtë kurë deri kur u shërova. Njëherë dola unë dhe Ummi Mistah deri në Menasi, ku kryenim nevojat tona, ashtu dilnim nganjëherë natën. Kjo ka qenë atëherë kur nuk kishim nevojë në afërsi të banesave tona. Punët e pastrimit ishin sikur që kanë genë më përpara tek arabët, me dhe ose diç tjetër. Pastaj unë dhe Ummi Mistah, bija e Ebu Ruhamit, u nisëm dhe derisa shkoni ajo u vërsul me xhyben e vet duke thënë: “**U vërsul Mistahi,,** e unë i thashë: “Keq bëre që veprime ashtu. Po i bërtet një njeriu i cili ka marrë pjesë në Bedr”.

- Oj zojë - tha ajo - nuk ke **dëgjuar çka flasin bota dhe ma** sqaroi rastin e shpifjes, kështu që sëmundjes time i shtoi edhe një sëmundje. Kur u ktheva në dhomën time, hyri Pejgamberi a.s dhe pyeti, “Si je,,?”

- Më lejo të lutem, i thashë, të shkoj te familja ime, te prindërit?

- Me këtë rast, tha Aisheja, dëshiroja të mësoj të vërtetën nga ata. Pejgamberi a.s. më lejoi dhe unë shkova te prindërit e mi dhe ia tregova nënës time se çka flasin bota, kurse ajo u përgjigj:

- Bija ime, lehtësoja vetës këtë gjendje, mos i vë vesh. Pasha All-llahun, pak ka gra që jetojnë në harmoni me burrin e vet, por që kanë shemër, e ato të mos veprojnë kundër asaj.

- Qofsh lartësuar o Zot - thashë, e bota fliste për këto gjëra.

- E kalova atë natë - thotë Aisheja - dhe gdhiu dita e lotët e mi nuk pushuan, e as që e shijova gjumin. Kur gdhiu dita, Pejgamberi a.s. e thirri Aliun, birin e **Ebu Talibit dhe Usamen, birin** e Zejdit kur ishte ndalur Shpallja, që të **konsultohet me ata për** ndarjan me shtëpiarët e vet.

Sa për Usamen, ai e tregoi se çka ndiente në shpirtin e vet

---

---

nga dashuria ndaj tyre dhe tha: o Pejgamber i All-llahut, ruaji shtëpiarët tu! Pasha All-llauon unë kam vetëm mendim të mirë: Kurse Aliu, biri i Ebu Talibit, tha: “o **Pejgamber i All-llahut, All-llahu nuk të** ka vënë në mundime me të, ka gra edhe tjera, përveç asaj. Pyete robëreshën le ta konfirmojë edhe ajo’ ,.

Pastaj Pejgamberi a.s. e thirri Beriren dhe e pyeti: “A ke parë te ajo (Aisheja) ndonjë shenjë dyshimi?,,

- Jo, u përgjigj Berira. Pasha Atë që të ka dërguar me Shpallje të vërtetë, unë nuk kam parë asgjë te ajo që mund të konsiderohet si e metë, porse ajo është femër shumë e re kah mosha dhe e zë gjumi te magjja dhe vjen delja e shtëpisë dhe e ha.

Pejgamberi a.s. pas kësaj u ngrit e doli në minber, menjëherë atë ditë dhe kërkoi falje nga All-llahut b. Ubej b. Seluli. Pastaj Pejgamberi i Zotit pyeti: “Kush do të më ndihmojë kaudër njeriut i cili ka shkaktuar shqetësime në familjen time? Pasha All-llahun, unë për familjen time di vetëm mirë. Kanë përmendur edhe një njeri, ndër tjerë, (Sufjanin), kurse unë për atë nuk di kurrigjë të keqe, dhe ai nuk ka hyrë në familjen time pa qenë edhe unë me të”.

Në këtë moment u ngrit Sa,ad b. Mu,adhi dhe tha:

- o Pejgamber i All-llahut, pasha All-llahun, unë do të ndihmojë kundër atij. Nëse ai është nga fisi Evs do t,ia presim kryet me shpatë, e nëse është nga vëllezërit tonë nga Hazrexhët do të sillemi me të sipas urdhërit që të japësh ti.

Mandej u ngrit Sa,d b. Ubad, njeri i parë nga Hazrexhitet, para kësaj kohe ka qenë njeri i mirë, porse tash e ka mundur mburrja, dhe tha:

- Gënjen, pasha All-llahun se nuk do ta mbysësh e as që mund ta bësh këtë.

Pastaj u ngrit Usejd b. Hudajr dhe tha:

- Rren pasha Zotin - Pasha Zotin do ta mbysim Ti je dyftyresh dhe i mbron dyftyreshat.

Erdhi puna që dy fiset, Evs dhe Hazrexh, të nisin shamatë

---

---

ndrmjet veti, a Pejgamberi a.s. ende ishte në minber. Zbriti nga minberi i pajtoi dbe ata heshtën, edhe ky heshti.

Kam qarë atjë ditë pa ia da, lotëtë me shkonin rrëke dhe nuk kam ditur ç,është gjumi. Edhe prindërit e mi ishin te unë. Kështu kam qarë një ditë e dy net aq sa mendova që nga vaji do të më çahen mushkëritë. Derisa ata dy ishin te unë, e unë qaja - thotë Aisheja - një grua nga ensaret kërkoi leje të hyjë dhe unë e lejova. Ajo hyri dhe u ul, ka qarë bashkë me mua. Në këtë gjendie tonën, duke qarë, hyri Pejgamberi a.s. dhe u ul, ai nuk ishte ulur te unë qysh prej ditës kur kanë filluar të flisnin atë çka flisnin, e kishte kaluar një muaj, por lidhur me rasiin tim nuk kishte shpallje. Pastaj - thotë Aisheja – r.a. shebadet dhe tha:

**- Aishe, për ty më është shpallur kështu kështu, nëse, pra ti je e pastër nga këto shpifje, All-llahu do të ruajë, e nëse ke gabuar kërkoi falje prej All-llahut dhe drejtoju me pendim, ngase kur robi e pranon gabimin dhe pendohet All-llahu ia fal. Kur e kreu fialën Pejgamberi i All-llahut, lotët m,u pakësuan, ashtu që nuk i ndieja, vetëm nga një pikë. Atëherë i thashë babait tim:**

- Përgjigjui për mua Pejgamberit të All-llahut.

**- Pasha All-llahun, nuk di çka t,i them Pejgamberit të All-llahut tha (Ebu Bekri r.a.).**

**- Mandej i thashë nënës time: Përgjigjui për mua Pejgamberit të All-llahut në atë çka tha ai.**

- Jo, pasha All-llahun, nuk di çka t,i them Pejgamberit s.a.v.s., u përgjigj ajo.

Mandej Aisheja tha:

- Unë jam femër e re shumë, nuk këndoj shumë Kur,an. Pasha All-llahun vazhdova - me siguri, e di se ju keni dëguar çka flasin bota, kjo u ka rënë ta dini dhe ju besoni në atë, edhe po t,ju them se unë jam e pafajshme, e pastër nga ajo çka flitet, këtë All-llahu e di se jam e pastër, ju nuk do të më besoni: por nëse unë e pranoj atë shpifje, e All-llahu e di se unë jam e pastër, ju do të besoni. Pasha All-llahun, unë e kam, njëlloj sikur që e

---

---

keni edhe ju, shembullin vetëm te babai i Jusufit kur tha: “... **Sabrun xhemil, se All-llahu është ai prej të cilit mund të kërkohet ndihmë kundër asaj që po flisni.,**’

Pastaj u vendosa në shtrojen time me shpresë se All-llahu do të më shpëtojë nga shpifja. Por, pasha All-llahun nuk kam **menduar se mund të vijë Shpallje e veçantë për rastin tim**, e konsideroja veten jo të denjë që Kur’ani të trajtojë çështjen time, porse kisha **vetëm shpresën** se Pejgamberi a.s. do ta shohë në ëndërr që All-llahu po më shpëton nga shpifja. Dhe, pasha All-llahun, akoma pa luajtur a l vendit, dhe askush nuk kishte dalë nga shtëpiarët, erdhi Shpallja dhe e kaploi si giithmonë në raste të ulla, temperatura ashtu që djersët i rridhnin si xhevahir (qelibar) në ditë të ftohtë, dhe kur i kaloi kjo, Pejgamberi a.s. buzëqeshi. Fjalën e parë që e tha, me këtë rast, ishte:

- **Aishe, falëndero All-llahun, All-llahu të ka shpëtuar** (erdhi Shpallja se je e pafajshme, je e pastër).

Nëna ime, pastaj, më tha: “**Shko te Pejgamben a.s.**”

- Jo, i thashë. **Nuk i afrohem dhe nuk i falënderoj askujt përveç All-llahut. All-llahu xh.sh. atëherë ka shpallur: “Ata**

---

*133 “Ata që kanë trilluar shpife ju mos e konsideroni atë si ndonjë krim ndaj jush. Jo, ajo është mirë për ju. Secili prej tyre do të jetë i dënuar sipas mëkatit që e ka merituar; atë, të cilin e udhëheq arroganca e vet, e pret vuajtje e madhe.”*

*“Sikur mos ta dëgjonit atë (shpitie), besimtarët dhe besimtarët do të mendonin mirë për vete dhe do të thonin: “kjo është gënjeshtër e qartë”. “Pse nuk i sollën katër dëshmitarë? Pra, pasi nuk sollën dëshmitarë, tek All-llahu ata janë gënjeshtarë.”*

*“Sikur të mos jetë mirësia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij në këtë botë, dhe në batën tjetër, për shkak të mëkateve që keni bërë, do t’u kishte goditur dënim i rëndë”.*

*“Kur keni filluar që me gjuhën tuaj ta tregoni atë dhe me plot gojën keni folur atë për çka nuk keni ditur asgjë, e keni konsideruar imtësi, por ajo tek All-llahu është e madhe”.*

*“Sikur, sapo e dëgjuat atë, të kishit thënë: “Neve nuk na ka hije të flasim për këtë, Ti qofsh lavdërnar!Kjo është shpifje e madhe”.*

*“All-llahu ju këshillon që, një gjë të tillë, nëse jeni besimtarë, kurrë të*

---

---

---

**që kanë trilluar shpifje...**<sup>133</sup>

**Kur e shpalli All-llahu** xh.sh. këtë për pafajsinë time, Ebu Bekr es-Siddiku r.a. tha, e ky mbante, e kishte nën mbikqyreje, Mistah b. Uthathe sepse e kishte farefis: **“Për Mistahin nuk jap më, nuk harxhoj asgjë, pasi që ka folur kështu për Aishen.”**

Pastaj është shpallur nga All-llahu: *“Mos ta lëshojnë rastin ata që kanë pasuri...”*<sup>134</sup>

Ebu Bekr es-siddiku, atëherë, tha: “Pasha All-llahun unë gjithsesi dëshiroj që All-llahu të më falë” dhe përësi filloi t’ia japë Mistahut ndihmën që i jepte me përpara.

Pejgamberi i All-llahut për rastin tim e pyeste edhe Zeineh b. Xhahshin, i thoshte: **“Zejneb, çka di të për atë që ke dëgjuar?”**

**- O Pejgamber i All-llahut** - iu përgjigj ajo - **më ruaj Zot veshët dhe sytë e mi** (nga rrena), pasha All-llahun, unë di vetëm mirë për të. Ajo është, tha Zejnebeja, e ngritur, edukuar në famë, e All-llahu e ka ruajtur me devotshmëri.

Buhariu thotë, të njejtën gjë na ka treguar edhe Fulejhi që transmeton nga Hisham b. Urve, ky nga Urve, dhe ai nga Aisheja dhe Abdullah b. Zubejri. Gjithashtu, njëlloj, na ka transmetuar - thotë Buhariu - edhe Fulejhi nga Rebia b. Ebi Abdurrahman dhe Jahia b. Seid, të cilët përciellin nga Kasim b. Muhammed b. Ebi Bekri *mos e përsëritni*”.

*“E All-llahu ua sqaron ajetet, sepse All-llahu është shumë i dijtëm dhe i-urtë”.*

*“Ata të cilët dëshirojnë që te beismtarët të përkapet amoraliteti, i pret dënim i dhëmbeskëm në këtë dhe në botën tjetër. All-llahu e di, por ju nuk e dini.*

*“Sikur të mos ishte mirësia e All-llahut ndaj jush dhe mëshira e Tij, mirëpo, All-llai’u me të vërtetë është shumë i butë e i mëshirshëm».* (Nur,20).

<sup>134</sup> *Mos ta lëshojnë rastin ata të cilët kanë pasuri e mjete nga ju, t u japin të apermëve dbe të ngratëve, edbe atyre që për hirë të All-llabut kanë lënë vendlindjen e vet; le t’ua falin dbe mos t’ua zënë për gabim! A dëshironi që edhe juve All-llahu t’ua falë’ All-llabu falë dbe është sbumë i mEsbirshëm».* (Nur, 22)

---

---

**ËSHTË E MJAFTUESHME QË PAFAJËSINË E NJERIUT TA VERIFIKOJË VETËM NJË INDIVID**

Ebu Xhemil ka thënë:

E kam gjetur një fëmijë të hudhur dhe kur më pa Umeri, tha: “Ndoshta është fatkeqësi nga Al-Gujejri. Duket se ky dyshoi në mua, prandaj plaku i katundit tha: “Ky është njeri i mirë , çka Umeri e vërtetoi dhe tha: “Shko ti sepse **kujdesi ndaj fëmijës na takon** neve (shtetit).

**2662.** - Na ka treguar Muhammed Ibnu Selam të cilit i kumtoi Abdu-l-Vehabi, këtij Halid al-Hadh-dhai ai nga Abdurrahman b. Ebi Bekr, ky nga babai i vet i cili ka thënë:

- Një njeri lavdëroi njërin përpara Pejgamberit a.s. dhe **Muhammedi a.s. tha disa herë: “I mjeri ti, ia preve kryet shokut tënd ia preve kryet shokut tënd,,.**

Pastaj tha: “Secili nga ju që do të lavdërojë vëllanë e vet, le të thotë, gjithsesi, “Mendoj se është kështu e kështu”, All-llahut i **përket mirësia e tij, përveç All-llahut nuk e di askush tjetrin si është.** Mendoj se është kështu e kështu, nëse Ai e di për të tillë. (Krahaso: 6061, 6162).

**NUK ËSHTË E PËLQYESHME TA LAVDËROSH NDOKEND PËR TEPË; LE TË THOTË VETËM ATË ÇKA DI PËR NJË NJERI**

**2663** - Na ka treuar Muhammed b. Sabbah, këtij Ismail b.Zekerija të cilit i transmeton Burejd b.Abdullahu nga Ebu Burde, ky nga Ebu Musa r.a. i cili ka thënë se Pejgamberi s.a.v.s. e dëgjoi një njeri se si e lavdëronte një tjetër, dhe e teproi në lëvdaga, prandaj i tha:

E shkatërruat, gjegjësisht ia pret shpinën atij njeriu (Krahaso: 6060).

---

## PJEKURIA E FËMIJËVE DHE DËSHMIA E TYRE

All-llahu xh.sh. thotë: “Kur fëmijët tuaj arrijnë moshën e pjekurisë..”<sup>135</sup>

Mugire ka thënë: “Pjekuria, pubertiteti im ka filluar në moshën 12 vjeçare.

Pubertiteti i femrave fillon me mensturacionin e parë, sipas fjalës së All-llahut të Lartmadhërishëm: “E ato që nuk e kanë në rregull pastrimin mujor..”<sup>136</sup>

Kurse Hasan b.Salih thotë: Mbaje mend se një vajzë, bij, jona është bërë gjyshe në moshën 21 vjeçare.”

**2664.** Na ka treguar Ubjedullahu b. Seid, këtij Ebu Usame të cilat Ibn Umeri r.a. ka thënë se ky iu paraqit Pejgamberit a.s. të marrë pjesë në luftën e Uhudit, kur i kishte vetëm 14 vjet. Ai

---

<sup>135</sup> Edhe kur fëmijet tuaj arrijnë moshën e pjekurisë le të lypin lejë (për të hy) ashtu sicc kanë lypur lejë ata përpara tyre. Ashtu All-llahu ua shpjegon ligjet e veta. All-llahu është shumëi dijsëm dhe i urtë.” (Nur 59).

<sup>136</sup> “Kurse, ata, gratë e të cilëve, që nuk e kanë në rregull pastrimin mujor (mensturacionet), në mos e paccin ditur, “Iddeti” i ktyre është tre muaj, sikurse edhe ato që nuk kanë pasur mensturacion. Shtatzënat presin deri sa të lindin. Kush i ruhet All-llahut, Ai do t’ia lehtësojë punën e tij/”

“Ja, këto janë dispzitat e All-llahut që ua shpallë juve, kush i rhet All-llahut, Ai do t’ia neutralizojë veprat e këqija të tij dhe do t’ia rritë shpërblimin.”

“Le të banojnë ku banoni edhe ju, sipas mundësive tuaja, dhe mos u beni dëm me qëllim që t’i ngushtoni. Nëse janë me barrë furnizoni deri sa të lindin; e në se u japin gji fëmijëve tuaj, atëherë atyre jepuni shpërbilin e vet dhe merruni vesh ne mes veti. E në qoftë se keni vëshitrësi, atëherë le t’ua jep gji tjetra.”

“Ai që ka, le të shpenzojë sipas ppasurisë së vet, por edhe ai që shtë në skamje le të shpenzojë nga tajo që i ka dhënë All-llahu, sepse All-llahu nuk ngarkon askënd më tepër se sa i kën dhënë. All-llahu me siguri pas një vështirësie bën lehtësimin.” (Talak; 4-7)

nk më lejoi.

Pastaj jam paraqitur në fultë e Hendekut, tani kihsa 15 vjet, dhe tash më lejoi.

Nafiu ka thënë: Erdha te Emer b. Abdu-l-Azisi, kur ishte halif, dhe ia paraqita këtë rast e ai tha: “Me të vërtetë ky është kufiri i fëmijërisë dhe pjekurisë te meshkujt, dhe u shkroi me këmbësve të vet që të përgatisin mjete ushatarake për ata që i kanë mbushur 15 vejt (Krahaso: 4097).

**2665** – Na ka treguar Ali b. Abdullahi, këtij Sufjani të cilit i kumtoi Safvan b. Sulejmani nga A'ta b. Jesara, ky nga Ebu Seid Hudari t.a. se ky ka ardhur te Pejgamberi a.s. dhe ai i ka thënë:

-Pastrimi, larja, ditën e xhuma është detyrë për secili të moshuar (që ka hyrë në pubertet)

### **PYETJA E GJYKATËSIT PËR PROKURORIN PËRPARA BETIMIT: “A KE ARGUMENT?”**

**2666, 2667.**- Na ka treguar Muhammedi se i ka rrëfyer Ebu Muaviu duke transmetuar nga A'meshi, ai nga Shekiku, ky nga Abdullahu r.a. që ka thënë:

**Pejgamberi i All-llahut, ka thënë: “Kush betohet dhe pajtohet me atë që ka gabuar për t’ia rrëmbyer pasurinë muslimanit, kur të dalë para All-llahut, Ai që të jetë i zmerëruar ndaj këtij.”**

Abdullahu ka deklaruar se Esh'ath b. Kajsi ka thënë:

-Pasha All-llahun, kjo ka qenë për shkak timin. Ndërmjet meje dhe një hebreji ishte një tokë ndaj të cilës ai ma mohonte pronësin, dhe unë e solla te Pejgamberi a.s. dhe Alejhisselame tha:- A ke argument? Jo, u përgigja, thotë, Esh'athi.

- Pastaj, thotë Esh,athi, i tha hebrejit “Betohu».

---

- Unë i thashe, thotë përsëri Esh' athi, o Pejgamber i All-llahut, po kur të betohet ai mua më shkon pasuria.

Ateherë All-llahu xh.xh shpalli- "Ata të cilët obligimin e vet ndaj. All-llahut..."<sup>137</sup>

## BETIMI I PËRKET TË PADITURIT NË SENDET FIZIKO-PENALE

-Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: "Duhet dy dëshmitarë ose betimi i të paditurit."

Kutejbe ka deklaruar se i ka thënë Sufjani nga Ibn Shubrume: Më ka rrëgyer Ebu Zinad për dëshminë e dëshmitarit dhe betimin e prokurorit. Unë e kam thënë:

- I lartëmadhërishmi ka thënë: "**Dhe sillni dy dëshmitarë...**"<sup>138</sup>

Nëse është e mjaftueshme - i thashë - dëshmija e dëshmitarit dhe betimi i prokurorit, atëherë nuk ka nevojë të përkujtojnë njeri-tjetrin, dhe çka do të ndodhë me vërejtjen e tjetrës palë.

**2668.** - Na ka treguar Ebu Nujam, këtij Nafi b. Umer nga Ibn b. Mulejke: Ibn Abbasi r.a. ka shënuar se **Pejgamberi s.a.v.s. ka vendos që betimi i përket të paditurit.**<sup>139</sup>

**2669, 2670.** - Na ka treguar Osman b. Ebi Sheibe se i ka

---

<sup>137</sup>"Ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak – në botën tjetër nuk kanë asgjë, atyre All-llahu në ditën e kijametit nuk do t' u flasë fare e as do t' i shikojë, dhe nuk i pastorn – ata e kanë për të vuajtur dënim të dhembshëm". (Imran:77).

<sup>138</sup> "...Dhe sillni dy dëshmitarë, dy meshkuj nga ju, e nëse nuk ka dy meshkuj, atëherë një mashkull e dy femra me dëshminë e të cilave jeni të kënaqur. Nëse njëra prej atyre harron le ta përkujtojë tjetra.... (Bekare: 282).

<sup>139</sup> Betimi bëhet me kërkesën e palës kundërt në kontest, Gjykatësi ka mundësi që pa kërkesën e palës të afrojë palën tjetër për betim, si:

a). nëse dikush kërkon ndonjë të drejtë në pasurinë që ka lënë tjetër kush dhe e argumenton këtë, gjykatësi do t,i propozojë prokurorit (ai që **padit**) **betimin** se ai këtë obligim nuk e ka paguar as personalisht e as me ndërmjetës, por as që e ka liruar të vdekurin nga ai obligim, nuk ia ka fal,

kamtuar Xheriti nga Mensuri, ky nga Ebu Vaili i cili ka thënë:  
Abdullahu tha:

- Kush betohet me qëllim që të fitojë ndonjë pasuri të huaj, do të dalë para All-llahut, e Ai do të jetë i zemëtuar ndaj tij. Ndërkaq i Lartëmadhërishmi All-llah, duke konfirmuar këtë, shpalli: **“Me siguri ata që obligmin e vet ndaj All-llahut...”**<sup>140</sup>

Mandej doli Eshath b. Kaisi dhe pyeti: Çka u tha Ebu Abdurrahmani;

Ne i shpieguam se çka na tha, dhe ai vazhdoi:

- Ajo është e vërtetë. Është shpallur për shkak timinn. Unë e kisha një kontest me një njeri përr një problem dhe dolëm para Pejgamberit a.s. e ai tha. “ose dy dëshmitarët tu ose betimi i atij».

- Ai sigurisht do të betohet - i thashë - nuk e ka dert.

Pasta; Pejgamberi as. tha: **“Ai që betohet rrejshëm me qëllim** që të fitojë të drejten e huaj, do ta takojë All-llahun, e Ai

---

e as pra që ia ka lëshuar këtë ndonjë të treti, se nuk ka marrë asgjë prej askujt dhe se ai nuk ka garancë nga i vdekuri;

b) nëse dikush kërkon të drejtën e vet në pasuri dhe këtë e argumenton me padinë e vet, gjyqji i betohet se ai këtë pasuri nuk ia ka shitur askujt, as ia ka falur, me fjalë tjera nuk e ka tëhuaisuar;

c) nëse blerësi dëshiron ta kthej prap sendin e blerë për shkak të ndonjë të mete, gjyqji do t’i kërkojë betimin se nuk ka qenë i kënaqur me atë send sapo e ka vëreitur të metën;

d) Nëse ndokujt i jepet vendim të blejë me përparësi gjyqji do të kërkojë të betohet se ai nuk e ka shkëput, atë të drejtë.

Pala në kontest gjyqësor për kontratën që është detyruar të betohet, nëse e refuzon betimin në mënyrë decidive ose me heshtie, gjyqji) i merr vendim në bazë të dorëheqjes së tij nga betimi, dhe nëse ajo palë dëshiron, pasi të kryhet gjykimi, të bëjë be ajo kërkesë nuk i përfilllet.

Betimi i memecit ose refuzimi i tij të bëjë be jan të plotfuqishme kur ai të shprehet me shenjat adeknata për memecë. (*Mexhel-le i abkami-sherijje*)

<sup>140</sup> “Ata të cilët obligimin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak- në botën tjetër nuk kanë asgjë, atyre All-llahut në ditën e Kijametit nuk do t’u flasë fare e as do t’i shohë, dhe nuk i pastron ata kanë për të vuajtur dënim të dhimbshëm.” (*Imram:77*)

---

---

do të jetë **i zemëruar ndaj tij**. Atëherë All-llahu xh.sh. shpalli si konfirmim kesaj ajetin e lartpërmendur.

**NËSE DIKUSH VËRTETON DIÇKA OSE  
PËRGËNJESHTRON DUHET T'I LYPET  
ARGUMENT DHE TË PARAQESË ARGUMENTIN E  
KËKRUKAR**

**2671.** - Muhammed b. Beshan na ka treguar se i ka transmetuar Ibn Ebi Adij nga Hishami, këtij Ikrime nga Ibn Abbasi r.a. se Hilal b. Umejje shpifi për gruan e vet të Pejgamberi a.s. (për amoralitet) me Sherik b. Sehma. **Pejgamben a.s. i tha:**

- Argumentin ose kamxhikun shpines tënde?

- o Pejgamber i All-llahut, tha ai, kur dikush prej nesh sheh njeriun mbi grua të vet a nis të kërkojë (dëshmitare) argument..., kurse Muhammedi a.s. prapë vazhdoi: **“Argumentin ose kamxhikun shpinës tënde,”**

Ibn Abbasi, pastaj, përmendi hadithin e betimit-mallikimit të ndërsjellë. (Krahaso: 4747, 5307).

**BETIMI PAS IQINDISË**

**2672.** Na ka treguar Ali b. Abdullah, këtij i kumtoi Xherir b. Abdul-Hamidi nga A'meshi, ky nga Ebu Salibu, kurse ai nga Ebu Hurejre r.a. i cili deklaroi se Pejgamberi a.s. ka thënë:

-Janë tre gurpe njerëzish me të cilët All-llahu nuk do të flasë, nuk do t'i shiqojë dhe nuk do t'i lirojë nga gabimet dhe ata i pret dënim (në ditën e Kijametit).

a) njeriu që ka ujë, gjatë rrugës, dhe nuk i jep udhëtarit tjetër hiq

b) njeriu që i shet dikujt ndonjë send vetëm për levërdi të kësaj bote, vetëm për këtë interes, dhe kur ia paguan shumën që ky dëshiron do të premtojë por nuk do ta plotësojë atë premtim, dhe

c) njeriu i cili ia shet, vlerëson, tjetrit mallin pas iqindisë (kah

mbrëmja - terri) dhe bën be rrjeshëm në Zotin se për atë send ka dhënë kaq e kaq, dhe blerësi e merr, e blen.

**I AKUZUARI BETOHET MENJËHERE  
SAPO T,I KERKOHET DHE NUK SHKON  
NGA NJËRI VEND NË TJETRIN**

Mervani i urdhëroi Zejd b. Thabitit të betohet qysh në minber:

**“Betohu për këtë menjëherë aty ku je, në vend,,** dhe Zejdi deshi të betohet, por hoqi dorë nga betimi në minher dhe Mervani u habit për këtë.

**Pejgamberi s.a.v.s. tha: “ose dy dëshmitarët tu ose betimi i tij”** por nuk e thesoi në mënyrë të veçantë njërën më shumë se tjetrën.

**2673.** - Na ka treguar Musa b. Ismail të cili i transmetoi Ahdu-l-Vahidi nga A'meshi, ky nga Ebu Vaili, ky nga Ibn Mes'udi r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. tha:

- Kush betohet që të **rrëmbejë ndonjë pasuri, do ta takojë All-llahun**, por Ai do të jetë i zemëruar ndaj tij.”

**KUR NJEREZIT SHPEJTOJNË NË BETIM**

**2674.** - Na ka treguar Is-hak b. Nasr, këtij AbdurezaLu, të cilit Ma,meri i transmeton nga Hemmami, ky nga e Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. u afroi disa njerëzve betimin dhe ata shpejtuan të gjithë, prandaj ly urdhëroi që ata të heqin short ndërmjet veti cili prej tyre do të betohet.

**FJALËT E TË LARTMADHËRISHMIT ALL-LLAH**

«Ata të cilët obligmin e vet ndaj All-llahut dhe besatimin e vet e shesin për diçka që vlen krejt pak në botë tjetër nuk kanë

---

<sup>141</sup> Kur'an, 3: 77.

---

asgjë, atyre All-llabu në ditën e kijametit nuk do t' u flasë fare e as do t' i shikojë, dhe nuk i pastron - ata kanë për të vuajtur dënim të dhembshëm».<sup>141</sup>

**2675.** - Na ka treguar Is-haku se i ka kumtuar Jezid b. Hanm, këij Aëami, të cilit i transmetoi Ibrahim Ebu Ismail Es-Sekeski që e ka dëgjuar Abdullah b. Ebi Evfa' r.a. duke thënë:

- Një njeri ekspozoi mallin e vet dhe bënte be në All-llahun se për atë ka dhënë aq para sa nuk ishte e vërtetë, prandaj është shpallur: "Me të vërtetë..."<sup>142</sup>

Ibn Ebi Evfa thotë: **"Kush betohet, ai rren dhe ha kamatën"**

**2676, 2677.** - Na ka treguar BisEr b. Halid, këij Muhammed b. Xhafer i transmetoi nga Shu'be, ky nga Sulejmani, ai nga Ebu Vaili, ky nga Abdullahu r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

- Kush betohet rrejshëm që t,ia rrëmbejë pasurinë dikujt, ose ka thënë: "... e vëllaut të vet, do të takohet në All-llahun, e Ai do të jetë i zemëmar në të.,, Për ta konfirmuar këtë All-llahu në Kur'an thotë: "<sup>143</sup>

Më vonë më takoi Esh'athi dhe më pyeti:

-Çka ju tha sot Abdullahu? Këtë e këtë, iu përgjigja. Ai ajete është shpallur për shkak timin, thë Esh'athi.

## SI BËHET BETIMI

All-llahu i Lartëmadhërishtëm ka thënë: "*të përbetohem në Allllahu ..*"<sup>144</sup>, por fjalë e Tijë është edhe: "*.. të afrohen ty duke u betuar në All-llahun...*"<sup>145</sup>

Thuhet "Bil-lahi", "Tall-llahi", dhe "Vall-llahi" që do të thotë:

---

142 Shih Shënimin 141.

143 Shih Shënimin 141.

144- Kur'an, 9: 62.

145 "*E çka do të ndodhë kur, për shkak të veprave që i kanë bërë vetë, ata `i godas ndonjë fatkeqësi, dhe të vijnë ty duke u betuar në All-llahun: Ne vetëm kemi dëshiruar mirësi dhe pajtim".Nisa: 62)*

---

Pasha All-llahun, kurse Pejgamberi a.s. ka thënë: “...njeriu që bën **be në All-llahun rrejshëm pas iqindisë nuk betohet ndryshe.**’

**2678.** - Na ka treguar Ismail b. Abdullah dhe thotë se i ka transmestuar Maliku nga Mixha i vet Ebu Suhejli, ky nga habai i vet se ka dëguar nga Talha b. Ubjedullahi r.a. duke thënë:

- Erdhi një njeri te Pejgamberi a.s. dhe e pyeti për fenë Islame e ky iu përgjigj: Pesë kohë namazi gjatë një dite dhe një nate.

- A kam hala ndonjë, përveç këtyre, e pyeti ky. **Jo, përveç nëse ti dëshiron vullnetarisht të falësh,** iu përgjigj, ai.

- Pastaj Pejgamberi a.s. tha: Agjërimi i muajit Ramazan.

- **A kam ndonjë borxh tjetër përveç këtij, e pyeti ky. Jo, përveç nëse ti dëshiron vullnetarisht të agjërosh,** iu përgjigj ai.

- Mandej, thotë Talha, Pejgamberi a.s. përmendi zeqatin, e ky i tha: A kam hala ndonjë borxh përveç kësaj? Jo, vetëm nëse dëshiron ti vullnetarisht - i tha ai.

- Njeriu pastaj u kthye, thotë Talha, duke thënë:

- **Pasha All-llahun kësaj nuk kam për t,i shtuar e as t,i hequr asgjë.**

- **Ky ka shpëtuar nëse e thotë të vërtetën** - tha Pejgamberi a.s.

**2679.** - Na ka treguar Musa b. Ismail, këij i kumtoi Xhujejri nga Naf-u, ky nga Abdullahu r.a. se **Pejgamberi a.s. daklaroi:**

- **Kush betohet, le të betohet në All-llahun ose le të heshtë.** (Krahaso: 3836, 6108, 6646, 6648).

## **SJELLJA E ARGUMENTIT PAS BETIMIT (TË PADITURIT)**

Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: ‘**Ndoshta ndokush prej jush e argumenton më mirë me argumentin e tij se sa ai tjetri.,,**

Tavusi, Shurejhi dhe Ibrabimi kanë thënë: “Argumenti i besueshëm është më i vlefshëm se betimi i rrejshëm.,,

---

**2680.** - Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, i cili transmeton nga Maliku, ky nga babai i vet, kurse ai nga Zejnebja, ajo nga Ummi Selemeja r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë:

- **Ju i kontestoni gjërat te unë, por ndoshta dikush prej jush me argumentet e veta argumenton më mirë se tjetri, prandaj nëse ndokujt i jap ndonjë të drejtë të vëllait të vet në bazë të prezentimit të tij (argumentimit të tij të rrejshëm) i kam dhënë një pjesë të zjarrit të xhehennemit, pra ai mos ta marrë.**

## **KUSH KA URDHËRUAR ZBATIMIN E PREMTIMIT**

Këtë e ka bërë Hasan (Basriu), duke përmendur Ismailin a.s. se ka qenë i sinqertë në premtime.

Ibn Eshve ka vendsour (dhënë vendim) të zbatohet premtimi duke transmetuar këtë nga Semur, kurse Misver b. Mehreme ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. i cili përmendi edhe vjehrrin e vet, dhe tha: **“Më premtoi dhe e zbatoi premtimin.”**”

Ebu Abdullahu ka thënë: E kam parë Is-hak b. Ibrahimin që e verifikonte këtë me deklaratën e Ibn Eshvetit.

**2681.** - Më ka treguar Ibrahim b. Hamza, këtij Ibrahim b. Sa'd b. Abdullah, se Abdullah b. Abbasi r.a. i kamtoi: Ebi SuElani më ka transmetuar se Herkeli i tha: **“Të kam pyetur çka ju urdhëron ai (Muhammedi)?”**

- Ti ke konfirmuar se ju urdhëron namazin, zekatin, modestinë dhe zbatimin e kontratave, ruajtien e amanetit që të besohet, e kjo është veti e secilit Pejgamber - ka thënë Herakliu.

**2682.** - Na ka treguar Kutejbe b. Seld se i ka transmetuar Ismail b. Xhaferi nga Ebu Suheil b. Nafi' b. Malik b. Ebi Amir, ky nga babai i vet ndërsa ai nga Ebu HureJreja r.a. se **Pejgamben a.s. ka thënë:**

- Dyfytërëshi, hipokriti, ka tre shenja: kur net rren, nëse i besohet ndonjë send ai tradhton dhe kur premtion diçka, nuk e zbaton.”

**2683.** - Na ka treguar Ibrahim b. Musa, këtij i kamtoi Hishami

---

nga:, Ibn Xhurejxhi i cili ka thënë:

Më ka transmetuar Amr b. Dinar nga Muhammed b. Aliu, ky nga Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili ka thënë:

- Kur ndërroi jetë Pejgamberi a.s. Ebu Bekrit i arritën të ardhura nga A'la b. Hadremiu (mëkëmbës i Bahrejnit) dhe Ebu Bekri tha: "Kush ka pasur ndonjë kërkesë nga Pejgamben a.s. (ndonjë borxh) ose ai i ka premtuar ndonjë send, le të vijë te ne,,.

- Unë - thotë Xhabiri - atëherë i thashë:

Pejgamberi s.a.v.s. më ka premtuar se do të më japi kaq, kaq dhe kaq duke zgjatur duart e mia tri herë, dhe Ebu Bekri m'i numëroi në dorë pesëqind, pastaj edhe pesëqind, e mandej edhe pesëqind (dërhëmë).

**2684.** - Më ka treguar Muharnmed b. Abdurrahman, këij Seid b. Sulejarn se i ka transmetuar Mervan b. Shuxha nga Salim el-Eftasi ky nga Said b. Xhubejri, i cili ka thënë:

Më pyeti një hebrej, banorë i Hirës: Musa cilin nga dy premimet ka zbatuar? Nuk di, i thashë, pa shkuar të pyes ndonjë dijetar arab. Shkova dhe e pyeta Ibn Abbasin, e ai tha: I ka zbatuar dy premtimet më të mira e të dashur për (Shuajbin), sepse kur ka thënë diçka ndonjëri nga Pejgamberët e All-llahut, ai edhe e ka bërë atë, e ka plotësuar', .<sup>146</sup>

## **POLITESITI NUK DO TË MERRET PËR DËSHMITAR APO DIÇKA TJETËR**

Sha,biu ka thënë: Nuk është e lejuar dëshmia e ithtarit të fesë tjetër kundër njëri-tjetrit, kurse All-llahu xh.sh. thotë: "...

---

146 Për rastinn e përmendur bëhet fjalë në ajetet 22-28 të sures Kasas

147 Kur'an, 5: 14.

---

**prandaj u kemi shtënë urrejtjen në mes tyre....,**<sup>147</sup>

Ebu Hurejre r.a. transmeton nga Pejgamberi a.s.

- **Mos u besoni ithtarëve të librave tjera, por mos detyroni të gënjejnë thuani: I besojmë All-llahut dhe asaj çka ka shpallur...**<sup>148</sup>

**2685.** - Na ka treguar Jahja, b. Bukejr, këiij Lejthi i transmetoi nga Junus, ky nga Ibn Shihabi, ai nga Ubjedullah b. Abdullah b. Utbe, kurse ai nga Ibn Abbasi r.a. i cili ka thënë:

- O muslimanë të tubuar si do të pyesni ithtarët e librit tjetër, kur Libri juaj, i shpallur Pejgamberit a.s. përmban sqarimet më të reja për All-llahutn; ju atë e lexoni, nuk është i falsifikuar, dhe All-llahu kua treguar se ithtarët e Librave të mëhershme, që ua ka dërguar All-llahu, i kanë shtrembëruar dhe ndryshuar atë Libër me duar të veta dhe kanë thënë: :Kjo është nga All-llahu për të blerë me të diçka të pavlefshme “. (Kur,an, 2:79)

- Po a nuk ju ndalon juve ajo që u ka ardhur t’i pyesni ata. Jo, pasha All-llahutn, kurrë nuk kemi parë ndojnë prej tyre që t’ju pyes lidhur me atë cka u është shpallur(Krahaso: 7263, 7522,

---

148 “*Thuani: «Ne i besojmë All-llahut dhe çka na është shpallur neve çka i është shpallur Ibrabimit, Ismailit dhe Is-hahut dhe Jahubit, dhe pasardhësve dhe çka i është dhënë Musaut dhe Isait, edhe në atë çka u është dhënë profetëve nga Zoti i tyre, ne nuk e dallojmë asnjë nga mesi i tyre, ne atij i jemi nënshtruar.»*

“Andaj, nëse kanë besuar ashtu siç i besuat Ju, janë në rrugë të drejtë, e nëse kthehen nga kjo rrugë, atëherë janë në kundërshtim, por All-llahu të mjafton kundër atyre. Ai i dëgjon dhe i di të gjitha. (Bekaretu: 136-137).

Muslimanët duhet të besojnë të gjithë të dërguarit (pejgamberët) e Izraelitëve dhe të krishterëve të cilët kanë pranuar shpallje nga All-llahu. Për këtë arsye feja Islame është fe gjithnjëzore. Ky është mësim islam që i përket periudhës kur ebrenjt dhe të krishterët përpiqeshin të bashkojnë forcat e tyre dhe ta zhduknin këtë besim.

7523).

## **TËRHEQJ AE SHORTIT NË RASTE PROBLEMATIKE DHE FJALA E ALL-LLAHUT**

.. Kur ata i hodhnë pendat e tyre .. <sup>149</sup>

Ibn Abbasi ka thënë: Kanë hedhur short dhe pendat vendosin rrjedhën e gjykimit. Penda e Zekerijjaut vendosi këtë rast dhe këtë (Merjemen) e mori nën mbrojtje

I lartmadhërisht All-llahu thotë: "... dhe hoqën short.. <sup>150</sup>

Ebu Hurejre r.a. ka thënë: Pejgamberi u afroi disa njerëzve të betohen dhe ata ngurruan, prandaj ai urdhëroi të hidhet shortimidis tyre se cili do të bëjë be.

**2686.**- Na ka treguar Umer b. Hafs b. Gijath i cili thotë më ka transmetuar babai im, tij A'meshi i ka thënë se e ka informuar Sh'biu se e ka dëgjuar Nu'man b. Beshirin r.a. duke thënë:

-Pejgamberi a.s. ka thënë: "ai që nuk i ruhet kufijve, ndalesave të All-llahut dhe ai që i then ata i ngajn njerëzve të cilët hedhin shortin për t'u vendosru në anije dhe dikush prej tyre arrin në pjesën e poshtme e tjetri në pjesën e epërme. Ata në pjesën e poshtme të barkës e kalojnë pranë ujit përmbi ata që janë në pjesën e epërme dhe me këtë i shqetësojnë, dhe dikush merr

---

<sup>149</sup>"Këto janë informata të fshehta që po ti shpallim ty. TI nuk ke qenë te ata kur i huhdën pendat e tyre (për short) për të parë se cilit prej tyre do t'i lihet në besim Merjemja, dhe ti nuk ishe me ata kur shtyheshin ndër veti."

<sup>150</sup>. Me këto që përmend më lart alutdohet në rastin që është mbarshTURUAR në ajetet 141-148 nga sureja Saffat: "Tërhaqi hsortin dhe shorti i ra atij. DHe e gëlltiti peshk, sepse ai e meritonte këtë. dHe sikur ai të mos ishte prej atyre që e lartësonte (Allahun), Do të mbetej me sigur në barkun e tij deri në Ditën kur do të ringjalllen. Por Ne e nxorëm në një vend të shkretë, ndërsa ai i shte i sëmurë, e mbi të mbëltuam një lozë kungulli; Dhe atë e dërguam për një ëindmijë e më tepër njeësz. dhe ata i besuan, ndërsa Ne atëa i keqëaqëm deri në një afat të caktuar."

---

sopatën dhe fillon ta shpërthejë pjesën e poshtme të barkës, e ata vijën e i thonë: “Hej çka bën?”

-Më shqetësoni – u përgjigjet – mua më duhet ujë.

Nëse e mrrin, kapin për dorë, do ta shpëtojnë atë dhe vetveten, por nëse e lënë ai do t’i humbë me shithë të.

**2687.** - Na ka treguar Ebu-l-Jeman, këtij SHuajbi i transmeton nga Zuhriu: “Më ka transmetuar Harixhe b. Ensarja se Ummi A’ la njëra nga tratë e tyre iu betua për besnikëri Pejgamberit a.s. dhe i kumtoi se Osman b. Medhuni tërhoqi shortin për të banuar me rstin kur ensarjitë hudhënm shortin për vendosjen e muhaxhirëve, dhe Osman B. Madhun, thotë Ummi A’la, u vendos te ne. Ai pastaj u sëmur dhe ne kujdeseshim për të deri kur ndërroi jetë. Ne e mbështollë, e përgatitëm dhe erdhi Pejgamberi a.s. e unë i thashë: “All-llahu të mëshiroftë o Ebu Saib. Unë po dëshmojë, All-llahut të nderodfdtë”.

Atëherë Pejgamberi a.s. më tha: Kush të tha se All-llahi e ka nderuar? Nuk e di i thashë – O Pejgamber i All-llahut, t’u bëfsha kurban me nënë e me babë.

Pastaj Pejgamberi a.s. tha:Sa i përket Osmanit, ai , pash All-llahun ka qenë i bindur, dhe unë, pa dyshim ia shpresoj të mirën.Pasha All-llahutn, unë nukj e di se çka do të bëhet me të , e unë pra jam pejgamber.

Pasha All-llahun, tha Ummi A’la, pas asaj ngjarje kurrë më nuk kam marr kënd në mbrojtje, nuk e kam, arysetuar.

Kjo ngjarje, thotë Ummi A’la më mallëngjeu dhe më mori gjumi e në ëndërr pashë burimin e Osmanit duke rrjedhur.

Shkova te Pejgamberi i All-llahut dhe ia paraqita këtë, e ai tha: Ajo është ëpunë e tij e mirë.

**2688.** Nga ka trguar Muahmed b. Mukatil, këtij i kumtoi Abdullhu, atij Janusi i transmtion nga Zuhriu, se Urveja transmtoi nga Sisheja:

-Kur sëshronte Pejgamberi i All-llahut të niset në rrugë, hudhte shortin ndërmjet bashkëshortëve të veta, dhe kujt i dilte shorti, ajo shkante me ta. Ai secilë bashkëshorti i kushtonte,

---

caktonte një tidë e një ngnatë, përveçse SEcda b. Ze,'a që ia falte rendin e fvet Aishes, bashkëshortes së Pejgamberit a.s. duke dëshiruar që me këtë të fitojë simpatinë e të Dërguarit të Allahut.”

**2689.** Ismaili thotë: Më ka transmetuar Maliku nga Sumejj, rob i liruar i Ebu Bekrit, ai nga Abu Salihu, ky nga Ebu Hurejra r.a. se Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

**-Sikur ta dinë njerëzit se çka ka për këndimin e ezanit dhe në rendin e parë të namazit me xhemat, dhe nëse nuk do të gjenin mënyrë tjetër për të arritur te këtë, përveçse shortit, ata do të hudhin shortin. Po ta dinin çka ka në faljen me kohë të drekës di të shpejtonin, ngarkonin dhe sikur të dinin çka ka në jaci dhe në sabah, do të vinin ti falnin, qoftë edhe zधारë-barkasi**

---

**KREU 53**  
**PAJTIMI**

## **PAJTIMI (TË PAJTUARIT NDËRMJET NJERËZVE)**

All-llahu xh.sh. thotë. *“Në shumë biseda të tyre të. fsheht nuk ka ndonjë dobi, përveç se kur kërkojnë të ndahet sadabaja ose të bëhen vepra të mira ose të pajtojnë njerëz ndërrnjet veti. Dhe kush e bën atë me dëshirë që të ftojë simpatinë e All-llahut, Ne, me siguri, do ‘i japim shpërblim të madh’.* (Nisa: 114).

### **DALJA E KRYEFAMILJARIT ME SHOKE TË VET NË VENDIN E NGJARJES TË PAJTOJË NJERËZIT**

**2690.** - Na ka treguar Seid b. Ebi Merjem se i ka thënë Ebu Gassan: Më ka transmetuar Ebu Hazimi nga Sehl b. Saidi r.a. që disa njerëz nga fisi Benu Amr b. Avf kishin njëfarë kontesti ndërmjet, dhe Pejgamberi a.s. bashkë me disa shokë të vet shkoi t,i pajtojë. Hyri koha e namazit e Pejgamberi a.s. akoma nuk kishte ardhur. Erdhi Bilali e thirri ezanin për namaz, kurse Pejgamberi ende nuk kishte arritur. Atëherë Bilali hyri te Ebu Bekri dhe i tha:

- **Pejgamben a.s. u vonua, ka hyrë koha e namazit, a po del imam?**

- **Po, nëse dëshiron,** tha ai.

- Atëherë Bilali këndoi ikametin për namaz dhe Ebu Bekri kaloi përpara. Mandej erdhi Pejgamberi a.s. eci nëpër radhët e njerëzve deri kur arriti në radhën e parë të njerëzve e ata filluan të duartrokasin. Ebu Bekri gati nuk desh t,i vejë veshin fare, s'deshi të kthehet nga namazi, po të mos e kishin tepruar ata me duartrokitje. Atëherë u kthye dhe pa se pas tij ishte Pejgamberi a.s. Ai i bëri shenjë me dorë që të falë namazin ashtu (si e kishte

---

filluar), kurse Ebu Bekri ngriti dorën, falënderoi All-llahun dhe u tërhoq prapa, pas Pejgamberit deri sa u barazua me rendin e parë, Pejgamberi a.s. kaloi përpara dhe u fal me xhemat, por kur e kreu namazin, u kthye kah njerëzit, xhemati, dhe tha:

- **O burra, kur ndodh diçka në namaz ju me dorën e djathtë i bini shpinës së dorës së majtë. Kjo duartrokiite është vetëm për gratë.** Cilido që i ndodhë diçka në namaz, le të thotë “Subhanalllah” d.m.th. “Qofsh lartësuar o Zot!” dhe kushdo që e dëgjon do të kthehet. o Ebu Bekr, çka pate që kur të bëra shenjë me dorë (t’i falësh) nuk e fale xhematin?

- **Nuk i ka hije të birit të Ebu Kuhafes të prijë imam, para të dërguarit të All-llahut - u përgjigj ky.**

**2691.** - Na ka treguar Museddedi, këtij Mu'temiri i ka thënë: Kam dëgjuar nga babai im se Enesi r.a. ka thënë:

- Pejgamberit s.a.v.s. i thanë: Të vish te Abdullah b. Ubejji,,

Pejgamberi s.a.v.s. i hipi gomarit, u nis te ai dhe bashkë me ta u nisën edhe muslimanët dhe shkuan, ishte vend moçalik. Kur erdhi Pejgamberi s.a.v.s. ai i tha:

- Largohu nga unë! Pasha All-llahun, po më shqetëson era e gomarit tënd. Atëherë njëri nga ensaret tha:

- Pasha All-llahun, gomari i Pejgamberit s.a.v.s. me siguri, ka erë më të mirë se ti. Kjo e zemëroi njërin nga njerëzit e Abdullahut dhe u fjalosën. Secili prej këtyre dyve zemëronte shokët e tjetrit dbe erdhi puna në kacafytie me degë, me këpucë dhe duar. Më vonë na është kumtuar se për këtë shkak ishte shpallur: “... **Nëse dy grupe...**”<sup>151</sup>

## **NUK ESHTË RRENACAK KUSH PAJTON NJERËZ**

**2692** - Na ka treguar Abdu-l-Aziz b. Abdullah të cilit Ibrahim

---

151, “Nëse dy grupe besimtarësh bien në kundërshtim, pajtoni ata, ese njëri nga ata, megjithatë i bën dëm tjetrit, atëherë luftonte atë grup).

---

b.

Said i transmeton nga Salihu, kurse ai nga Ibn Shihabi se i ka kumtuar Humejd b. Abdurrahman që nëna e tij' Ummu Kulthumi, e bija e Ukbës i ka treguar se **ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:**

- Nuk është rrenacak ai që pajton nierëzit duke pëshpëritur për mire gjegjesisht thote diçka të mirë.

### **URDHËRI I "KRYEPLAKUT SHOKEVE TË VET: EJANI ME NE T'I PAJTOJMË**

**2693.** - Na ka treguar Muhammed b. ALdullah, këji Abdu-l-Aziz b. Abdullah el-Uvejsi dhe Is-hak b. Muhammed el-Fervi: Na ka transmetuar Muhammed b. Xhaferi nga Ebu Hazimi, ai nga Sahil b. Sa'id r.a. që banorët e Kubas u rrahë dhe u goditën me gurë dhe kur e lajmëruan për këtë Pejgamberin e All-llahut, ai tha:

**- Ejani me ne t'i pajtojmë.**

Fjalët e të lartmadhërishmit All-llah

"... Nëse ata dy bëjnë marrëveshje ndër veti, pajtimi është më i mirë...<sup>152</sup>

---

ka bërë krime derisa t' u bindet normave të All-llahut. Nëse binden, atëherë pajtoni ata pa mbajtur anën e askujt, dhe jini të drejtë! All-llahu njemend i do të drejtët». (Kur'ani, Huxhurat: 9).

Pajtueshmëria dhe uniteti i muslimanëve është themel i përparimit shoqëror dhe muslimanët janë të detyruar të intervenojnë në raste të mosmarrveshjeve dhe përçarjeve ndërmjet muslimanëve, midis anëtarësisë së vet.

152 "Në qoftë se ndonjë grua frikësohet nga kryeneqësia e burrit apo se do ta lërë pas shpine, atëherë nuk është mëkat nëse ata dy bëjnë marrëveshje ndërveti, pajtmi është më i mirë. Njerëzit janë krijuar grykësa, e në qoftë se ju silleni mirë dhe ruheni, All-llahu është i informuar shumë mirë për veprat tuaja". (Kur'an, Nisa: 128).

Nëse amoralitetin e ka kryer individi i pamartuar, i jepen njëgind të rame me kamxhik e pastaj internohet nga vendi ku e ka bërë veprën për një vit, sipas mendimit të Shafi' iut, Ahmedit, Is-hakut dhe disa bashkëkohanikëve të tyre. Mirëpo Maliku dhe Evaziu konsiderojnë se kamxhikimi dhe internimi janë vetëm për mashkullin e pamartuar, kurse për femrën e pamartuar vetëm

---

2694. - Na ka treguar Kutejbe b. Said, këtij i transmetoi Sufiani nga Hisham b. Urve, e ai nga babai i vet, kurse ky nga Aisheja r.a. e cila për ajetin **“Nëse gruaja frikësohet sjelljes së keqe... ka thënë:**

- Ai është njeriu që sheh te gruaja e vet diçka që nuk i pëlqen siç është pleqëria apo diçka tetër, dhe do të ndahet prej saj, e ajo thotë: “Më mbaj (mos më përzë), dhe furnizom sa dhe si mundesh”.

- **Këtu nuk ka gjë të keqe** - thotë Aisheja - **nëse ata dy pajtohen.**

## **NËSE PALËT BIEN VENDIM JO TË DREJTË AJO MARRËVESHJE NUK ËSHTË E VLEFSHME**

---

kamxhikosja mjafton.

Ibrahirn Nehaiu, Ebu Hanife, Muhamedi, Ebu Jusufi dhe Zuieri thonë:

“Kur bën amoralitet vajza (beqaresha) do të rrihet me njëqind kamxhikë, ndërsa internimi dhe gjatësia e kësaj mase varen nga qëndrimi gjyqit.

Dënimi shqiptohet me qëllim që ta përmirësojë fajtorin, e internimi mund të shtyjë edhe më tepër në gabime.

Halih Umer e përzuni nga Medineja një të dënuar, i cili më vonë shkoi në një vend joislam dhe e la fenë Islame dhe Umeri bëri be se më nuk do të zbatojë asi vendimi ndaj askujt.

Nga ky hadith mund të nënkuptohet edhe:

- nuk është e domosdoshme që edhe gjykatësi të jetë i pranishëm në ekzekutimin e dënimit ndaj fajtorit;

- gjykatësi duhet të jetë patjetër i aftë në profesionin e vet dhe vendimet t’i siellë në bazë të argumenteve të pakontestueshme. Vendimi që merret pa **argument është** i pavlefshëm dhe joligjor. Dëmi që paguhet në mënyrë joligjore duhet t’i kthehet palës menjëherë;

- dënimi me gurë ndaj lavirësisë zbatohet vetëm ndaj personit që e kryen veprën dërsia ka qenë nën kurorë, dhe kjo kërkon që aktin e kryer ta dëshmojnë katër dëshmitarë të besueshëm. Ata duhet të dëshmojnë se e kanë parë aktin seksual në detale, ose duhet që personi i akuzuar ta pranojë aktin e kryer. Këtë akt, sipas mendimit të Shafiut, duhet ta pranojë një herë, kurse sipas qëndrimit të Ibn Ebu Lejthit dhe Imam Ahmedit duhet ta pranojë katër herë.

2695, 2696. - Na ka treguar Ademi, këtij Ibn Ebi Dhi'bi, kurse këij i transmetoi Zuhriu nga Ubejdullahu, ai nga Ebu Hurejre dhe Zejd b. Halid el-Xhuheniye r.a. të cilët kanë deklaruar:

- Erdhi një beduin dhe tha: o Pejgamber i All-llahut, na giyka sipas Librit të All-llahut. Kundërshtari i tij pastaj u ngrit dhe tha:

**“E tha të vërtetën, gjykona sipas Librit të All-llahut”.**

Atëherë beduini tha: Djali im ishte rrogëtarë (për kaq para) por ka bërë amoralitet me gruan e tij dhe më thanë: Djalit tënd i bie dënimi me gurëzim, të rrihet me gurë”. Unë pastaj e lirova (pagova) djalin tim nga ky faj me njëqind dele dhe një robëreshë. Më vonë kam pyetur njerëz të dijshtëm që më thanë: “Djalit tënd i bie dënimi me njëqind të rëna, shkopinj, dhe të përzihet prej aty për një vit. **Pejgamberi a.s. tha:**

**- Pa dyshim do t'ju giykoj sipas Librit të All-llahut: Sa i përket robëreshës dhe dhenve, të kthehen ty, kurse djalit tënd i takojnë njëqind të ramet dhe përzënia për një vjet. Kurse ty o Unejs, si burrë të takon: të ngrihesh nesër herët dhe ta rrahësh me gurë gruan”.**

Unejsi, mandej, shkoi dhe e rrahu me gurë.

2697. - Na ka treguar Jakub, këtij Ibrabim b. Saddi i transmetoi nga babai i vet, ky nga Kasim b. Muhammedi, ky nga Aisheja r.a. që tha:

**- Pejgamberi a.s. ka thënë: “Ai që fut në këtë çështje (besimin tonë) risi që nuk i takon, ajo hudhet.,,**

Këtë e kan transmetuar edhe Abdullah b. Xhafer el-Mabremi dhe Abdu-l-Vabid b. Ebi Avni nga Seid b. Ibrabimi.

---

---

**SI SHKRUHET MABRËVESHJA PER NJË ÇËSHTJE  
KONKRETE, ME FILAN FILANIN, PA E  
THEKSUAR PËRKATËSINË E FISIT E TË GJINISË<sup>153</sup>**

2698. - Na ka treguar Muhammed b. Beshar, këtij Gunder, kënj i transmetoi Shu'be nga Ebu Is-haku i cili ka thënë: E kam dëgjuar Bera b. Azib r.a. dake thënë: “Kur bëri Pejgamber a.s. marrëveshje me të pranishmit në Hudejbi, Ali b.Ehi Talilbi r.a. shkroi marrëveshjen dhe aty shkroi: **“Muhammedi, Pejgamberi i All-llahut”**, për çka politeistët thanë:

- Mos e shkruaj: **“Muhammedi Pejgamber i All-llahut”**. Po të kishim pranuar ne ty si Pejgamber, ne nuk do të bënim luftë me ty.”. Pejgamberi i tha atëherë, Aliut: **“Fshije këtë”**.

- **Unë këtë nuk e fshij** - tha Aliu.

- Këtë, pastaj e fshiu Pejgamberi a.s. personalisht dhe lidhi me ata marrëveshje për paqe si vijon: Ai dhe shkokët e tij të hyjnë në Mekke) vetëm për tri ditë dhe aty do të hyjnë vetëm me armët në këllëf. Ashabët, pastaj, e pyetën çka është ai këllëf arme, e ai u përgjigj: Ajo torba me atë çka ka brenda”.

2699. - Na ka treguar Ubejdullah b. Musa që transmeton nga Ismaili, ky nga Ebu Is-haku, kurse ai nga Beraa r.a. i cili ka thënë:

- Pejgamben s.a.v.s. vendosi të kryejë Umren në muajin Dhu-l-ka,de, por mekkasit nuk deshën ta lejojnë të hyjë në Mekke, den sa të merren vesh që aty të qëndrojnë vetëm tri ditë dhe kur e shkruan marrëveshjen, shkruan: **“Kjo është çka ka vendosur**

---

153 Nëse palët kontraktuese ose dëshmitarët janë persona të njohur, me autoritet, mjafton që të thonë vetëm emrin dhe mbiemrin, për t'u dalluar nga të tjerët. Nëse kemi të bëjmë me persona që nuk janë të pranishëm ose persona të vdekur, duhet të përmendet emri i babës dhe i gjyshit. Nëse palët e interesuara dhe objekti i kontestit janë të pranishëm, dëshmitari giatë dëshmisë do t'i tregojë me dorë, dhe nuk ka nevojë të përmend emrin e babës dhe të gjyshit të atyre palëve (*Mexhel-lei ahkam-i sher'ijje*).

---

---

**Pejgamberi i All-llahut Muhammedi.”**

- Ne nuk e pranojmë këtë profetësi. Po ta kishim pranuar se ti je Pejgamberi i All-llahut, nuk do të kishim kundërshtuar. Ti je Muhammed, i biri i Abdullahut.

- **Unë jam Pejgamber i All-llahut - tha ai, dhe jam Muhammedi i biri i Abdullahut.** Pastaj i tha Aliut: **“Fshije Pejgamber i Allllahut”.**

- **Jo, pasha Zotin - tha Aliu - kurrë nuk kam për ta fshirë.** Atëherë Pejgamberi i All-llahut mori kontratën dhe e çoi (Aliun) të shkruaj: **“Kjo është ajo çka ka vendosur Muhammedi i binri i All-llahut, se do të hyjë në Mekke me armët në këllëf dhe nuk do të**

**pengohet askush nga banorët e saj, nëse dëshiron të pasojë këtë (pejgamberin a.s.) por nuk do të dalë prej aty, kurse nga shokët e tij, nëse dëshiron ndokush të mbetet aty në Mekke, lirisht mund të ndalet.,,**

Kur hynë muslimanët në Mekke dhe u kaloi afait i qëndrimit, politeistët erdhën te Aliu dhe i thanë: **“Thuaj shokut tënd, le të dalë prej këtu se afati ka kaluar.,.** Pejgamberi a.s. atëherë, doli dhe muslimanët i pasoi e bija e Hamzës (Umama) duke thirrur: ‘o axha, o axha im:, dhe e mori Aliu për dore dhe i tha Fatimes: **“Mbaje vajzën e axhes tënd.,** dhe ajo i ndihmoi të hypë në deve <sup>154</sup>. Aliu pastaj ka diskutuar me Zejdin dhe Xhaferin lidhur me këtë duke thënë:

- Unë jam më i afermi i saj, ajo është e bija e axhës tim.

- Xhaferi ka thënë: **“Ajo është e bija e axhës tim kurse tezja e saj është bashkëshortja ime.,.**

- Zejdi përsëri ka thënë: **“Ajo është bija e vëllait tim”.,** ndërsa Pejgamberi a.s. ia caktoi tezes së saj duke i thënë:

- Tezja është në vend të nënës.

- Aliut i tha: **“Unë e ti jemi një (unë nga ti e ti nga unë).**

---

154 Vajza e Hamzës, Umama nuk është kthyer prap te politeistët nga se në marrëveshjen e Hudejbijes nuk ka qenë i vënë ky kusht për femrat.

---

- 
- Xhaferi i tha: “Më përngjan nga pamja dhe nga sjelljet,,  
- Zejdi, prap, i tha: “Ti je vëllai jonë dhe robi jonë i lituar.”<sup>155</sup>

## MARRËVESHJA E PAQES ME POLITEISTËT

Lidhur me këtë është transmetuar nga Ebu Sufjani, kurse Avf b. Malik duke transmetuar nga Pejgamberi a.s. thotë: “Pastaj u përpilua marrëveshja ndërmjet jush dhe grekëve (të verdhëve).

Sehl b. Hunejfi, lidhur me këtë thotë: “Ju **kam parë në ditën e Ebu Xhendelit**”. Esmā dhe Nisveri transmetojnë edhe këtë nga Pejgamberi s.a.v.s..

2700 - Musa b. Mesudi ka thënë se i ka transmetuar Sufian b. Seidi nga Ebu Is-haku, ky nga Bera'a b. Azib r.a. i cili ka thënë:

Pejgamberi a.s. ka lidhur marrëveshje paqësore me politeistët

---

155 Zejd Ibn Harith ishte rob i h. Hatixhes dhe ajo ia fali Muhammedit a.s. si fëmij, kurse ai e liroi dhe e mori si birë me shpirtë dhe njerëzit e quanin Zjed i biri i Muhammedit deri kur u shpall ajeti: “**Thirruni me emrat e baballarëve tuaj...**” Më vonë Muharnmedi a.s. bëri vëllazërimin ndërmjet atij dhe Hamzës. Aisheja r.a. thotë: “Në çdo luftë që merrte pjesë Zejdi, Muhamrnedi a.s. ia besote komandën. U vra në luftën në Mut'a.

Në muajin Dhu-l-Ka'de të vitit 6 hixhri (628 m.) Muhammedi a.s. u nisë për në Mekke të kryej haxhin. Në afërsi të Mekkes e ndalen politeistët dhe ky dërgoi në Mekke Osman b. Affanin të zhvillojë biseda me ta. Atëherë Kurejshitët dërguan në Hudejbi Suhejl b. Amrin i cili lidhi marrëveshje me Muhammedin a.s. për pikat e lartpërmendura që do të vlejnin 10 vjet.

Muslimanët duhej të kthehen prap këtë vit, dhe do të vinin në vitin e ardhshëm kur do të bënin haxhin dhe do të rrinë më së shumti tri ditë e gjetë kësaj kohe Kurejshitët do të lëshojnë Mekken. Fiset tjera përreth, sipas dëshirës së tyre, mund t'u bashkohen muslimanëve ose Kurejshitëve. Me këtë marrëveshje shumë muslimanë nuk ishin të kenaqur, porse Muhammedi a.s. ua sqaroi dhe i bindi de kjo marrëveshje do të jetë e dobishme për bashkësinë islame, dhe kjo shumë shpejt u bë e vërtetë.

në ditën e Hudejbijes për tri gjëra:

a) Ata që t'i vijnë nga politeistët t'i kthejë prapë te ata, kurse ata nga muslimanët që shkojnë te ata, nuk i kthehen Muharnmedit a.s.

b) Në Mekke të hyjnë vitin e ardhshëm dhe aty të rrinë tri ditë.

2701. - Na ka treguar Muhamedi. Rafi', këtij Surejxh b. Nu'man i cili ka thënë: Na ka transmetuar Fulejhi nga Nafiu, ky nga Ibn Umeri r.a. se Pejgamberi a.s. doli (nga Medina) të kryejë umren, kurse kurejshitët i dolën, pengesë, përpara tij dhe Qaes, dhe ky preu kurbanin dhe rruajti kryet në Hudejbi, dhe aty lidhi me ata marrëveshje paqësore që përmbante si vijon: Umren ta kryejë vitin e ardhshëm, nga armët do të mbajnë me vete vetëm shpatën; dhe aty do të rrijnë sa t'u thonë ata (Kurejshitët).

Kështu që Alejhisselami umren e kreu vitin tjetër, hyn në Mekke ashtu siç ishte marrë vesh me ata, dhe pasi i kaloi dy tri ditë, i urdhëruan të dalë nga Mekka dhe ai doli. (Krahaso: 4252.)

2702. - Na ka treguar Museddedi, këtij Bishri, këtij i transmetoi Jahja nga Bushejr b. Jesari, ky nga Sehl b. Hatheme i cili ka thënë:

U nis Abdullah b. Sehl dhe Muhajjis Mes'ud b. Zejdi deri në Hajber e bashkë me ata (e kishte) edhe marrëveshjen e paqës. (Krahaso: 3173, 6143, 6898, 7192).

### **UJDIA – MARRËVESHJA – PËR LARJE TË GJAKUT**

2703. -Na ka treguar Muhammed b. Abdullak Ensariu si vijon: Më ka transmetuar Humejdi se i kishte rrëfyer Enesi, ë Rubejja - **kjo është e bija** e Nadres, ia theu dhëmbin e parë (çerës) një vajze dhe këta deshën t'ia paguajnë dhe të falin, lironen, hurse të dëmtuarit nuk e deshën këtë. Mandej erdhën

---

te Pejgamberi a.s. dhe ai i urdhëroi të paguhet haku. Atëherë Enes b. Nader tha:

O Pejgamberi i All-llahut, a t'i thehet dhëmbi i parë Rubejjes? Jo, pasha All-llahun i cili të ka dërguar me të vërtetën, saj nuk do t'i thehet dhëmbi, Pejgamberi s.a: i tha: "O Enes, sipas Librit të All-llahut falen, kurse Pejgamberi s.a.s.v. tha: **"Ka nga njerëzit e All-llahut që kur betohen në Zotin, Ai u jep mbarën, u jep mirësi.**

El-Fezeri shton duke transmetar nga Humejdi, ky nga Enesi: "Njerëzit ishin të kënaqur dhe e pranuan pagën e hakmarrjes, **dëmshpërblimin**". (Krahaso- 2806 4499, 4500, 4611, 6894).

### **DEKLARATA E PEJGAMBERIT A.S. NË DOBI TË HASAN B. ALIUT R.A.**

Ky djali im është zotëri, i parë. Ndoshta All-llahu Xh.sh. me ndërmjetësimin e tij do të pajtojë dy bashkësi të mëdha.

Edhe All-llahu xh.sh thotë: "... Pajtoni, pra ata".

2704. - Na ka treguar Abdullah b. Muhamed, i cili ka përcjell nga Sufjani se Ebu Musa ka thënë: E kam dëgjuar Hasan basriun duke thënë: **"Pasha All-llahun, është nisur Aliu sikur bjeshka drejt Muaviut me disa njësi uashtarake»**. Atëherë Amr b. As tha: Unë me siguri i shoh njësitë dhe nuk kthehem deri kur të vriten moshatarët e tyre". Pastaj Muaviu i tha e ai, pasha Zotin në atë kohë ishte njëri nga njerëzit më të mirë: O Anr, nëse vriten këta, edhe këta, edhe ata (të atyre) cilin ta lë të kujdeset për punët, kush do të mbetet për gratë e tyre, kënd e kam për pasurinë e tyre të patundshme dhe fëmijët e tyre".

Atëherë Muaviu i dërgoi Hasanit dy veta nga Kurejshitet prej fisit Benu Abdi Shems: Abdurrahman b. Semure dhe Abdullah b. Amir b. Kurejz dhe tha:

- Shkoni ju të dy te ai, paraqitnia gjëndjen, thuani dhe lutni për zgjidhje paqësore. Mandej ata erdhën dhe hynë te ai,

---

biseduan dhe i thanë porosinë, dhe kërkuan pajtim, kurse Hasan b. Aliu u përgjigj:

- Ne jemi të bijtë e Abdu-l-Muttalibit dhe na takon kjo pasuni dhe ky popull, me të vërtetë, me derdhjen e gjakut të vet do të bëjë krim”.

- **Muaviu të afron** - i thanë ata dy - **këtë e këtë dhe kërkon e të bën rixha, lutet... Kush më garanton për këtë? Pyeti Hasani. Për këtë të garantojmë ne** - u përgjigjën ata.

Gjithçka u kërkonte Hasani, ata i përgjigjeshin: **“Për këtë të garantojmë ne”**. Dhe ata u pajtuan me të. Më vonë Hasani (Basriu) ka thënë:

- E kam dëgjuar Ebu Bekrin duke thënë: “E kam pa Pejgamberin s.a.v.s. në minder, kurse Hasan b. Aliun pranë tij, dhe ky njëherë iu kthye njerëzve, e pastaj Hasanit dhe tha: “Ky dialoshi im është zotëri, i parë, dhe ndoshta All-llahu me ndërmjetësimin e tij do t’i pajtojë dy bashkësi të mëdha muslimanësh që janë të ngatërruar ndër veti.

Ebu Ahdullah (Buhariu) thotë: Më ka thënë Ali b. Ahdullahu: Këtë rast na e ka vërtetuar edhe dëgjimi i Hasan (Basriut) personalisht nga Ebu Bekri.<sup>156</sup> (Krahaso: 3629, 3746, 7109).

## **A DO TË JAPË SHENJË PËR PAJTIM KUJDESRTARI - IMAMI**

2705. - Na ka treguar Ismail b. Ebi Uvejs, i cili thotë: Më ka treguar vëllai im që transmeton nga Sulejmani, ky nga Jahja b. Seidi, ky nga Ebu Rixhal Muhamed b. Abdurrahmani, se nëna e

---

156 Hasani si nip i Muhammedit a.s. por edhe si Kurejshit konsideronte se pushteti i takon atij, e bashkë me të edhe të ardhurat përkatëse. Muaviu, përmes të deleguarve të vet, i premtoi Hasanit dhe familjes së tij privilegje të lakmueshme, dhe ky pranoi, u pajtua me Muaviun dhe hoqi dorë nga hilafeti në dobi të Muaviut.

---

---

---

tij Amreta, e bija e Abdurrehmanit, ka deklaruar:

E kam dëgjuar Aishen r.a. duke thënë: Njëherë Pejgamberi s.a.v.s. dëgjoji zerin e disave që bënëin shamatë para dyerve. E ngritën zerin e kur nisen prej tyre dyve kërkoi nga i dyti që t'i lejojë diçka (nga borxhi) dhe që t'ia lehtësojë pak kushtet ai iu përgjigji: Pasha All-llahun këtë nuk e bëj” Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. doli dhe tha:

**- Ku është ai që bëri be ashtu në All-llahun, se nuk do të bëjë mirësi?**

- Unë jam o Pejgamberi i All-llahut. Ai lyp çka është më e mirë për të.

2706. - Na ka treguar Jahja b. Bukjer dhe ka thënë se i ka transmetuar Leithi nga Xhafer b. Rebia, ky nga A'rexhi i cili thotë:

- Më ka rrëfyer Abdullah b. Ka,ab b. Malik nga Ka,ab b. Maliku se ky kishte te Abdullah b. Ebi Hadred al-Eslemi njëfarë borxhi, dhe ky e takoi dhe ia kërkoi, ashtu që i ngritën zërat. Në këtë moment kah ata rastisi të kalojë **Pejgamberi a.s. dhe tha:**

- O Ka'b - dhe bëri me dorë sikur i fliste: “Gjysmën”.

Atëherë Ka'bi mori nga borxhliu gjysmën e borxhit, kurse gjysmën tjetër e la, ia fali.”<sup>157</sup>

## **RENDËSIA E PAJTIMIT TË NJERËZVE DHE VLERA E DREJTËSISË NDËRMJET TYRE**

---

157 Nga hadithi mund të rezultojë:

- është e preferueshme që kushtet për të paguar borxhin të jenë sa më të përshtatshme për borxhliun, madje gjatë pagesës edhe të zbritet diçka.

- muslimani nuk guxon të bëjë be se nuk do të kryej punën e cila në esencë është vepër bëmirëse dhe fisnike.

Sipas mendimit të Nevevint rekomandohet që një betim të tillë ta prishish, ta thejsh, dhe për kompensim të agjërosh tri ditë resht ose të presish një kurban për të varfërit.

- borxhliu mund ta lus kreditorin për t'ia ulë borxhin ose t'ia vazhdojë afatin e pagesës.

---

---

2707. - Na ka treguar Is-hak b. Mensur se i ka kumtuar Abdurezaku, këtij Ma'meri nga Hammami, ky nga Ebu Hurejre r.a. i cili deklaroi:

- **Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: “Sadaka bie në çdo nyje të njeriut për çdo ditë që ka dhënë Zoti, prandaj edhe sjellja e drejtë ndaj njerëzve është sadaka.<sup>158</sup> (Krahaso: 2891, 2989).**

**NËSE KUJDESTARI JEP SHENJË PËR  
MARRËVESHJE, KURSE PALA E REFUZON,  
VENDIMI I SHQIPTOHET ME GJYKIM TË DREJTË**

2708. - Na ka treguar Ebu-l- Jeman se i ka transmetuar Shuajbi nga Zuhriu i cili ka thënë:

- Urve b. Zubejr më ka thënë se Zubejri i ka treguar ngjarjen e vërtetë kur është zënë me një nga Ensarijtë, i cili merrte pjesë në Beder përpara Pejgamberit a.s. për një grusht ujë nga shkarpa me të cilin që të dy ujitnin (tokën) dhe **Pejgamberi s.a.v.s. tha:**

- **O Zubjer, ujite ti dhe pastaj liroja rendin fqiu tënd.**

- Ensariu u zemërua dhe tha: “A vetëm pse është axha yt, o Pejgamber i All-llahut?” Pejgamberi u skuq në fytyrë dhe shtoi: **“Ujite dhe mbaje deri kur të arnj uji përmbi mure (të oborrit).** Me këtë Pejgamberi s.a.v.s. ia realizoi në tërësi të drejtën Zubejrit, por përpara kësaj Pejgamberi s.a.v.s. i bëri shenjë Zubejrit që të zbatojë një qëndrim më bujar për të dhe Ensariun.

- Pasi që Ensariu thotë Zuhriu e zemëroi Pejgamberin a.s. ai me një vendim decidiv ia plotësoi Zubejrit të drejtën e tij.

Urve thotë se Zubejri ka deklaruar: “Pasha All-llahun, më duket se ky ajet ka zbritur vetëm për këtë: **“Dhe jo, pasha Zotin tënd, ata nuk janë besimtarë derisa për gijkatës në**

---

158 Eshtrat janë bazë e organizmit të njeriut, bosht i stabilitetit të tij dhe kusht për veprim të sigurt, prandaj kemi për detyrë që për këtë t'i falënderojmë All-llahun me fjalë dhe me punë të mira.

---

---

---

*mosmarrëveshjet e tyre nuk të pranojnë ty, e pastaj për shkak të gjykimit tënd në sbpirtërat e tyre nuk ndiejnë aspak pestë, dhe derisa të përulen plotësisht". (Nisa: 65).*

## MARRËVESHJA KUTURU E BËRXHLIUT DHE TRASHËGIMTARIT

Ibn Abbasi ka thënë:

- Nuk ka kurrgjë të keqe që pjesëmarrësit ndërmiet veti të ndahen: njëri të marrë borxhin kurse tjetri mjetin (çka ka lënë ai) dhe nëse kjo të njëri prej tyre humbas, shkatërrohet, ai tjetri nuk ka të drejtë të kërkojë kompenzim nga shoku i tij.

2709. - Na ka treguar Muhammed b. Beshshar se i ka transmetuar Abdu-l-Vehabi këtij Ubejdullahu i kumtoi nga Vehab b. Kejsani, ky nga Xhabir b. Abdullahu r.a. i cili deklaroi:

- Babai ndërroi jetë, dhe ai kishte borxh. Unë u propozova borxhlinjve të tij të marrin hurma për atë sa ishte borxhi. Këta nuk deshën të veprojnë kështu duke menduar se hurmat nuk e mbulojnë borxhin në **terësi. Une pastaj shkova te Pejgamberi a.s. dhe ia sqarova këtë rast, ai më tha:**

- Kur t'i vjelësh dhe t'i grumbullosh në lëmë lajmëroje Pejgamberin s.a.v.s..

Mandej erdhi ai, bashkë me të edhe Ebu Bekri dhe Umen, u ul në lëmë, bëri një dua për bereqet, e mandej shtoi: Thirri borxhlinjtë e tu dhe laje borxhin".

Të gjithëve, pa përjashtim, atyre që u kishte borxh babai im, ua pagova borxhin dhe për mua mbetën edhe 13 barre (vesak)<sup>159</sup>, dhe këto: shtatë barrë nga hurmat e klasës më të mirë, kurse gjashtë barrë nga kualiteti më i dobët, përkatësisht gjashtë të dobëta e shtatë të mira. Shkova te Pejgamberi s.a.v.s. në kohën e akshamit, namazit të akshamit, i tregova, Ai buzëqeshi dhe tha:

---

159 Vesak-barre, masë për peshë që mban 60 sa'a ose 199 kg. e 20 dk.

---

- **Shko te Ebu Bekri dhe Umeri e tregoju për këtë:**

- **Po, ne e kemi ditur** - thanë ata dy- **se ajo ashtu do të bëhet pasi bëri Pejgamberi atë çka bëri.** (bëri dua).

Hishami ka transmetuar nga Vehbi, ky nga Xhabiri: “... në kohën e namazit të iqindisë”, dhe nuk e ka përmenduar Ebu Bekrin, e as që Alejhisselami ka buzëqëshur, dhe se Xhabir b. Abdullahu ka deklaruar: “**Babai im ka pas lënë borxhe tridhjet barre....,**”

Ibn Is-haku ka transmetuar nga Vehbi, kurse ai nga Xhabiri: “... në kohën e namazit te drekes...”

## **MARRËVESHJA PËR BORXHIN DHE GJËRA TJERA**

2710. - Na ka treguar Abdullah b. Muhammed se ka thënë osman b. Umeri.

- Junusi më ka kumtuar, kurse Lejthi thotë Junusi më ka treguar përmes Ibn Shibabit:

- Më ka kumtuar Abdullah b. Malik se e ka informuar Ka'ab b. Malik se ai ka lypur nga Ibn Ebi Hadred, në xhami, t'ia paguajë borxhin që ia kishte qysh në kohën e Pejgamberit a.s. E ngritën zërin aq lart sa i dëgjoi Pejgamberi s.a.v.s. i cili ishte në dhomën e vet.

Pejgamberi a.s. doli, zbuloi një anë të perdes (mbi derë) te dhoma e tij, thirri Ka'ab b. Malikun duke i thënë:

- **o Ka,ab.**

- **Urdhëro, o Pejgamber i All-llahut,** - u përgjigj Ka,abi. Pastaj Alejisselami duke bërë me dorë, i dha shënim që ta zbresë për gjysëm, kurse Ka'abi i tha:

- **Këtë e kam bërë, o Pejgamber i All-llahut.**

- Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. thirri:

## Kreu 54.

### PARAQITJA E KUSHTEVE PËR TË PRANUAR FENË ISLAME, DHE MARRJA E VENDIMIT PËR BETIM

2711, 2712. - Na ka treguar Jahja b. Bukejr që i ka transmetuar Lejthi nga Ukajli, ky nga Ibn Shihabi i cili ka thënë: Më ka kutuar Une b. Zubejr i cili thotë se ka dëgjuar nga Mervani dhe Misveri b. Mahreme r.a. kur kanë përcjellë fjalët e shokëve të Peigarnherit a.s.

- Kur e shkroi Suhejl b. Amr kontratën (e Hudejbijes) me atë

---

160 Marrëveshja (ujidja) është kur ua mbush mendjen, dy palëve të lidhin një kontratë e cila shmang konteson dhe arrihet me ofertë dhe pranim të ofertës. Ujdia mund të jetë pranim i të paditurit. mohim i të padituri dhe heshtje e të paditurit.

Ai që lidh marrëveshje (bie në ujdi) ose nuk e mohon të drejtën e vet në tërësi ose pjesërisht. duhet të jetë patjetër moshërritur. pra, marrëveshja e të sëmurit momentalisht nuk është e vlefshme, edhe e të rralluarit në kujtesë për shkak të pleqërisë, dhe të miturit, edhe të paafitit për të menduar serizoisht. Mirëpo marrëveshja e të miturit të autorizuar është e vlefshme, nëse nuk ka ndonjë dëm për të.

Nëse kujdestari i të miturit bën marrëveshje për ndonjë kërkesë, kjo është e vlefshme, nëse nga kjo nuk pason ndonjë dëm për të miturin, por nuk është e vlefshme në rast se është e dëmshme për të miturin. Për **shembull**, nëse **dikush e padit** të miturin për ndonjë shumë të hollash dhe babai i tij pajtohet që të paguajë atë shumë nga jetet e të miturit. Kjo ujdi është e vlefshme, nëse **paditësi ka argument**, e nëse nuk ka ujdija, pranimi nuk vlen. Nëse **i mituri ka ndonjë kërkesë (të marr borxhin)** prej ndokujt dhe babai i tij ban marrëveshje duke bërë lëshime dhe ia ul shumën, marrëveshja e tillë është e pavlefshme, nëse ka argument për kërkesë e nëse nuk ka argument, marrëveshja është e vlefshme.

Heqja dorë (të falësh) nga kërkesa e të miturit, të marrit dhe të rralluarit për shkak të pleqërisë, nuk është e vlefshme. (*Mexhel-le-i-Ahkam i sler-ijje*).

rast Subejl b. Amri i kushtëzoi (paraqitu kushte) Pejgamberit a.s.:

**“Kushdo që vjen te ti prej nesh, qoftë edhe musliman, a do të na e kthesh e të na e dorëzosh prapë neve.,, Besëdrejtët, besimtarët nuk e pranuan këtë dhe u hidhëruan, kurse Suhejli nuk dëshironte asgjë tjetër, përveç se këtë, andaj edhe Pejgamberi a.s. lidhi marrëveshie me të për këto dhe Ebu Xhundelin e ktheu prapë te babai i vet Suhejb b. Amri. Dhe kushdo që i vinte, giatë kësaj periudhë, ai e kthente prapë, madje edhe kur qëllonte të vijë muslimani.**

Erdhën edhe muslimane si muhaxhire, të ikura. Nga ato që erdhen te Pejgamberi a.s. atëherë ka qenë edhe vajza Ummu Kulthumi, e bija e Ukbe b. Ebi Muajtiti. Pastaj erdhën familja e saj dhe kërkuan që Pejgamberi a.s. t’ua kthente prapë, mirëpo ai këtë nuk ua ktheu sepse All-llahu për këtë ka shpallur: *“...Kur t’u vijnë muslimanet si të ikura, vërtetojnë rastin, por All-llahu e di më së miri besimin e tyre...”* e deri te fjalët: *“... ato as që u lejohen atyre...”*<sup>161</sup>

---

161 *“O besimtarë! Kur t’iu vijnë besimtarët si emigrantë, ju verifikoni ato, por All-llahu e di më së mirë besimin e tyre. Nëse i njihni si besimtare, mos ua ktheni mosbesimtarëve. Ato nuk u lejohen atyre as ata u lejohen këtyre. Jepnu atë që kanë shpeuzuar dhe nuk e keni mëkat të kurorëzoheni me ato pasi që t’iu jepni metrin. Mos i mbani politeistet nën kurorë! Kërkoni atë çka e keni dhënë, por edhe ata le të kërkojnë çka kanë shpenzuar. Ai është gjykim i All-llahut. Ai gijkon ndërmjet jush. All-llahu është shumë i dijshtëm e i urtë?”*

*“Nëse ndoujë prej gravet tuaja shkon te mosbesimtarët, dhe u vjen rasti juve, atëherë atyre që s’kanë shkuar gratë jepnu aq sa kanë shpeuzuar ato për mehr. Frikësahuni All-llahut të cilit ju i besoni”.*

*“o Profet, kur të vijnë besimtarët që të obligoben para teje se nuk do t’i bëjnë shak All-llahut asnjësend, dhe se nuk do të vjedhin, nuk do të bëjnë amoralitet, se nuk do t’i mbysin femijët e vet dhe se nuk do të gënjejnë duke shpifur me çka kanë në duar dhe këmbët e tyre dhe se nuk do të kundërshtojnë në çka dihet, prano obligimin e tyre dhe lute All-llahun t’i falë. Me të vërtetë All-llahu fal, është mëshirëplotë”.* (Mumtabane: 10-12).

---

2713. - Urve ka thënë: Më ka kumtuar Aisheja r.a.:  
“Pejgamben All-llahut i verifikonte ato në bazë të këtij ajeti:

“O Profet, kur të vijnë besimtarët që të obligohen para teje se nuk do t’i bëjnë shak All-llahut asnjësend, dhe se nuk do të vjedhin, nuk do të bëjnë amoralitet, se nuk do t’i mbysin fëmijët e vet dhe se nuk do të gënjejnë duke shpifur me çka kanë në duar dhe këmbët e tyre dhe se nuk do të kundërshtojnë në çka dihet, prano obligimin e tyre dhe lute All-llahun t’i falë. Me të vërtetë All-llahu fal, është mëshirplotë”. (Mumtabane: 12).

Urve ka thënë edhe këtë: Aisheja ka thënë: Cila do prej tyre që e pronte këtë kusht Pejgamberi asaj i thoshte: Betimin tend e pranoj, me fjalët që ky ia shqiptonte asaj.

Pasha All-llahun, në këtë betim – besatim - dora e tij kurrë nuk e ka prekur dorën e asnjë gruaje dhe ai, besën për besnikëri në Islam prej tyre e pranonte vetëm me fjalë. (Krahaso. 2733, 4182, 4891, 5288).

2714. - Na ka treguar Ebu Nuajm, i cili përcjell nga Ebu

---

- Sipas deklaratës së Ibn Abbasit gjashtë gra e kanë prishur kurorën me burrat e tyre mysliman, për shkak se dëshironin të mbeten në politeizëm, e ata janë:

Ummi Hakima e bija e Ebu Supanit, bashkëshorte e I’jad b. Shedadit, Fatimja, e bija e Ebu Umejje b. Mugire, motra e Ummi Selemes, që dikur ka qenë e martuar me Umer b. Hattabin dhe kur Umeri shkoi në Medine, bëri hixhret nga Mekka në Medine, aje mbeti në Mekke dhe u kthye në politeizëm; Bema, e bija e Ukbës, bashkëshorte e Shems b. Osmanit; Abdeta, e bija e Abdu-l-Azizit, ajo mbeti në Mekke dhe u kthye në politeizëm; Beme, e bija e Ukbës, bashkëshorte e Amr b. Vedda’it; Hinda e: bija e Ebu Xhehl b. Hishamit, bashkëshorte e Hisham b. Asit dhe Gjylsemeja, e bija e Harvelit, bashkëshorte e Umer b. Hattabit e cila nuk deshi të shkojë nga Mekka në Medinë me Umerin, por mbeti në Mekke dhe kultivoi fenë e rrethit të vet – politeizmin.

Muslimanët që u shpërngulën nga Mekka në Medine dhanë betimin para Muhamedit a.s. se këtë e kanë bërë për shkak të ndjenjave fetare dhe **pranuan obligimet** e theksuara në ajetin 12 sures Mumtehane...

---

Sufjani se Zijad b. Haka ka thënë:

E kam dëgjuar Xheririn R.a. kur thoshte. Kam dhënë betimin për besnikëri Pejgamberit a.s. e ai më shtroi për kusht: Singërisht t'ia mendosh të mirën çdo muslimani”.

2715. –Na ka treguar Museddeni se Jahja transmetoi nga Ismaili, i cili thotë: Më ka rëfyer Kajs b. Ebi Hazim, ky transmeton nga Xherir b. Abdullahu r.a. i cili ka deklaruar:

I kam dënë besën Pejgamberit të All-llahut se do të kryej namazin, të jap zekatin dhe t,i mendoj, singërisht të mirën çdo muslimani”.

### **SHITJA E PEMËVE ME FRUTE**

2716. - Na ka Treguar Abdullah b. Jusuf, këtij i kumtoi Maliku nga Nafi' u, që përcjellë nga Abdullah b. Umeri-r.a.:se Pejgamberi s.a. 'v.s. :ka thënë:

Kush shet pemët që janë fryzuar (bërë me fryte), fryti i tyre i përket shitësit, përveç në raste se blerësi e kushtëzon: b l erjen me gjithë fryte.

### **KUSHTET NË SHITBLERJE**

2717. – Na ka treguar Abdullah b. Mesleme, këtij i transmeton Lejthi nga Ibn Shihabii, ndërsa ky nga Urveja:

Më ka kumtuar Aisheja se Beirira erdhi te Aisheja për të kërkuar ndihmë që kjo ta kompenzoje lirimin e saj, e ajo nuk kishte paguar fare për kompenzimin e vet.

**-Kthehu te zotërinjtë tu – i tha Aisheja asaj, nëse dëshirojnë që të paguajnë për ty çmimin e lirit dhe kujdesi ndaj teje të kalojë në kompetencën time, do të bëjë atë ( pagesën).**

Berira këtë ua paraqiti zotërinjve të saj, por ato e refuzojnë dhe i thanë: Nëse dëshiron të llogarisi në ty, le ta bëjë, por tutorija ndaj teje do të jetë e jona”.

Aisheja këtë ia tregoi Pejgamberit a.s. e ai, për këtë, i tha:

---

---

**“Bleje dhe liroje, kurse patronati i përket atij që e liron robin”.**

**LEJOHET QE SHITËSI I KALORËSISË  
TË KUSHTËZOJË KALËRIMIN E ASAJ KAFSHE  
DERI NË NJË VEND TË CAKTUAR**

2718. - Na ka tregar Ebu Nuajm, që ka dëgjuar nga Zekerija, i cili ka thenë: **E kam degjuar Amirin duke thënë:**

Më ka rrëfuer Xhebiri se ai kishte udhëtuar kaluar ne devenë e vet të ngadalshme. Në rrugë e sipër ia behu Pejgamberi a.s. , i ra dhe e bekoi. Deveja ( atëherë) ia nisi të ecë ashtu që asnjë nuk ecte sikur ajo. Pejgamberi a.s. mandej tha:

**A po ma shet për një okë ( Vekijje)**

**Jo, iu përgjigja unë.**

Ai prapë më tha: “Shitma për një Evkije”.<sup>162</sup> Unë atëhere ia shita por ia shtrova një kusht që të kalëroj me të deri te familja ime.

Kur arritëm (në Medine) ia solla deven dhe ai ma pagoi sa kushtonte. Unë mandej u ktheva, e ai ma lëshoi për mbrapa dhe më tha: **“Nuk e marr deven tendë! Merre këtë deve tënde, kjo është pasuria jote”.**

Shu,beja transmetoi nga Mugire, ky nga Amri, e ky nga Xhabiri: “...Pejgamberi a.s. më lejoi shpinën e saj (të hipi në të) deri në Medinë,,.

Is-haku ka transmetuar nga Xheriri, ai nga Mugureja: “... **dhe unë ia shita, me kusht që shpina e saj e gërmusur të më takojë mua** deri kur të arrij në Medinë,,.

A’tau dhe të tierë thonë: “... deri **në Medinë, shpina e saj është për Ty**”. Muhammed b. Munkedir transmetoi nga Xhabiri:

---

162. Kjo ka pas vlera të ndryshme në kohë dhe vende të caktuara. Në Egjipt, p.sh. kishte vlerën 12 Derhem, në Damask 50 derhem, në Haleb 60 kurse në disa vende të perandorisë osmane edhe 150, manadej edhe 1000 derhem.

---

“... Xhabiri e kushtëzoi shpinën e saj (të hipi) deri në Medinë.

Zejd b. Eslemi ka transmetuar nga Xhabiri: “... **shpina e saj është** për ty deri kur të kthehesh te familja jote”.

Zubejri përcjell nga Xhabiri: “... **po ta lejojmë shpinën e saj të gërmusur deri në Medinë,,.**

A'meshi transmetoi nga Salimi, ai nga Xhabin: “... shko hipur në të deri te familja jote,,.

Abu Abdullah (Buhariu) thotë: “**Kushtëzimi ishte shprehur në shumë mënyra, gjë që për mua është më e drejtë**”.

Ubejdullah dhe Ibn Is-hak kanë transmetuar nga Vehbi, kurse ai nga Xhabiri: “**Pejgamberi a.s. e ka blerë për një okë (evkijje),,,**

Vehbin (në një version tjetër) e pason Zejd b. Eslem i cili transmeton nga Xhabiri.

Ibn Xhurejxh transmeton nga Ata, a edhe prej disa tjerëve, kurse ata nga Xhabin: “**Muhammedi a.s. e ka marrë për katër dukatë, e kjo është një okë, nëse e llogarisim dukatin nga dhjetë dërhëm,,.**

Mugireja i cili rastin e përmendur e transmeton nga Sha,biu, ai nga Xhabiri dhe Ibn Munkediri dhe Ebu Zubejr nga Xhabiri, nuk e përmendin çmimin e deves. A'meshi transmetoi nga Salimi, ky nga Xhabiri: “... **për dyqind dërhëmë...**”

Davud b. Kajs transmeton nga Ubedullah b. Miksem, kurse ai nga Xhabiri: “... **e ka blerë në rrugë për ne Tebuk**’. Më duket se ka Thënë”: “... për katër evake». Ebu Nadre ka transmetuar nga Xhabiri: “... **e ka blerë për njëzet dukatë...**”

Sh'abiu thotë: «për një vekije» është shprehur në shumë mënyrë, por edhe ajo është shprehur në shumë mënyra dhe ajo është – thotë Ebu Abdullahu (Buhariu) te unë me e pranueshme.

## **KUSHTET NË AFARIZMIN E NDËRSJELLTË**

2719. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman, këtij i kumtoi Shnajbi se i ka treguar Ebu-z-Zinadi nga A'rexhi, ky nga Ebu Hurejre

---

r.a. që tha:

Esarët i kanë thënë Pejgamberit a.s.: «**Ndaj ndërmjet nesh dhe vëllezërve tanë (Muhaxhirëve) pëmishtet tona**».

Jo, tha Mluhammedi as.

Mandej ernsarët thanë: «Do të na ndihmoni në punë (të punojmë **tokën**) dhe do t'ju pranojmë si hisetarë në prodhime».

**E dëgjuam dhe e pranuar** - u përgjigjën muhaxhirët.

2720. - Na ka treguar Musa b. Ismail, këtij i transmetoi Xhurvejr b. Esma' nga Nafi,' ky nga Abdullahu r.a. i cili ka deklaruar:

- Pejgamberi i All-llahut ia dha Hajberin hebrejve që ta punojnë dhe ta mbjellin dhe ata kishin gjysmën e prodhimit të asaj toke.

## **KUSHTET NË DHURATEË E MARTESËS GJATË LIDHJES SË KURORËS**

Umer b. Hattabi thotë: “**obligime të pjesëve të caktuara lindin** me të vënë të kushtit dhe ty të takon ajo që e ke kushtëzuar”.

Misveri ka thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. kur i përmendi vjehërrinë e vet <sup>163</sup> lavdëroi për marrëdhënie të mira dhe deklaroi: “**Më ka treguar, më ka besuar, më ka premtuar dhe e ka plotësuar premtimin**”.

2721. - Na ka treguar Abdullah b. Jusuf, këtij Lejthi, që thotë: Më ka transmetuar Jezid b. Ebi Habib nga Ebu-l-Hajri, ky nga Ukbe b. Amr:

---

163 Këtu fjala është për Ebu-l-Asin, bashkëshorti i Zejnebes, bijës së Muhammedit a.s. i cili u zu rob në luftën e Bedrit dhe u lirua pa kompenzim, me propozimin e Muhammedit a.s.

---

- E kam dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë: “Kushti më i rëndësishëm që duhet plotësuar është kontrata për dhuratën e kurorës me të cilën u lejohen raportet intime bashkëshortore”. (Krahaso: 5151).

### **KUSHTËZIMI NË BUJQËSI**

2722. - Na ka treguar Malik b. Ismail, këtij Ibn Ujejne, këtij Jahja b. Seid i cili ka deklarnar:

- E kam dëgjuar Hanzal az-Zuraki duke thënë: E dëgjova Rafi' b. Hadixhen r.a. që thoshte: Ne ensarët, kryesisht jemi marrë me bujqësi, andaj edhe e kemi dhënë tokën, ndonjëherë me qesim. Disa herë jepte prodhim një pjesë e tokës e ndonjëherë nuk jepte, dhe kjo na u ndalua, por nuk është ndaluar dhënia me të holla”.

### **ÇKA NUK LEJOHET GJATË LIDHJES SË KURORËS (NIKAHIT)**

2723. - Na ka treguar Museddedi, këtij Jezid b. Zurejji, të cilit i transmetoi Ma'meri nga Zuhriu, ky nga Seidi, ky nga Ebu Hurejre r.a. që tha:

- Qytetari nuk do të shesë (prodhimet) në emër të fshatarit - prodhues, nuk do të bëjnë gara-konkurrencë ndërmjet veti në tregti as nuk do të bëjnë gara me rritje të çmimit në tregëti me vëllan e vet, nuk do të lyp gruan të cilën e kërkon ai e as gruaja nuk do të kërkojë lëshimin e motrës së vet që t'ia përmbysë familjen (të prishë niqahin).

### **KUSHTËZIMI I PALEJUAR NË DËNIME**

2724, 2725. - Na ka treguar Kutejbe b. Said, këtij i transmetoi Lejthi nga Ibn Shihabi, këtij Ubejdullah b. Abdullah b. Utbe b. Mes'udi, i cili përcjell nga Ebu Hurejre dhe Zejd b.

---

Halid El-Xhuhejni r.a. që të dy kanë thënë:

- Një beduin erdhi te Pejgamberi s.a.v.s. dhe i tha:

- O Pejgamber i All-llahut, po të bëj be në All-llahun që të më gjykosh vetëm sipas librit të All-llahut.

Mandej edhe ai i dyti, pala e dytë në kontest, e që ishte më i kuptueshëm se ai i pari i tha:

- Po, të na gjykosh sipas librit të All-llahut.

- A më lejon të flas, i tha beduini.

- Fol, i tha Pejgamberi a.s.

- Djali im - vazhdoi ky - ka qenë hyzmeqar te ky dhe ka bërë amoralitet me gruan e tij. Mua më është kumtuar se djali im meriton gurëzim, denim me gurë, dhe unë e kam shpague nga ky denim me njëqind krerë dhen dhe një robëreshë të vogël. Më vonë i kam pyetur ulemanë dhe më kanë thënë që dialit tim i **takon denimi me njëqind kamxhik dhe përzënia nga vendi për një vjet, kurse gurëzimi i takon asaj, gruas.**

Pejgamberi i All-llahut, pastaj tha:

- **Pasha Atë, në fuqinë e të cilit gjëndet shpirti im, do t'ju gjykoj sipas librit të All-llahut: Robëresha e vogël dhe dhent të kthehen ty, kurse djalit tënd i takojnë njëqind kamxhikë dhe internim për një vjet.**

- **O Unejs, nesër në mëngjes të shkosh te ajo grua, dhe, nëse e pranon veprën (kurvërinë), gurëzoje. Unejsi të nesërmen në mëngjes shkoi te ajo - thotë transmetuesi - dhe ajo e pranoi veprën, kurse Pejgamberi s.a.v.s. urdhëroi dhe ajo mori denimin me gurëzim.**

**KUSHTET QË NUK LEJOHEN PËR ROBIN QË  
ËSHTË KONTRAKTUAR TË SHPAGUHET KUR AI  
ËSHTË I PAJTIMIT TË LIROHET ME SHITBLERJE**

2726. - Na ka treguar Hal-lad b. Jahja këtij i transmetoi Abdu-lVahid b. Ejmen el Mekkije se babai i tij ka thënë:

- Kam hyrë te Aisheja r.a. e ajo më tha: “Më erdhi Berira, ajo kishte bërë marrëveshje që të lirohet me shpagim, dhe më tha: “oj nënë e besëdrejtëve, me blej, sepse zotërinjtë e mi po më shesin, dhe më liro”.

- Mirë, tha Aisheja. Pastaj Berira shtoi: “Zotërinjtë e mi nuk më shesin pa kushtëzuar tutorinë e tyre ndaj meje”.

- **Unë nuk kam nevojë për ty - u përgjigj Aisheja.**

E dogjoi këtë Pejgamberi a.s. apo ia transmetuan, dhe pyeti:

- Çka është me Benren? Mandej tha: “Bleje dhe liroje, e ata le të kushtëzojnë çka të duan”.

Mandej - thotë Aisheja - e bleva dhe e lirova, kurse zotërinjtë e saj vunë kusht për patronat ndaj saj, Pejgamberi s.a.v.s. deklaroi:

- Patronati i takon atij që e liron robin,-madje qoftë njëqind herë shitësi të paraqesë kushte për leverdi të vetën.(nuk i vlejnë).

## **KUSHTET NË RAST SHKURORËZIMI**

Ibn MusejjeL, Hasan (Basriu) dhe A'tau kanë thënë:

Kur e thotë, njëherë, fjalën lëshim, ose e anulon, vendimtare, më i rëndësishëm është kushti.<sup>164</sup>

2727. - Na ka treguar Muhammed b. Ar'ara, këtij Shu'beja nga Adij b. Thabiu, kurse ai transmeton nga Ebu Hazim, ky nga Ebu Hurejre r.a. i cili ka deklaruar:

- Pejgamberi i All-llahut e ka ndaluar t'i presësh (prodhuesit në hyrje të qytetit) dhe t'i shesësh njerëzve (me shantazh) prodhimet e fshatarëve, gruan që të kushtëzojë bashkëshortit prishjen e kurorës me motrën e saj (për nga feja), njeriut të caktojë çmim formal vetëm për të nxitur blerësit e tjerë, edhe mosmjeljen e lopës, (që të duket gjithnjë e fryrë në pazar) para shitjes.

---

164 Kjo është njëllojë, qoftë t'i thotë: “Je e lëshuar nëse hyn në shtëpinë e filanit” ose t'i thotë: “Nëse hynë në shtëpinë e filanit, je e lëshuar”.

---

---

Muhamed b.Ar'arin ( aipas një transmetimi tjetër ) e mbështesin edhe Muadhi dhe Abdu-s-Samedi, të cilët e transmetojnë haithin nga Shu'beja.

## **KUSHTET GJATË BISEDIMEVE ME NJERËZIT**

2728-Na ka treguar Ibrahim b. Musa, këtij i transmetoi Hishami se Ibn Zhurejxhi i ka thënë: “ Mua më ka transmetuar Ja'la b. Muslim dhe Amr b. Dinar nga Seid b. Xhubejri, dhe që të dy kanë shtuar nga diçka në rrëfimin e vëllait të tyre, madje edhe të tjerët : “E kam dëgjuar duke transmetuar seid b. Xhubejrin që ka thënë: Në ishim të Ibn Abbasi dhe ai tha: “Më ka kumtuar Ubej b. Ka'ab:

-Pejgamberi i All-llahut ka thënë: “Musa ( shok i Hëzrit) ka qenë Pejgamber i All-llahut”.

Mandej ka përmendur rastin që Hëzri ka thënë:

-A nuk të thash se nuk mund të durosh me mua?

- Pyetja e parë (e Musait a.s.) ishte nga harresa, e dyta e kushtëzuar, kurse e treta ishte pyetje me qëllim.

Musa ka thënë: “Mos më qorto për atë që kam harruar dhe mos më ngarko me punë të rënda” (që të mësoj diçka nga ti).

Më vonë takuan një djalosh dhe Hëzi e mbyti.

Mandej vazhduan më tutje dhe gjetëm një mur, gati kah rrëzohet dhe ky e ngriti, meremetoi.

Ibn Abbasi, në vend të tekstit të Kur'anit “**Veraehum melikun**” d.m.th. Pas tyre ishte një mbret...”e lexonte “Emamehum melikun”, d.m.th. përpara tyre ishte një mbret...<sup>165</sup>

---

<sup>165</sup> Takimi i Musas a.s. me Hëdrin është mbarështruar në detale te kreu “Shkenca në librin e parë, faqe 136. Shih edhe suren 18: 60-83.

---

---

---

**KUSHTET NË TUTORI (PATRONAT)**

---

2729. - Na ka treguar Ismaili, këtij i transmetoi Maliku nga Hisham b. Urve, ai nga babai i vet, ky nga Aisheja e cila ka thënë:

- **Më erdhi Benra dhe më tha: “Jam marrë vesh me zotërinjtë e mi që të më lirojnë, të shpaguhem, për nëntë okë, dhe kjo te paguhet nga një okë në vit, prandaj më ndihmo të lutem”.**

- Nëse dëshiron unë do t’ua **përgatis menjëherë kurse patronati** ndaj teje të jetë i imi, - tha Aisheja. Berira, atëherë shkei te zotërinjtë e vet dhe u tregoi për këtë, por ata nuk e pranuan kushtin.

Pastaj ajo erdhi përsëri te këta dhe u tha: Unë atyre u shpjegova por ata nuk duan ndryshe, përveç se patronati ndaj meje të jetë i atyre”.

Pejgamberi a.s. rrinte ulur dhe e dëgjonte këtë, mirëpo Pejgamberin e kishte informuar edhe Aisheja për këtë, dhe ky tha: **“Merre këtë, por patronatin kushtëzoje për vete, sepse patronati i takon atij që e liron robin”.**

Atëherë Aisheja veprooi ashtu, kurse Pejgamberi a.s., më vonë u ngrit në mesin e burrave, falënderoi All-llahun dhe tha:

- Çka është me këta njerëz që vejnë kushte të cilat nuk figurojnë në librin e All-llahut. Çdo kusht që nuk është në librin e All-llahut është i pavlefshëm, qofshin edhe njëqind kushte. Vendimi i All-llahut është më i rëndësishmi, kurse kushti i All-llahut më i forti. Ndërsa patronati i takon vetëm atij që e liron robin.

**KUR VEHET KUSHTI NË MARRËVESHJE  
PËR PUNIM TË TOKES QË TA LARGOJË  
KUR DËSHIRON PRONARI I TOKËS**

2730. - Na ka treguar Ebu Ahmed, këtij Muhammed b.

---

---

Jahja Ebu Gassan al-Kinani, të cilit i transmetoi Maliku nga Nafi'u, ky nga Ibn Umeri, i cili thotë:

- Kur ia lënduan dorën (ia nxorrën prej vendit nyJen) Abdullah b. Umerit, Umeri u ngrit dhe ndër të tJera tha: **“Pejgamberi i All-llahut u bëri të mundur hebrenjve të Hajberit të punojnë në tokën, pasurinë e tyre dhe u tha: Ne do t’ju mbajmë sa të jetë vullneti i All-llahut”**.

Abdullah b. Umer doli atje, te pasuria e vet, dhe atje u sulmua (natën) duke fletur, i lënduan nyjet e duarve dhe të këmbëve, e ne atje nuk kemi armiq tjetër përveç atyre. Ata janë armiq të tanë. Ata na sjellin probleme dhe e shoh të rrugës të ndiqen, të përzihen prej aty.

- Kur vendosi për këtë Umeri, i erdhi njëri nga fisi Ebu-l-Hakik dhe i tha: “O sundues i besëdrejtëve, a do të na përzesht, ndjekësh, e Muhammedi neve na ka mbajtur, na lejoj të punojmë pasuritë dhe këtë na bëri kusht?”

- **A mendon se unë e kam harruar?** pyeti Umeri - **deklaratën e Pejgamberit a.s.**

Çka do të bëhet me ty, kur të jesh larguar nga Hajberi? Devet tua të reja do të sulmoin për çdo natë.

**Ai është Huzejle nga Ebu-l-Kasmii - tha ai. Po gënjen o armik i Pejgamberit** i tha Umeri.

Pastaj Umeri i përzuri duke iu dhënë, paguar, vlerën e pasurisë që e kishin si prodhime, deve, pasuri e tundshme, shala, frena e tjera.

Hammad b. Seleme ka transmetuar këtë nga Ubedullahi dhe mendoj - thotë Hammad - se Seleme transmeton nga Nafi'u, ky nga Ibn Umeri, e ai nga Umeri kurse ky prapë nga Pejgamberi a.s. kurse Hamadi e ka shkurtuar.

## **KUSHTET NË LUFTË DHE NË MARËVESHJE ME BANORËT E SHTETIT JOISLAM SI EDHE TË SHKRUARIT E ATYRE KUSHTEVE**

2731, 2732. - Na ka trguar Abdullah b. Muhamed atij

---

---

Abdurrezaku, të cilit i transmetoi Ma'meri duke thënë: *Mua më ka kumtuar Zuhriu: Urve b. Zubejr me ka transmetuar nga Mrisver b. Mahreme dhe Mervani dhe secili prej tyre e konfirmonte rrëfimin e shokut të vet:*

Pejgamberi i All-llahut doli nga Medina në kohën e Hudejbijes dhe pasi e kaluan një pjesë të rrugës, Pejgamberi a.s. tha: **“Halid b. Velidi ndodhet në Gamim me avangarden e kalorësisë kurejshite, mbania djathtas”**.

Dhe, pasha All-llahan, Halidi nuk kishte marrë vesh për këta, deri kur u gjendën në pluhurin e zi të ushtrisë, prandaj u nis me vrap t'u tërheq vërejtjen kurejshitëve.

Pejgamberi a.s. ecte dhe kur arriti në Thenijjet, që lëshohej drejt atyre, deveja u ndal në gjunjë, dhe njerëzit i thirrën: **“Ndal, ndal!”** dhe ai u ndal pak aty. Madje sahabët thanë:

-Kasva u gjunjëzua, Kasva u gjunjëzua! atëherë Pejgamberi a.s. tha: **“Kasva nuk u gjunjëzua. Nuk e ka edet, por atë e ndali Ai, i cili e pat ndalur elefantin ( e Ebrehes)”** madje dhe shtoi: **“Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, ata nuk do të ltpnin asgjë, për lartësim të shenjtërive të All-llahut e unë të mos ua jap atyre.**

**Pastaj e largoi atë prej tyre thotë transmetuesi – ndërsa u lëshua në fund të husejbijes, në Saednjë burim i vogël me pak ujë, prej nga njerëzit grabisnin nga pak dhe kështu vazhdonin deri kur e shterren dhe mandej iu ankuan Pejgamberit a.s. se kanë etje. Ai e nxorri shigjetën nga takami i vet dhe urdhëroi ta vendojnë tek burimi.**

Pasha Zotin ujë ridhte vazhdimisht dhe kishte për të pirë të gjithë deri kur u larguan prej aty. Dhe derisa ishin aty, u erdhi Budejl b. Vereka el-Huzai me një grup të shokëve të vet nga fisi Huza'a, të cilët kishin mbajtur, fshehur, sinqerisht, mendim të mirë për Pejgamberin a.s. nga banorët e Tihamës, dhe tha:

Unë e kam lënë Ka,ab b. Lujjin dhe Amir b. Lujjin të rrinë te disa burime të pashterrshme uji të Hudejbijes, dhe ata kanë deve që milen (me deve të vogla) edhe gra me fëmijë për gjiri.

---

---

---

Ata do të luftojnë me ty dhe do të largojnë nga Qabeja.

Ne nuk kemi ardhur - tha Pejgamberi a.s. - për asnjëfarë lufte, por jemi nisur të kryejmë Umren. Kurejshitët i ka lodhur lufta dhe i ka varfëruar, prandaj nëse dëshirojnë do t'ua vazhdoj afatin e (marrëveshjes për paqe) dhe rrugën do ta kenë të lirë ndërmjet meje dhe asaj bote, dhe nëse kjo dominon te ata dhe dëshirojnë të hyjnë aty ku ka hyrë bota, le ta bëjnë, por nëse kjo nuk mbizotëron te ata, vetëm për shkak se janë tubuar në numër të madh dhe nëse nuk e dëshirojnë këtë, pasha Atë në fuqinë e të cilit gjëndet shpirti im, do të luftoj me ata për këtë çështje, deri kur të ndahet qafa (shkojë koka) ose All-llahu të bëjë që të zbatohet Urdhëri i Tij.

Budejli pastaj tha: **“Do t'ua përcjelli ç'ka ke thënë”**.

Atëherë - thotë transmetuesi - ai shkoi, arriti te kurejshitët dhe tha:

Ne kemi ardhur te ju nga ai njeriu (Muhammedi). E dëgjuam se ç'ka thoshte, dhe nëse dëshironi t'ua prezentojmë, ne do ta bëjmë atë?

- **Nuk kemi nevojë** - thanë ata të marrët nga mesi i tyre - të na kumtohet asgjë prej tij, ndërsa të mençurit në mesin e tyre thanë: **“Na thuaj çka ke dëgjuar”**.

- E kam dëgjaur se fliste kështu e kështu, tha Budejli. Mandej ua rrëfeu se çka kishte thënë Pejgamberi a.s.

Urve b. Mes'ud, pastaj, u ngrit dhe tha:

**O burra, a jeni ju prindër? Gjithsesi po, u përgjigjën ata.**

**A thua nuk keni ju fëmijë?** pyeti ai. **Sigurisht, po, u përgjigjën ata.**

**A dyshoni në mua?** - pyeti ai. Jo, u përgjigjën ata.

**A nuk e dini - shtoi ai - se unë kam thirur në ndihmë banorët e Ukazit, dhe pasi që u tërhoqën (hoqën dorë) ua kam sjellë shtëpiarët e mi, fëmijët e mi dhe ato që më ndëgjojnë (nënshtrohen)? Sigurisht, thanë ata.**

**Me të vërtetë** - tha Urve - **ai u afron vijën e rrugës së**

---

---

**drejtë. Pranoni atë dhe më lejoni që të shkoj te ai. Shko i thanë ata.**

Ai pastaj bisedoi me Pejgamberin a.s. dhe Pejgamberi s.a.v.s. i tha njëloj çka i pat thënë Budejiit, kurse Urve u përgjigj:

O Muhammed, nuk mendon, ndoshta, të çrrënjosësh çështjen e popullit tënd? A e ke dëgjuar ndokënd nga arabët përpara teje se ka shfarosur shtëpiarët e vet, e ti të bëhesh i dyti? Pasha All-llahun, nuk shoh asnjë njeri me autoritet por as ndonjë nga masa e zakonshme, që është i aftë, që do të lagohet e të të lërë ty.

Në këto fjalë Ebu Bekri tha: Shih provokatorin e Lates! A ne të ikim e ta lëmë vetëm a?

**Kush është ky?** pyeti Urve. **Ebu Bekri**, i thanë.

**Pasha Atë në duart e të cilit është jeta ime, po të mos ishte respekti që kam ndaj teje, ti kurrë nuk do të kishe kaluar lehtë, dhe me s'do të isha përgjigjur -** tha Urve.

Pastaj - thotë nansmetuesi - e vazhdoi bisedën me Pejgamberin a.s. dhe sa herë që folte diçka, e kapte Pejgamberin a.s. për mjekre, kurse Mugire b. Shu'be rrinte mbi krye të Pejgamberit s.a.v.s. me shpatë i mbrojtur me helemete, dhe, kur Urve vente doren në mjekrën e Muhammedit a.s. Hugire i binte dores me pjesën e poshtme të dorzes së shpatës dhe i thoshte: **“Hiqe dorën nga mjekra e Pejgamberit të All-llahut”**.

Urve ngrin kryet dhe pyen: **“Kush është ky? Mugir b. Shu'be thanë.**

**Tradhtar, a nuk të ndihmova edhe unë në tradhtinë tënde.**

Mugire në kohën e xhahilijent ishte në shoqëri me një grup njerëzish (të fisit Thekif) i vrau dhe ua mori pasurinë, pas kësaj erdh në Medinë dhe pranoi fenë Islame. Pejgamberi atëherë i tha: **“Sa i përket islamizmit, une të pranoj, e sa për pasurinë me të nuk kam lidhje”**.

Pasta Urve hodhi një shikim në shokët e Pejgamberit a.s. e tha:

---

- Pasha Zotin Pejgamberi i All-llahut nuk ka lëshuar pështymë e ajo të mos bie në duart e ndonjërit nga burrat e pranishëm, dhe ai me këtë fërkonte fytyrën e trupin; dhe kur u jepte ndonjë urdhër, ata nxitonin si në gara të zbatojnë urdhërat e tij. Kur merrte abdest ata gati sa nuk përleshin për ujin e abdesit të tij, kurse kur fliste ata heshtnin, nuk dogjoheshin fare dhe nga respekti ndaj tij nuk e shikonin pa simpati.

Urve pas kësaj kthehet te shokët e vet dhe u tha:

-O burra, pasha Zotin, kam **qenë me delegacion të mbretit** kam qënë në delagacion te mbreti i Bizantit, mbreti i Persisë edhe i Etiopisë. Pasha Zotin kurrë nuk kam parë asnjë mbret kaq të respektuar nga shokët e vet, si e respektojnë shokët e Muhammedit Muhammedin. Pasha Zotin, nuk ka lëshuar pështymë që nuk ka rënë në shuplakë të ndonjërit prej tyre e ai me të fërkonte fytyrën dhe trupin, dhe kur i urdhëronte ndonjë send ata bënin gara të kryejnë urdhërin e tij, kur merrte abdest, gati sa nuk ziheshin për ujin e abdesit të tij, dhe kur fliste diçka, ata nuk ndiheshin fare, heshtnin, dhe nga respekti ndaj tij nuk e shikonin ashpër, të mërrrolur.

Ai ju afron drejtimin e rrugës së drejtë, prandaj pranone.

Mandej, një njeri nga (fisi) Benu Kinane tha:

**Më lejoni të shkoj te ai. Shko,** i thanë ata.

Kur iu afrua Pejgamberit a.s. dhe shokëve të tij, Pejgamberi s.a.v.s. tha:

- Ky është filan fisteku. Ai është nga një popull (fis) që e respektojnë devenë (për kurban në Qabe) prandaj dërgojeni një me te. Kur e sollen devenë burrat filluan telbijen. Kur e pa këtë, thirri, i mahnitur, **“Subhanall-llah, këta nuk meritojnë të pengohen nga vizita (Qabes)”**, mandej u kthye te shokët e vet dhe tha:

- Kam parë deve (për kurban në Qabe) me xherdana për qafe dhe të shenjuara (për kurban) dhe nuk mendoj të refuzohen nga Qabeja.

**- Kalo në marrëveshje - i tha Pejgamberi a.s.**

**Unë nuk e vazhdoj më, u përgjigj Suhejli.**

**Gjithsesi - shtoi Mikrezi - do ta bësh.**

**Unë nuk e vazhdoj më, tha prapë Suhejli.**

**Përkundrazi - ndërhyri Mikrezi - po, ta vazhdojmë.**

Atëherë Ebu Xhendeli tha: “o popull musliman, a do të më ktheni vallë te politeistët, e unë jam musliman? A nuk e dini se çka kam haqur? Kamë qenë i dënuar me dënimin më të rëndë për shkak të besimit në All-llah.

Umer b. Hattabi ka deklaruar:

- Unë atëherë iu drejtova Pejgamberit a.s. dhe i thashë: “A nuk je ti, me të vërtetë, Pejgamberi i All-llahut? Gjithsesi, po, tha ai. A nuk jemi ne në rugë të drejtë, e armiku ynë në të rrieshme? e pyeta unë.

Pa dyshim - u përgjigj ai. E pse atëherë t’u përkulemi atyre që nuk janë askushi në fenë tonë? Ai atëherë u përgjigj:

- Unë jam Pejgamber i All-llahut. Unë Atij nuk i kundërshtoj se Ai është ndihmësi im.

A nuk na ke folur - vazhdova unë - ti se do të vimë në Qabe dhe do ta vizitojmë? Po, patjetër, tha Alejhisselami. Të kam thënë se do të vijmë te ajo këtë vit? Jo - i thashë.

Po ti, pa dyshim - tha Muhammedi a.s. - do të vish ta vizitosh.

Unë, mandej - thotë Umeri - erdha te Ebu Bekri dhe i thashë: “o Ebu Bekr, a nuk është ai njëmend Pejgamber i All-llahut? Sigurisht **po**, tha ai. **Po ne a nuk jemi në të drejtë e armiku unë në të shrembër, e pyeta. Pa dyshim - u përgjigj ai.**

E përse atëherë të përkulemi te kurkushët për shkak të fesë tonë?

- O burre, tha Ebu Bekri: “Ai është ndihmës i tij dhe ky i përmbahet urdhërit të Tij. Pasha All-llahun, ai është më të drejtë.

Po a nuk ka thënë - vazhdova unë - se do të vijmë në Qabe dhe ta vizitojmë? Sigurisht, po, tha ky. A të ka thënë se do të vish këtë vit, e kjo nuk bëhet? - i thashë.

---

**Ti do të vish,** me siguri tha Ebu Bekri, **dhe do ta vizitosh.** Zuhriu ka deklaruar se Umeri më vonë ka thënë: **“Unë pas kësaj kam bërë shumë (vepra) të mira, për shkak të kësja sjellje time”.**

Pasi që e kreu marrëveshjen Alejhisselami, thotë Zuhriu, **Pejgamberi s.a.v.s. u tha shokëve të vet:**

Çohuni dhe pritni kurbanë dhe pastaj rruajeni kryet.

Pasha All-llahun, thotë Zuhriu, askush nuk u ngrit deri sa nuk e tha këtë urdhër tri herë. Pasi që nuk u ngrit askush prej tyre, ky hyri te Ummi Seleme dhe ia rrëfeu se çka i nodhi me njerëzit, kurse Ummi Seleme i tha: **“O Pejgamberi i All-llahut, nëse dëshiron këtë, dil dhe mos fol me asnjërin asnjë fjalë deri kur të presësh kurbanin për vete dhe ta thërrasish rrojtarin që të të rruaj,,.**

Atëherë ai doli dhe nuk foli me askënd prej tyre deri kur i kreu këto veprime: theri deven e vet, thirri rrojtarin e vet dhe ky e rruajti.

- Kur e panë njerëzit tjerë, u ngriten, therën devetë dhe rrujtën njëri tjetrin, aq të brengosur sa ishin në gjendje të zihen ndërveti.

Mandej i erdhën Alejhisselamit disa gra muslimane, prandaj All-llahu xh.sh. shpalli: *“O besimtarë! Kur t’iu vijnë besimtare si emigrante, ju verifikoni ato, por All-llahu e di më së miri besimin e tyre. Nëse i njihni si besimtare, mos t’a ktheni mosbesimtarëve. Ato nuk u lejohen atyre as ata u u lejohen këtyre. Jepnu atë që kanë shpenzuar dhe nuk e keni mëkat të kurorëzoheni me ato pasi që t’iu jepni mehrin. Mos i mbani politeistet nën kurorët,<sup>166</sup>*

---

<sup>166</sup> Ajeti vazhdon: *“Kërkoni atë çka e keni dhënë, por edhe ata le të kerkojnë çka kanë shpenzuar. Ai është gjykim i All-lladhut. Ai gjykon ndërmjet jush. All-llahu është shumë i dijshtëm e i urtë.”* (Mumtehine: 10).

---

Atëherë Umeri i lëshoi dy gra të vetat që ishin politeiste dhe njerën prej tyre e mori (beri kurorë) Muavi b. Ebi Sufjani, kurse tjetrën e mori Safvan b. Umejje.

Pejgamberi a.s. mandej u kthye ne Medine, dhe i erdhi Ebu Besiri, burrë kurejshit që ishte musliman, kurse kurejshitët kishin dërguar dy veta që ta lypin prapë.

Përmbaju marrveshjes - i thanë ata - që na ke dhënë. Muhammedi a.s. ua dorëzoi atyre të dyve dhe ata e morën, por duke shkuar kur arritën në Dhu-l-Hulejfe, u ndalën të hanë diçka prej hurmave që kishin me vete.

Me këtë Ebu Besiri i tha njërit prej tyre: **“ O filan, pasha All-llahun, ajo shpata jote po më pelqen, më duket e mirë “** Ai e nxori dhe tha: **“ Po, pasha Zotin. Kjo është njëmend e mirë, dhe me këtë kam ushtruar dhe jam aftësuar.”** Pastaj Ebu Besiri tha: **“ Tregoma ta shoh. Dhe ky ia rrëmbeu, zuri pozitën (për sulm) dhe ra ashtu që e ftofi (e mbyti) kurse tjetri iku, erdhi në Medine dhe vrap e hyri në xhami. Kur e pa Pejgamberi a.s. tha:,, Ky është njeri i trembur.,,**

Pasi iu afrua Pejgamberi a.s. i tha: **“ Pasha :Zotin, shoku im u vra, sigurisht edhe unë do të vritem, do të jem i mbytur.,,**

Atëherë erdhi Ebu Besiri dhe tha: **“ o Pejgamber i All-llahut, Pasha All-llahun, All-llahu te çoi te plotësosh obligimin per të mbrojturin tend (sipas marrveshjes). Më ktheve te ata, por All-llahu më shpëtoi prej tyre.**

Pejgamberi a.s. atëherë tha:,, E mjera nënë e tij. Kjo punë nxiti luftë, nëse i mbyturi ka ndokend nga familja,,

Kur dëgjoi këto fjalë Ebu Besiri e kuptoi se Muhamedi a.s. do t'ua dorëzojë prapë atyre, dhe mori rrugën, u largua, dhe erdhi deri në breg të detit.

Edhe Ebu Xhendeli - thotë transmetuesi -iku nga ata dhe iu bashkua Ebu Besirit.

Në këtë mënyrë secili që pranonte fenë Islame ikte nga kurejshitët, i bashkohej Ebu Bekrit dhe ashtu prej tyre u formua

---

një grup i madh. Dhe pasha All-llahun, sa herë që dëgjonin për ndonjë karavan kurejshit se është nisur për në Siri, ata ia zinin rrugën, njerëzit i vrisnin kurse pasurine ua merrnin.

Kurejshitët dërguan (Ebu Suflanin) te Pejgamberi a.s. duke e përbetuar në Zot dhe në lidhjen familjare, duke lutur që t'ua dërgojë (të zënë) kurse ata që vijnë vetë janë të sigurt. Atëherë Pejgamberi a.s. lëshoi urdhërin, për çka All-llahu xh.sh. shpalli: *“Ai është i cili ka penguar duart e tyre prej jush dhe të tuajat prej tyre në mes Mekkes, pasi që u bëri fitimtar kundër tyre, se All-llahu sheh mirë çka punoni ju”*. Ata janë të atillë që nuk besojnë dhe ju pengojnë ti afroheni Qabes, dhe kurbanët e dedikuar (i pengojnë) të arrijnë në vendet e tyre. Sikur të mos kishte burra besimtarë dhe gra besimtare, të cilët nuk i dini, do t'i maltretoni dhe ashtu për shkak të tyre, pa e ditur, do të turpëroheni. All-llahu le ta shtjerë në mëshirën e vet kë të dojë. E sikur të kishin qenë të ndarë, me të vërtetë do t'i kishim dënuar me dënim të rëndë ata të cilët nuk besojnë”. **“Kur ata që nuk besuan mbushën zemrat e veta me arrogancë, arrogancë të paganizmit...”,**<sup>167</sup>.

Krenaria e tyre mbështetej në faktin se ata nuk e pranuan që Muhammedi është Pejgamber i All-llahut dhe që nuk pranuan tekstin (marrëveshjen) **“Në emër të All-llahut, të Gjithmëshirshmit, Mëshirëplotit,”** dhe që i penguan muslimanët nga Qabeja.

2733. - Ukjali, duke transmetuar nga Zuhriu, thotë se Urveja ka thënë: “Më ka transmetuar Aisheja se Pejgamberi a.s. i ka marrë në hetime gratë e shpërngulura dhe na ka kumtuar se ai, kur i shpalli All-llahu xh.sh. që t'ua kthejnë politesitëve ato (dhuratat

---

<sup>167</sup> Ajeti vazhdon: “ .. pra All-llahu lëshoi qetësinë e vet në Profetin e vet dhe në besimtarët, edhe i obligoi të bëhen besimtarë të vërtetë - se ata edhe janë më të denjë dhe më të rëndësishmit si edhe familja e tyre, ndërsa All-llahu i di të gjitha”. (Fat-h: 24-26).

---

e martesës) që ua kanë dhënë ata atyre, grave të tyre që kanë ikur (nga Meka) dhe kur ka gjykuar që muslimanët të mos mbajnë në kurorë femra politesite Umeri i lëshoi (mënjëherë) dy gra të **vetat: Kurejben, të bijën e Ebu Ubejjit dhe të bijen e Xhervel el-Huza'iji dhe Kurejreja** u martua me Muavi b. Ebi Suflanin, kurse atë tjetrën e mori Ebu Xhehmi.

Pasi që politeistët nuk deshën të pranojnë të japin atë çka muslimanët u kanë dhënë (nga dhurata kurore) grave (bashkëshorte) të dikurshme) të veta, All-llahu sh.sh. ka shpallur: *"... Nëse ndonjëra prej grave tuaja shkon te mosbesimtarët, dhe u vjen rasti juve". (6:11).*

**"El-akbu,** është ajo që muslimanët i japin politeistit gruaja e të cilit ka ikur (te muslimanët në Medinë).

Më këtë rast ka urdhëruar edhe që dhuratë e kurores t,i jepet atyre, nga mesi i muslimanëve, gratë e të cilëve kanë shkuar, aq sa i ka dhënë ai dhuratë për kurorë grave të politeistëve; atyre që kanë ikur në (Mekke), por ne nuk dimë asnjë femër nga të ikurat (nga Meka në Medine) që të jetë kthyer (në politeizëm) pasi që e ka pranuar fenë Islame.

Ndërkaq na është transmetuar (thotë ZuEriu se Ebu Besir b. Esed eth-Thekafij erdhi te Pejgamberi a.s. si besimtar muhaxher në kohën (e marrëvehsjes paqes) prandaj Ahnes b. Sherik i shkroi Pejgamberit a.s. dhe ia kërkoi Ebu Besirin dhe me këtë rast ia përmendi tërë rastin.

## **KUSHTET NË RASTIN E HUAS**

2734. - Lejthi ka thënë: Më ka transmetuar Xhafer b. Rebi'u i cili transmeton nga Abdurrahman b. Hurmuzi, ky nga Ebu Hurejreja r.a. se Pejgamberi a.s. përmendi një njeri i cili ka kërkuar nga një izraleit që t,i japë hua një mijë dukatë dhe ky ia ktheu në afatin e caktuar.

---

Ibn Umeri dhe A,tau r.a. kanë thënë: **“Huaja është e lejuar kur i caktohet afati për kthim),,,**

## **ROBI I LIRUAR ME MARRËVESHJE PËR KOMPENZIM DHE KUSHTET QË NUK LEJOHEN NGASE JANË KUNDËRSHTIM ME LIBRIN E ALL- LLAHUT**

Xhabir b. Abdullah r.a. ka thënë për robin e liruar me marrëveshje për shpagim: “Kushtet e robit dhe të zotëriut, ndërmjet tyre janë (të plotfuqishme). Ndërsa Ibn Umeri, ose Umen r.a. thotë: **“Çdo kushtëzim në kundërshtim me librin e All-llahut është i pavlefshëm, qoftë edhe njëqind herë të kushtëzohet”**.

Ebu Abdullah (Buhariu) thotë: **“Kjo është transmetuar nga dy vetë: nga Umeri dhe Ibn Umeri),,,**

2735. - Na ka treguar Ali b. Abdullah, këtij i transmetoi Sufjani nga Jahja, ky nga Amra e ajo nga Aisheja r.a. e cila ka deklaruar se kësaj i erdhi Berira dhe kërkoi nga kjo ndihmë materiale për kompenzim, të lirohet prej robërisë, e kjo i patë thënë:

Nëse dëshiron do t’ia jap shumën zotëriut tënd, por patronati ndaj teje të kalojë tek unë. Dhe kur erdhi Pejgamberi a.s. kjo ia përmendi këtë, kurse Pejgamberi a.s. i tha: **“Bleje dhe liroje, ndërsa patronati i takon vetëm atij që e liron robin),,,**

Pastaj Pejgamberi i All-llahut u ngrit në minder dhe tha: **“Çka është puna e këtyre njerëzve që vejnë kushte të cilat nuk gjenden në librin e All-llahut! Ai që ve ndonjë kusht për vete që nuk është në Librin e All-llahut, nuk i takon këtij, madje edhe në qofë se këtë e bën njëqind herë”**.

---

**ÇKA ËSHTË E LEJUAR TË KUSHTËZOHET NË  
SHPREHUR DHE KUSHTET QË JANË TË  
RENDOMTA NDËR NJEREZIT DHE KUR DIKUSH  
THOTË “NJË QIND PA NJË,, (NËNTEDHJETË E  
NENTË PËR QIND)**

Ibn Avni transmeton nga Ibn Sirini, se një njeri i tha punëtorit të vet Hyzmeqarit): **“Shitja deven tënde, e nëse ajo nuk shkon me ty filan ditën, do të kesh prej meje njëqind derhemë dhe nuk doli, nuk shkoi,,.**

Shurejhi ka thënë: **“Ai që i kushtëzon vetes diçka vullnetarisht, pa e detytuar askush, e ka obligim (ta realizojë kushtin).**

Ejubi transmeton nga Ibn Sirini:

- Një njeri shiti njëfarë ushqimi dhe tha (blerëist): **“Nëse ti nuk vjen ditën e mërkur, ndërmjet nesh nuk kemi kurrfarë pazari dhe ai nuk erdhi. Shurjehi, më vonë, i ka thënë blerësit: “Ti ke tradhtuar dhe e gjykoi,,.**

2736. - Na ka treguar Ebu-l-Jeman, këtij i transmetoi Shuajbi, këtij Ebu-z-Zinadi nga A’rexhi, kurse ky nga Ebu Hurejre r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: **“All-llahu i ka nëntëdhjetë e nëntë emra, njëqind pa një, dhe kush i di më së miri do të hyjë në xhennet,,.** (Krahaso: 6410, 7392).

**KUSHTET GJATË LËNIES VAKËF**

2737. –Na ka treguar Kutejb Seit këtij Muhammed b. Abdullah Eansari, kurse këtij i Ibn Avn duke thënë:

Më ka lajmëruar Naf’u që transmeton nga Ibn Ummeri r.a. se Ummer b. Hattabit i pëlqeu një tokë në Hajber dhe i erdhi Pejgamberi a.s. t’i kërkojë këshillë për këtë dhe tha : **“ O Pejgamber i All-llahut, kam fituar një tokë në Hajber dhe nuk kam asgjë më të dashur se ajo pasuri, ccka po më**

---

---

**urdhëron të bëj për këtë ?”**

**Nëse dëshiron, tha Alejhisselami, bëre vakf, bazën ,kurse prodhimin shpërndaje.**

Pastaj Omeri – **Thotë Nafi’u ne bëri vakuf “ e la vakëf”** më kusht që nuk mund të shitet, nuk mund të dhurohet dhe nuk mund të trashëgohet, kurse rendimenti, frutet, u shpërndahen të varfërve, farefisit , për kompensim ( blerjen) e robërve, për hir të rugës së All-llahut, udhëtarit ( që nuyk ka mjet material), musafirrit. Edhe ai që e punon, udhëheq, nuk e ka gjynah të hajë nga ajo, me masë ( sipas traditës), të ushqeje edhe të tjerët duke mos grumbulluar për vete pasuri.

Ibn Avan ka deklaruar: Ia rrëfeva këtë Ibn Sirinit, e ai tha: “**... vetëm që me këtë të mos grumbullojë pasuri për vete”.**



---

## PASTHËNIE

*”Ai i cili punon mirë, sa grima - e sheh atë, por edhe kush bënë keq, qoftë sa grima - do ta shohë”.*

Kur'an 9:9: 7-8

Jeta, megjithatë rjedh binarëve të vet Të gjithë popujt e botës i kanë kush më shumë e kush më pak engjujt e djajt e vet. Populli shqiptar nuk mund të jete perjashtim. Në këto vite të lekundjeve të mëdha e të pergjithshme, sidomos në Ballkan, popullit shqiptar më shumëse të gjithë popujt e Ballkanit i ka rënë për hise të përjetojë më shumë hidhërime sesa gëzime. Në mënyrë të veçantë shqiptarët *e mbetur* jashtë kufijve të shtetit amë. Pavarësisht se me fajin e kujt

Megjithatë, edhe këta nuk e lenë pa e vënë një gurë në kalanë shqiptare, qoftë në fushë të arsimit, fesë, kulturës shkëncës etj, e cila kala, edhe pasi të ndërtohet nuk mund të qëndrojë pa angazhimin konkret e me sinqeritet të pjesës më të madhe të faktorit shqiptar.

Viti 1994 do të mbahet mend, për shumëçdka , por historia e kulturës shqiptare këtë moment do ta shënojë me prezantimine veprës “Sabihu-l-Buhaari”, pra lexuesve shqiptarë, për herë të parë në gjuhën shqipe, nga e cila vepër se shpejti do të ketë në duar tetë vëllimet e parë. Koleksioni i Buharit me hadithe të Muahmmedit a.s. paraqet kulminacionin e saktësisë haditheve të Alejhisselamit. Për kriterin e saktësisë flet fakti se prej gjashtëqind mijë hadithve të mledhura, pas nj

7 shqyrtimi dhe krahasimi të gjithanshëm të burimit dhe përcjelljes deri tek mebledhësi, në nëntë vëllimet e Buhariut kanë gjetë vend vetëm 7563 (shtatë mijë e psqind e gjatëdhejete e tre) hadidjhe.

Me këtë botim të “Sahihu-l- Buhari” lexuesi shqiptar ka në duar dy burime themelore të Fesë Islame: Kur’anin dhe Hadithin.

Lexues të nderuar, literatura Islame shqiptare zë fill në vitet e njëzeta të shekullit njerëzit, mirëpo nga lëmi i haditheve, deri në idtëtë e sotme, në gjuhën shqipe, nuk kemi pasë ndinjë botim të ceccantë më vëllimore se :Katërdht hadithe” nga Imam Nevevi, që është botuar disa herë anë e kanëd ku jetojnë shqiptarët. Në vitin, 1994, doli nga shtypi edhe libri “Kështu fliste Muahmmedi a.s.” në du vëllime, por koleksioni “sabibu-l-Buhari”, si në origjinal, po ashtu edhe përkthimi edhe botimi në gjuhën shqipe, nga shumë aspekte ndryshojën prej përkthimeve dhe botimeve tjera, e që mund të hetohet dhe nga lexuesi i zakonshëm.

Me sa di, ndër lexuesit shqiptarë është menduar dhe është biseduar individualisht për përkthimin e “sahihu-l- Bulhari”, mirëpo deri në fund të vitit 1992 nuk kishte asgjë konkrete. Pas disa konsultimeve, në fillim të vitit 1993 me arsimtarët e degës së Orejentalistikës në Prishtinë në 18 ’93 morëm përsipër detyrën konkrete që ta përkthejmë koleksioni e njohur të haditheve me titullin “Sabiul-Buhari”.

Dashti All-llahu xh.sh dhe në afatin e paraparë u kryen vëllime 1.2.3.4,5,7, e më vonë vëllimi 8, por kur duhet të gjenin një botues hasi shara në gozhdë. U drejtuam instiutcioneve kopetente islame në Prishtin, Shkup, Dibër me shkirm dhe me gojë por përgjigjen e morëm ose me heshtje ose me arsyetim se momentalish nuk është në gjendje ta marrë përsipër botimin pastaj iu afruam shtëpisë botues “Logos –A” në Shkup, por dhe aty nuk arritë të sigurojnë mjetet për botim në nëntor të 1994 vendosëm që botues të bëhen se cili përkthyes për librin e vet dhe duke falenderuar shtypshkonjë “Tinegate” në Prishtinë dhe bashkëpunëtorëve të tjerë për mirëkuptimin që treguan lidhur me pagesën e shërbimeve teknike”Sahbiu-l-Bubari” në gjuhën shqipe u bë pronë e tërë lexuesve shqiptarë.

Nderkaq vëllimi i gjashtë mbeti pa u përkthyer. Në qershor

---

---

---

të vitit 1995, në emër të grupit punues kërkova nga bashkpunëtori Ruzhdi Lata që deri në janar të vitit 1996 ta krye } këtë obligim, por mbeta pa përgjigje. Prandaj në qershor të ~vitit 1998 i hyra punës në përkthimin e librit të 6 dhe me ndihmën e Zotit xh.sh. lexuesi shqiptarë tani do ta ketë edhe këtë vëllim me hadithe në gjuhën e vet amtare.

Nëntë vëllimet e Buhariut me 7563 hadithe të zgjedhura e të mbarshtruara sipas temave boshte për çështjet Islame' si: namazi, agjërimi, zekati, haxhi eti.. janë të redaktuara edhe nga filologu **Ibn Malik** dhe u botuan, përveç vendeve të tjera , edhe në Kajro në vitet 1862, 1887, 1889, 1893, 1894, dhe në literaturën Islame zënë vendin e parë, pas Kur'anit, si spjegimi më autentik i normave në besim dhe në veprime në fenë Islame.

Numrimi i haditheve, kështu siç ia prezentoimë lexuesit tonë, është bërë nga muhaddithi i njohur Ahmed b. Ali b *haxter Al'Aska/ani* 1371-14~ (77:3 852 h.) me çka ka dhënë kontribut të madh për funksionalitetin e kësaj vepre të rëndësishme. Edhe ne gjatë përkthimit i përmbahemi besnikënsht kësaj radhitie.

Libri i gjashtë përfshin 477 hadithe, që në këtë vëllim gjenden ndërmjet numrave 2260 e 2737. Nga këto hadithe mësojmë si vepronte Pejgamberi Muhammed a.s. me puntorët e krahut me mëditie, me autorizimet për pagesën e horxheve tjetrit; çka u lejonte dhe çka nuk i lejonte shokët dhe bashkëkohësit e vet lidhur me punët e bujqësisë, ujëdhënies, huazimeve të ndryshme; mësojmë për kushtet e dëshmitarit në konteste gjyqësore, për pajtimin e njerëzve, roli i parisë në paitimin ndërmjet njerëzve për mosmarrëveshie të ndryshme, etj.

Tani, me librin e gjashtë të Sahihu-l-Buhanut në gjuhën shqipe, nga hadithet që i ka zgjedhur fakihu dhe muhaddithi i merituar, Buhariu, që kam fatin e kënaqësinë t'ua afroj në gjuhën amtare;

---

---

si dhe nga komentimet e nevojshme që janë të zgjedhura nga Ibn Haxher Al-Askalani dhe Hasan Shkapur, ju personalisht njoftoheni dhe infomoheni se çka ka thënë Resulull-llahu për pagesën e puntont, për pajtimin e njerezve, si duhet vepruar me para e sende të gjetura, si veprohet me borxhet, kush mund të ndërmjetesojë në pagesën e borxhit; do të mësoni për fitimin me nder nga bujqesia dhe nga tregtia etj.. Tani kur këto sqarime i kemi në gjuhën tonë, na mbetet që ti zbatojmë në mënyrë korrekte këto veprime ashtu siç vepronte, porosiste apo parapëlqente Muhammedi a.s. Në rast të ndonjë paqartësie të leçisim me kujdes kureshtien e bashkëkohanikëve të Muhammedit a.s. dhe përgjigjet që u jepte ai për çështje konkrete. Nëse kështu veprojmë kurrë nuk do të gabojmë.

Në këtë botim i jemi përmbajtur me besnikëri origjinalit të Buhariut, prandaj lexuesit shqiptar, vargu i emrave në pjesën e parë të secilit hadith “senedi”, që jemi përpjekur, sa ka qenë e mundshme ta rreshtojmë në frymën e gjuhës shqipe: *Na ka treguar. . . na ka rrëfyer. . . i cili ka dëgjuar. . . ai nga. . . nëpërmjet të. . . i cili i ka thënë: . . . , këtij; . . . , ndërsa. . . , etj.*, ne asnjë mënyrë mos i duket si përsëritje e kotë. Përkundrazi lexuesi të ndiejë kënaqësi, sepse në këtë mënyrë ka arrit te fjala e Muhammedit a.s., të cilën bashkëkohaniku i tij, për shembull: Ebu Bekri, Enes b. Maliku, Aisheja, Ebu Hurejreja r.a. etj., ia la amanet brezit pas tyre, ndërsa këta brezit tjetër dhe kështu, Buhariu (81087~, i shënoi, i zgjodhi me kujdes, i verifikoi dhe ua la amanet atyre që dëshirojnë të marrin dituri nga burimi. Nëse ndonjorin nga hadithet që i lexoni këtu nuk mund ta kuptoni lehtë, atëherë përpiquni ta veni vehten në shekullin e shtatë, në radhë të parë në rrethanat historike, sociologjike e kulturore, por edhe ato gjeografike. Në këtë mënyrë asgjë nuk do të mbetet e paqartë.

Përmendja e emrave, “senedi” që fillon nga ai më i afërti për

---

---

---

mbledhësin e haditheve, dhe shkon kah ai më i largëti, i cili giendet tek burimi, Buhariut i ka shërbyer të verifikojë kualitetet e nevojshme, morale, psiqike, fizike, të atyre nëpër gojën e të cilve ka kaluar hadithi konkret. Sëkëndejmi në këtë vëllim do të hasni hadithe të ngjashme me ndryshime minimale dhe kjo është garancë e saktësisë në vijën e përgjithshme të haditheve që i keni para vetes. Sepse evidentimi i hadithit që bënë fjalë për një çështje nga disa transmetues, pa asnjë ndryshim, ose me ndryshime krejtësisht të vogla, flet për transmetimin besnik të haditheve duke i ruajtur detajet më të imta.

**Buhariu na thote:** *Hadithet që i kam shenuar i kam mbledhur mbase edhe nga ,më tepër se 1000 dijetarë, dhe nuk e kam shënuar asnjë hadith për të ci/in nuk e kam vargun e transmetuesve “senedin” të pashkëputur në burim.*

Këtë mënyrë të prezantimit para lexuesit tonë e kemi parë të arsyeshme sa për lexuesit e zakonshëm, aq edhe për katëgorinë e lexuesëve të cilët janë të kyçur në rrjedhat e burimeve dhe literaturës islame, posaçërisht të hadithit. Ky prezantim besnik, me sened të plotë sipas origjinalit, dhe me tekstin e hadithit origjinal përballë përkthimit në gjuhën shqipe, është mbështetia më e fortë që shërben për evitimin e hamendjes eventuale të ndonjë lexuesi laik apo edhe profesional.

*Sahihu-/Buhari* është botuar dhe ribotuar sa e sa herë. Është botuar me komentime e pa komentime, madje edhe është përkthyer në gjuhë të ndryshme të botës. Ka disa përkthime në gjuhën turke, kurse në gjuhën frengje është botuar ndërmjet viteve 1903-1914 me titullin “El-ehadisu-l-islamijje”, e më vonë edhe në anglisht. Në njërin nga botimet në gjuhën turke, botimi i tretë, i përkthyer nga Kamil Mliras, nuk është respektuar tërësia e koleksionit. Përveç kësaj, këtu është hequr edhe senedi, si pjesë përbërëse dhe e pandashme e hadithit sipas kriterit që ka zbatuar

---

---

Buhariu për besueshmërinë e haditheve. Një veprim të tillë nuk e kemi parë të arsyeshëm për ta përfillur në punën tonë, pavarësisht nga përsëritja e shpeshtë e emrave të transmetuesve të haditheve.

Lexuesi shqiptar në Sahihu-l-Buhari, në librat: 1, 2, 3, 4 etj. do të vërejë ndonjë laramani metodologjike që është rriedhojë e dy faktorëve. Njëri është faki se secili nga përkthyesit ka stilin e vet të punës e të shprehurit. Madje edhe në zgjedhjen e komentimit bashkëpunorët kanë qenë të pavarur të vendosin personalisht, kurse në tekstin e haditheve të gjithë janë obliguar të respektojnë me besnikëri senedin dhe metnin në bazë të Buhariat, me numrim të Ibn Haxher al-Askalaniut.

Faktori i dytë është si rrjedhojë e kushteve objektive në të cilat kanë punuar arsimtarët e Degës së orientalistikës gjatë kësaj periudhe. Në mungesë të hapësirës për punë kaq serioze, siç është projekti në përkthimin e koleksionit të Buhariut, fillimisht në tetë vëllime, me 3000 faqe, realizuesit e këtij projekti nuk kanë pasë mundësi të konsultohen për të gjitha çështiet që kërkonin harmonizim gjatë punës njëvjeçare. Kemi qenë të shtrënguar që çështjet konkrete të përpiqemi t'i harmonizojmë në biseda të improvizuara në vend jo të përshtatshëm për këtë qëllim. Kjo gjendje ka qenë e kushtëzuar sa nga rrethanat e përgjithsme të vështira që përjetojnë punonjësit shkencorë, aq edhe nga fakti se, All-llahu xh.sh. ka krijuar edhe aso njerëz që kanë mundësi të afrojnë kushte më të mira për punë, por u mungon kapitali shpirtëror.

Megjithatë, çka do All-llahu xh.sh. bëhet, dhe vetëm Ai është i denjë për adhurim. I dërguari i Tij, Muhammedi a.s. meriton çdo respekt, kurse për punën e bërë deri tash kanë të drejtë dhe detyrë, të gjithë ata që dinë, të marrin pjesë në evitimin e gabimeve të mundshme për botimet e ardhshme.

---

Endjej si obligim por edhe nderë e kënaqësi që posaçërisht kolegëve të Degës së orientalistikës, edhe bashkëpunëtorëve të tjerë t' u shpreh falënderim e mirënjohje të sinqertë për angazhimin e tyre të pakursyer që kjo punë të kryhet me faqe të bardhë. U shpreh mirënjohje të sinqertë të gjithë atyre që kanë kontribuar në mirëvajtjen dhe efikasitetin e reulizimit të këtij projekti, si dhe redaktorët profesionalë, redaktorët gjuhësorë, korrektorët, realizuesit teknikë dhe të gjithë ië njerëve të cilët kanë marrë pjesë dhe kanë kontribuar në çfarëdo mënyrë qoftë

**All-llahu i shpërblef të gjithë si di Ai  
Ndihamo Zot që puna të vazhdojë deri në fund**

**Prishtinë, dhjetor 1999**

**Ramazan, 1420**

**Feti Mehdiu**



---

---

## LITERATURA

Al-Muntehab fi tefsîri-I-Kurani-l-Karîm, at-tabatu-l-hâmise,  
al Kahire,

1975. (Lexhnetu-l-Kur'an vessunneti).

*Al-Mu'xhemu-l-ves, ^t, 1, 2, Daru-l-Meanf bi Misr, 1972*  
(1392 h.).

*Arabsto - ruskii slovar, Moskva, 1962, Sastavil prof. H.K.*  
Baranov.

Dr. Ahmed Shelehi, *Tarihu-t-teshri il-islâmî ve*  
*târihinnadhmi-l-kadijjeti*

*fi-l-islâm, al-Kahire, 1976.*

Fet-hu-l-Bâri, bisherhi Sah~hi-l-Buhâri, *al-xhuz'urrabi, al-*  
*xhuzu-l*

*hamis, "Dâru-l-ma'rife" Bejrut, s.a.*

*Fjalor serbokroatisht-shqip (grup autorësh IAP) Prishtinë,*  
1986.

Fjalor i gjuhës shqipe, Tiranë, 1954 (Rilindia, Prishtinë, 1965).

Islam. Ansiklopedisi, 2. cilt, Istanbul, 1961.

Un Hisham, assîretunnehevijje, 1-4, Al-Kahire, 1974.

Kur'an-i dhe hija e tij *shqip*, përktheu Feti Mehdiu, Shkup-  
Stamboll,

1 999.

Kitabu rijadi-s-salihîn min kelâmi Sejjidi-l-murselîn, el-Kahire  
(Mektehetu-l-g jumbûri j jeti-l-arabi j jeti) s.a .

*Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1, 2, Prishtinë, 1981 .*

Nerkez Smailiagic, *LeLsiFon Islamo, Sara jevo, 1990 (I.K.*  
"Svietiost").

Sahihu-Ebi Abdil-lah al-Buhâri, ol-xhuz'uththalithu,  
"Mektebetu-l

Gjumbûrij jeti-l-aralaijjeti" Al-Kahire, s.a.

*Sahih-i Buhâri muhtasari Tecrid-i Sarih tercemesi ve Serhi,*  
dordunu

## ***Sahihu- l-Buhari***

---

cilt, (sekizinci baski) Ankara, 1985, Mutercimi ve Sarihi Kâmil Miras.

*Sabibul-Buhari, Buharijina zbirka hadisa, treca knliga,* Prijedor, 1975,

prijevod i komentar Hasan Skapur.

Teulik *Muftic*, Arapsko-sprstobrvatski rjecnik, 1-2, Sarajavo, 1973

(Udruzenie limije u SRBiH - Sarajevo.

*Tefsîru-l-Xhelâlein biRamishi-l-Kur'ani-l-Kerîm*, Bejrut, 1987 (1407 h.)

(Kaddeme lehu Shejh Abdulkadr al-Arnaut).

---

---

## Permbajtja

Puna me mëditje e njeriut te mire dhe fjalët e Allahut xh.sh. ....	8
Ruajtja e bagëtive në kararit .....	8
Punësimi i politeistit me mëditje, në rast nevoje dhe kur nuk ka musliman .....	9
Marrja e punëtorit me mëditje të kryejë punë pas tri ditësh pas një muaji os epas një viti lejohet dhe kushtet e vëna vlejné deri kur të kalojë .....	9
Angazhimi me mëditje në ekspeditë luftarake .....	10
Marrja me mëditje e punëtorit në kohë të caktuar pa e definuar punën si duhet sipas ajetit .....	11
Lejohet angazhimi i punëtorit me mëditje të ndreqë numrin që është duke u rrëzuar .....	12
Punëtori me mëditje për gjysëm dite .....	12
Punëtori me mëditje deri për në iqindi .....	13
Mëkati i atij që pengon pagesën e punëtorit .....	14

Mëditja e punëtorit prej iqindie deri në mbrëmje .....	14
Angazhimi i punëtorit me mëditje i cili heq dorë nga fitimi dhe kjo i mbetet punëdhënësit, e ai e shton këkë ose manipulon me pasuri të huaj dhe realizimi i tepricës nga kjo .....	15
Angazhimi me mëditje për të bartur barrë në shpinë dhe atë fitim për ta dhënë sadaka .....	17
Pagesa e ndërmjetësit në shitblerjen e sendeve të caktuara .....	17
A mund të punësohet muslimani te politeisti në shtetin joislam .....	18
Ç'ka paguhet për magji në fiset arabe duke kënduar suren fatiha .....	19
Tatimi për robin dhe tatimet e detyrueshme për robëreshat .....	21
Të ardhurat e atij që lëshon gjak .....	22
Ai që u tha zotërinjve të robit që t'ia lehtësojnë pak tatimin .....	22
Fitimi i prostitutës dhe robëreshës .....	23
Deveja për mbarësim .....	23
Toka me qira dhe vdekja e njëriës palë .....	24

---

---

**KREU 38. PAGESA E BORXHIT ..... 25**

Transferi i borheve, ushëzimi i kreditorit te tjetri;  
a mund të tërhiqet udhëzimi ..... 25

Nëse kreditori udhëzohet te pasaniku  
ai nuk ka të drejtë ta refuzojë ..... 26

Lejimi i transferit të borxhit nga i vdekuri te tjetri ..... 27

**KREU 39. GARANCI NE HUA ..... 28**

Garanca në hua dhe borxhe për persona të tjerë ..... 28

Fjalët e All-llahut xh.sh.: “Atyre me të cilët  
keni lidhur kontrata japnu pjesën e tyre” ..... 31

Ai që garanton për borxhin e të vdekurit  
nuk mund të tërhiqet nga garaca  
sipas rrëfimit të Hasanit ..... 33

Mbrijtja e Ebu Bekrit në kohën  
e Pejgamberit a.s. Dhe obligimi i tij ..... 34

Pasoja e borxhit ..... 36

**KREU 40. AUTORIZIMI I NDËRSJELLTË ..... 37**

Autorizimi i shoqi-shoqit për ndonjë gjë ..... 37

Muslimani lejohet të autorizojë jomuslimanin  
në shtetin josilam ose në shtetin islam ..... 38

Autorizim për ndërrim të parave .....	39
Është e lejuar që bariu ose i autorizuari të presë delen e cila po ngordh, ose diçka që prishet ta ndreq, kur është në rrezik të dëmtohet .....	39
Autorizimi për atë që është i pranishëm dhe atë që nuk është i pranishëm .....	41
Autorizimi për të paguar borxhet .....	41
Lejohet dhurata për përfaqësuesin e popullit ose ndërmjetësuesit të tij në bazë të deklaratës së Pejgamberit s.a.v.s. që i tha delegacionit të fisit hevazin, me rastin e kërkit të robërve .....	42
Lejohet autorizimi i dikujt të japë diçka pa i sqaruar se sa, ia jep sipas traditës së vendit .....	43
Autorizimi i udheheqësit nga ana e një gruaje për të lidhur kurorë - nikah .....	44
Lejohet që dikush të autorizojë një njeri e ky të lejë mangut diçka dhe autorizuesi këtë e lejon me vone, ose i autorizuari i jep hua ndokujt për një kohë të caktuar .....	45
Shitblerja e të autorizuarit refuzohet nëse ai shet në mënyrë të paligjshme .....	47
Autorizimi për vakaf dhe shpërndarjen e tij, a mundet i besueshmi të ushqejë mikun e vet, apo të ushqehet vetë sipas traditës .....	48

Autorizimi per dënim .....	49
Autorizimi per të shfrytëzuar devetë .....	49
Kur i thotë të autorizuarit: “Kryeje punën siç të ka urdhëruar All-llahu” e ai i përgjigjet “e mora vesh çka the” .....	50
Autorizim të besueshmit për të ruajtur arkën etj .....	51
<b>KREU 41. BUJQËSIA.</b> .....	51
Vlera e bujqësisë dhe pemtarisë .....	51
Punët gjate të cilave duhet ruajtur nga pasojat e mjeteve te bujqësisë dhe transporti i tyre në vende të caktuara .....	52
Përgatitja e qenit për lëvrim .....	53
Përdorimi e lopës .....	54
Kur dikush thotë: “Më ndihmo të punoj pemishten ose diçka tjetër dhe do te jesh pjesëmarrës (ortak) në frytet e tyre” .....	54
Prerja e trupave te pemeve .....	55
Punimi i tokës me përgjysmë ose të ngjashme .....	56
Punimi i tokës me qesim pa kushtëzuar se sa vjet .....	57
Punimi i tokës me hebrenjtë .....	57

Kushtet që nuk janë të pëlqyeshme në punën e tokës me përgjysmë .....	57
Punimi i tokës me kapitalin e tjetërkujt pa lejen e tyre, por kanë fitim edhe ata .....	58
Vakafi i sahabëve te Pejgamberit a.s. dhe toka e haraxhëve, mbjellja dhe pulla .....	60
Ai që e ringjall (ripunon) tokën .....	60
Kur pronari i tokës thotë: “ Të unë je sa te ketë thëne All-llahu”, pa e përmendur afatin me çka të dy palët ishin të kënaqur .....	61
As-habët e ndihmonin njëri-tjetrin në punët e bujqesisë edhe pemtarisë .....	62
Qesimi i tokës me ari dhe argjend .....	64
Mbëltimi i pemeve .....	65
<b>KREU 42. UJËDHËNIA .....</b>	<b>66</b>
All-llahu xh.sh. thotë: .....	66
Lejimi që të japësh ujë për sadaka, dhuratë ose lënia e porosisë (amanet) qoftë pjeserisht ose tërësisht .....	67
Thënia: “Pronari i ujit ka përparësi te ujit deri kur të ngrihet” e mbeshtetur në deklaratën e Pejgamberit s.a.v.s.	

---

---

“Nuk ndalohet teprica e ujit” .....	68
Ai qe hap bunar ne pasuri te vet nuk paguan kompensim .....	69
Kontesti për bunar dhe vendimi perkatës .....	69
Gjynahi për mosdhenie uji .....	71
Ndalja e lumit .....	71
Pjesa e sipërme ujitet para të poshtmes .....	72
Pjesa e epërme vaditet deri në nyje .....	72
Shpërblimi për ujëdhënie .....	73
Mendimi se pronari i bunarit ose jauxhikut me ujë ka më shumë te drejtë për ujë .....	75
Toka pa pronar i takon All-llahut dhe Pejgamberit te tij .....	76
Dhënia ujë njerëzve dhe bagetive ne lumenj .....	77
Shitja e druve dhe barit .....	78
Normat për ndarjen e tokës .....	80
Devja milet te uji .....	80
E drejta për të kaluar në kopsht ose pemishte dhe e drejta në rend te uji .....	80

---

---

**KREU 43. HUAJA, KREDITI,  
LIKUDIMI I BORXHIT,  
KUFIZIMI DHE FALIMENTIMI ..... 82**

Ai që blen diçka me kredi e paratë nuk i ka,  
ose nuk i ka me vete ..... 82

Kush merr pasurine e tjereve me qëllim  
që t'i paguajë ose t'i zhdukë ..... 83

Pagesa e borxheve ..... 83

Deveja me qera ..... 85

Të kerkuarit e borxhit si ka hije ..... 85

A jepet deveja që është më e vjetër se  
ajo që është huazuar ..... 86

Pagesa e borxhit ne mënyrë të denjë ..... 86

Lejohet që borxhliu të insistojë të paguajë më pak  
se sa i kërkobet ose që ai t'ia falë ..... 87

Kur dikush. për pagesë të borxhit, lë tjetër send  
ose për hurma jepen hurma tjera. me takmin ..... 87

Lutja për lehtësim të borxhit ..... 88

Falja e xhenazes së borxhliut ..... 88

Zvarritja e likuidimit të broshit  
nga ana e të pasurit është dhunë ..... 89

---

Ai që të lyp borxhin ka të drejtën e fjalës .....	89
Nëse dikush e gjen pasurinë e vet te falimentuesi, te ai që ia ka dhënë ta shesë, hua ose ta ruajë, ai ka më se shumti të drejtë në këtë .....	90
Shtyrja e larjes së borxhit për nesor ose më vonë dhe këtë nuk e konsideron shtyrje të qëllimshme .....	90
Shitësi i pasurisë së falimentatorit- ose të atij që nuk paguan asgjë, dhe këtë ua shpërndan borxhlinjve ose ia jep atij që ta shpenzojë për vete .....	91
Të huazuarit dikujt diçka deri në afat të caktuar ose caktimin i afatit në rast shitblerje .....	91
Ndërmjetësimi për ulje të borxhit .....	91
Ndalimi i shkatërrimit te pasurisë së huaj në bazë të shpalljes së All-llahut .....	92
Si edhe kufizimi nga mashtrimi .....	93
Robi është ruajtës i pasurisë së zotëriut të vet dhe ai punon vetëm me pëlqimin e atij .....	93
<b>KREU 44. MOMARRËVESHJET .....</b>	<b>94</b>
Çka thuhet për sjelljen e palëve të kontestuara ndërmjet muslimanit dhe heurit .....	94
Ai që refuzon çështjen e mbrapshtanit dhe të mendjepakut (abnormalit)	

---

## **Sahihu- I-Buhari**

---

dhe gjykatësi nuk e vë në diskutim .....	96
Konfrontimi i palëve njerën kundër tjetrës .....	97
Përzënia e gjynahqarit dhe ngatërrestarit nga shtëpia pasi të merret vesh për ta .....	99
I autorizuari me porosi mund te shpreh mendimin e të vdekurit .....	99
Duhet sigurnar (mbrojtur) prej atij që ka rrezik .....	100
Lidhja dhe mbyllja në harem (Qabe) .....	100
Këmbëngulësia në Iypjen e borxhit .....	101
Të paguarit e borxhit .....	101
<b>KREU 45. SENDI .....</b>	<b>102</b>
Nëse pronari i sendit të gjetur e përshkruan saktësisht, ai do t' i dorëzohet atij. ....	102
Deveja e humbur .....	103
Delja e humbur .....	104
Nëse pronari i sendit të gjetur nuk gjendet edhe pas një viti ai send i takon gjetësit .....	105
Nëse gjen në det (ujë) dru kamxhik ose diçka të ngjashme merre .....	106

---

Gjetja e hurmës në rrugë .....	106
Si e lajmërojnë mekkasit sendin e gjetur .....	107
Kafsha e huaj nuk milet pa lejën e pronarit .....	108
Nëse pronari i sendit të gjetur vjen pas një viti, gjetësi do t'ia kthejë? Sepse ai send te ky ka venë vetëm për ta ruajtur .....	109
Ai që gjen e merr sendin e gjetur dhe nuk e lë të dëmtohet ose ta marrë ndokush që nuk është i denjë .....	109
Shpallja e sendit të gjetur pa ia dorëzuar organit-pushtetit .....	110
<b>KREU 46. DHUNA</b> .....	111
All-llahu xh.sh. thotë: .....	111
Dënimi për dhunë .....	112
Përkitazi me fjalën e All-llahut "Mallkimi i All-llahut qoftë mbi zullumqarëtmizorët" .....	113
Muslimani muslimanit nuk do t'i bëjë dhanë por as do t'ia falë. ....	114
Ndihmoi vëllait tënd kur bënë dhanë apo kur i bëhet atij dhouna .....	114
Ndihma për atë që i shkelet e drejta. ....	115

---

Kundërvënia zullumqarit në bazë të fjalëve të All-llahut ...	115
Të falësh të shtypurin në bazë të fjalëve të All-llahut .....	116
Dhuna është terr i ditës së gjykimit .....	116
Ruajtja dhe kuidesi nga mallkimi i atij të cilit i është bërë dhunë .....	116
Ushtrimi i dhunës ndaj dikujt që e fal .....	117
Falja e padrejtësisë që i bëhet individit .....	117
Falja, lejimi i ndonjë çështje dikuit pa e sqaruar hollësisht .....	118
Gjynahi për grabitjen e tokës se huaj .....	118
Nëse njerint i jepet leje- e ka hallall (të lejuar) .....	119
Fjalët e të lartmadhërishmit. All-llah: E ai është armik i perbetuar” (2: 204) .....	120
Gjynahi i atij që konteston diçka duke e ditur se nuk ka të drejte .....	120
Rrenacaku në kontest .....	121
Kompenzimi ndaj të demtuarit nese demtuesi ka pasuri .....	121
‘Tubimi nën hije .....	122
Fqinji nuk ka të drejte ta pengoje fqinjin të mbjellë peme afër rrethojës së tij .....	123

---

.Derdhja e verës alkoolit - nëpër rrugë.....	123
Oborret e shtëpive, vendosja nëpër to dhe ndenja nëper male .....	124
Bullarët afër rrugeve që nuk pengojnë .....	124
Heqja e pengesave nga rruga .....	125
Dhoma me kat, papafingo e ngritur(mansardat) nën catia dhe tjera .....	125
Lidhja e devesë per gurit ose per dere të xhamisë .....	130
Të qëndruarit gjatë kryerjes së nevojës së vogël ne plehërishte .....	130
Pastrimi i rruges nga sendet qe pengojnë njerëzit .....	130
Kur shtohen njerëzit e shpërndahen dhe kur dëshirojnë të ndërtojnë afër rrugës të lënë vendin e rrugës në gjerësi shtatë kutë (metra) .....	131
Marrja. plaçkitja, e sendeve pa lejen e pronarit .....	131
Thyerja e kryqit dhe mbytja e thiut .....	132
Të thyerit e eneve me alkool dhe grisja e calikëve me venë .....	132
Ai që lufton për pasurinë e vet .....	133
Thyerja e enës së huaj .....	133

---

Nese dikush shemb murin e tjetrit le t'ia ndërtojë njëlloj si e ka pasur .....	134
<b>KREU 47. BASHKIMI I MIETEVE .....</b>	<b>135</b>
Të shoqëruarit në ushqime shpenzime të udhëtimit dhe tesha .....	135
Dy pronarë te paurisë së përbashkët kanë të drejtë kërkese të ndërsjellë për zekatin .....	137
Ndarja - pjesëtimi i dhenve (kafshëve) .....	138
Të bashkuarit e hurmat pa leje te bashkëpronarit .....	139
Vleresimi i drejte i sendeve midis bashkëpronarëve .....	139
Ndarja me short dhe terheqlje të shigjetave .....	140
Të shoqëruarit e jetimit dhe trashëuesit (mirasxhinjtë) .....	141
Bashkëpronësia ne tokë dhe sende tjera .....	142
Nëse bashkëpronarët ndajnë shtëpinë ose diç tjetër nuk kanë të drejtë. në shfuqizim as të drejtë përparësie për blerje .....	143
Bashkëpronësia në ari, argjendi dhe në ato sende që lejohet këmbimi .....	144
Shoqërorizmit në bujqësin me jomuslimanin ne shtetin islam dhe jomuslimanin të cilit i është ofruar strehim - azil .....	144

---

Ndarja e bagëtisë dhe drejtësia në ndarje .....	144
Pjesëmarrja në ushqime dhe të tjera .....	144
Bashkëpronësia te rob	145
Bashkëpronësia në kurbane dhe deve dhe bashkangjitja tjetrit në kurban pasi që ai ta ketë nisur për në mekke .....	146
Barazimi i kafshëve - gjatë ndarjes - dhjete të imta me një lope .....	147
<b>KREU 48. PENGU</b> .....	148
Pengu garantifni ne prezence .....	148
Lënia peng e parzmores .....	148
Lënia peng e armës .....	149
Lënia peng e kafshëve që milen .....	149
Të garantuarit te hebrenjtë dhe të tjerët .....	150
Nëse garantuesi dhe i garantuari, nak pajtohen, detyra e prokuront është ta argumentojë kurse i akuzuan të betohet .....	151
<b>KREU 49. LIRIMI I ROBIT</b> .....	152
Lirimi i robit dhe rëndësia e lirimi .....	152

Cilin rob është më mirë të lirosh .....	152
Lirimi i robërve kur zihet dielli apo ndodh ndonjë fenomen tjetër .....	153
Lirimi i robit ose robërshes që e kanë dy pronarë .....	153
Lirimi i piesërishëm i robit .....	155
Gabimi dhe harresa në fjalën e robit, lëshimin e gruas dhe të ngjashme .....	156
Nëse dikush thotë për robin e vet: ai i takon All-llahut dhe ka ndërmend ta liroj të marrë dëshmitarë për ta liruar .....	156
Robëresha - nënë fëmijë .....	157
Shitja e robit që pronari i ka premtuar lirimin pas vdekjes së tij .....	158
Shitja ose kujdesi ndaj robit të liruar .....	159
Nëse zihet rob vëllai ose axha, a do të kompensohet (lirohet) nëse ai është politeist .....	159
Lirimi i politeistit .....	160
Ai që kishte rob nga arabët, dhe e liroi, e shiti, mbaiti marrëdhënie martesoren ose e ka liruar, por edhe pasardhësit i ka robëroar .....	160
Shpërblimi për edukim dhe arsimim të robërshës .....	163

---

Fjalët, deklaratat e Pejgamberit a.s .....	163
Robi që i lutet All-llahut si e meriton dhe zotriut të vet sinqerisht mirë i mendon .....	164
Urrejtja e prolongimit të lirimit të robit dhe fjalët: “... Robi im robëresha ime” .....	165
Kur shërbëtori sjell ushqim .....	167
Robi është roje e pasurisë së zotëriut të vet .....	167
Nëse rriheni ruajeni fytyrën (shmangini të mëshuarit në fytyrë) .....	168
<b>KREU 50. KONTRAKTIMI I ROBIT .....</b>	<b>168</b>
Robi i kontraktuar, gjynahi i atij që qorton robin e vet, kistet e kontraktuara vjetore dhe fjalët e All-llahut .....	168
Kushtet që lejohen në kontraktimin e kompenzimit të robit .....	170
Robi i kontraktuar mund të kërkojë ndihmë materiale edhe nga të tjeret. ....	171
Shitja e robit të kontraktuar nëse edhe ai është i kënaqur .....	172
Nëse robi i kontraktuar i thotë dikuj: “më blejë dhe më liro” dhe ky për këtë shkak e blen (kompeusoln) .....	172

<b>KREU 51. DHURATA, RËNDËSIA DHE NXITIA PËR TË DHËNË DHURATA .....</b>	<b>173</b>
Dhurata, rëndësia dhe nxitia për të dhënë dhurata .....	173
Dhurata e vogël .....	174
Ai që kërkon dhuratë nga shokët e vet .....	174
Të kërkuarit ujë për pije .....	176
Pranimi i gjahut si dhuratë .....	176
Pranimi i dhuratës .....	177
Dhurata për shokun dhe përpjekja më e theksuar për disa bashkëshortë se sa për disa tjera .....	179
Dhurata që nuk rrefuzohet .....	181
Ai që konsideronte se dhurata i lejohet edhe atij që nuk është i pranishëm .....	182
Kompezimi për dhuratë .....	182
Dhurata fëmijës .....	182
Të dëshmuarit në dhuratë .....	184
Dhurata e ndërsejlltë basllkëshortëve (burri gruas dhe e kundërta) .....	185
Gruaja mund të japë dhuratë pa lejen e burrit si edhe të lirojë robin, edhe pse e ka burrin,	

---

---

me kusht që të jetë normale (jo e marrë) .....	186
Prej ku fillon me dhuratë .....	187
Kush nuk dëshiron të pranojë dhuratën per ndonje arsye .....	188
Nëse dikush dhuron ose vetëm e premtton dhuratën dhe vdes para se ta relaizojë ate premtim .....	189
Mënyra e pranim-dorëzimit të teshave e gjësendeve tjera .....	190
Kur i dhuron dikujt dicka e ai e pranon pa thënë “e pranova,” .....	190
Kur dikush ia fal borxhin e vet borxhliut .....	191
Dhurata e individit për grupin .....	192
Dhurata e pranuar dhe e papranuar e shënuar dhe e pashënuar .....	192
Kur një grup i dhuron popullit .....	194
T’i japësh dhurate dikujt derisa është në shoqëri me dikënd .....	195
Lejohet t’ia dhurosh deven njeriut i cili është duke kalëruar .....	196
Dhurata që është e papëlqyeshme ta veshësh .....	196
Pranimi i dhuratës nga politeisti .....	197

---

---

Dhurata politeistëve .....	199
Askujt nuk i lejohet ta tërheqë dhuratën dhe sadakan .....	200
Dhurata në shfrytëzim të përjetshëm dhe dhurata në përdorim të përjetshëm. me kusht që pasuria të jetë prone e të gjallit .....	202
Marria e kalit hua .....	203
Ti japësh hua nuses (vajzës së re) per t' u zbukuruar në dasmë .....	203
Rëndësia e dhuratave .....	203
Shprehja “Po të jap këtë vajzë të shërbej” si traditë që është bërë. lejohet .....	206
Dhurimi i kalit luftëtarit .....	206
<b>KREU 52 DËSHMIA</b> .....	207
Dëshmia i takon prokurorit paditësit .....	207
Kur dikush verifikon drejtësinë e dikujt përmes ndonjërit që i përgjigjet .....	208
Dëshmia e individit që e fsheh plotësisht dëshminë .....	208
Kur dëshmojnë një a më tëper dëshmitarë e të tjerë thonë: ne nuk e dimë këtë vendoset sipas deklaratës .....	210
Drejtësia e dëshmitarëve .....	211

---

---

Sa dëshitarë duhet të që të konstatohet korrektësia e dikujt .....	212
Dëshmia e farefisnisë, e njohur si gjidhënie vdekja e moçme e dikujt dhe konfirmimi i saj .....	213
Dëshmia e shpifësit, vjedhësit, dhe lavirit .....	215
Dëshmitari nuk do të dëshmojë padrejtësisht .....	217
Ç'ka thuhet për të dëshminë e rrejshme .....	218
Dëshmia e të verberit vlefshmëria juridike, martesë e tij dhe a mund të martojë tjetërkënd, shitblerja e tij dhe a mund të këndojë ezanin dhe të tjera si ikamet, të bëhet imam etj. ....	219
Dëshmia e grave .....	221
Dëshmia e robëreshës dhe robërve .....	222
Dëshmia e mëndeshës .....	223
Verifikimi i vlefshmërisë së disa grave me anë të tjerave ..	223
Është e mjaftueshme që paaftësinë e njeriut ta verifikojë vetëm një individ .....	230
Nuk është e pëlqyeshme ta lavdërosh ndokënd për tepër; le ti thotë vetëm atë çka di për një njeri .....	230
Pjekuria e fëmijëve dhe dëshmia e tyre .....	231

---

Pyetja e gjykatësit për prokurorin përpara betimit: “a ke argument?” .....	232
Betimi i përket të paditurit në sendet fiziko-penale .....	233
Nëse dikush vërteton diçka ose përgenjshtron duhet t’i lypet argument dhe të paraqesë argumentin e kërkuar .....	235
Betimi pas iqindisë .....	235
I akuzuari betohet menjëherë sapo t’i kërkohet dhe nuk shkon nga njëri vend ne tjetrin .....	236
Kur njerëzit shpejtojnë në betim .....	236
Fjalët e të lartmadhërishmit All-llah .....	236
Si bëhet betimi .....	237
Sjellja e argumentit pas betimit (të paditurit) . .....	238
Kush ka urdheruar zbatimin e premtimit .....	239
Politesiti nuk do të merret për dëshmitar apo diçka tjetër .....	240
Tërheqja e shortit në raste problematike dhe fjala e All-llahut .....	242

---

---

**KREU 53. PAJTIMI ..... 245**

Pajtimi (të pajtuarit ndërmjet njerëzve) ..... 246

Dalja e kryefamiljarit me shokë të vet  
në vendin e ngjarjes të pajtojë njerëzit ..... 246

Nuk është rrenacak kush pajton njerëz ..... 247

Urdhëri i kryeplakut shokëve të vet:  
ejani me ne t'i pajtojmë ..... 248

Nëse palët bien vendim jo të drejtë ajo marrëveshje  
nuk është e vlefshme ..... 249

Si shkruhet marrëveshja për një çështje konkrete, me filan filanin,  
pa e theksuar përkatësinë e fisit e të gjinisë ..... 251

Marrëveshja e paqës me politielstët ..... 253

Ujdijsa - marrëveshja - për larje të gjakut ..... 254

Deklarata e Pejgamberit a.s.  
Në dobi të hasan b. Aliut r.a. .... 255

A do të japë shenjë për pajtim kuidestari - imami ..... 256

Rëndësia e pajtimit të njerëve  
dhe vlera e drejtësisë ndërmjet tyre ..... 257

Nëse kujdestari jep shenjë për marrëveshje,  
kurse pala e refuzon, vendimi i shqiptohet  
me gjykim të drejtë ..... 258

Marrëveshja kuturu e borxhliut dhe trashëgimtarit ..... 259

Marrëveshja për borxhin dhe gjëra tjera ..... 260

**KREU 54. KUSHTËZIMET ..... 261**

Paragitja e kushteve për te pranuar fenë islame,  
dhe marrja e vendimit për betim ..... 261

Shtija e pemëve me fryte ..... 264

Kushtet në shitblerje ..... 264

Lejohet që shitësi i kalorsisë të kushtëzojë kalërimin  
e asaj kafshe deri në një vend të caktuar ..... 265

Kushtet në afarizmin e ndërsjellë ..... 266

Kushtet në dhuratën e martesës  
gjatë lidhjes së kurorës ..... 267

Kushtëzimi në bujqësi ..... 268

Ç'ka nuk lejohet gjatë lidhjes së kurorës (nikabit) ..... 268

Kushtëzimi i palejuar në dënime ..... 268

Kushtet që nuk lejohen për robin që është  
kontraktuar të shpaguhet kur ai është i pajtimit  
të lirohet me shitblerje ..... 269

Kushtet në rast shkurorezimi ..... 270

---

Kushtet gjatë bisedimeve me njerëzit .....	271
Kushtet në tutori (patronat) .....	272
Kur veheet kushti në marrëveshje për punim të tokës që ta largojë kur dëshiron pronari i tokës .....	272
Kushtet në luftë dhe në marrëveshje me banorët e shtetit joislam si edhe të shkruarit e atyre kushteve. ....	273
Kushtet në rastin e huas .....	282
Robi i liruar me marrëveshje për kompensim dhe kushtet që nuk lejohen ngase janë në kundërshtim me librin e All-llahut .....	283
Ç'ka Është e lejuar të kushtëzohet në shprehur dhe kushtet që janë të rëndomta ndër njerëzit dhe kur dikush thotë “një qind pa një” (nëntëdhjetë e nëntë për qind) .....	284
Kushtet gjatë lënies vakëf .....	284



